

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

9

Prishtinë, gusht 2002

MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

Për klasën IX orientuese

Prishtinë, gusht 2002

Redaktorë:
Isuf Zeneli
Ramush Lekaj
Bajram Shatri

Lektor
Ali Llunji

Georg-Eckert-Institut
für Internationale
Schulbuchforschung
Braunschweig
Schulbuchbibliothek

Ballinën e punoi
Bajram Bardhi, pik. akad.

2002/3257

Redaktor teknik
Nijazi Hashani

YU
2-7
(1,2002)



Institucionet Kalimtare të Vetëqeverisjes
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë

Udhëzim administrativ mbi Planin dhe programin mësimor për klasën e nëntë orientuese

Numër: MASHT 09 / 2002

Datë: 15 gusht, 2002

Ne përputhje me Rregulloren nr. 2001/19 të dt. 13 shtator 2001, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 42.2 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm (në pritje të shpalljes) Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1 Qëllimi

- 1.1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përfshirja e planit dhe programit mësimor për klasën e nëntë (9) orientuese si rezultat i ristrukturimit të sistemit në arsimin fillor dhe të mesëm.

Neni 2 Plani dhe programi

- 1.2. Plani dhe programi mësimor për klasën e nëntë i është bashkangjitur Udhëzimit Administrativ.

Neni 3 Zbatueshmëria

- 3.1. Plani dhe programi mësimor hyn në fuqi në vitin shkollor 2002/2003.

- 3.2. Me zbatimin e planit dhe programit të klasës së nëntë (9) orientuese shfuqizohen planet dhe programet e deritanishme të klasës së parë të arsimit të mesëm.

Neni 4


Përfundim

- 4.1. Plani dhe programi mësimor për klasën e nëntë (9) orientuese për shkollat me mësim në gjuhën serbe do të zbatohet në vitin shkollor 2003/2004.

Neni 5

Hyrja në fuqi

- 5.1. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi më 15 gusht 2002



Mr. Rexhep Osmani, ministër

Përmbajtja

Udhëzimi administrativ 3

- I. Hyrje 7
- II. Qëllimi 8
- III. Objektivat e përgjithshme 10
- IV. Vlerësimi 11
- V. Udhëzime metodologjike 13
- VI. Burimet dhe mjetet mësimore 13
- VII. Plani mësimor i lëndës 14
 1. Gjuhët dhe komunikimi 15
 - 1.1. Gjuhë shqipe dhe letërsi 17
 - 1.2. Gjuhë angleze 31
 2. Matematika dhe Teknologji e informimit dhe komunikimit
 - 2.1. Matematikë 45
 - 2.2. Informatikë 57
 3. Shkencat natyrore
 - 3.1. Biologji 67
 - 3.2. Kimi 77
 - 3.3. Fizikë 87
 - 3.4. Gjeografi 101
 4. Studimet shoqërore
 - 4.1. Histori 117
 - 4.2. Edukatë qytetare 139
 5. Artet
 - 5.1. Edukatë muzikore 151
 - 5.2. Edukatë figurative 161
 6. Edukata fizike dhe sportet
 - 6.1. Edukatë fizike dhe sporti 169
 7. Fillet e ekonomisë dhe drejtësisë 179
 8. Bazat e teknikës 197
- VIII. Udhëzime për zbatimin e Planit dhe programit 221

I. HYRJE

Arsimi në çdo kohë ka përfaqësuar dhe sot përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të vendeve të ndryshme e gjithashtu edhe të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, tash Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare, MASHT synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe programit lëndor pushon mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtimi i rezultateve të të nxëniet, mjetet mësimore, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Parimet kryesore të punës së grupeve profesionale ishin:

- Përfshirja e balancuar e lëndës;
- Ndërlidhja e brendshme dhe e jashtme e lëndës;
- Nxitja e zhvillimit të aftësive në nxënie;
- Inkurajimi i nxënësve në punë dhe në hulumtime të pavarura;
- Zbatueshmëria e shkathtësive në jetën e përditshme.

Në Planin dhe programin mësimor të klasës së nëntë janë përfshirë këto fusha mësimore:

- Gjuhët;
- Matematika dhe TIK;
- Shkencat natyrore;
- Shkencat shoqërore;
- Artet;
- Edukata fizike dhe sportet;
- Fusha e lëndëve shoqërore;
- Fusha e lëndëve teknike.

Në kuadër të secilës fushë mësimore, përfshihen lëndët përkatëse mësimore në vartësi nga qëllimi dhe objektivat që e ndihmojnë zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të nxënësit.

Me qëllim që secila prej fushave dhe lëndëve mësimore të shprehin ndikimin dhe veprimin e tyre në ndërtimin e personalitetit të gjithanshëm të nxënësit, janë marrë parasysh përmbajtjet programore të lëndëve që duhet të kenë qasje ndër-lëndore dhe t'u përshtaten moshës së nxënësve.

Fillimi i zhvillimit të Planit dhe programit mësimor për klasën e nëntë (9) mund të jetë i paqartë për shumë mësimdhënës dhe hulumtues arsimorë, por në bazë të dinamikës së zhvillimeve aktuale të reformës dhe funksionit që ka klasa e nëntë (9), ishte pika më e mundshme për ta arritur në vitin e ardhshëm shkollor 2002/03 dhe pa e penguar procesin e zhvillimit të Planit dhe programit kombëtar për klasët e tjera sipas strukturës së sistemit të arsimit në të ardhmen (shih skemën në faqen 9)

Grupet punuese arritën ta finalizojnë verzionin përfundimtar të këtij dokumenti sipas dinamikës së paraparë, kurse pjesa tjetër shumë e rëndësishme e punës mbetet për t'u përmbushur nga ana e mësimdhënësve, të cilëve edhe u kushtohet ky Plan dhe program. Për ta lehtësuar zbatimin e këtij Plani dhe programi mësimor, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë do të organizojë kohë pas kohe cikle ligjeratash me mësimdhënës të udhëhequr nga ekspertë fushash përkatëse me një udhëzim shtojcë e këtij Plani dhe programi.

II. QËLLIMET

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë me qëllim realizimi të vizionit të saj në procesin e ndërtimit të një shkolle bashkëkohore, përpiloi këtë dokument i cili të gjithë mësimdhënësve të klasës së nëntë do t'i u shërbejë udhëzues profesional për çështjet më thelbësore të procesit të mësimhënies dhe të mësimnxënies, si për objektivat e përgjithshme e specifike, përmbajtjen programore, udhëzimet metodologjike, burimet dhe mjetet mësimore, rezultatet e pritura dhe vlerësimin.


Plani dhe programi lëndor për klasën e nëntë (9) ka për qëllim:

- Vazhdimin e ndërtimit të vlerave shpirtërore të nxënësit dhe
- Konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e të ardhmes së tyre.

Plani dhe programi mësimor gjithashtu nxënësit i siguron mundësinë:

- Të zhvillojë dhe thellojë njohuritë e tij të përgjithshme dhe të veçanta me interes tërëjetësor;
- Të rishqyrtojë dhe vlerësojë pikëpamjet e tij për dukuritë dhe fenomenet që e rrethojnë;
- Të gjykojë për rëndësinë e shkathtësive të fituara në fund të shkollimit të obliguar;
- Të zbatojë aftësitë dhe shkathtësitë e arritura në situata konkrete për t'i përballuar vështirësitë e ndryshme në jetën e përditshme.

STRUKTURA E SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË



III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Për të jetësuar qëllimet e këtij Plani dhe programi nevojiten shumë rezultate të të nxëniet që mund të jenë të shkallës së përgjithshme dhe specifike. Gjithë herë vendosen paraprakisht rezultatet e përgjithshme të të nxëniet, të cilat duhet të jenë të shkallës së nevojshme të së përgjithshmes dhe të dallohen qartë në aspektin e shkallës së ndërlikueshmërisë apo tërësisë që synojmë të arrihet.

Në bazë të qëllimit të Plani dhe programit mësimor të klasës së nëntë (9) MASHT synon që në fund të vitit mësimor nxënësi t'i arrijë këto objektiva të përgjithshme:

A. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Të jetë kritik ndaj lëndës;
- Të jetë i hapur;
- Të jetë tolerant;
- Të gëzojë respekt;
- Të jetë i vullnetshëm.

B. Të njohë

- Fjalorin (terminologjinë);
- Faktet;
- Konceptet;
- Parimet;
- Procedurat dhe metodat.

C. Të kuptojë

- Faktet dhe parimet (të zbatojë në situata të thjeshta);
- Përmbajtjen e materialeve;
- Relacionin shkak-efekt;
- Arsyetimin e metodave dhe të procedurave.

Ç. Të zbatojë në situata të reja

- Faktet dhe parimet.
- Procedurat dhe metodat;
- Zgjidhjen e problemeve .

D. Të analizojë

- Zbërthimin e informatave;
- Krahasimin e fakteve;
- Marrëdhënien ndërmjet shkakut dhe efektit;
- Raportin e ngjarjeve në një tekst.

DH. Të sintetizojë (të menduarit kritik- kompleks)

- Njohjen e informatës relevante dhe jo relevante;
- Dallimin ndërmjet faktit dhe mendimit;
- Zbatimin e parimeve në zgjidhjen e problemeve;

- Interpretimin e materialit ilustrues;
- Njohjen e supozimeve.

Për të vlerësuar arritjen e këtyre objektivave duhet të zhvillojmë procedura dhe mjete adekuate të matjes (shih vlerësimi).

IV. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzuese. Ai duhet të mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e pritura) të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore siç janë:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të të cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

IV. 1. Instrumentet e vlerësimit

Është shumë me rëndësi që për veçoritë që duam t'ia vlerësojmë, të përdorim mjetin apo instrumentin adekuat të matjes. Me çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësit, andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundshme mjete dhe teknika të ndryshme në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësit.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetësori (vetëvlerësimi);
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe objektiva;

- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje) me:
 - përgjigje alternative të shumta;
 - përgjigje të hapuar të shkurtra;
 - përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësuesi e vlerëson të nevojshëm

Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me anën e të cilave përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësues për klasën e nëntë (9).

IV. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësues, çdo nxënës duhet të arrijë një rëndësi prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- Shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- Shumëmirë (arritje e lartë);
- Mirë (arritje mesatare);
- Mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- Pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë (shiko tabelën më poshtë) të cilat bazohen në:

Objektivat e përgjithshme	Arritje shumë e lartë 90%	Arritje e lartë 80%	Arritje e kënaqshme 60%	Arritje e kufizuar 40%	Arritje e pamjaftueshme
<i>Njohja e lëndës</i>	Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.
<i>Të kuptuarit e proceseve shkencore</i>	Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak efekt, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak efekt, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak efekt, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore	Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore
<i>Të menduarit kritik</i>	Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: Njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: Njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse si: Njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.		
<i>Shkathësitë manovruese</i>	Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathësitë manovruese			Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathësitë manovruese	

V. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Zbatimi i një metode (p.sh. deduktive) nuk do të thotë përjashtim i një metode tjetër (p.sh. asaj induktive). Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme nga se nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimnxënies. Prandaj gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me qëllim të arrihen rezultate optimale gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- Shpjegimi dhe sqarimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Të mësuarit problemor;
- Diskutimi (debati);
- Puna në grupe;
- Demonstrimi dhe interpretimi;
- Teknika e të menduarit kritik;
- Shtrim idesh (brainstorming);
- Vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjejn zbatim edhe ligjërata interaktive e kombinuar me aktivitete praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses mësimi në natyrë, eskursione të ndryshme studimore, vizita institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet, zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

VI. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij Plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri më tash burimi kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse. Për çastin mungon një tekst i vetëm adekuat për lëndën përkatëse, por mësimdhënësit dhe nxënësit kanë mundësi të shfrytëzojnë tekste të ndryshme nga klasat paraprake dhe vijuese për lëndën përkatëse si dhe materiale tjera plotësuese me qëllim sigurimi të një baze shkencore për dituritë dhe përvojën e fituar.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- Doracakë, atlase, broshura;
- Gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- Fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- Modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- Programe të kopjuterëve, interneti, CD etj.

Është kompetencë e arsimtarit që në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuele, auditive dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

VII. PLANI MËSIMOR I LËNDËS

Nr.	Lëndët mësimore	Numri i orëve	Përqindja
1.	Gjuhë shqipe dhe letërsi	140	13.33
2.	Gjuhë angleze	105	10.00
3.	Matematikë	140	13.33
4.	Informatikë	105	6.67
5.	Biologji	35	3.33
6.	Kimi	35	3.33
7.	Fizikë	35	3.33
8.	Gjeografi	35	3.33
9.	Histori	70	6.67
10.	Edukatë qytetare	35	3.33
11.	Edukatë muzikore	35	3.33
12.	Edukatë figurative	35	3.33
13.	Edukatë fizike dhe sportet	70	6.67
14.	Fillet e ekonomisë dhe drejtësisë	105	10.00
15.	Bazat e teknikës	105	10.00
	Gjithsej	1050	100.0

*Gjuhë shqipe
dhe letërsi*

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

4 orë në javë, 140 orë në vit

HYRJE

Lënda e gjuhës amtare në klasën e nëntë ka për qëllim të verifikojë, të riorganizojë, të përgjithësojë dhe të sintetizojë tërësinë e njohurive të përveçsuara nga klasa e dytë deri në të tetën. Është, pra, një përgjithësim e thellim i atyre njohurive dhe praktikave gjuhësore, po, sigurisht, të riorganizuara në përputhje me perspektivat e zhvillimit të këtyre njohurive dhe praktikave gjuhësore në klasat e shkollës së mesme.

Për këtë arsye, në kurrikulën e klasës së nëntë orientuese të shkollës së mesme, do të parashikohen njohuri për formimin e shprehive të përdorimit të shqipes standarde me gojë dhe me shkrim, njohuri për sistemin gjuhësor dhe për drejtshkrimin dhe pikësimin.

Do t'u jepen vend gjithashtu njohurive për gjuhën në përgjithësi dhe për gjuhën shqipe në veçanti, njohuri për variantet e saj territoriale dhe sociale, për kulturën e gjuhës etj. Gjuhës së shkruar, formave të shumta të ekzistencës dhe të përdorimit të saj në kohën e sotme, do t'u kushtohet vëmendje e veçantë, përmes temave që lidhen me formimin e shprehive të komunikimit me shkrim.

Leximi letrar duhet të jetë rezervë e rëndësishme, me qëllim të konkretizohen dhe të thellohen njohuritë dhe shprehitë e fituara në lëndën e gjuhës shqipe.

Letërsia dhe mësimi i saj në shkollë është njëra ndër fushat më të gjithanshme e më ndikuese në zhvillimin mendor, në formimin shpirtëror dhe edukimin letrar dhe estetik të personalitetit të njeriut.

Mësimi i letërsisë në klasën e nëntë orientuese është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprahe, është thellim i leximit, njohjes dhe sintetizim i dijes themelore për letërsinë në kuptimin e saj teorik, letrar, estetik dhe gjuhësor.

Struktura e programit të letërsisë, për klasën e nëntë, është ndërtuar mbi bazën e vlerave letrare, gjinore, kohore dhe hapësinore. Pjesa më e madhe e shtrirjes së programit i takon letërsisë shqipe, pastaj letërsisë botërore, më pak teorisë së letërsisë dhe letërsisë gojore.

Koncepti i programit të letërsisë për klasën e nëntë mbështetet:

- Në programin dhe në tekstet e letërsisë që aktualisht përdoren në shkollën fillore;
- Në programin dhe në tekstet e letërsisë që aktualisht përdoren në vitin e parë të shkollës së mesme;

- Në përvetësimin, në njohjen dhe në dijen themelore për këtë fushë si mundësi e përfundimit të mësimin të letërsisë në shkollë;
- Në mënyrën e tillë të konceptimit ku leximi, njohja dhe dija për letërsinë janë në funksion të vazhdimin të shkollimit të mesëm dhe atij të lartë;
- Në përputhje me moshën, me aftësitë psikike dhe mundësitë receptuese për letërsinë;
- Në lidhjen ndërlëndore me gjuhën si mjet thelbësor i krijimit letrar.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Objektiv kryesor në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë në nivelin e kërkesave të sotme është të rritë, zotërimin aktiv të gjuhës amtare nga brezi i ri, si edhe t'i pajisë ata me njohuritë teorike bazë për sistemin e gjuhës standarde, në veçanti, dhe për gjuhën shqipe, në përgjithësi.

Lënda e gjuhës amtare në klasën e nëntë orientuese do të ketë katër linja kryesore. Dhe këto janë: një për zgjerimin dhe thellimin e shprehive të përdorimit të gjuhës së folur, një për zgjerimin e thellimin e shprehive të përdorimit të gjuhës së shkruar, një për veçoritë e sistemit gjuhësor të shqipes standarde dhe një për njohuritë dhe shprehitë e përdorimit korrekt të normave drejtshkrimore dhe të shenjave të pikësimin.

Rëndësia, pesha dhe domosdoshmëria e mësimin të letërsisë në shkollë, përkatësisht në klasën e nëntë orientuese, pasqyrohet nëpërmjet këtyre objektivave të përgjithshme:

- Zhvillimit dhe forcimit të qëndrimit pozitiv për letërsinë dhe për gjuhën si fundament i saj;
- Krijimit të kulturës së leximit dhe zhvillimit të aftësive receptuese për letërsinë;
- Zgjerimit dhe përvetësimit të letërsisë si njohje dhe si dije themelore teorike, letrare, estetike dhe gjuhësore;
- Zgjerimit të dijes për autorë dhe vepra të përhershme letrare kombëtare dhe botërore;
- Zhvillimit të të menduarit kritik, gjykimin, argumentimit dhe vlerësimit autonom për fenomene, procese, autorë dhe vepra letrare;
- Formimit letrar dhe gjuhësor dhe provave për shkrime joletrare, gjysmëletrare, letrare, të imagjinuara dhe atyre profesionale;
- Zgjerimit të njohurive letrare dhe njohja e potencialit të gjuhës si mjet me të cilin krijohen veprat letrare, pafundësia e figurshmërisë së saj;
- Zgjerimit të dijes letrare dhe horizonti i saj ndikues në formimin e botës kulturore, artistike, shpirtërore dhe qytetare të nxënësit ;
- Zhvillimit dhe zgjerimit të dijes në sferën njohëse, emocionale dhe artistike dhe identifikimi i vlerave me lidhje ndërlëndore e lëndore: gjuhë, muzikë, pikturë, film, teatër, media etj.

STRUKTURA E LËNDËS

Gjuha shqipe dhe letërsia si lëndë mësimore edhe në klasën e nëntë (9) orientuese ruan lidhjen strukturore e ndërstrukturore paraprake.

Ruajtja dhe vazhdimësia e strukturës paraprake është në funksion dhe në përputhje me perspektivat e zhvillimit të pjesëve përbërse dhe të veçanta në drejtim zgjerimi e thellimi të njohurive në klasat e shkollës së mesme.

Mbështetur në lidhjen ndër-lëndore paraprake dhe funksionimi praktik, programi i kësaj lënde mësimore është ndërtuar mbi bazën e dy tërësive të mëdha strukturore:

- STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE: 88 orë
- STRUKTURA E PROGRAMIT TË LETËRSISË: 60 orë

STRUKTURA E PROGRAMIT TË GJUHËS SHQIPE

Strukturën e programit të gjuhës shqipe e përbëjnë:

- I. TËRËSITË TEMATIKE
- II. ZBËRTHIMI I TËRËSIVE TEMATIKE
- III. QËLLIMI
- IV. LITERATURA

I. TËRËSITË TEMATIKE

Në programin e gjuhës shqipe për klasën e nëntë (9) orientuese janë paraparë këto tërësi tematike:

1. Komunikimi dhe gjuha: 2 orë;
2. Gjuha shqipe dhe historia e saj: 2 orë;
3. Shprehi të gjuhës së folur: 12 orë;
4. Shprehi të gjuhës së shkruar: 18 orë;
5. Njohuri dhe praktikë për sistemin gjuhësor: 45 orë;
6. Drejtshkrim dhe pikësim: 6 orë.

II. ZBËRTHIMI I TËRËSIVE TEMATIKE

II.1. KOMUNIKIMI DHE GJUHA

- a. Gjuha si mjet komunikimi;
- b. Procesi i komunikimit;
- c. Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar;
- ç. Regjistrat e gjuhës.

III. 1. QËLLIMET

Do të aftësohen nxënësit të njohin veçoritë e gjuhës si mjet komunikimi, veçoritë e gjuhës së folur dhe të shkruar si dy variante që kanë secili veçoritë e tyre të ndërtimit dhe të funksionimit.

II. 1. GJUHA SHQIPE DHE HISTORIA E SAJ

- a. Origjina, vjetërsia dhe shtrirja;
- b. Historia e shkrimit të shqipes;
- c. Dialektet e gjuhës shqipe;
- ç. Shqipja standarde.

II. 2. QËLLIMET

Nxënësit do të njihen nxënësitë me vjetërsinë dhe origjinën ilire të gjuhës shqipe, me veçoritë e funksionimit të saj në hapësirë, me dialektet e gjuhës si dhe me veçoritë e formimit të shqipes standarde.

II. 3. SHPREHI TË GJUHËS SË FOLUR

- a) Komunikimi në shoqëri;
 - Përhëndetja, prezantimi, falënderimi, ftesa, urimi, pyetje-përgjigje
- b) Shprehja e gjendjes emocionale-ndjenjave;
 - Me anë të të folurit, tonit, me anë të tipareve shprehëse të fytyrës, me anë të gjesteve, etj.;
- c) Përdorimi i fjalorit;
 - Mënyra e përdorimit të fjalorit, kërkimi i fjalëve në fjalor;
- ç) Diskutojmë;
 - Shprehim mendimet, vlerësojmë, debatojmë, argumentojmë;
 - Rregullat e diskutimit;
- d) Referojmë;
 - Përgatitja e një referati;
 - Referimi para të tjerëve;
- dh) Tregojmë;
 - Tregojmë ngjarje personale;
 - Ritregojmë mbi bazën e leximeve.

III. 3. QËLLIMI

Nxënësit në klasën e nëntë orientuese duhen të bëhen të ndërgjegjshëm që gjuha ndryshon në vartësi nga qëllimi dhe situata e komunikimit, në vartësi

nga bashkëbiseduesit dhe natyra e marrëdhënieve me to. Nuk përdoret e njëjta gjuhë, në kuptimin i njëjti fjalor, të njëjtat mjete gjuhësore dhe struktura, i njëjti intonacion, kur bisedojmë me njëri-tjetrin, kur flasim me një epror ose kur flasim para një auditori. Po kështu nuk përdoret i njëjti fjalor, të njëjtat mjete ose struktura gjuhësore ose i njëjti intonacion, kur tregojmë një ngjarje, kur përshkruajmë diçka, kur argumentojmë një veprim ose pikëpamje, kur polemizojmë me dikë për diçka e kështu me radhë. Pra, do të vijojë dhe do të thellohet më tej puna për aftësimin e nxënësve të paraqesin me gojë përvojën vetjake, botën e tyre të brendshme dhe pikëpamjet për zhvillimet e sotme në përputhje me moshën dhe me formimin e tyre. Kërko-het përdorimi i një gjuhe të thjeshtë, të qartë dhe korrekte, po që vjen duke u pasuruar e përsosur gjithnjë.

II. 4. SHPREHI TË GJUHËS SË SHKRUAR

- a. Shkruajmë
 - Njoftime, ftesa, shkresa, kërkesa, etj.;
- b. Letërkëmbimi
 - Letra shoqërore, letra zyrtare, letra biznesi, telegrame, kartolina;
 - Shënime shoqërore, hartimi i një raporti, etj.;
- c. Shkruajmë për veten
 - Autoportreti, portreti;
 - Autobiografia, biografia
- ç. Përshkrimi – format e përshkrimit
- d. Shkrimi i reportazhit, teknika e hartimit të intervistës
- dh. Si të bëjmë përmbledhjen për një libër
- e. Si të bëjmë dhe shkruajmë një referat

Vërejtje: Në këtë tërësi tematike janë paraparë të realizohen katër hartime (katër orë hartim, dhe katër të tjera për korrigjim).

III. 4. QËLLIMI

Do të ushtrohen dhe të aftësohen nxënësit të tregojnë, të përshkruajnë apo të informojnë me shkrim për probleme të jetës së tyre të përditshme, të shprehin me shkrim ndjenjat e tyre, të vlerësojnë, të argumentojnë pikëpamjet apo qëndrimet e tyre, si dhe të shkruajnë tipa të ndryshëm tekstesh: telegrame, letra, njoftime, tregime të shkurtra, autobiografi, biografi po edhe të bëjnë intervista, raporte, referate etj.

II. 5. NJOHURI DHE PRAKTIKË PËR SISTEMIN GJUHËSOR

- a. Njohuri fonetike
 - Sistemi fonetik i shqipes standarde;
 - Sistemi grafik i shqipes standarde.

- b. Fjalët e ndryshueshme
 - Emri
 - Gjinia dhe numri i emrave dhe i mbiemrave
 - Përemri dëftor, pronor, pyetës, i pacaktuar dhe lidhor
 - Numërori
 - Folja
 - Zgjedhimi i foljes, format veprorë dhe joveprorë të foljes, kohët e foljes, mënyrat e foljes, format e pashtjelluara të foljes
- c. Fjalët e pandryshueshme
 - Fjalët e pandryshueshme dhe roli i tyre
 - Ndajfolja
 - Parafjalët
 - Lidhëzat
- ç. Funksionet gramatikore që lidhen me foljet
 - Kryefjala dhe kallëzuesi i kryefjalës
 - Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë
 - Rrethanori
- d. Funksionet gramatikore që lidhen me emrin
 - Përcaktori i shprehur me mbiemër, përemër, numëror
 - Përcaktori i shprehur me emër
 - Ndajshtimi
- dh. Tipat e fjalisë dhe strukturat e tyre
 - Tipat e fjalisë
 - Rendi i fjalëve në fjali
 - Fjalja e thjeshtë dhe fjalja e përbërë
 - Fjalitë e përbëra me bashkërenditje
 - Fjalitë e përbëra me nënrenditje
 - Fjalja e përbërë me më shumë se dy pjesë
 - Ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë

III. 5. QËLLIMI

Kjo tërësi tematike u kushtohet njohurive për sistemin gjuhësor. Synon të riorganizojë, përgjithësojë dhe sintetizojë njohuritë e fituara për sistemin gjuhësor në klasat II-VIII të shkollës tetëvjeçare.

Në këto klasa është zhvilluar një punë e gjerë për dhënien e njohurive teoriko-praktike për sistemin gjuhësor, përfshirë këtu njohuritë për fonetikën, morfologjinë, fjalëformimin, sintaksën etj. Atje nisemi nga njësitë sintaksore për të ardhur te pjesët e ligjëratës. Në klasat II-IV përmbajtja e njohurive gjuhësore është praktikë gjuhësore, pra, nocionet gjuhësore nuk jepen teorikisht, po praktikisht, në përputhje me përvojat gjuhësore të fëmijëve të kësaj moshe. Në klasat V-VIII, për shkak të zhvillimit të mendimit abstrakt, të fëmijët e kësaj moshe, është kaluar në trajtimin teorik të veçorive të ndërtimit dhe funksionimit të sistemit gjuhësor, po edhe këtu pa harruar aspektin praktik të problemit.

I. 6. DREJTSHKRIM DHE PIKËSIM

- a. Parimet e drejtshkrimit të shqipes
 - Drejtshkrimi i zanoreve, i grupeve të zanoreve dhe i diftongjeve;
 - Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve;
 - Drejtshkrimi i emrave, mbiemrave;
 - Përdorimi i shkronjave të mëdha dhe shkrimi i datave.
- b. Rregullat e pikësimit
 - Shenjat kryesore të pikësimit;
 - Shenjat që përdoren në fund të fjalisë;
 - Shenjat që përdoren brenda fjalisë;
 - Thonjëzat dhe vizat.

IV. 6. QËLLIMI

Njohja e parimeve të drejtshkrimit të shqipes, drejtshkrimi i zanoreve, i grupeve të zanoreve dhe i diftongjeve, drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve, përdorimi i shkronjave të mëdha. Parimet e pikësimit, shenjat kryesore të pikësimit, rastet kryesore të përdorimit të pikës, pikëpyetjes, pikëçuditjes, presjes, pikëpresjes, dypikave, shumëpikëshit, thonjëzave, kllapave dhe vizës.

IV. LITERATURA

1. UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

a. Literatura bazë:

- **Gjuha shqipe 5**, Prishtinë
- **Gjuha shqipe 6**, Prishtinë
- **Gjuha shqipe 7**, Prishtinë
- **Gjuha shqipe 8**, Prishtinë
- **Drejtshkrimi i gjuhës shqipe**, botim i Tiranës ose i Prishtinës.
- *B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe* (Për mësuesit e gjuhës shqipe), Bashkëpunoi E. Topi, Tiranë 1997 ose Prishtinë, 1998,
- **B. Beci**, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër, 2000 ose Prishtinë 2001.

I.1. Komunikimi dhe gjuha do të shfrytëzohen: kapitulli i parë i tekstit Gjuha shqipe 5; kapitulli i parë i tekstit Gjuha shqipe, 6; kapitulli i parë i librit B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe (Për mësuesit e gjuhës shqipe), Bashkëpunoi E. Topi, Tiranë 1997 ose Prishtinë, 1999

I.2. Gjuha shqipe dhe historia e saj, do të shfrytëzohen: kapitulli i parë i tekstit Gjuha shqipe 5; kapitulli i parë i tekstit Gjuha shqipe, 6; dhe kapitulli hyrës i librit B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër, 2000 ose Prishtinë 2001.

I.3. - I.4. Shprehi të gjuhës së folur dhe Shprehi të gjuhës së shkruar do të shfrytëzohen kapitujt **Flasim dhe hartojmë** të teksteve Gjuha shqipe 5, 6, 7, 8.

I.5. Njohuri dhe praktikë për sistemin gjuhësor do të shfrytëzohen kapitujt përkatës në tekstet e klasave 5, 6, 7, 8. , si edhe librat e botuar për sistemin gramatikor të shqipes në Shqipëri ose Kosovë, B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe (Për mësuesit e gjuhës shqipe), Bashkëpunoi E. Topi, Tiranë 1997 ose Prishtinë, 1998, B. Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Shkodër, 2000 ose Prishtinë 2001.

I.6. Drejtshkrim dhe pikësim, shfrytëzohen kapitujt përkatës të librit Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, botimi i Tiranës ose i Prishtinës.

STRUKTURA E PROGRAMIT TË LETËRSISË

Strukturën e programit të letërsisë e përbëjnë:

- I. Tërësitë tematike;
- II. Zbërthimi i tërësive tematike;
- III. Qëllimi;
- IV. Rezultatet;
- V. Literatura.

I. TËRËSITË TEMATIKE

1. Teori e letërsisë: 8 orë;
2. Letërsi gojore: 5 orë;
3. Letërsi shqipe: 30 orë;
4. Letërsi botërore: 12 orë.

II. ZBËRTHIMI I TËRËSIVE TEMATIKE

II. 1. TEORI E LETËRSISË

- a. Klasifikimi i letërsisë- Gjinitë dhe llojet letrare;
- b. Poezia dhe llojet e saj;
- c. Proza dhe llojet e saj;
- ç. Figurat stilistike;
- d. Metrika.

III. 1. QËLLIMI

Zbërthimi i kësaj tërësie tematike ka këto qëllime:

- Të kuptuarit e nocionit letërsi; dallimet në mes letërsisë gojore dhe asaj të shkruar; gjinitë dhe llojet letrare.
- Poezia-llojet. Poezia lirike-shkurtësia, shprehja e unit, idetë, motivet, temat, funksioni shprehës, llojet e saj. Poezia epike-ndërtimi, gjatësia,

ngjarjet, personazhet, llojet e saj. Poezia dramatike-ndërtimi kompozicional, protagonisti, antagonisti, dialogu, monologu, didaskalitë, llojet e saj.

- Proza-të kuptuarit, fabula, personazhet, rrëfimi, përshkrimi, llojet e saj.
- Figurshmëria, kuptimi i ndërtimit të figurave, llojet e figurave.
- Ritmi, rima, dhe llojet e saj, vargu dhe llojet e tij, strofa.

IV.1. REZULTATET

Pas zbrërthimit, përpunimit dhe përfundimit të kësaj tërësie tematike, nxënësi duhet:

- Të njohë, të dijë dhe të bëjë dallim në mes letërsisë gojore dhe asaj të shkruar, mënyrën e ndërtimit të gjinive dhe formave letrare, specifikave të tyre.
- Të kuptojë rëndësinë e figurave, të ritmit, të organizimit të vargut dhe të strofës.

V.1. LITERATURA

Për këtë tërësi tematike dhe për realizimin e suksesshëm të saj sugjerohen këto burime dhe kjo literaturë:

- *Zejnullah Rrahmani*, "Teoria e letërsisë" (Për shkollat e mesme), Prishtinë 1996. Kapitujt: III, IV, V.
- *Enver Muhametaj, Xhevat Lloshi*, "Nga teoria e letërsisë dhe stilistika gjuhësore" (Për shkollat e mesme), Tiranë 1992.
- *Arian Kadiu, Lauresha Stroni, Kumrije Hamiti* "Leximi letrar 8", Prishtinë 1999. Njësitë: subjekti i veprës, metonimia, apostrofi, strofa dhe llojet e saj, gjuha e veprës letrare, njohuri për gjinitë dramatike, monodrama, rima e brendshme.

II. 2. LETËRSI GOJORE: 6 orë

- a. Lirika
- b. Epika
- c. Proza popullore

III. 2. QËLLIMI

Zbrërthimi i tërësisë tematike, letërsi gojore, qëllim kryesor ka që nxënësi:

- Të kuptojë veçoritë e letërsisë gojore si krijimtari më e vjetër letrare, veçoritë e lirikës, të dallojë dhe të njohë llojet e lirikës;
- Përmes leximeve të kuptojë karakterin tregimtar të epikës, strukturën e saj, ngjarjen, personazhet, elementin fantastik, elementin historik real, të njohë llojet e epikës;

- Të kuptojë dhe njohë prozën popullore, format e shkurtra të saj, sidomos përrallën, legjendën, anegdotën etj.

IV. 2. REZULTATET

Pas zbrërthimit, shpjegimit dhe interpretimit të kësaj tërësie tematike, nxënësi duhet të tregojë njohuri për:

- Letërsinë gojore si mënyrë e komunikimit, si formë letrare, si anonimat;
- Veçoritë e lirikës, formën e saj, figuracionin dhe llojet e lirikës;
- Veçoritë e epikës, lidhjen e saj me mitologjinë, historinë, elementin fantastik, elementin real, ngjarjet;
- Veçoritë e prozës popullore, format e saj, figuracionin, funksionin dhe llojet e prozës popullore.

V. 2. LITERATURA

Realizimi i suksesshëm varet nga gjetja dhe përdorimi i literaturës përkatëse. Literatura e sugjeruar, jo e vetme :

- *Haki Baçi, Folklori shqiptar*, Prishtinë, 2001
- *Grup autorësh, LEXIMI LETRAR 8*, Prishtinë, 1999. Pjesa: Folklor, f.5-16.
- *Grup autorësh, LEXIMI LETRAR 7*, Prishtinë, 1999. Pjesët: Fjalë të urta, Maro Përhitura, Këshillat e plakut, Tanusha, Për gjithë Shqipërinë, Shqiptarët janë çue në kambë, Borë e madhe paska ra.

II. 3. LETËRSI SHQIPE

a. Letërsia e vjetër: 3 orë

- Letërsia e vjetër shqipe. Humanistët. Shkrimtarët filobiblikë. Bejtexhinjtë:
- *Pjetër Bogdani*, "Këngët e Sibilave"

b. Rilindja Kombëtare: 12 orë

- Letërsia romantike-përfaqësuesit:
- *Jeronim de Rada*, "Këngët e Milosaos";
- *Naim Frashëri*, "Lulet e Verës";
- *Ndre Mjeda*, "Juvenelia"
- Autorë dhe vepra të tjera. Zgjedhja e lirë.

c. Letërsia moderne: 12 orë

- *Gjergj Fishta*, "Juda Makabe";
- *Lasgush Poradaci*, "Ylli i Zembrës";
- *Ernest Koliqi*, "Tregtar flamujsh";
- Autorë dhe vepra të tjera. Zgjedhje e lirë.

ç. Letërsi bashkëkohore: 8 orë

- *Ismail Kadare*, "Kështjella";
- *Anton Pashku*, "Lutjet e mbrëmjes";
- *Ali Podrimja*, "Poezi";
- Autorë dhe vepra të tjera. Zgjedhje e lirë.

III. 3. QËLLIMI

Kjo tërësi tematike përbën boshtin e strukturës së programit të letërsisë për këtë klasë. Nisur nga rëndësia dhe pesha e saj, qëllimet kryesore janë:

- Nxënësi të njohë dhe të përvetësojë letërsinë shqipe nga fillimet e saj deri më sot, të përfaqësuar nga autorët dhe veprat kryesore të kësaj letërsie;
- Nxënësi të kuptojë veprat e këtyre autorëve, t'i lexojë dhe analizoj ato. Gjatë analizës të kuptojë idetë, motivet, temat, stilet, kompozicionin, personazhet, figuracionin, ritmin, rimën, vargun, strofën dhe gjuhën;
- Nxënësi të kuptojë kohën dhe hapësirën e shfaqjes së letërsisë shqipe të autorëve dhe të veprave të kësaj letërsie;
- Nxënësi të njohë dhe kuptojë kushtet dhe rrethanat në të cilat është zhvilluar letërsia shqipe.

IV. 3. REZULTATET

Pas shpjegimit dhe leximit të autorëve dhe të veprave të tyre letrare, nxënësi duhet të kuptojë, të dijë, të gjykojë, vlerësojë në mënyrë autonome:

- Për karakterin e letërsisë së vjetër, për Pjetër Bogdanin si krijuesin më të rëndësishëm të kësaj letërsie, për *Këngët e Sibilave*.
- Për rëndësinë e Rilindjes Kombëtare, për veçoritë e letërsisë romantike, për përfaqësuesit kryesorë të saj, për llojet gjinore dhe tematike të veprave të tyre, për stilet, figuracionin, për vlerat letrare, për faktorët kushtëzues, për gjuhën e shkrimeve.
- Për autorët dhe për veprat që i takojnë letërsisë moderne-bashkëkohore, për krijimin e trajtave dhe formave letrare, për gjerësinë motive dhe tematike, për gjuhën e re poetike, për prozën moderne tregimtare, për zhvillimin e shumëllojshëm të dramatikës, për modernitetin e krijuar me vetëdije kritike nga autorë dhe vepra letrare .
- Për letërsinë bashkëkohore, për individualitete dhe vepra letrare, për dukuri përcaktuese historike dhe letrare, për zhvillime të poezisë, të prozës dhe të dramaturgjisë, për tema e shtresime të shumta tematike, për strukturimet nëntekstore, për gjuhën simbolike, për sistemin figurativ etj.

V. 3. LITERATURA

Për realizimin e kësaj strukture tematike literaturë bazë sugjerohen:

- *Dr. Sabri Hamiti: Letërsia e Vjetër Shqipe* (për klasën e parë të shkollave të mesme), Prishtinë 1999 . Pjesa: Letërsia e Vjetër Shqipe, f. 13 –23; Pjetër Bogdani, f. 46-81;
- *Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Çapaliku: Letërsia Shqipe* (për klasën e dytë të shkollave të mesme), Prishtinë, 2000. Pjesët: Rilindja Kombëtare , Letërsia Romantike, f.7-20; Jeronim de Rada, f.45-77; Naim Frashëri f.181-244 ; Ndre Mjeda, f.293-339,
- *Dr. Sabri Hamiti: Letërsia Moderne Shqipe* (për klasën e tretë të shkollave të mesme), Prishtinë, 1998. Pjesët: Letërsia Moderne Shqipe f. 9-15; Gjergj Fishta f.17-40 ; Lasgush Poradeci, f.95-116; Ernest Koliqi f.125-147;
- *Ali Aliu, Shaban Sinani, Stefan Çapaliku, Tonin Çobani; Letërsia Bashkëkohore Shqiptare 4* , Prishtinë, 2001. Pjesët: Ismail Kadare, f.151-177 ; Anton Pashku, f.178-192; Ali Podrimja f.293-339.
- *Pjetër Bogdani, "Këngët e Sibilave"*, Prishtinë, 2001. (lexim i plotë)
- *Jeronim de Rada, "Këngët e Milosaos"* (Kënga I, II, XXII dhe kënga XXX);
- *Naim Frashëri, "Lulet e Verës,"* Prishtinë, 1990 (lexim i plotë);
- *Ndre Mjeda, "Juvenilia"*, Prishtinë, 1990 (f. 7-77, 123-165)
- *Gjergj Fishta " Juda Makabe "* Prishtinë (lexim i plotë)
- *Lasgush Poradeci " Ylli i Zemrës"*, Prishtinë , 1990. (Poezitë : Zog i qiejve; Gjuha e zjarrtë; Naim Frashërit; Vallja e yjeve; Gjeniu i anijes; Lundra dhe flamuri; Vdekja e Nositit.
- *Ernest Koliqi , "Tregtar Flamujsh"*, Prishtinë (lexim i plotë);
- *Ismail Kadare, "Kështjella"*, Prishtinë (lexim i plotë);
- *Anton Pashku, "Lutjet e mbrëmjes"*, Prishtinë, 1998 (lexim i plotë);
- *Ali Podrimja, " Poezi"*, Prishtinë 1997 (lexim i plotë);

II. 4. LETËRSI BOTËRORE: 12 orë

- a. Letërsia e vjetër
 - *Homeri, "Iliada"; "Odiseja"*
- b. Letërsia e Rilindjes
 - *Uiljam Shekspiri, "Romeo e Zhuljeta"*
- c. Romantizmi
 - *Xhorxh Gordon Bajron, "Çajld Harold"*
- ç. Realizmi dhe Simbolizmi
 - *Honore Dë Balzaku, "Xha Gorioi"*
 - *Sharl Bodëleri. "Lulet e së keqes"*

d. Letërsia e shekullit XX

- *Ernest Heminguej*. "Plaku dhe deti".

III. 4. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj tërësie tematike është:

- Nxënësi të kuptojë shfaqjen e epeve homerike, rëndësinë, strukturën, personazhet, lidhjet me mitologjinë;
- Nxënësi të kuptojë rëndësinë e Rilindjes evropiane, veçoritë e artit të Shekspirit, temat, personazhet dhe ndërtimin kompozicional të tragjedive të tij letrare;
- Nxënësi të njohë dhe të kuptojë romantizmin si drejtim letrar, Bajronin dhe veprën e tij, lidhjet e kësaj vepre me shqipëtarët dhe Shqipërinë;
- Nxënësi të dallojë veçoritë kryesore të realizmit përmes leximit të veprës *Xha Gorioi* të Balzakut; të kuptoj simbolizmin, modernitetin poetik dhe perfaqësuesin më të madh Bodlerin.
- Nxënësi të njohë njërin ndër shkrimëtarët më të mëdhenj të shekullit XX dhe veprën e tij më të rëndësishme, *Plaku dhe deti*.

IV. 4. REZULTATET

Pas zhvillimit dhe përfundimit të tërësisë tematike, letërsia botërore, nxënësi duhet të ketë fituar dhe sintentizuar :

- Njohuri themelore për epet homerike, për rëndësinë e tyre, për periudhat dhe drejtimet letrare, të shfaqura kronologjikisht, të letërsisë botërore;
- Njohuri themelore për individualitete dhe vepra më të rëndësishme e më tipike për periudhat dhe drejtimet e kësaj letërsie;
- Njohuri elementare për tiparet, veçoritë, stilet, ndikimet dhe zhvillimet e poezisë dhe të prozës së kësaj letërsie, duke parë në kohë dhe në hapësirë me gjithë tërësinë e shfaqjes së saj.

IV. 5. LITERATURA

Përpos ligjërimeve të mësimdhënësit për mësimin dhe njohjen e kësaj tërësie tematike sugjerohet kjo literaturë.

- Letërsia botërore 1, (për klasen e parë të shkollave të mesme), Prishtinë.
- *Homeri*, "Iliada dhe Odiseja", (Pjesë të zgjedhura), Prishtinë, 2001;
- **Letërsia botërore 2**, (për klasën e dytë të shkollave të mesme); Prishtinë; 2002
- *Uiljam Shekspiri*, "Romeo e Zhuljeta", Prishtinë (lexim i plotë);

- *Xhorxh Gordon Bajron*, "Çajld Harold", Prishtinë (kënga e dytë "Shtegtimet e Çajld Haroldit");
- **Letërsia botërore 3**, (për klasën e tretë të shkollave të mesme), Prishtinë 2000. Pjesët: Realizmi f.7-15; Simbolizmi f.15-21; Honore dë Balzak f.42-71; Charl Bodler f.171-194;
- *Honore dë Balzak*, "Xha Gorioi" ,(lexim i plotë);
- *Charl Bodler* , "Lulet e së keqes" (cikël me poezi);
- **Letërsia botërore 4**, (për klasën e katërt të shkollave të mesme), Prishtinë 2000. Pjesët: Letërsia moderne f.5-41; Ernest Heminguej f.145-166;
- *Ernest Heminguej* , "Plaku e deti" (lexim i plotë).

Vërejtje: Veprat pas të cilave shkruan leximet e plota janë paraparë lexime të programuara jashtë klase, analiza e të cilave bëhet në klasë (lektyra shkollore).

*Gjuhë
angleze*

GJUHA ANGLEZE

3 orë në javë, 105 orë në vit

I. HYRJE

Mësimi i gjuhës angleze, si gjuhë e huaj do t'i aftësojë nxënësit të fitojnë dituri, t'i zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë për të cilat ata kanë nevojë për gjuhën angleze, për t'u shkolluar në nivele të ndryshme arsimit, për të konkurruar në tregjet botërore të punës, për udhëtime turistike në shtete të ndryshme të botës, për kërshëri, etj.

Nxënësit duhet të aftësohen për të njohur dhe për të respektuar diversitetin kulturor në shoqëri. Prandaj, përfshirja e anglishtes si gjuhë e huaj në kurrikulet e shkollave tona do ta zgjerojë edhe më tepër kulturën e përgjithshme të nxënësve. Ajo do t'i aftësojë nxënësit të kuptojnë më lehtë dhe më mirë kulturat anglofone në vend dhe në botë (në Britani, SH.B.A., Kanada, Australi, Zelandë të Re etj.).

Zhvillimi i aftësive për të menduar dhe strategjia për ta mësuar është arsye më tepër për mësimin e gjuhës angleze në shkollat tona. Nxënësit që mësojnë anglisht përforcojnë aftësitë gjuhësore në përgjithësi dhe thellojnë dijen për të kuptuar natyrën dhe rolin e gjuhëve dhe të kulturave në jetën e tyre. Duke i përvetësuar strategjitë e mësimin të gjuhës së huaj, ata do të jenë më të aftë për ta përcjellë dhe për ta përdorur të mësuarit e gjuhës në situata të ndryshme jetësore.

Nxënësit e gjuhëve të huaja, duke ndërlidhur shkathtësitë e disiplinave të tjera të dijes, mësojnë si të bëjnë transferin e shkathtësive dhe të përmbajtjes së gjuhës angleze në mënyrë të kuptojnë më mirë përmbajtjen dhe shkathtësitë e gjuhës amtare. Nxënësit, duke mësuar edhe një gjuhë, ngrisin nivelin akademik dhe intelektual të tyre.

II. ASPEKTET NDËRDISIPLINARE

Nisur nga fakti se mësimi i gjuhës angleze nuk është qëllim për vete, duhet vënë në dukje se temat që do të trajtohen në programin e kësaj lënde, ndërlidhen me synimet e përgjithshme kurrikulare.

Në kuadër të programit të gjuhës angleze, përmes thellimit të njohurive për realitetin që i rrethon, nxënësit njëkohësisht zhvillojnë edhe aftësitë e përballjes me sfida të ndryshme jetësore. Përmes përmbajtjes shumështrësëshe të programit të gjuhës angleze, ata do të mësohen të shtrojnë hipoteza dhe t'i testojnë ato duke hedhur poshtë informacionin joqenësor dhe duke nxjerrë përfundime përmes përdorimit dhe thellimit të katër shkathtësive gjuhësore, të cilat janë thelb i komunikimit.

Njohja e kulturave të tjera dhe rrjedhave botërore do t'u ndihmojë nxënësve në formësimin dhe moderimin e mënyrës së të menduarit dhe të komunikimit përkitazi me çështjet dhe problemet, për të cilat përpiqen të gjejnë zgjidhje.

Në këtë drejtim peshë të veçantë kanë procedurat, strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies që mbështeten në qasjen komunikative, ato që për pikënisje kanë përbushjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe ato që e vënë nxënësin në qendër të procesit të nxënies.

Përparësitë e këtyre qasjeve janë:

- Nxënësit gjatë procesit të mësimit zhvillojnë veprimtari që kanë vlerë praktike arsimuese;
- Lëmi dhe tema për të cilën mësojnë është në sferën e interesit të nxënësve, gjë që shton nivelin e motivacionit dhe të angazhimit të tyre;
- Nxënësit u ekspozohen gjuhës angleze në formën e saj të natyrshme, autentike, joartificiale. Kjo gjuhë është e lehtë dhe e kuptueshme;
- Mësimi dhe e gjithë veprimtaria zhvillohet në gjuhën angleze, si rrjedhojë, nxënësi e kupton se ajo është mjet për komunikim e jo prodhim final;
- Nxënësit nuk njihen me gjuhën në mënyrë artificiale përmes një varg rregullash të strukturave gramatikore; si dhënia e njohurive, ashtu edhe njohja e realitetit që i rrethon, bëhet në gjuhën angleze;
- Mësimi zhvillohet në grupe me nxënës njohurish të ndryshme paraprake; si rrjedhojë bashkëpunimi, ndërveprimi dhe ndërndikimi, nxënësit me njohuri jo të plota paraprake, plotësojnë zbrazëtitrat dhe konsolidojnë dijen e tyre në saje të ndihmesës së nxënësve me njohuri më të plota;
- Në procesin e nxënies vëmendja përqendrohet në nxënësin si individ, kështu që nxënësit nxiten të mësojnë dhe të nxënë në mënyrë vetjake, duke u dhënë kohë të mjaftueshme për ta arritur këtë qëllim.

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Programi i gjuhës angleze mëton që përmes tij nxënësit të fitojnë tërësi njohurish dhe shkathtësish përkitazi me:

- Interpretimin, të shprehurit dhe bisedimet rreth kuptimit që përbën komunikimin;
- Njohjen me frymën e ideve, mënyrën e sjelljeve, të qëndrimeve, mënyrën e jetesës, personalitetet, veprat e shquara dhe simbolet, monumentet kulturore dhe historike, si dhe të arriturat shkencore e teknologjike të botës angloamerikane, që përmbledhen me termin kulturë;
- Sistemin fonologjik, ortografik, leksikor e gramatikor dhe diskursin, domethënë aspektin lingustik; dhe
- Proceset kognitive dhe metakognitive, proceset e ndërndikuara shoqërore që paraqesin arsimimin e përgjithshëm gjuhësor.

Derisa në të kaluarën, si rrjedhojë e ndikimit të metodologjisë së mësimdhënies së gjuhëve klasike, rëndësi parësore i është kushtuar aspektit lingvistik, pra zotërimit të strukturave gramatikore dhe zbatimit mekanik të tyre nga njëra anë, leximit dhe përkthimit të teksteve të shkruara, nga ana tjetër, që është plotësisht në pajtim me natyrën e këtyre gjuhëve, metodë kjo që është dëshmuar si e pasuksesshme për mësimin e gjuhëve të gjalla, kurrikulet bashkëkohore, të gjuhëve të huaja në përgjithësi, e në veçanti ato të gjuhës angleze, pasqyrojnë rëndësinë e zhvillimit simultan e të integruar të katër shkathtësive themelore komunikative të nxënësit:

- Shkathtësisë për të dëgjuar;
- Shkathtësisë për të folur;
- Shkathtësisë për të lexuar dhe
- Shkathtësisë për të shkruar (listening, speaking, reading, writing skills).

Programi i gjuhës angleze për klasën e nëntë do t'i kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të shkathtësive komunikative, duke u përqendruar më shumë në funksionet gjuhësore dhe në aftësimin e nxënësve për përmbushjen e tyre, duke përdorur strukturat e njohura tash më të përpunuara. Qëllimi është që përmes funksionalizimit të punohet në mënyrë më të efektshme në përforcimin e njohurive paraprake të nxënësve, të thellohen dituritë në rrafshin fonologjik, leksikor, funksional dhe edukativ përmes begatimit me tema dhe qasje të reja, duke përdorur procedura, strategji dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës angleze, si dhe duke i integruar të katër shkathtësitë gjuhësore.

Programi i gjuhës angleze për klasën e nëntë synon që nxënësve t'ua bëjë të mundshme të kuptojnë rëndësinë e mësimin dhe të nxënies së gjuhës në kontekstin e dhënë, në mënyrë që përmes vënies së strukturave në funksione të caktuara, të jenë në gjendje të komunikojnë me fondin leksikor që kanë dhe me nivelin e shkathtësive që zotërojnë. Qëllim përfundimtar është zhvillimi i aftësive dhe i vetbesimit të domosdoshëm për komunikim të rrjedhshëm dhe ndërveprim me anglishtfolësit, qofshin ata burimorë a joburimorë, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar.

IV. ZOTËSITË, SHKATHTËSITË KRYESORE DHE SPECIFIKE

Zotësitë dhe shkathtësitë e përgjithshme dhe specifike që do të promovohen përmes mësimin të gjuhës angleze lidhen me komunikimin e rrjedhshëm si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. Pasi që komunikimi në thelb është dërgim dhe pranim i mesazhit, përmes shkathtësisë për të kuptuar me dëgjim, nxënësit do të aftësohen të pranojnë mesazhe dhe, në vartësi nga qëllimi i të dëgjuarit dhe detyra që duhet përmbushur të bëjnë përzgjedhjen e informacionit relevant. Meqenëse shkathtësitë gjuhësore nuk paraqiten të izoluara, por ato zakonisht integrohen për qëllime komunikimi, pas pranimit të mesazhit, identifikimit dhe përzgjedhjes së informacionit relevant, nxënësit duhet të jenë në gjendje të marrin vendime dhe të reagojnë në mënyrë

adekuate në situata të caktuara; në situatën gjuhësore përgjigja e tyre është funksioni komunikativ i cili realizohet, qoftë me të folur, qoftë me të shkruar.

Sa i përket shkathtësisë për të folur, në fund të klasës së nëntë, nxënësit do të jenë në gjendje të flasin për veten e tyre, të përshkruajnë pamjen fizike dhe karakterin e njerëzve të tjerë, do të jenë të aftë të përshkruajnë dhe krahasojnë objektet, gjallesat dhe njerëzit, të flasin për shprehitë, preferencat, shkollën, punën dhe mjedisin ku jetojnë, të flasin për marrëdhëniet familjare e shoqërore me njerëzit në rrethin e tyre. Ata po ashtu duhet të jenë të aftë të përshkruajnë veprimet dhe ngjarjet që ndodhin në të tashmen, përmes të folurit të rikujtojnë ngjarjet dhe ndodhitë nga e kaluara, si dhe të bëjnë plane për të ardhmen.

Në rrafshin fonologjik, i cili ndërlihet me shkathtësitë për të dëgjuar dhe për të folur, nxënësit, përveç që do ta kenë zotëruar sistemin tingullor dhe drejtshqiptimin e fonemave të anglishtes, duhet t'i kenë të qarta raportet midis drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit të gjuhës angleze, si dhe dallimet rrënjësore midis shqipes dhe anglishtes në këtë aspekt.

Sa i përket shkathtësisë për të shkruar, nxënësit duhet të jenë të aftë që në mënyrë të pavarur ose duke ndjekur udhëzimet e ndryshme, të hartojnë shkrime llojesh të ndryshme, siç janë kartolinat, letrat joformale dhe formale, përshkrime të objekteve të banimit, të personave që i njohin mirë, si dhe të shkruajnë tregime të shkurtra.

Në fushën e leksikut nxënësit pritet të zotërojnë njësitë leksikore të nën-fushave që lidhen me objektet e përdorimit të përditshëm dhe të ambientit jetësor. Ata po ashtu duhet të jenë të aftë të përdorin në komunikim fjalët që emërtojnë shtete, përkatësi kombëtare e gjuhë të ndryshme, fjalët që ndërlihen me objektet e banimit, shkollën, profesionet, vendin e punës, ushqimin dhe pijet, veshmbathjen, kushtet atmosferike, institucionet publike, nddjenjat njerëzore, etj.

Përveç zotërimit të njësive leksikore, duhet të jenë të aftë të përdorin fjalorët një dhe dygjuhësh dhe të punojnë në mënyrë të pavarur në pasurimin e fondit të tyre leksikor, duke marrë një pjesë të përgjegjësive për nxënie.

Në kuadër të funksionalizimit të stukturave dhe të integritetit të shkathtësive gjuhësore, nxënësit duhet t'i zotërojnë formulat socio-kulturale të anglishtes, si për shembull, përshëndetjet, të kërkuarit ndjesë, falënderimi, etj. Ata po ashtu duhet të dinë të kërkojnë dhe të japin informacion të duhur përkitazi me orientimin në hapësirë dhe në kohë, çmimet e mallit, etj. Nxënësit duhet të zotërojnë rregullat e mirësjelljes në familje, në shkollë, në shoqëri e vende publike. Në përfundim të klasës së nëntë prej nxënësve po ashtu pritet të jenë në gjendje të japin dhe të pranojnë sugjerime, të argumentojnë qëndrimet vetjake, të pajtohen me mendimet e të tjerëve dhe t'i kundërshtojnë ato në situata të caktuara.

V. QASJET DHE METODAT

Të mësuarit e gjuhës angleze kërkon qasje dhe metoda të ndryshme. Në këtë udhëzim për mësimdhënës sugjerojmë disa qasje që reflektojnë pari-

met dhe përparësitë e programit të gjuhës angleze dhe të cilat mund t'i motivojnë nxënësit në mësimin e gjuhës, duke realizuar qëllimet dhe objektivat e programit. Megjithatë, këto qasje nuk do të jenë të përkryera. Ato duhet adaptuar dhe përshtatur nevojave të shkollës, klasës, nxënësit dhe mësimdhënësit dhe do të plotësohen nga vetë talenti i mësimdhënësit, ekspertiza dhe përvoja e tij.

Roli i mësimdhënësit

Mësimdhënësi është gjithnjë model për nxënësit, prandaj duhet të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e përdorimit të gjuhës, si dhe faktorëve të rëndësishëm si qartësia e gjuhës, diksioni, toni i zërit, mimika e fytyrës dhe gjestet. Mësimdhënësi po ashtu duhet t'i nxitë nxënësit të zhvillojnë gjuhën e tyre, duke u përqendruar rregullisht në fjalët e reja, por edhe në kuptimet e reja të fjalëve tash të njohura.

Bashkëveprimi i mësimdhënësit me nxënësit është tipar themelor në ngritjen e vetëdijes së nxënësit në mësimin e gjuhës angleze. Mësimdhënësi do t'i motivojë nxënësit të begatojnë fjalorin përmes pyetjeve, modeleve dhe sugjerimeve. Në këtë mënyrë do t'u mundësojnë atyre ta përdorin gjuhën drejt, pa gabime dhe me kuptim të plotë.

Dihet se gjuha angleze ka disa variante (britaneze, amerikane, kanadeze, australiane, etj.) andaj nga mësimdhënësi pritet që nxënësve aty për aty dhe në kontekstin e dhënë t'u jep sqarime për dallimet thelbësore midis dy standardeve kryesore (britaneze dhe amerikane) në të gjitha rrafshet gjuhësore dhe në drejtshkrim.

Procedurat, strategjitë dhe teknikat

Veprimtaritë që mësimdhënësi zhvillon në klasë janë të larmishme. Ato kryhen përmes përdorimit të një varg procedurash, strategjish e teknikash mësimore, ku nxënësit bashkëpunojnë në forma të ndryshme organizimi:

- Puna me gjithë klasën;
- Puna në grupe;
- Puna në çifte,
- Puna individuale.

Është e rëndësishme që, para se të vendoset forma e organizimit të veprimtarive, mësimdhënësi duhet të dijë veçoritë e secilës prej tyre.

Puna me gjithë klasën është ndër format më të zakonshme në shkollë. Mund të përdoret me efikasitet në mësimin e gjuhës angleze, në mënyrë që:

- Të aktivizohen të gjithë nxënësit gjatë orës së mësimit. Pra e gjithë klasa të punojë bashkë, të njihen nxënësit me ide ose tema të reja, të

merren udhëzimet për veprimtaritë dhe detyrat, ose të bëhet një përmbledhje e punës së përbashkët;

- Të ngjallet interesi në klasë për një temë të caktuar përmes tregimit të këndshëm të një ngjarjeje.

Puna në grupe ose në çifte: Me qëllim aftësimi të nxënësve të komunikojnë, të diskutojnë dhe të këmbëjnë mendime, në gjuhën angleze është e domosdoshme mësimdhënësi të organizojë punën në grupe të vogla nxënësish në gjirin e të cilëve ata mund të veprojnë, të reagojnë dhe të bashkëpunojnë. Puna në grupe preferohet edhe për shkak të numrit të madh të nxënësve në klasë, gjë që bën të mundshëm racionalizimin e kohës dhe efektshmërinë më të madhe në nxënie. Kjo mënyrë e punës kërkon ndryshim si në qëndrimin e mësuesit, ashtu edhe të nxënësit. Grupet duhet të jenë heterogjene. Puna në grupe është e dobishme kur dëshirojmë:

- Të bisedojmë për probleme të ndryshme;
- Të përsëritim njohuritë e fituara më parë;
- Të diskutojmë për çështje të ndryshme;
- Të përshkruajmë një personazh ose situatë, e të tjera;
- Rreth punës në grupe mësimdhënësi duhet të ketë kujdes dhe të ketë takt pedagogjik;
- Ai duhet të drejtojë punën e grupeve në mënyrë të tillë që të gjithë të aktivizohen dhe të shprehin mendimet e tyre;
- Detyra e grupit të përcaktohet qartë, nxënësit duhet të dinë se çfarë do të diskutojnë dhe për sa kohë;
- Të përcaktohet drejtuesi i grupit (nga mësimdhënësi ose nga vetë grupi), detyra e tij, si dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve të tjerë në grup;
- Të përcaktohet qartë mënyra e raportimit të përfundimeve me gojë ose me shkrim;
- Ndërhyrjet e mësimdhënësit të jenë nxitëse jo të pengojnë nismën e nxënësve.

Organizimi i veprimtarive në grupe ose në çifte sjell një varg përfitimesh për mësimdhënësin dhe për nxënësit. Është mirë që të fillohet me punën me çifte, pasi nxënësit të çlirohen më shpejt nga ndjenjat dhe drujtja dhe pasi të fitojnë përvojë, kalohet në grupe. Përparësitë e përdorimit të tyre në mësimin e gjuhës angleze janë në këto drejtime:

- Nxënësit kanë më shumë mundësi të komunikojnë me njëri - tjetrin,
- Janë më të përqendruar në mësim, pasi secili ka detyrën dhe përgjegjësinë e vet, nga kryerja e secilës përcaktohet edhe rezultati i grupit;
- Ndihen më të sigurt dhe më të lirë se kur pyeten para nxënësve në klasë. Puna në grupe e në çifte i ndihmon nxënësit për të shprehur mendimet e tyre;

- Rritet bashkëpunimi i nxënësve me njëri-tjetrin përmes shkëmbimit të mendimeve, ideve dhe plotësimit të tyre.

Puna individuale; Diskutimet me gjithë klasën dhe puna në grupe shpesh kërkojnë punë individuale nga nxënësit. Është me rëndësi që nxënësit të mësojnë të punojnë në mënyrë të pavarur, si dhe të bashkëpunojnë. Kjo bën që disa nxënës të përforcojnë veçanërisht punën e tyre dhe i krijojnë mundësi mësuesit të vlerësojë përparimin individual.

Loja me role

Loja me role, që ndryshe emërtohet edhe si dramatizim, është formë simulimi që në mësimin e gjuhës së huaj luan rolin e një teknike komunikative. Atë e luajnë nxënësit në një situatë të veçantë, të simuluar, joreale dhe në këtë situatë ata janë krijues dhe të gjallë.

Përparësitë e lojës me role: Përdorimi i lojës me role i jep laryshi orës së mësimin, e bën atë të këndshme dhe pa shqetësime. Në situatë të tilla nxënësi zbavitet dhe si e tillë ka përparësi në tri aspekte:

Në planin shoqëror:

- Të nxënësit kultivon aftësitë për të komunikuar në çift dhe në grup;
- E vendos atë në situatë të veçanta në marrëdhënie me individë dhe me grupin;
- I krijojnë mundësi për t'u zbavitur.
- E aftëson të ketë e të marrë përgjegjësi të ngjashme me ato në jetën reale.

Në planin pedagogjik:

- Rrit motivimin e nxënësit;
- Bën të mundshëm të mësoarit në grupe heterogjene;
- I jep mundësi nxënësit të jetë krijues dhe aktiv;
- E ndihmon nxënësin të sjellë përvojën e vet.

Në planin psikologjik:

- I jep mundësi nxënësit të njohë vetveten;
- E motivon nxënësin e turpshëm;
- Zhvillon të menduarit krijues dhe imagjinatën.

Organizimi i lojës me role në gjuhën e huaj bëhet në çifte ose në grupe dhe nxënësit i jep më shumë mundësi të ushtrojë gjuhën e nxënë:

- Në komunikim të drejtpërdrejtë,
- Duke e ndihmuar nxënësin të përdorë struktura gjuhësore të përvetësuar më parë;
- Duke e orientuar në situata më komplekse të komunikimit gjuhësor;
- Duke i dhënë hapësirë përdorimit të fjalorit;
- Duke fituar shkathtësitë e të folurit në çdo situatë.

Efektet negative të vlerësimit

Efektet negative të vlerësimit klasik nominal dhe të korigjimit të përhershëm dhe atypëratyshëm të gabimeve ndikojnë negativisht, ngase nxënësi:

- Humb vetëbesimin nga frika se mund të bëjë gabime;
- Humb gatishmërinë të ndërmarrë nisma dhe t'i hyjë rrezikut; e thotë vetëm atë që di se mund ta thotë;
- Bëhet i varur nga ndërhyrjet dhe korigjimet nga ana e mësimeve dhe humb aftësinë e vetëkorigjimit.

Përmbajtja programore

	Vocabulary	Everyday English	Skills
1	Countries	Greetings	Speak. list. read. and writing
2	The family Food and drinks	In a café: Ordering food and drinks; prices;	Reading and speaking:
3	Jobs; Leisure activities	Asking about people; What time is it?	Reading and speaking; Describing people
4	Leisure activities	Social expressions	All four skills
5	Places, rooms, Household goods	Directions	All four skills
6	Countries and languages Homophones	On the phone	Speaking and reading
7	Silent letters	Special occasions Congratulations	Reading, speaking and writing
8	Relationships	Dates and time	All four skills
9	Food and drinks: Shops and shopping	Polite requests	All four skills
10	City and country adjectives / nouns	Directions	Speaking, reading and writing
11	Clothes	In a clothes shop	Speaking: At the party
12	The weather	Making suggestions	Reading and speaking
13	Describing feelings	Catching a train	Speaking/reading/listening.
14	Means of transport	At the airport	Reading / speaking / listening

Libri (teksti mësimor) i përcaktuar për klasën e nëntë “ Headway Elementary” është i punuar në atë mënyrë që mësimdhënësve të gjuhës angleze u mundëson organizimin e orës mësimore dhe ndarjen e programit në njësi mësimore duke integruar katër shkathtësitë themelore komunikative.

Pasi që libri me të cilin do të punohet në klasën e nëntë i integron të katër shkathtësitë gjuhësore dhe mëton që përmes funksioneve të përvetësohen strukturat, e vetmja mënyrë e ndarjes së terësisë së orëve mund të bëhet vetem përmes parashikimit të orëve të dedikuara për një njësi mësimore.

Libri në fjalë përmbanë 14 tërësi mësimore (Units) të cilat do të zhvillohen për 6 – 8 orë mësimi.

VII. LITERATURA

Për lëndën e gjuhës angleze në klasën e nëntë do të shfrytëzohet teksti Headway – Elementary si tekst themelor i cili në vete përmban:

- **Librin e mësuesit;**
- **Librin e nxënësve;**
- **Librin e punës;**
- **Audiokasetat;**
- **Videokasetat.**

Matematikë

MATEMATIKË

4 orë në javë, 140 orë në vit

HYRJE

Matematika si shkencë është shumë vështirë të përkufizohet por në të "ekzaminohen format hapësinore dhe marrëdhëniet sasiore të botës reale". Zhvillimi i saj u bë krahas zhvillimit të njerëzimit.

Roli i matematikës mbështetet në zhvillimin e aftësive intelektuale të nxënësve, duke filluar nga të vërejturit deri tek abstraksionet, gjeneralizimet, gjykimet dhe përfundimet e drejta.

Së bashku me lëndët e tjera, matematika synon, të japë ndihmesë të rëndësishme në formimin e karakterit të qytetarit të ardhshëm. Ajo farkëton vullnetin, forcon bindjen ndaj forcës së arsytimit logjik, nxit kurajon për debatin e argumentuar etj.

Aktivitetet matematike bëjnë të mundshme zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme, jetës shoqërore dhe aktiviteteve shkencore që formulohen në modele matematikore. Këto të gjitha studiohen përmes metodave matematikore.

Programi i matematikës për klasën e nëntë orientuese është konceptuar për të siguruar koherencën dhe vazhdimësinë e lëndës në përmbajtje dhe në trajtimin metodik të ndihmojë nxënësin për orientim profesional të merituar. Zhvillimi i përmbajtjeve mësimore do të jetë në funksion të përforcimit të njohurive dhe të zotësive të fituara më parë në shkollimin paraprak. Programi synon edhe thellimin e përshkallëzuar të njohurive, duke zbatuar metodat dhe idetë kryesore në të gjitha linjat.

Në program për çdo kapitull jepet sasia orientuese e përmbajtjeve mësimore me qëllimet specifike, udhëzimet metodologjike dhe rezultatet e pritura në fund të klasës së nëntë.

Arsimtari duhet t'u shmanget mbingarkesave për nxënësin, jo vetëm në vëllimin e materialit, por edhe në shkallën e vështirësisë në përmbajtje. Ai duhet të ketë parasysh se programi i klasës së nëntë ndihmon orientimin si për arsimim të përgjithshëm ashtu edhe për orientim profesional. Aktiviteti matematik i nxënësve duhet të mos jetë i stërngarkuar dhe të zhvillohet në përputhje me interesat dhe moshën e tyre.

SYNIMET E PËRGJITHSHME

Me të mësuarit e matematikës synohet që nxënësi të njohë botën rreth tij dhe të interpretojë atë me anën e termave matematike, të njohë situatat problemore dhe si të veprojë në to.

Të mësuarit e matematikës në shkollë synon të japë ndihmesë të rëndësishme në edukatën mendore të qytetarit. Duke u marrë me aktivitet matematik, në mënyrë të programuar, te nxënësi kultivohet ndjenja e punës mendore, shprehitë e autodidaktit, aftësia për abstraktim, për hamendje të një hipoteze e për ta verifikuar me arsyetim deduktiv. Ushtrohet saktësia e të shprehurit, komunikimit, hollësitë e argumentimit, përgjithësisht rigoroziteti i të menduarit; krahas këtyre zhvillohet përfytyrimi i hapësirës dhe ushtrohet posaçërisht komunikimi me mjete grafike, që është, sidomos sot, gjuhë shumë e përhapur komunikimi.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi i mësimit të matematikës në shkollë është që nxënësit:

- Të zhvillojnë interesimin në matematikë si dhe të menduarit dhe aftësinë e tyre për të mësuar dhe për ta përdorur matematikën në situata të ndryshme;
- Të vlerësojnë vlerën dhe përdorimin e formave matematikore të shprehjes;
- Të zhvillojnë aftësinë e tyre për të formuluar, përfaqësuar dhe zgjidhur probleme me ndihmën e matematikës, ashtu si edhe të interpretojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë zgjidhje lidhur me situata problemore origjinale;
- Të zhvillojnë aftësitë e tyre për të përdorur modele të thjeshta matematikore, si dhe përdorimet e këtyre modeleve në mënyrë kritike.

Nxënësit duhet të dinë dhe të përdorin:

- Konceptet numerike bazë dhe llogaritjen me numra realë, vlerat e përafërta, përpjesëtueshmërinë dhe përqindjen;
- Metoda të ndryshme, sistemet matëse dhe instrumente krahasimi, të vlerësojnë dhe të përcaktojnë masën e shkallëve të ndryshme të madhësisë;
- Konceptet gjeometrike bazë dhe metodat për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave dhe për përshkrimin dhe krahasimin e vetive të rëndësishme të informacionit statistikor;
- Koncepte algebrike bazë, shprehje, formula, ekuacione dhe mosbarazime;
- Vetitë funksionale të ndryshme dhe grafikëve të tyre korrespondues;
- Konceptin e probabilitetit në situata të rastësishme dhe konkrete.

ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME DIDAKTIKE

Në didaktikën e matematikës bëhet fjalë që:

- a) Përmbajtja arsimore të trajtohet në frymën e matematikës. Aktivitetet matematikore të zhvillohen në një ndërlidhje logjike dhe të pashkëputshme;
- b) Të mos nënçmohet as mbiçmohet mundësia intelektuale e nxënësit. Meqenëse mundësitë janë të njohura që më parë, duhet shtruar kërkesa vazhdimisht deri sa nxënësi mund t'i kryen kërkesat duke pasur parasysh se inteligjenca e nxënëve është mjaft e hapur ndaj çdo sugjerimi dhe nisme;
- c) Në program ka përmbajtje themelore dhe ndihmëse. Të mos trajtohen në të njëjtën mënyrë dhe të mos shkohet në mbarimin e domosdoshëm të tërë përmbajtjes;
- d) Meqenëse të mësuarit e matematikës përherë është proces progresiv, por gjithëherë duke e shfrytëzuar përmbajtjen përkatëse paraprake mund të ndërtohen edhe përsëritje speciale, por duke u thelluar dhe zgjeruar ato. Jo me përsëritje sterotipe;
- d) Duke shfrytëzuar materiale të llojllojshme didaktike duhet pasur parasyshë realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përgjithshme dhe specifike.

TEKSTET DHE BURIMET E TJERA MËSIMORE

Njohuritë dhe informatat që merren nga teksti shkollor duhet t'u përshtaten nevojave dhe interesimit të nxënësve, por edhe të kenë përshtatshmëri me përmbajtjet programore për klasën përkatëse.

Për realizimin e përmbajtjeve programore të matematikës në klasën e nëntë orientuese rekomandohet që deri të hartohen tekste të reja të përdoren tekstet shkollore që ishin në shërbim deri më tash për nxënësin:

- Matematika për klasën VII;
- Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën VII;
- Matematika me përmbledhje detyrash për klasën VIII;
- Matematika për klasën e parë gjimnaz.

Lidhur me përdorimin e tekstit shkollor shih udhëzimet në Kornizën e Kurrikulit të Ri të Kosovës.

Nxënësit dhe arsimtarët mund të zgjedhin edhe literaturë tjetër ndihmëse për zhvillimin me sukses të programit të matematiukës nga klasa e nëntë orientuese.

Meqenëse tash teknologjia e mjeteve mësimore dhe e teksteve është përsosur, çdo herë duhet të kemi parasysh zhvillimet e reja në këtë fushë.

Nga burimet e tjera që duhet përdorur për zhvillimin me sukses të matematikës në klasën e nëntë janë:

- **Algoritmat** për llogaritje përmendësh dhe algoritmat me shkrim për operacionet themelore llogaritëse;

- **Veglat gjeometrike** si vizorja me shabllon, gjeotrekëndëshat dhe kompas;

- **Llogaritësi i xhepit** i cili përdoret në sasi të kufizuar kryesisht në funksion të lehtësimit të mësimit (p.sh. njehësimi i rrënjës katrore, përcaktimi i përpjesëtueshmërisë, njehësimi i vlerës së shprehjes, llogaritje me numra të mëdhenj, numra me shenjë etj.). Rekomandohet që llogaritësit e xhepit në orë të përdoren vetëm në rastet e lartshënuara, në orë të caktuara dhe kur duhet të flitet për përdorimin dhe rolin e llogaritësve.

Kompjuteri përdoret lidhur me tabelat kompjuterike. Atëherë kur përdoret kompjuteri mësimi duhet të mbahet në kabinetin e kompjuterëve. Ekzistojnë edhe programet kompjuterike të lidhura në përmbajtje me gjeometrinë dhe statistikën. Përdorimi i kompjuterëve në zhvillimin e këtyre programeve duhet të jetë i kufizuar. Duhet t'i shmangemi nxënies pasive dhe „vartësisë“ nga kompjuteri.

- Temat: 1. GJEOMETRIA DHE MATJET: 28 ORË**
2. ARITMETIKA DHE ALGJEBRA: 88 ORË
3. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE: 14 ORË
NË DISPOZICION: 10 ORË

QËLLIMET KRYESORE	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME DHE AKTIVITETE DIDAKTIKE	REZULTATET QË DUHET ARRITUR
KAPITULLI: Numrat realë (14 orë)			
<p>- të kuptohen marrëdhëniet e përfshirjes të bashkësive numerike (bashkësia e numrave natyrorë përfshihet në bashkësinë e numrave racionalë etj);</p> <p>- njohja me vetitë themelore të numrave realë dhe zbatimi i tyre i suksesshëm;</p> <p>- vërejtja e nevojës dhe domethënies së vlerave të përafërta si dhe aftësimi për rumbullakimin e numrave dhe vlerësimi i gabimit.</p>	<p>Bashkësia e numrave natyrorë N. Zbërthimi i numrit natyror në faktorë të thjeshtë.</p> <p>Bashkësia e numrave të plotë Z. Numri racional, bashkësia Q. Veprimet me numra racionalë. Numri irracional, bashkësia R. Veprimet me vlerat e përafërta të numrave realë. Paraqitja e numrave realë në boshtin numerik.</p>	<p>Bëhet një pasqyrë e shkurtër e numrave, si bashkësi dhe nënbashkësi prej atyre natyralë deri tek ata realë. Të sistematizohen njohuritë mbi numrat, në mënyrë të posaçme me parimin e përhershmerisë së vetive të operacioneve llogaritëse. Gjatë zgjidhjes së detyrave mund të përdoren edhe llogaritësit (llogaritësit e xhepit, kompjuterët etj)</p>	<p>Nxënësit duhet të dinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për raportin në mes të bashkësive të numrave - për vetitë algjebrike të numrave realë. - të përdorë dhë të zgjidhë detyrat me shprehje numerike në kllapa dhe pa kllapa. - për veprimet me vlerat e përafërta në bashkësinë e numrave realë.

KAPITULLI: Kuptime fillestare dhe njohuri të gjeometrisë në plan. Vektorët (16 orë)			
<p>- të përcaktohen raportet në mes të pikave, drejtëzave dhe rrafsheve në hapësirë dhe këto raporte të shënohen me simbole;</p> <p>- të njihen mënyrat e përcaktimit të rrafshit dhe të përcaktohet pingultia në mes të drejtëzës dhe rrafshit;</p> <p>- të njihen figurat kongruente dhe nocioni lidhur me to;</p> <p>- të përcaktohet nocioni i trekëndëshave kongruentë;</p> <p>- të zbatohet kongruenca për konstruktimin e trekëndëshave.</p> <p>- njoftimi me faktet themelore mbi vektorët (kuptimi, barazia, mbledhja, zbritja) dhe zbatimet e tyre.</p>	<p>Pika, drejtëza dhe rrafshi. Gjysmëdrejtëza, segmenti, vija e thyer, shumëkëndëshi, gjysmëplani, këndi. Vetitë e figurave. Pingultia dhe paralelizmi i drejtëzave. Trekëndëshi, 3 raste të kongruencës së trekëndëshave. Rrethi dhe qarku. Kuptimi i vektorit. Vektorë të barabartë. Veprime me vektorët: mbledhja, zbritja.</p>	<p>Të jepen disa kuptime themelore, me anë të tyre të nxirren kuptime të reja dhe me anë të disa shembujve të thjeshtë të njihet thelbi i vërtetimit të teoremave.</p>	<p>Nxënësi duhet të dijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në model të përshkruaj pozitën e ndërsjellë të elementeve gjeometrike në hapësirë në mënyrë simbolike. - duke i krahasuar figurat gjeometrike të bëjë dallime në mes të figurave kongruente (të përputhshme) - për segmentin e orientuar, mbi nocionin e vektorit, mbledhjen dhe zbritjen e vektorëve.
KAPITULLI: Homotetia dhe ngjashmëria (12 orë)			
<p>- të përcaktohen dhe të shënohen raportet e gjatësive të dy segmenteve;</p>	<p>Homotetia dhe vetitë e saj. Teorema e Talesit. Ngjashmëria e trekëndëshave, tre raste</p>	<p>Nxënësi le ta përshkruaj dhe ta vlerësojë si ndikon ndryshimi i të dhënave në zgjidhjen e detyrave. Nxënësit duhet ta njohin homotetinë</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përpjesëtimin e gjatësive të segmenteve ta përdorë për kërkimin e gjatësisë së panjohur në mënyrë llogaritëse dhe

<p>- grafikisht të përcaktohet segmenti i dytë, nëse e njohim gjatësinë e njërit segment dhe raportet e gjatësive të segmenteve;</p> <p>- të ndahet segmenti në përpjesëtimi të dhënë;</p> <p>- të njihen figurat e ngjashme dhe nocionet lidhur me to: brinjët homologe dhe këndet homologe;</p> <p>- të përcaktohet nocioni trekëndëshat e ngjashëm;</p> <p>- të shënohet përpjesëtimi i gjatësive të brinjëve homologe të dy trekëndëshave të ngjashëm dhe të njehsohet brinja përkatëse.</p> <p>- të dihet dhe të përcaktohet ku mund të zbatohen teorema e Talesit dhe ajo e Pitagorës.</p>	<p>të ngjashmërisë së trekëndëshave. Ngjashmëria e shumëkëndëshave. Zbatimi . Teorema e Pitagorës. Zbatimi.</p>	<p>si një transformim i rrafshit, i cili nuk është izometrik, ndërsa ngjashmërinë si kompozicion të homotetisë dhe të izometrisë. Është mjaft i rëndësishëm zbatimi i ngjashmërisë në vërtetimin e teoremave të Pitagorës dhe të Talesit. Nxënësi le të dijë t'i zgjidhë trekëndëshat kënddrejtë në trupat gjeometrikë me teoremën e Pitagorës.</p>	<p>grafike.</p> <p>- të dallojë lidhjen në mes të homotetisë dhe ngjashmërisë;</p> <p>- të zbatojë homotetinë dhe ngjashmërinë në detyra konstruktive;</p> <p>- të dijë për brinjët homologe dhe këndët homologe</p> <p>- të zbatojë teoremën e Pitagorës në zgjidhjen e trekëndëshit të drejtë.</p>
<p>KAPITULLI: Shprehjet shkronjore (20 orë)</p>			
<p>- të dihet më shumë për shndërrime identike në</p>	<p>Monomi, polinomi, thyesa racionale. Vlerat e</p>	<p>Me ndihmën e shumëzimit, thjeshtimit dhe faktorizimit bëhen</p>	<p>- të shndërrojnë shprehjet me ndryshore në shprehje identike me to, duke përdorur</p>

<p>shprehjen racionale, - të dihet në cilat raste thyesa racionale është e pamundshme; - të njehsohet katrori i shumës dhe i ndryshimit të binomit, ndryshimi i katrorëve; - të njehsohet kubi i shumës dhe i ndryshimit të binomit, ndryshimi i kubëve, shuma e kubëve; - të thjeshtësohet shprehja me ndryshore dhe të njehsohet vlera e saj për vlerë të dhënë të ndryshores; - të zërthehet shprehja në faktorë.</p>	<p>palejshme të ndryshores në shprehjen racionale. Shndërrime identike të shprehjeve racionale (shumëzime, faktorizime, thjeshtime) <i>Katrori i binomit;</i> <i>Ndryshimi i katrorëve;</i> <i>Shuma dhe ndryshimi i</i> <i>kubëve;</i> Zërthimi në faktorë. Veprimet me shprehje racionale</p>	<p>shndërrime identike të shprehjeve dhe thyesave racionale. Gjatë zërthimit të shprehjeve veprojmë, kryesisht, me ndryshimin e katrorëve dhe me nxjerrjen e faktorit të përbashkët. Të zotërojë ideja mbi kryerjen e transformimeve identike të thyesave algjebrikë.</p>	<p>faktorizimin, zërthimin, reduktimin, thjeshtimin, rregullën e heqjes së kllapave me shenjën minus përpara, formulën e katrorit të binomit, formulën e ndryshimit të katrorëve dhe të kubëve etj. - duhet t'i zbatojë formulat dhe të dijë të zërthen në faktorë shprehjet shkronjore.</p>
<p>KAPITULLI: Ekuacionet dhe inekuacionet (18 orë)</p>			
<p>- Të zgjidhen ekuacionet e thjeshta zërthyesë; - të përcaktohet nocioni ekuacione të njëvlershme; - të përdoren rregulla formale për zgjidhjen e ekuacioneve të fuqisë së parë dhe të vërtetohen ato;</p>	<p><i>Kuptimi i ekuacionit me një ndryshore. Zgjidhja e ekuacioneve. Ekuacione të njëvlershme. Ekuacioni i fuqisë së parë me një ndryshore; ekuacione të thjeshta. Zbatimi i ekuacioneve të fuqisë së parë me një ndryshore. Zgjidhja e ekuacioneve</i></p>	<p>Gjatë zgjidhjes së ekuacioneve përdoren rregullat për zgjidhjen e ekuacioneve. Zgjidhjen e ekuacioneve me parametra e marrim si materie të vështirë. Rregullat lidhur me shqyrtimin e ekuacioneve mund t'i ilustrojmë me shembuj përkatës. Në çdo rast duhet t'u iket ekuacioneve dhe inekuacioneve me</p>	<p>Nxënësit duhet të dinë: - t'i zgjidhin ekuacionet e fuqisë së parë me një të panjohur dhe detyrat e thjeshta tekstuale; -t'i zgjidhin inekuacionet e formës së prodhimit në faktorë linearë. - zgjidhjen e problemeve të thjeshta matematikore me ekuacione.</p>

<ul style="list-style-type: none"> - të zgjidhet ekuacioni i fuqisë së parë me koeficientët realë ; - të zgjidhet ekuacioni i fuqisë së parë me parametra dhe të bëhet shtjellimi i thjeshtë; - të përdoret barazimi linear gjatë zgjidhjes së deytarve të thjeshta tekstuale; 	<p>me parametra. Diskutim. <i>Inekuacionet e formës:</i> $ax * b$ <i>Inekuacionet e formës:</i> $(ax + b) \cdot (cx + d) * 0$ <i>Inekuacionet e formës:</i> $(ax + b)/(cx + d) * 0$ <i>(shenja (*) zëvendësohet me <, >, ≤, ≥)</i></p>	shprehje tepër të ndërlikuara.	
KAPITULLI: Përpjesëtimi i drejtë dhe i zhdrejtë (10 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> - Të përcaktohet dhe të shkruhet përpjesëtimi i dy madhësive; - të përcaktohet dhe të shënohet përpjesëtimi; - të njehsohet elementi i panjohur i përpjesëtimin; - të zgjidhen detyra mbi përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë me ndihmën e përpjesëtimin. 	<p><i>Përpjesa dhe përpjesëtimi.</i></p> <p><i>Përpjesëtimi i drejtë dhe i zhdrejtë.</i></p> <p><i>Zbatime. Përçindja.</i></p>	<p>Gjatë zgjidhjeve, formon dhe përdor ekuacione për zgjidhjen që përfshijnë përpjesëtimin e drejtë dhe të zhdrejtë; Paraqitja e tyre në mënyrë grafike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të zgjidhë detyrat me përdorimin e përpjesëtimin. - të zbatojë përpjesëtimin për njehsimin e përçindjes.
KAPITULLI: Funkzioni (12 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> - Të paraqitet bashkësia e pikave në boshtin real dhe në sistemin e koordinatave; - të përvetësohet domejthënia e shënimit: 	<p><i>Sistemi koordinativ në rrafsh;</i> <i>Funksioni linear me një ndryshore;</i> <i>Grafiku i funksionit linear.</i></p>	<p>Gjatë shtjellitimit të funksionit linear duhet të kemi kujdes të posaçëm për grafikun, për të kuptuar koeficientët k dhe n, si dhe në pozitën e pikës ndaj drejtëzës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të kuptojnë vartësinë e dy madhësive dhe të dinë ta shënojnë në mënyrë simbolike atë (në formë formule) ta paraqesin me tabelë dhe në mënyrë grafike; - të dinë për nocionin e ekuacionit,

<p>$y = f(x)$ dhe $f(a)$;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëhen shënime në formë funksioni me përpjesëtim të drejtë dhe të zhdrejtë; - të përcaktohet funksioni linear $y = kx + n$ (grafiku, domethënia e koeficienteve k dhe n, pozita e pikës ndaj drejtëzës); - në mënyrë grafike dhe me njehsim të vërtetohet a i takon pika e dhënë drejtëzës; - të përcaktohen pikëprerjet e drejtëzës me të dy boshtet e koordinatave; - në mënyrë grafike të përcaktohet pikëprerja e dy drejtëzave; - të shkruhet barazimi i drejtëzës (nëse i njohim koeficientet, apo koeficientin dhe pikën); - të përcaktohet zeroja në grafikun e funksionit linear; 			<p>leximin e grafikut, pikëprerjen me dy boshtet koordinative.</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorin njohuritë algjebrike për zgjidhjen e problemeve dhe detyra të thjeshta nga jeta e përditshme. - të interpretojnë grafikun në situata reale.
KAPITULLI: Sistemet e barazimeve lineare me dy dhe tri të panjohura (16 orë)			
- Të paraqiten grafikisht dy ek. e fuqisë së parë	<i>Sistemi i ek. të fuqisë së parë me dy apo tri te</i>	Përdoren njohuritë e fituara nga ekuacionet dhe funksionet për	- Nxënësit duhet të dinë të zëvendësojnë njëri-njëri në ekuacionin tjetër dhe

<p>me dy të panjohura; - të caktohen pikat e prerjes, apo forma e tjera; - të përdoret metoda e zëvendësimit apo e eliminimit; - të zbatohet sistemi I ekuacioneve në zgjidhjen e problemeve të thjeshta.</p>	<p><i>panjohura. Zgjidhja e sistemeve. Zgjidhja grafike. Zbatime të sistemit të ek. të fuqisë së parë me dy apo tri të panjohura.</i></p>	<p>zgjidhjen e sistemeve. Zgjidhja bëhet vetëm me metodën grafike, të zëvendësimit dhe të eliminimit të së panjohurës. Meqenëse për herë të parë nxënësi përdor sistemet me tri të panjohura, të merren forma sa më të thjeshta. Zbatimi i sistemeve bëhet në zgjidhjen e shumë problemeve nga jetá e nxënësit.</p>	<p>ta zgjidhin mandej si ekuacion linear; - të barazojnë koeficientet për eliminim në të panjohurave; - të zgjidhin sistemin e ekuacioneve me tri të panjohura; - të zbatojnë sistemin e ekuacioneve në detyra të thjeshta.</p>
---	---	---	---

KAPITULLI: Statistika dhe Probabiliteti (14 orë)

<p>- Të njihen llojet themelore të pyetjeve (po ose jo, zgjedhëse, përgjigjet numerike, përgjigjet e thjeshta e tj.); - përpiloni pyetësorin e thjeshtë. - të përcaktohet mesatarja aritmetike, modusi dhe mediana për të dhëna të cekura; - me kuptim të përcaktohet tipi i mesatares (sipas tipit të të dhënave); - të krahasohen në mënyrë kritike mesataret; - të llogaritet mesatarja</p>	<p>Përpunimi i të dhënave; <i>Planifikimi dhe përpilimi i pyetësorëve të thjeshtë. Mesatarja aritmetike; modusi; mediana; devijimi; Sinteza e njohurive: përdorimi i veglave të mësuara (makinat llogaritëse, grafikët, tabelat etj.) Përvojat me ngjarje të rastësishme: .nacionet; ngjarja, rezultati; gjasa ; ngjarja: e pamundshme, e sigurt, me gjasë të njëjtë e tj.</i></p>	<p>Nuk është e menduar, që nxënësi të mësohet t'i punojë pyetësorët, por ta kuptojë kufizimin lidhur me përdorimin e tyre dhe të zbulojë çfarë informatash mund të mblidhen me pyetësorin dhe në ç'masë duhet t'u besohet përgjigjeve. Të kuptojë mesataren aritmetike dhe ta zbatojnë në mënyrë praktike. Të vlerësojnë modusin dhe të dallojnë medianën. Të dizajnojnë, të përdorë fleta dhe mjete të tjera, të bëjnë eksperimente dhe prova. Të dizajnojnë dhe të përdorë tabela, grafikë, slajde për paraqitjen e të dhënave Të kuptojë se gjatë grumbullimit të të dhënave bëhen devijime dhe t'i gjejë</p>	<p>- Të jenë aktivë në punën në grupe për planifikimin e pyetësorëve ; - të kenë qëndrim kritik për llojet e pyetësorëve; - të përdorin mënyrat e përshtatshme për mbledhjen e të dhënave; të dhënat e mbledhura t'i paraqesin me diagrame të përshtatshme. - të krahasojnë në mënyrë kritike mesataren, të llogarisin; - të dijnë të përdorin kalkulatorin apo ndonjë mjet tjetër; - në mënyrë kritike të vlerësohen veglat për mbledhjen e të dhënave dhe mbi mënyrat e paraqitjes së të dhënave; -- llojet e ngjarjeve dhe të përdorin konceptin e probabilitetit, për raste të thjeshta.</p>
--	---	--	--

<p>me llogaritar xhepi dhe me tabelë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktohet dhe të paraqitet grafikisht distanca »interkuartile«. - të zgjedhet mënyrë e përshtatshme për mbledhjen e të dhënave dhe për paraqitjen e tyre; - në mënyrë kritike të vlerësohen veglat për mbledhjen e të dhënave dhe për mënyrat e paraqitjes së të dhënave; - të zgjedhet mënyrë e përshtatshme për mbledhjen e të dhënave dhe për paraqitjen e tyre; - në mënyrë kritike të vlerësohen veglat për mbledhjen e të dhënave dhe për mënyrat e paraqitjes së të dhënave. <p>të përfitohen përvojat mbi gjasën e shprehur numerikisht.</p>		<p>dhe vlerësojë ato.</p> <p>Nxënësi vërteton, përkatësisht vlerëson me prova gjasën e ngjarjes (duke qenë i vetëdijshëm për domethënien e numrit të provave).</p> <p>Në bazë të analizës me drurin kombinatorik i parashikon rezultatet.</p>	
---	--	---	--

Informatika

INFORMATIKA

3 orë në javë, 105 orë në vit

HYRJE

Qëllimi

Përvetësimi i njohurive dhe e shkathtësive të nevojshme për përdorimin e suksesshëm dhe të pavarur të pajisjeve të teknologjisë informative dhe komunikuese.

Parimet e përgjithshme:

- Theksi në përvetësimin e shkathtësive;
- Demonstrimi;
- Puna individuale dhe grupore;
- Njohja me parimet e funksionimit të aplikacioneve.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Njohja e komponenteve hardverike dhe softverike të sistemit kompjuterik;
- Përdorimi i sistemit operativ Windows;
- Përdorimi i aplikacioneve (MS Word, programet e integruara në Windows);
- Përdorimi i Internetit.

QËLLIMET E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET QË DUHET ARRITUR
Tema 1: Sistemet numerike, Njësia për sasinë e informatës dhe kodet			
Fondi i orëve: 4			
Njohja me sistemin dekad dhe binar. Përkufizimi i njësisë për sasinë e informatës. Kuptimi i kodeve	Sistemi dekad, sistemi binar, konvertimi dekad-binar dhe, binar-dekad, operacionet aritmetikore me numra binarë (mbledhja, zbritja) Biti, Byte-i, shumëfishat e bitit dhe byte-it. Kodi ASCII	Ligjërimi i përmbajtjes programore, ushtrime numerike për operacionet aritmetikore me numra binarë, ushtrime numerike për operacionet e shndërimit byte në bit, shumëfishat, kilo, mega, giga, tera bit (byte) Ushtrime me simbolet e Kodit ASCII (shkronjat e gjuhës shqipe: Ë, ë, Ç, ç, etj.)	Dituri të përvetësuarra për sistemin binar, zotërimi i operacioneve aritmetikore me numra binarë, operacionet me shumëfisha të bitit dhe byte-it
Tema 2: Sistemi kompjuterik			
Fondi i orëve: 2			
Nocioni i sistemit kompjuterik; Njohja me hardverin, softverin dhe shfrytëzuesit e sistemit kompjuterik	Sistemi kompjuterik, hardveri, softveri, shfrytëzuesit (njeriu, kompjuterët e tjerë, pajisjet teknologjike të proceseve). Ndërlidhja.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, paraqitja e komponenteve hardverike dhe softverike.	Identifikimi i pjesës hardverike dhe softverike të sistemit kompjuterik
Tema 3: Hardveri			
Fondi i orëve: 4			
Njësia qendrore, njësitë hyrëse dhe dalëse, kujtesa	Njësia qendrore, funksioni modelet e procesorëve, cilësitë: gjatësia e fjalës procesorike, shpejtësia e punës, frekuenca e punës. Njësitë hyrëse dhe dalëse, funksioni, llojet: monitori, tastiera, miu, ploteri, skeneri, kamera	Ligjërimi i përmbajtjes programore, prezentimi vizuel i komponenteve hardverike, demonstrimi i montimit të kompjuterit.	Identifikimi i komponenteve të ndryshme të sistemit kompjuterik, njohja e cilësive të komponenteve

	<p>digjitale, modemi, kartela e rrjetit, kartela e zërit me altoparlanta, njësitë e CD-ve, disketave, DVD-ve, zipat.</p> <p>Memoria, funksioni, mediumet e memories: gjysëmpërçuese (RAM, ROM, EPROM) optike (CD, DVD) dhe magnetike (disqet, disketat, shiritat), kapaciteti, shpejtësia, organizimi: memoria qendrore, kesh memoria, memoria e jashtme (periferike)</p>		
--	---	--	--

Tema 4: Softveri

Fondi i orëve: 2

<p>Njohja me kuptimin e softverit, funksionin e softverit sistemor dhe aplikativ</p>	<p>Softveri sistemor (sistemi operativ), shembuj: sistemi operativ DOS, UNIX, Windows;</p> <p>Softveri aplikativ, shembuj: Paketete për zhvillimin e aplikacioneve (Visual Basic, Access, etj.), programet për zyrë (MS Office), programet për disenj, multimedia;</p> <p>Ndërlidhja e softverit me hardverin dhe shfrytëzuesit</p>	<p>Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i përdorimit të sistemeve operative (veprime themelore për DOS dhe Windows) dhe programeve të ndryshme aplikative (Word, Excell, Acces, Corel, etj.)</p>	<p>Dallimi i funksionit të sistemit operativ nga aplikacionet softverike. Identifikimi i aplikacioneve softverike për përdorime praktike.</p>
--	---	---	---

Tema 5: Sistemi operativ			
Fondi i orëve: 14			
Njohja me sistemin operativ Windows	Lëshimi në punë, paraqitja në sistem. Desktopti, ikonat, dritaret, dialogjët, etj. Startimi dhe mbyllja e programeve. Folderët dhe fajllat, operacionet: hapja, mbyllja, krijimi, fshirja, kopjimi, shtypja, etj. Konfigurimi i Windows-it: Control Panel (Display, Time, etj.). Çlajmërimi, ristartimi, ndalja e Windowsit.	Ligjerimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore	Aftësimi i nxënësve për kryerjen e operacioneve themelore në Windows
Tema 6: Programet aplikative			
Fondi i orëve: 26			
Njohja me aplikacione të integruara në Windows Njohja me programin aplikativ MS Word.	Programet e integruara në Windows: Windows Media Player, Notepad, Calculator, Paint, etj. MS Word Startimi. Shkruarja e tekstit, shkronjat e vogla dhe të mëdha, fontet, madhësia e shkronjave. Ruajtja, hapja, mbyllja e dokumentit, dalja nga programi. Editimi (insertimi i tekstit, selektimi, fshirja, kopjimi, zhvendosja, etj.). Insertimi dhe vizatimi i objekteve. Tabelat. Shtypja e dokumentit.	Ligjërimi i përmbajtjes programore, demonstrimi i ekzekutimit të operacioneve, puna individuale dhe grupore.	Aftësimi i nxënësve për kryerjen e operacioneve themelore të MS Word-it dhe të aplikacioneve të integruara në Windows

Tema 7: Interneti			
Fondi i orëve: 2			
Njohja me zhvillimin historik, përdorimi i Internetit, Interneti si rrjetë globale.	Nevoja e shkëmbimit të të dhënave nëpërmes kompjuterëve; Paraqitja e Internetit. Ofruesi i shërbimeve të Internetit (provider-i). Lidhja në Internet përmes rrjetit lokal (kartela e rrjetit, kabloja, hub-i/switch-i, router-i). Lidhja në Internet përmes telefonit (modemi, lidhja telefonike). Protokollet, IP numrat, domeni, adresa. Aplikacionet: World Wide Web, E-mail, transfer i fajllave (FTP), etj.	Ligjerimi i përmbajtjes programore. Prezentimi i pajisjeve hardverike të nevojshme për lidhje në Internet të përmendura në përmbajtje. Vizitë ofruesve të shërbimeve të Internetit dhe Internet Caffe-ve.	Dituri të përvetësuarra për Internetin. Identifikimi i pajisjeve hardverike, softverike dhe komunikuese për lidhje në Internet
Tema 8: Internet Explorer			
Fondi i orëve: 16			
Njohja me programin Internet Explorer.	Startimi. Adresa e Web faqes. Struktura e Web faqes (linkat, menytë, kornizat). Operacionet (kopjimi, shtypja, download, etj.). Web faqe interesante. Kërkimi në Internet (Search Engines, Google, Ask, Altavista, etj.) Web mail – Hotmail, Yahoo. Hapja e llogarisë, shkruarja e porosisë, bashkëngjitja e fajllave (attachments), dërgimi, pranimi, ruajtja, shtypja.	Ligjërimi i përmbajtjes programore. Demonstrimi i punës me Internet Explorer. Puna individuale dhe grupore	Aftësimi i nxënësve për përdorimin e Internet Explorerit, kërkimin e informatave në Internet, hapjen e e-mail adresave, pranimin dhe dërgimin e porosisë, etj.

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. *Dr. Agni Dika, Mr. Seb Rodiqi, Kompjuterët dhe Informatika*, për nxënësit e kl. I të shkollës së mesme, Prishtinë, 2001
2. *Dr. Agni Dika, Seb Rodiqi, Kompjuteri për të gjithë*
3. *Mr. Salem Lepaja, Lule Ahmedi, Kompjuterika dhe komunikimet* për studentët e shkollës së lartë pedagogjike
4. Literatura në gjuhën angleze për: **Windows 95, Windows 98, Windows 2000, Windows XP, MS Office 97, MS Office 2000, MS Office XP, Internet Explorer**, etj.
5. Udhëzimet e integruara në Windows dhe aplikacionet MS Office dhe Internet Explorer

Pajisjet dhe parakushte të tjera të nevojshme

1. Kabineti me kompjuterë dhe shtypës;
2. Aplikacionet e nevojshme softerike;
3. Lidhja në Internet, rrjeti lokal në kabinet;
4. Komponente hardverike për demonstrim;
5. Trajnime për arsimtarë;
6. Mirëmbajtja.

Kushtet minimale

1. Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor
2. Trajnime për arsimtarë

VËREJTJE

1. Për shkolla që nuk kanë lidhje në Internet propozohet shfrytëzimi i kabineteve në shkollat të cilat i kanë këto kushte të nevojshme. Nëse kjo mundësi nuk ekziston propozohen vizitat në Internet Caffë-të;
2. Nëse shkolla nuk ka kompjuterë të potencohen aspektet teorike të temave të parapara në program dhe demonstrimi nëse shkolla ka së paku një kompjuter;
3. Në fondin e paraparë të orëve janë të përfshira ligjërimi, përforcimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.
4. Nëse shkolla nuk ka kompjuterë ose lidhje në Internet propozohet që fondi i orëve të shpërndahet në temat etjera për të cilat këto kushte nuk janë të nevojshme.

UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh. ligjërimi 25%, demonstrimi 25 %, puna individuale dhe grupore 50%;
2. Inkurajimi i punës individuale, shkëmbimi i dijes dhe i shkathtësive, puna interaktive;

3. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara

VLERËSIMI

Vlerësimi i suksesit të nxënësve duhet të bëhet me shrim dhe me gojë për pjesën teorike të programit mësimor, ndërsa për pjesën praktike në bazë të nivelit të kryerjes së operacioneve praktike të punës me kompjuter.

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale

1.1. Shkëmbimi i informatave përmes medimeve të ndryshme si disketat, CD-ROM-at, zip disqet, rrjetit lokal kompjuterik

1.2. Krijimi i dokumenteve më të përbëra me vizatime, tabela, stile të ndryshme – shembull: Gazeta e klasës ose shkollës, etj.

2. Krijimi i përmbajtjeve për Internet (Web design) dhe aplikacioneve softwareike (programimi);

2.1. Njoftimi i nxënësve për ekzistimin dhe mundësitë e software-it për krijimin e Web faqeve dhe programeve aplikative;

2.2. Grupi i programerëve të shkollës.

Biologji

BIOLOGJI

1 orë në javë, 35 orë në vit

1. PARATHËNIE

Zhvillimi i programit mësimor i lëndës së biologjisë është sajuar mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, metodat dhe instrumentet e vlerësimit. Ky program më tepër është i përqendruar në atë se çfarë dhe cilat lloje të rezultateve të të nxënit duhet t'i arrijë nxënësi, çka duhet të punojë mësuesi.

2. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e nëntë siguron mundësinë e mirë për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e aftësive të tij për të njohur ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, organizimin, ndërtimin dhe zhvillimin e botës së gjallë.

Zhvillimi i shkathtësive për të konsultuar literaturën relevante dhe mbledhjen e informatave shkencore në mënyrë të pavarur.

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e nëntë i siguron nxënësit përvojën e zhvillimit të mëtejme:

- Në njohjen dhe të kuptuarit e botës së gjallë;
- Të aftësive për identifikimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave relevante shkencore
- Të shkathtësive për të komunikuar me kompetencë për çështje të ndryshme në fushën e biologjisë;
- Në komentimin dhe në vlerësimin e ndërlikueshmërisë dhe madhësisë së proceseve dhe fenomeneve biologjike;
- Në njohjen e veçorive të ndryshme të ekosistemeve të Kosovës
- Të vlerësimit të pozitës së pabarabart të njeriut në biosferë në kuptimin e krijimit të përparësive dhe pasojave për mjedisin jetësor;
- Të aftësive që shkathtësitë e asimiluara të shkencës së biologjisë t'i përdorë në situata të së përditshmes.

3. ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Përmbajtja e lëndës është organizuar në theksimet e tërësive kryesore apo thelbësore të lëndës së biologjisë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të lëndës së biologjisë për klasën e nëntë.

Organizimi i përmbajtjes (shih fq. 10) përfshin:

- Ndërtimin;
- Balancimin;
- Mbarështrimin.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin katër tërësi mësimore kryesore me anë të të cilave përfshihet fundamenti i lëndës.

Ndërtimi i lëndës është bërë mbi bazën e theksimeve të balancuara të përmbajtjes sipas rëndësisë së tërësive mësimore.

Tab.1. Organizimi i përmbajtjes së lëndës

Nr.	Tërësitë mësimore	Orë mësimi	%
1.	Ndërtimi dhe funksioni i sistemeve të gjalla	16	45
2.	Cikli jetësor i organizmave	4	11
3.	Organizmi dhe mjedisi jetësor	5	14
4.	Biodiverziteti dhe evolucioni	3	9
5.	Punë praktike	4	11
6.	Orë në dispozicion	3	9
	Numri i përgjithshëm i orëve	35	100

Mbarështrimi i përmbajtjes së lëndës në klasë bëhet për jo më pak se 35 orë mësimi, sipas kësaj trajte:

- Tërësia mësimore;
- Qëllimi;
- Përmbajtja programore;
- Rezultatet e pritura;
- Ndërlidhja.

4. TËRËSITË MËSIMORE

4. 1. NDËRTIMI DHE FUNKSIONI I SISTEMEVE TË GJALLA (16 orë)

A. Qëllimi

Është që nxënësit të:

- Njohin dhe kuptojnë veçoritë themelore të qenieve të gjalla nëpërmjet ndërtimit dhe funksionit të sistemeve kryesore organike;
- Identifikojnë, përshkruanëj dhe vlerësojnë konceptet dhe parimet themelore në ndërtimin dhe në funksionin e sistemeve organike;
- Analizojnë dhe kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet e ndërtimit dhe funksionit të sistemeve organike.

B. Përmbajtja programore

1. Qeniet e gjalla që të kryejnë funksionet e ndryshme jetësore janë të ndërtuara nga: njësia themelore – qeliza, indet, organet dhe sistemet e organeve.
2. Bimët janë të ndërtuara nga *indet* themelore: meristema, indi gardhor etj. dhe *organet* bimore: organet vegetative dhe riprodhuese.

3. Proceset thelbësore jetësore te bimët – *fotosinteza*.
4. Kafshët sikur edhe bimët kanë nevoja të ndryshme jetësore të cilat i plotësojnë në rrugë të ndryshme nëpërmjet funksionit të indeve, të organeve dhe të sistemeve themelore organike si,
 - Sistemi për lëvizje;
 - Sistemi për tretjen e ushqimit;
 - Sistemi për qarkullimin e gjakut;
 - Sistemi i frymëmarrjes;
 - Sistemi urogjenital;
 - Sistemi nervor, shqisat dhe
 - Sistemi endokrin.
5. Njeriu ballafaqohet me sëmundje të ndryshme bashkëkohore të shërueshme dhe të pashërueshme.

C. Rezultatet e pritura

Nxënësit në fund të klasës së nëntë nga kjo përmbajtje mësimore duhet të:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe me funksionin e sistemeve të gjalla;
- b. Të hulumtojnë dhe të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e qelizës, të indeve, të organeve dhe të sistemeve kryesore organike;
- c. Të bënëj dallimin e planit organizativ ndërmjet bimëve dhe kafshëve;
- ç. Të përshkruajnë ndërlidhjen e ndërtimit dhe të funksionit ndërmjet organeve të ndryshme;
- d. Të shpjegojnë rolin e proceseve thelbëore jetësore – *fotosintezës, frymëmarrjes, qarkullimit të materieve dhe kontrollit*;
- dh. Të kuptojnë si organizmat janë në gjendje ta mirëmbajnë mjedisin e brendshëm të tyre nga infeksionet, ndotësit etj.;
- e. Të parashikojnë çka do të ndodhë nëse një organ nuk funksionon, çrregullohet puna e tij ose e humb funksionin;
- ë. Të analizojnë, sintetizojnë dhe shfrytëzojnë parimet themelore të ndërtimit dhe të funksionit të sistemeve të gjalla në jetën e përditshme të tij.

D. Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- *Kiminë*, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të qelizës
- *Fizikën*, në aspektin e njohjes së ligjshmërive fizike, si qarkullimi i materieve – osmoza, difuzioni etj.

4. 2. CIKLI JETËSOR I ORGANIZMAVE (4 orë)

A. Qëllimi

Është që nxënësit:

- Të kuptojnë rëndësinë thelbësore të procesit të shumimit;
- Të identifikojnë, përshkruajnë dhe vlerësojnë fazat kryesore të një cikli jetësor të organizmave të ndryshëm;

- Të kuptojnë dhe të shpjegojnë për ngjashmërinë dhe ndryshueshmërinë e pasardhësve me prindërit.

B. Përmbajtja programore

1. Bimët dhe kafshët i kanë të zhvilluara organet për shumim në të cilat prodhohen qelizat seksuale. Qelizat seksuale bashkohen (frytëzimi) pastaj vijon zhvillimi embrional, lindja, rritja, lënia e pasardhësve dhe vdekja;
2. Baza molekulare e cila siguron trashëgimin e vetive tek pasardhësit. Si pasojë e gabimeve në bazën gjenetike të qelizave seksuale, shfaqen sëmundje trashëguese tek organizmat.

C. Rezultatet e pritura

Nxënësit në fund të klasës së nëntë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor dhe trashëgimit;
- b. Të kuptojnë dhe të përshkruajnë procesin e formimit të qelizave seksuale, frytëzimin dhe zhvillimin embrional;
- c. Të hulumtojnë dhe të përshkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të zhvillimit embrional dhe trashëgimit tek organizmat e ndryshëm;
- ç. Të përshkruajnë mekanizmin e trashëgimit të vetive të pasardhësit;
- d. Të hulumtojnë dhe të demonstrojnë fazat kryesore të zhvillimit embrional të shpendët, (në shembullin e zogut të pulës);
- dh. Të parashikojnë përcaktimin e seksit të njeriu;
- e. Të vlerësojnë rolin e shumimit dhe të trashëgimit në zhvillimin e botës së gjallë.

D. Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- *Kiminë* për të njohur përbërjen kimike të materialit trashëgues dhe enzimave;
- *Anatominë*, fiziologjinë dhe biokiminë.

4. 3. ORGANIZMI DHE MJEDISI JETËSOR (5 orë)

A. Qëllimi:

Është që nxënësit:

- Të njohin dhe të kuptojnë ndërvartësinë e organizmave me mjedisin jetësor;

- Të identifikojnë, të përshkruajnë dhe të demonstrojnë ndikimin e faktorëve kryesorë të mjedisit në sigurimin e kushteve jetësore për qeniet e gjalla;
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë dobitë dhe pasojat e veprimit të njeriut në biosferë.

B. Përmbajtja programore

1. Organizmat janë të varur nga kushtet e mjedisit jetësor dhe nga marrëdhëniet ndërmjet organizmave—*nocionet themelore ekologjike*;
2. Në ekosistem dhe në biosferë bëhet *qarkullimi i vazhdueshëm i materies dhe i energjisë*;
3. Organizmat krijojnë marrëdhënie të ngushtë me mjedisin jetësor pa ndërmjetësimin e njeriut—*ekosistemet natyrore* dhe me ndërmjetësimin e njeriut—*ekosistemet artificiale (urbane dhe rurale)*;
4. Ndikimi i njeriut në mjedisin jetësor shpesh ndikon në ndërrimet e kushteve fizike dhe kimike të tij (*ndotja*), por njeriu gjithashtu ndërmerr masa të ndryshme për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor.

C. Rezultatet e pritura

Nxënësit në fund të klasës së nëntë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore në ekologji;
- b. Të kuptojnë dhe të përshkruajnë procesin e qarkullimit të materies në ekosistem;
- c. Të vërejnë dhe të shpjegojnë marrëdhëniet e organizmave në ekosistemet natyrore;
- ç. Të krahasojnë, të analizojnë dhe të vlerësojnë shkallën e ndryshueshmërisë ndërmjet ekosistemeve artificiale dhe atyre natyrore;
- d. Të identifikojnë treguesit e ndotjes së mjedisit jetësor;
- dh. Të parashikojnë ndryshimet e mjedisit jetësor të vendbanimit ku jetojnë.

Ndërlidhja

Përmbajtja programore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- *Kiminë*, në aspektin e njohjes së përbërjes kimike të dheut, ndërrimeve cilësore të mjedisit jetësor
- *Fizikën*, në pikëpamjen e njohjes së faktorëve fizikë dhe ndryshimeve fizike të mjedisit jetësor;
- *Sistematikën*, njohjen e llojeve si ndërtues të sistemeve ekologjike;
- *Evolucionin, zoogeografinë* etj.

4. 4. BIODIVERZITETI DHE EVOLUCIONI (3 orë)

A. Qëllimi

Është që nxënësit:

- Të vërejnë, të njohin dhe të kuptojnë se bota e gjallë është e përbërë prej një laryshie të madhe të llojeve bimore dhe shtazore;
- Të kuptojnë dhe të përshkruajnë procesin e seleksionimit natyror dhe artificial të qenieve të gjalla
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e faktorëve të ndryshëm të evolucionit në procesin e krijimit të llojeve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve

B. Përmbajtja programore

1. Zanafilla e jetës dhe zhvillimi i botës së gjallë;
2. Organizmat bimorë dhe shtazorë janë zhvilluar në kushte të ndryshme të mjedisit jetësor dhe kanë qenë të varur nga faktorë të ndryshëm të evolucionit;
3. Organizmat gjatë zhvillimit të tyre u janë nënshtruar seleksionimit natyror dhe pastaj me ndërhyrjen e njeriut seleksionimit artificial;
4. Organizmat janë të sistematizuar në kategori të ndryshme sistematike.

C. Rezultatet e pritura

Nxënësit në fund të klasës së nëntë nga kjo përmbajtje mësimore duhet:

- a. Të njohin dhe të zbatojnë fjalët dhe përkufizimet kryesore që kanë të bëjnë me biodiversitetin dhe evolucionin;
- b. Të analizojnë dhe të përshkruajnë faktorët e ndryshëm evolutiv që ndikuan në zhvillimin dhe në përsosjen e qenieve të gjalla;
- c. Të hulumtojnë dhe të kuptojnë rolin e seleksionimit natyror dhe artificial;
- ç. Të analizojnë dhe të vlerësojnë rolin e njeriut në biodiversitet;
- d. Të përshkruajnë procedurën e procesit të sistematizimit të llojeve të ndryshme në kategori të ndryshme sistematike.

D. Ndërlidhja

Përmbajtja mësimore e kësaj tërësie mësimore ka ndërlidhje me:

- *Gjeografinë*, në kuptimin e njohjes së përbërjes së shtresave të ndryshme të dheut;
- *Ekologjinë*, në kuptimin e njohjes së faktorëve të ndryshëm të mjedisit jetësor në procesin e zhvillimit evolutiv dhe diverzitetit;
- *Gjenetikën*, në aspektin e njohjes së ligjshmërive të trashëgimit në procesin e krijimit të llojeve.

5. PUNËT PRAKTIKE (4 orë)

Me fjalën punë praktike kuptojmë aktivitetet që kryejnë nxënësit në natyrë dhe në laborator. Këto punë kryhen me qëllim konkretizimi të pjesës teorike të lëndës.

Në mungesë të laboreve, punët praktike mund të kryhen edhe në klasë, me kusht që materiali dhe mjetet e punës të parapara për punë praktike paraprakisht të sillen në klasë.

Punët laboratorike nuk janë ndonjë metodë e veçantë e mësimit por janë formë organizimi e punës mësimore gjatë së cilës nxënësit në bashkëpunim me arsimtarin vrojtojnë strukturat, proceset dhe fenomenet e ndryshme gjatë eksperimentit, diseksionit dhe teknikës së mikroskopimit.

Punët praktike të cilat do të duhej të realizoheshin në mësimin e biologjisë për klasën e nëntë janë:

- Demonstrimi i punës me mikroskop – të vërejturit e qelizës bimore; në epidermën e bulbit të qepës ose qelizën shtazore; në mukozën e gojës të njeriu;
- Ndërtimi anatomik i gjethit dhe sqarimi i procesit të fotosintezës;
- Lulja dhe ndërtimi i saj;
- Vrojtimi i organeve të frymëmarrjes të peshqit dhe të gjitarët;
- Të vërejturit e organeve të ekskretimit të shtazët (insektet–bumalla (brumbulli), amfibet-bretkosa);
- Të vërejturit e organeve të qarkullimit të gjakut të bretkosa.

Mbetet kompetencë e arsimtarit që sipas kushteve që ka në shkollë të vendos për mënyrën e realizimit të domosdoshëm të katër ushtrimeve.

6. METODOLOGJIA- UDHËZIME DIDAKTIKE

Mësimi në biologji si dhe në çdo punë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.t.h mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim që realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike.

Mendohet se çdo lëndë përpos metodave të përgjithshme mësimore i ka edhe metodat e saja të veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimin e biologjisë, përmendim:

- Metoda e të shprehurit me gojë (monologu);
- Metoda e bashëbisedimit (dialogu);
- Metoda e punës me tekst;
- Metoda e demonstrimit;
- Metoda e punës laboratorike etj.

Përpveç metodave të lartshënuara, në shkollat ku arsimtarët janë trajnuar për zbatimin e metodave dhe të strategjive të reja të mësimdhënies përmes punës në grupe me nxënës në qendër, mund të zbatohen edhe teknikat e mësimdhënies sipas metodologjisë të menduarit kritik gjatë leximit dhe shkrimit.

Çdo metodë mësimore i ka anët pozitive dhe negative. Kjo do të thotë se me zbatimin e një metode të vetme mësimore nuk mund të realizohen të gjitha qëllimet dhe detyrat e mëimit të lëndës së biologjisë. Prandaj ato patjetër duhet të kombinohen në vartësi nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat të cilat synohen të realizohen.

Në praktikë thuaj se nuk ekziston orë e biologjisë në të cilën aplikohet vetëm një metodë mësimore. Me zbatimin e disa metodave mësimore në të njëjtën orë të mëimit, ora bëhet më dinamike, thyhet monotonia dhe ngritet interesimi i nxënësve për mësim.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore e freskon mësimin, e bënë atë më interesant, me çka arrihet që rrezultatet në nxënje të jenë më të mira.

Për realizimin sa më të mirë të qëllimeve të parashtruara në orë mësimore duhet të punojmë në frymën e parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e ndërlikuara, prej konkretes kah abstraktja dhe prej të përgjithshmes kah e veçanta.

7. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të biologjisë së biologjisë për klasën e nëntë rekomandohet përdorimi i këto burime dhe mjete mësimore:

- **Biologjia** për klasën V, botoi **Libri Shkollor**, Prishtinë;
- **Biologjia** për klasën VI, botoi **Libri Shkollor**, Prishtinë;
- **Biologjia** për klasën VII, botoi **Libri Shkollor**, Prishtinë;
- **Biologjia** për klasën VIII, botoi **Libri Shkollor**, Prishtinë;
- **Biologjia** për kl I të shkollës së mesme, ETMMK, Prishtinë, 1983.

Krahas tekstit shkollor si burim tradicional i mësimnxënies, për zbatimin e suksesshëm të përmbajtjeve mësimore sygjerohet edhe përdorimin e doracakëve, si ndihmë shtesë në procesin mësimor (atlas botanik, zoologjik, anatomik, fjalori terminologjik etj).

Është kompetencë arsimtarit që në vartësi prej kushteve në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuele, auditive dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kimi

KIMI

1 orë në javë, 35 orë në vit

HYRJE

Lënda e kimit si shkencë natyrore, ku për bazë ka njohuritë, rezultatet e shkencave të tjera (fizikës, biologjisë, matematikës, informatikës, gjeologjisë etj.), dhe eksperimentin, vazhdimisht zhvillohet, begatohet me zbulime të reja. Kjo sikur obligon nevojën e risive permanente edhe të kurrikulit me rezultate dhe fakte të reja shkencore.

Në këtë kurrikul i është dhënë theks i veçantë njohurive që kanë karakter formues për arritjen dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive të kimit që u ndihmojnë nxënësve për t'u ballafaquar me probleme konkrete në jetë, për profesionet e ardhshme. Realizimi i këtij kurrikuli nënkupton edhe krijimin e kushteve dhe standardeve themelore materiale – teknologjike të shkollës dhe arsimit në tërësi.

Qëllimi i lëndës së kimit në klasën e nëntë (IX) është që nxënësit t'i zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë nga kimia e përgjithshme, inorganike dhe organike, që do t'u shërbejnë në jetë dhe në praktikë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe si bazë për vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm në shkolla të mesme dhe të larta.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Arritja e njohurive për lëndën e kimit si shkencë natyrore;
- Pozitën dhe lidhshmërinë e kimit me shkencat e tjera;
- Nxënien e nocioneve themelore dhe njohurive bazë nga kimia e përgjithshme, inorganike dhe organike;
- Njohja me ligjshmëritë dhe dukuritë fizike dhe kimike të materies;
- Arritja e aftësive e të vërejturit të ndryshimeve fizike dhe kimike si dhe rrethanave të shkaktarëve që kushtëzojnë paraqitjen e tyre;
- Njohja me gjuhën dhe nomenklaturën kimike sipas IUPAC;
- Njohja me të mirat që kimia ia sjellë njerëzimit;
- Krijimi i shprehive dhe shkathësive për punë, përdorimi i aparateve, teknikave dhe metodave laboratorike dhe sjellja e tyre në laborator;
- Lënda e kimit ndihmon në formimin e personalitetit të nxënësit;
- Aftësia e gjykitimit të drejtë ndaj dukurive, krijimi i ndërdijes për nevojën e vërtetimit të fakteve, të menduarit kritik etj.;
- Aftësia kreative e implementimit të njohurive teorike në praktikë (në industrinë ushqimore, në mjekësi, në farmaci, në bujqësi etj.;
- Zhvillimi i aftësive për aktivitet të pavarur shkencor, duke shfrytëzuar informacione nga burime të ndryshme;
- Synon në arritjen e efekteve në bashkërenditjen dhe kooperimin e organizuar në kuadër të shkollës edhe me komunitetet jashtë shkollore për probleme të rrafshit më të gjërë, siç është: ruajtja e mjedisit, efektet urbane dhe problemet më të gjëra ekonomike-shoqërore që janë të lidhura me punën e shkollës.

QËLLIMET E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET QË DUHET ARRITUR
Tema:			
<p>Lëndat e kimisë si shkencë natyrore dhe lidhja e saj me shkencat e tjera: fizikën, biologjinë, matematikën, informatikën etj.</p> <p>Kuptimi dhe përkufizimi i materies dhe substancës.</p> <p>Njohja me laboratorin e kimisë në të cilin zhvillohet puna eksperimentale.</p> <p>Njohja me atomin si mikrobotë.</p> <p>Pjesët përbërse të atomit, e në veçanti për strukturën elektronike.</p> <p>Njohja me gjuhën kimike nga aspekti cilësor dhe sasior.</p> <p>Shprehja matematikore e raporteve të ndërtimit të produkteve të reaksioneve kimike nga reaktantët.</p>	<p>KIMIA SI SHKENCË NATYRORE (2)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Materia dhe substanca - Laboratori i kimisë dhe masat e mbrojtjes <p>STRUKTURA E ATOMIT (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grimcat themelore; - Nivelet dhe nënivelet energjetike; - Orbitalet atomike dhe numrat kuantikë. <p>REAKSIONET KIMIKE (4)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simbolet (shenjat), formulat dhe barazimet kimike; - Moli, masa molare dhe vëllimi molar; - Ushtrime numerike dhe laboratorike. 	<p>Zbatohen metoda të shumëlloshme: metoda e shpjegimit, bisedës dhe ajo laboratorike. Mësimi të zhvillohet në laboratorin ose kabinetin e kimisë ku nxënësit konkretisht shohin veglat dhe pajisjet e laboratorit.</p> <p>Zbatohet metoda: e shpjegimit, e bisedës dhe e demonstrimit, duke përdorur modele, vizatime, fotografi, filma etj.</p> <p>Vlerësimi i nxënësve bëhet me anë të debatimit dhe testimit.</p> <p>Zbatohet metoda: e shpjegimit, e bisedës dhe e demonstrimit ku përdoren kimikate, vegla dhe pajisje laboratorike, modele, fotografi, vizatime etj.;</p> <p>Vlerësimi bëhet me forma të ndryshme: me test, me punën praktike individuale dhe grupe.</p>	<p>Nxënësit të kuptojnë nocionin e materies dhe të substancës si pjesë përbërëse të natyrës.</p> <p>Rolin e laboratorit kimik, masat mbrojtëse dhe veprimet që duhet ndërmarrë në raste rreziku, infrastrukturën laboratorike: veglat, enët, aparatet, kimikatet etj.;</p> <p>Nxënësit të arrijnë parafytyrim të qartë për strukturën e atomit si mikrobotë.</p> <p>Raportin në mes të strukturës së brendshme dhe elektronike të tij;</p> <p>Kuptimi cilësor dhe sasior i simboleve dhe i formulave kimike;</p> <p>Paraqitja e reaksioneve kimike me ndihmën e simboleve dhe formulave kimike;</p> <p>Shprehja matematikore e molit përmes masës, masës molare dhe vëllimit molar.</p> <p>Në mënyrë të pavarur të bëjnë llogaritjet stekimometrike të këtyre madhësive.</p>

<p>Njohja me parimin e ndërtimit të sistemit periodik; Karakteristikat e elementeve sipas pozitës së tyre në sistemin periodik.</p>	<p>PARIMI I NDËRTIMIT TË SISTEMIT PERIODIK(1)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Energjia e jonizimit; - Afiniteti ndaj elektronit; - Elektronegativiteti. 	<p>Zbatohet metoda: e shpjegimit, bisedes dhe demonstrimit. Përdorën mjete të ndryshme siç janë: Sistemi periodik, fotografi, vizatime etj.</p>	<p>Arrihet kuptimi i ligjshmërisë të ndërtimit të sistemit periodik. Kuptimi i vetive të çdo elementi në bazë të pozitës së tij në sistemin periodik.</p>
<p>Kuptimi mbi strukturën e molekulës; Forcat tërheqëse që i mbajnë atomet në molekulë, përkatësisht individë formulorë.</p>	<p>STRUKTURA E MOLEKULËS (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhja jonike; - Lidhja kovalente; - Lidhja koordinative; - Lidhja hidrogjenore; - Lidhja metalike. 	<p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës dhe e demonstrimit. Përdoren këto mjete mësimore: modele të rrjetave kristalore të ndryshme, substanca të ndryshme, fotografi, skica etj.</p>	<p>Të kuptuarit e formimit të strukturës së molekulës përmes lidhjeve kimike të njëjta dhe të ndryshme. Kuptimi i vetive karakteristike të substancave si pasojë e lidhjeve kimike të ndryshme.</p>
<p>Njohja me sistemet e përbëra materiale në të gjitha gjendjet agregate (tretësit dhe në veçanti substancat e tretura) si pjesë e natyrës.</p>	<p>TRETËSIRAT (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e tretësirave sipas madhësisë së grimcave; - Përqendrimi i tretësirave; - Ushtrime laboratorike. 	<p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës, e demonstrimit dhe e punës laboratorike. Përdoren mjete dhe kimikate të ndryshme. Si tretës kryesisht merret uji, ndërsa substanca që treten të merren ato që janë në gjendje të ngurtë të lëngët;. Vlerësimi të bëhet me test dhe punë praktike.</p>	<p>Kuptimi i tretësirave dhe i përqendrimit të tyre; Përgatitja dhe përdorimi i tyre në jetën e përditshme, por duke veçuar aspektin fiziologjik dhe laboratorë të ndryshëm.</p>

<p>Njohja me materiet bazë të kimisë inorganike. Karakteristikat kryesore të metaleve, të jometaleve dhe të gjysmëmetaletve (metaloide).</p>	<p>KIMIA INORGANIKE (4)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e komponimeve inorganike(oksidge, acide, baza dhe kripëra); - Metalet, jometalet dhe gjysmëmetalet (metaloide); - Ushtrime praktike eksperimentale nga kimia inorganike 	<p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës, e demonstrimit dhe e eksperimentale; Përdoren mjete të ndryshme mësimore, siç janë: kimikate të ndryshme(oksidge, acide, baza dhe kripëra), minerale të ndryshme, metale, jometale dhe gjysmëmetale të ndryshme; Vlerësimi i njohurive të bëhet me test dhe punë praktike.</p>	<p>Kuptimi mbi substancat themelore që e përbëjnë natyrën; Veçoritë dhe roli i tyre në jetën praktike; Të dinë që Kosova është e pasur me shumë minerale natyrore që përmbajnë metale: Pb, Zn, Ni, Ag, Au, Al etj, jometale (silikate) dhe minerale të tjera.</p>
<p>Njohja me komponimet organike ose komponimet e karbonit; Hidrokarburet, llojet, struktura e tyre</p>	<p>KIMIA ORGANIKE HIDROKARBURET (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hidrokarburet e ngopura (Alkanet); - Alkenet dhe dienët; - Alkinet; - Hidrokarburet aromatike. 	<p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës, e demonstrimit; Përdorën mjete të ndryshme p.sh. modele stereokimike, kimikate të ndryshme, benzeni, ndonjë karburant etj.; Vlerësimi i nxënësve bëhet me testim.</p>	<p>Kuptimi i hidrokarbureve, ndarja e tyre sipas strukturës, lidhjes kimike; Izomeria, llojet e izomerisë; Hidrokarburet alifatike dhe aromatike; Hidrokarburet me strukturë anazore dhe jounazore; Nomenklatura IUPAC dhe përdorimi i tyre.</p>
<p>Nxënësit do të njihen me komponimet organike në të cilat oksigjeni është i lidhur me karbonin në formë të grupeve funksionale;</p>	<p>KOMPONIMET ORGANIK ME OKSIGJEN (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Alkoolet dhe fenolet; - Aldehydet dhe ketonet; - Acidet karboksilike dhe derivatet e tyre. 	<p>Zbatohet metoda: e shpjegimit, bisedës, e eksperimentit demonstrues; Përdoren mjete dhe kimikate të llojllojshme që gjenden në laborator ose në treg; Vlerësimi i njohurive të nxënësve bëhet me test.</p>	<p>Nxënësit duhet t'i kuptojnë komponimet organike që përmbajnë grupet funksionale: - OH, - CHO, = CO, - COOH, Ar-OH. Të kuptojnë metodat e sintezës së tyre, vetitë, emërtimin dhe përdorimin e tyre në praktikë.</p>

<p>Rëndësia dhe përdorimi i këtyre komponimeve në: mjekësi, farmaci, amvisëri, kozmetikë, si masa plastike etj.</p> <p>Njohja me komponimet që përmbajnë azot. Në veçanti nxënësit do të njihen me ato komponime që janë pjesë përbërëse të organizmit me rëndësi jetësore, si dhe ato që përdoren si lëndë e parë industriale.</p> <p>Nxënësit të njihen me karbohidratet (sheqernat) që janë komponime organike që përftohen nga produktet natyrore dhe janë me rëndësi të veçantë për jetë (për ushqim) dhe si lëndë e parë në industrinë (e letrës, të tekstilit etj). Në veçanti nxënësit të njihen</p>	<p>KOMPONIMET ORGANIKE ME AZOT (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aminat - Aminoacidet dhe proteinat - Acidet nukleike <p>KARBOHIDRATET (2)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monosakaridet; - Disakaridet; - Polisakaridet. 	<p>Zbatohet metoda: e shpjegimit, bisedës, demonstrimit. Përdoren mjete dhe kimikate të ndryshme nga këto komponime. Vlerësimi i nxënësve bëhet me test.</p> <p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës dhe punës laboratorike. Përdoren mjete dhe kimikate të karbohidrateve si dhe aparatura të nevojshme për zhvillimin e eksperimentit. Nxënësit punojnë individualisht, në çifte ose në grupe nën mbikëqyrjen e mësimeve të tyre.</p>	<p>Nxënësit duhet të dinë për aminat dhe ndarjen e tyre në alifatike, aromatike, primare, sekundare dhe terciare; Metodat e sintezës së tyre, vetitë, emërtimin dhe zbatimin e tyre; Nxënësit duhet të kuptojnë strukturën e aminoacideve, vetitë e tyre polifunksionale, ndarjen dhe formimin e proteinave nga këto. Duhet të dinë lidhjen peptide dhe acidet nukleike (AND dhe ARN) dhe rolin e tyre në proceset biokimike në organizëm.</p> <p>Nxënësit të kuptojnë se karbohidratet janë produkte natyrore që formohen si rezultat i fotosintezës; Të njohin strukturën e karbohidrateve, ndarjen e tyre në monosakaride (glukoza dhe fruktoza), disakaride (sakarozën, maltozën dhe laktozin) dhe polisakaride (amidoni dhe celuloza); Rëndësinë vitale të këtyre</p>
--	---	--	--

<p>me glukozen, fruktozin, sakarozin, maltozin, laktozin si dhe amidonin e celulozën.</p> <p>Njohja me komponimet organike si produkte natyrore me origjinë bimore me aktivitet të theksuar fiziologjik dhe me rëndësi të madhe humane që kanë zbatim në farmaci dhe në mjekësi. Njëkohësisht nxënësit do të njihen me përdorimin e pakontrolluar të këtyre komponimeve që mund të kenë pasoja të papërmirësueshme për brezin e ri.</p> <p>Nxënësit do të njihen me shkaktarët e ndotjes së mjedisit jetësor(ujit, ajrit dhe të tokës) Vetëdijësimi dhe krijimi i kulturës te nxënësit për ruajtjen e mjedisit të pastër me sjelljet dhe shembullin e tyre.</p>	<p>KOMPONIMET HETEROCIKLIKE (1)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Alkaloidet; - Drogat. <p>ASPEKTE KIMIKE TË NDOTJES SË MJEDISIT JETËSOR (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndotja e ajrit,ujit dhe tokës; - Masat mbrojtëse nga ndotja. 	<p>Zbatohen metodat: e shpjegimit, e bisedës, e demonstrimit; Përdoren mjete ilustrative siç janë: fotografitë,filmat etj.</p> <p>Zhvillimi i kësaj teme mund të bëhet, jo vetë në klasë, por edhe në ndonjë mjedis tjetër të pastër për shembull parku i qytetit,malet e afërta, buzëlumenjve dhe liqeneve të pastër etj., si dhe në mjedise të ndotura, duke vizituar ndonjë lokalitet industrial, sidomos ato të cilat nuk përdorin filtra dhe masa të tjera për mbrojtje dhe të bëhet krahasimi i tyre. Vlerësimi i njohurive të nxënësve të bëhet me test.</p>	<p>komponimeve për jetë dhe si lëndë të para në industri. Nxënësit të arrijnë të formojnë kuptimin për alkaloidet dhe drogat. Të dinë rëndësinë humane të disa alkaloideve (morfina,atropina ,kokaina ,kinina etj.); Të dinë të dallojnë efektet e dëmshme nëse mirren (përdoren) në mënyrë të pakontrolluar.</p> <p>Nga njohuritë që i kanë arritur nxënësit nga lënda e kimisë,të jenë në gjendje t'i dallojnë ndotësit, shkaktarët dhe pasojat.</p>
--	---	---	--

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE


Për realizimin me sukses të përmbajtjeve programore në lëndën e kimisë për klasën e nëntë (IX) është e nevojshme pajisja e shkollave me laboratore (kabinete) të kimisë (ose laborator mobil), mjete të tjera ndihmëse (grafo-skop, kompjuter etj.), modele atomike–molekulare, tekste shkollore dhe burime të tjera që gjenden në treg. Arsimtari duhet të shfrytëzojë autonominë që gëzon për të shfrytëzuar dhe kërkuar literaturë dhe mjete të tjera mësimore që mendon se do t'i ndihmojë në realizimin e objektivit të këtij kurrikuli.

Deri në hartimin e tekstit adekuat për këtë program arsimtarëve u rekomandohet të shfrytëzojnë dhe konsultojnë këtë literaturë e cila ekziston:

- *Dr. Nexhat Daci, Dr. Rexhep Mehmeti, Dr. Muhamet Bicaj dhe Dr. Xhavit Ahmeti, KIMIA 7, Libri shkollor*, Prishtinë, 1999;
- *Dr. Nexhat Daci, Dr. Rexhep Mehmeti, Dr. Muhamet Bicaj, KIMIA 8, Libri Shkollor*, Prishtinë, 1999;
- *Dr. Rexhep Mehmeti, KIMIA për klasën e parë gjimnaz, Libri Shkollor*, Prishtinë;
- *Dr. Nexhat Daci, Dr. Osman Leci, KIMIA ORGANIKE, Libri Shkollor*, Prishtinë;

Për konsultim: *Dr. Pandeli Troja, Dr. Muhamet Bicaj, KURS I SHKURTËR I KIMISË ORGANIKE, Libri Shkollor*, Prishtinë;

- **FJALORI I KIMISË**, SH.B. "8 Nëntori" Tiranë;
- *Dr. I. Filipoviq, Dr. S. Lipanoviq (shqipëruar nga Dr. Xhavit Ahmeti), KIMIA E PËRGJITHSHME DHE INORGANIKE.*



Fizikë

FIZIKË

(Një orë në javë – 35 orë në vit)

1. HYRJE

Qëllimi i lëndës së fizikës është që nxënësit t'i njohin dukuritë natyrore, ligjet kryesore të fizikës, metodat e hulumtimit fizik, të formojnë bazën e njohurive shkencore mbi botën dhe t'i orientojnë nxënësit në zbatimin e njohurive të fituara nga lënda e fizikës në profesionin që do ta zgjedhin, në jetë dhe në punë.

Lënda e fizikës zhvillon të nxënësit aftësi intuitive, logjike, edukon proceset e formimit të koncepteve, zhvillon kujdesin për koherencën e argumentimit, kënaqësinë për kërkimin e së vërtetës.

Lënda e fizikës në klasën IX synon përforcimin, deri diku edhe thellimin e njohurive nga fizika. Synon përforcimin e njohurive nga fizika për zbatimin e tyre në jetë dhe për vazhdimin e arsimimit. Lënda e fizikës e klasës së nëntë synon që nxënësit të zotrojnë njohuritë kryesore që janë mësuar në klasën VI, VII dhe VIII të shkollës fillore, e që tash përfshihen në këtë program në një formë më të avancuar.

Detyrat e lëndës së fizikës janë:

- Njohja e ligjeve themelore të natyrës;
- Njohja e rëndësisë së shfrytëzimit të metodave eksperimentale;
- Aftësimi i nxënësve për zgjidhjen cilësore të detyrave të thjeshta nga fizika;
- Zhvillimi i shprehive të punës të nxënësit dhe interesimi për shkencat e tjera natyrore;
- Njohja e rolit të njeriut për zotërimin dhe ndërrimin e natyrës dhe formimi i qendrimit të drejtë të nxënësit ndaj mbrojtjes së mjedisit natyror;
- Vënia e bazës për arsimimin teknik;
- zhvillimi i shprehive të nxënësit për kursimin e energjisë;
- zhvillimi i ndjenjës për punë në grupe dhe në ekipe punuese, zhvillimi i ndjenjës së shoqëririzimit dhe të vetive të tjera pozitive të personalitetit, të domosdoshme për bashkëpunim konstruktiv në zgjidhjen e detyrave.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË MËSIMIT

Detyrat operative të paraqitura veç e veç për disiplinat e veçanta duhet të realizohen në formë ligjëratash që i mban arsimtari i fizikës, demonstrimeve të njësive përkatëse mësimore (temave), ushtrimeve numerike dhe laboratorike. Këto të fundit i bëjnë vetë nxënësit me ndihmën e arsimtarit të lëndës.

a) Mekanika

Nxënësve duhet t'u jepen kuptimet themelore të lëvizjes mekanike:

- Të njihen me madhësitë që e karakterizojnë lëvizjen e njëtrajtshme dhe atë të ndërrueshme (trajektorja, rruga, intervali i kohës, shpejtësia dhe nxitimi);
- T'i përdorin njësitë e këtyre madhësive në sistemin SI (m , s , m/s , m/s^2);
- Të dinë të matin dhe llogaritin shpejtësinë mesatare (\bar{v}), shpejtësinë e çastit (v) dhe nxitimin (a);
- Të dinë t'i paraqesin në mënyrë grafike dhe simbolike rezultatet e matjeve të tyre, t'i analizojnë, t'i interpretojnë dhe t'i paraqesin ato rezultate në mënyrë matematike;
- Të dinë se si nga shpejtësia e dhënë të parashikojnë pozitën e trupit pas një kohe të caktuar;
- Të kuptojnë se përshkrimi i lëvizjes do të jetë aq më i saktë, sa më i shkurtër të jetë intervali i kohës;
- Të kuptojnë se masa e trupave si madhësi fizike, hyn vetëm gjatë bashkëveprimit të trupave;
- të bëjnë dallimin ndërmjet masës dhe peshës së trupit;
- Të dinë shprehjen matematike për impuls dhe sasi të lëvizjes ($F\Delta t$, mv);
- Të kuptojnë se sasia e lëvizjes është madhësi vektoriale e orientuar në kahun e shpejtësisë;
- Të kuptojnë mënyrën se si forca shkakton lëvizjen e trupave (si pasojë e bashkëveprimit të trupave ndërmjet tyre: tërheqjes, shtyrjes, deformimeve, ndërrimit të sasisë së lëvizjes);
- Të dinë shprehjen matematike që lidh forcën, masën dhe nxitimin $F = ma$;
- Të dinë se kjo shprehje vlen për të gjitha llojet e forcave;
- Të dinë se forca matet me dinamometër dhe të përdorin sistemin SI (N);
- Të dinë se forca është madhësi vektoriale dhe të kuptojnë mirë se forca shkakton nxitimin;
- Të dinë të zbatojnë ligjin e dytë të Njutonit;
- Të dinë të përcaktojnë shtypjen e trupave të ngurtë me anë të matjeve dhe të llogaritjeve;
- Të kuptojnë se shtypja në gaze dhe lëngje përhapet njësoj në të gjitha drejtimet;
- Të kuptojnë ligjin e Paskalit, kurse ligjin e Arkimedit të dinë vetëm ta zbatojnë;
- Të kuptojnë shtypjen atmosferike;
- Të dinë të punojë me manometrën me lëng dhe me aneroid dhe t'i përdorin njësitë SI (paskali, Pa);
- Të kuptojnë se puna e forcës është e barabartë me ndërrimin e energjisë (dhe jo forca herë rruga, sepse këtë nxënësit e kanë mësuar në klasat e mëparshme);
- Të dinë se energjia e përgjithshme në mekanikë përbëhet prej shumës së energjisë kinetike dhe asaj potenciale;
- Të dinë njësitë e energjisë, punës dhe fuqisë;

- Në shembujt konkretë të dinë të llogaritit fuqinë e makinave dhe të aparateve të ndryshme;
- Të dinë të zbatojnë ligjin e ruajtjes së sasisë së lëvizjes dhe të energjisë;
- Të kuptojnë se trupi lëviz njëtrajtësisht ose qëndron në qetësi, atëherë kur forca rezultuese që vepron mbi atë trup është e barabartë me zero;
- Të kuptojnë se prej ligjit të dytë të Njutonit mund të nxirret ligji i parë;
- Të kuptojnë se ç'është inercia e trupave;
- Të kuptojnë se me forcën është i lidhur nxitimi e jo shpejtësia e atij trupi;
- Të dinë me fjalë dhe në formë matematike të shkruajë ligjin e tretë të mekanikës;
- Të kuptojnë se aksioni dhe reaksioni gjithmonë ekzistojnë së bashku dhe se është e pamundshme ta kemi njërin pa tjetrën;
- Të kuptojnë se forca e aksionit dhe ajo e reaksionit nuk veprojnë në një trup, por në dy trupa të ndryshëm, të cilët bashkëveprojnë;
- Të njihen me konceptet themelore mbi molekulat siç janë: përkufizimi i molekulës (si njësi strukturale e komponimeve kimike), masa, madhësia dhe numri i tyre në njësi vëllimi;
- Të dinë se me ngritjen e temperaturës së trupave, lëvizja e molekulave do të bëhet më e shpejtë;
- Të dinë të përdorin termometrin dhe njësitë e matjes (kelvin K dhe celzius $^{\circ}\text{C}$);
- Të kuptojnë se energjia e brendshme është e barabartë me shumën e energjive kinetike dhe potenciale të molekulave brenda trupit;
- Të dinë se kjo energji ndërrohet me punë ose me nxehtësi;
- Të dinë se nxehtësia dhe temperatura nuk janë madhësi të njëjta fizike;
- të dije se nxehtësia është energji e brendshme e cila kalon nga një trup në trupin tjetër;
- të dije se temperatura karakterizon madhësinë e lëvizjes kaotike të molekulave të një trupi.

b) Elektriciteti, magnetizmi dhe optika

Përmes këtyre tërësive mësimore, nxënësit duhet të kuptojnë se:

- Ekzistojnë dy lloje elektriciteti si dhe ekziston tërheqja dhe refuzimi i trupave të elektrizuar;
- Të dinë njësitë e sasisë së elektricitetit, potencialit (tensionit) dhe kapacitetit elektrik, në sistemin SI (C, V dhe F);
- Të njihen me kuptimin e fushës elektrike dhe punën në këtë fushë;
- Të dinë të përdorin voltmetrin dhe ampermetrin;
- Të dinë se ç'është intensiteti i rrymës elektrike, rezistenca elektrike, energjia elektrike dhe fuqia e rrymës elektrike;
- Të dinë zbatimin e ligjit të Omit, rregullat e Kirhofit dhe ligjin e Xhulit;
- Të dinë të sqarojnë paraqitjen e rrymës dhe të fushës elektrike nga pikëpamja elektronike;

- Të dinë t'i lidhin burimet e rrymës, shpenzuesit dhe instrumentet në qarkun elektrik;
- Të dinë lidhjen paralele dhe serike të burimeve dhe rezistencave;
- Të kuptojnë se qarku elektrik është i ngjashëm me qarkullimin e ujit nëpër gypa;
- Të fitojnë njohuritë themelore mbi fushën magnetike;
- Të kuptojnë veprimin e saj në përçuesin me rrymë (kjo është me rëndësi për shkak të zbatimit të madh në instrumente elektrike dhe në elektromotorë;
- Të vërejnë ekuivalencën e fushës magnetike të përçuesit me rrymë dhe të magnetit permanent;
- Të dinë për induksionin magnetik dhe njësitë e tij në sistemin SI (T) dhe të mësojnë më thellë për fluksin magnetik dhe njësitë e tij në SI (Eb);
- Të njihen me fenomenin e induksionit elektromagnetik;
- Të kuptojnë ligjin e Faradejit për induksion elektromagnetik në nivel elementar, po ashtu edhe rregullën e Lencit;
- Të njihen me fenomenin e vetinduksionit;
- Të dinë ç'është koeficienti i vetinduksionit dhe njësia e matjes në SI (henri, H);
- Të dinë se gjeneratori elektrik që punon në bazë të induksionit elektromagnetik prodhon rrymë alternative, por mund të prodhojë edhe rrymë njëkahu, mirëpo në gjeneratorin me komutator;
- Të dinë se drita është formë e energjisë;
- Të dinë se shpejtësia e dritës në vakuum është 300 000 m/s;
- të dije se drita reflektohet nga sipërfaqja e trupave;
- Të dinë se kur drita kalon nga një mjedis në tjetrin ajo përthyer,
- Të kuptojnë se prizmi është trup optik, i cili duke e përthyer dritën që kalon nëpër të formon shëmbëllime të objekteve (pasqyrat dhe thjerrat janë lloj prizmit optik);
- Të kuptojnë se me ndihmën e prizmit bëhet dispersioni i dritës.

c) Struktura e materies dhe gjithësia

Përmes këtyre tërësive mësimore nxënësit duhet:

- Të njihen me modelet më të thjeshta të strukturës së atomit (elektronet, protonet dhe neutronet);
- Të mësojnë se atomi ka bërthamën rreth së cilës rrotullohen elektronet;
- Të dinë se bërthamat e atomeve përbëhen vetëm prej protoneve dhe prej neutroneve;
- Të dinë se protonet, nutronet, elektronet dhe fotonet janë grimca themelore;
- Të fitojnë njohuritë e para mbi forcat bërthamore, energjinë bërthamore dhe zbatimin e saj;
- Të dinë se edhe bërthamat e atomeve janë jostabile duke u zbërthyer vetvetiu me anë të rrezatimit radioaktiv;
- Të njihen me strukturën e kristaleve dhe sistemet kristaline;

- Të njihen me gjysëmpërçuesit dhe vetitë e tyre;
- Të dinë se në gjysëmpërçues bartës të rrymës elektrike janë elektronet dhe vrimat;
- Të njihen me diodën gjysëmpërçuese, triodën, transistorin dhe përforcuesit e tjerë elektronikë si dhe me zbatimin e tyre;
- Të kenë njohuri themelore mbi fenomenin e superpërçueshmërisë,
- Të njohin hapësirën kozmike dhe trupat qiellorë;
- Të kuptojnë vjetërsinë e Tokës, Diellit, galaktikave dhe të gjithësisë;
- Të kuptojnë se astronomia është edhe shkencë eksperimentale.

Në hartimin e këtij Plani dhe programi, një pjesë e mirë e lëndës së fizikës nga klasat e mëparshme është përsëritur për shkak të rëndësisë së saj, por në një nivel më të lartë përmbajtësor dhe metodik, në mënyrë që të zotërohet sa më mirë për qëllime zbatimi dhe operacionalizimi. Një pjesë e vogël e lëndës (rreth 30%) është e re dhe ajo duhet të ligjërohet në formë teorike-konceptuale, në mënyrë që nxënësit të mësohen të mendojnë në mënyrë shkencore, duke i ndërruar botëkuptimet dhe bindjet e tyre që i kanë fituar nga jeta e përditshme.

3. PROGRAMI I LËNDËS SË FIZIKËS PËR KLASËN E NËNTË

/Përmbajtjet programore dhe udhëzimet për realizimin e tyre / (31+4)

1. MEKANIKA (7)

- 1.1 Shpejtësia dhe nxitimi. Masa dhe sasia e lëvizjes. Impulsi dhe forca. Ligjet e Njutonit në mekanikë. Puna mekanike. (2)
- 1.2 Lëngjet e përsosura dhe reale. Shtypja hidrostatike. Ligji i Arkimedit. Ligji i Paskalit. Shtypja atmosferike. Tensioni sipërfaqësorë. (2)
- 1.3 Ligji i gravitetit. Fusha e gravitetit dhe potenciali i saj. Puna në fushë të gravitetit. Ligjet e Keplerit. (2)
- 1.4 Energjia kinetike dhe potenciale. Energjia potenciale e gravitetit dhe e sustës. Ligji i ruajtjes së energjisë në mekanikë. (1)

Udhëzim: Në kuadër të mësimeve të këtij kapitulli kërkohet që nxënësit të kuptojnë përkufizimet themelore të mekanikës dhe këto të lidhen, aty ku mundet, drejtpërdrejt me përvojën. Mësimet gjatë një ore janë konceptuar në formë të një tërësie, p.sh. pasi të përkufizojmë shpejtësinë dhe masën e trupit, njëkohësisht kemi përkufizuar sasinë e lëvizjes si prodhim i masës dhe i shpejtësisë. Në këtë mënyrë vazhdojmë duke i përkufizuar madhësitë deri në përfundim të tërësisë së parë. Në mënyrë të ngjashme vazhdojmë edhe me tërësinë e dytë e cila paraqet orë të veçantë. Tërësia e tretë, kërkon shprehje matematikore vetëm të atij niveli që nxënësit të mund të zgjidhin detyra në mënyrë të pavarur. Këtu është veçanërisht me rëndësi të tregohet me shembuj nga jeta e përditshme se në fushë të gravitetit puna nuk varet nga forma e rrugës së trupit, por, vetëm nga pika e fillimit dhe e fundit e lëvizjes, sepse është fjala për lloj të veçantë të forcës, për forcën

konservative. Por nxënësve u tregohet edhe ekzistimi i llojeve të tjera të forcave. Ligjet e Keplerit të përkufizohen dhe të mbështeten vetëm në gjeometrinë e elipsës.

Tërësia e katërt e formuluar si orë e veçantë ka të bëjë vetëm me energjinë mekanike dhe nxënësve u tregohet ekzistimi i dy energjive potenciale: të gravitetit dhe sustës dhe energjisë kinetike të lëvizjes. Të tregohet me shembuj nga jeta e përditshme se energjia kinetike varet prej zgjedhjes së sistemit të referimit, sepse pikërisht shpejtësia varet nga zgjedhja e sistemit. Në të gjitha tërësitë mësimore veçanërisht t'i kushtohet rëndësi njësitë të madhësive: Kërkohet që nxënësit të mbajnë në mend njësitë për: masë, shpejtësi, nxitim, sasi të lëvizjes, impuls, forcë shtypje, punë, përkatësisht energji.

Literatura për leksione dhe detyra: Fizika për kl. I gjimnaz. Arsimtari i lëndës nga ky libër merr vetëm njësitë mësimore përkatëse që deri diku u përgjigjen kërkesave të këtij programi. Këto njësi mësimore të kërkojnë në kapitujt 2, 3, 4, 5. **Nxënësit** me sukses mund ta përdorin librin e fizikës së kl. VII.

2. NXEHTËSIA (3)

2.1. Përkufizimet themelore për molekulat. Energjia e brendshme e trupave dhe ndryshimi i saj. Gazi i përsosur dhe real. Kuptimi dhe matja e temperaturës. Termometrat. (1)

2.2. Sasia e nxehtësisë. Termokapaciteti i trupave. Ndërrimi i vëllimit me temperaturë. Shkrirja dhe ngrirja. Avullimi dhe valimi. Kondensimi dhe sublimimi. (2)

Udhëzim: Në këtë kapitull është me rëndësi parësore të tregohet se energjia e përgjithshme e trupit përbëhet prej energjisë kinetike, potenciale dhe energjisë së brendshme. Se nxehtësia dhe puna janë dy trajta të ndryshimit të energjisë së brendshme të trupit. Të tregohet se ekziston lidhmëri në mes të energjisë së brendshme dhe lëvizjes së molekulave përbërëse të trupit. Të kuptojnë çka është temperatura dhe si matet, të dinë cilat janë shkallët termometrike. Të kuptojnë nga jeta e përditshme çka është termokapaciteti i trupit, p.sh. pse rëra apo metalet ftofen menjëherë kurse uji më ngadalë. Të merren disa shembuj të tjerë. Të mund të shpjegojnë dukuritë e avullimit, valimit, kondensimit, shkrirjes dhe ngulosjes së trupave nga aspekti i përfytyrimeve molekulare. Të kuptojnë eksperimentalisht se trupat kur nxehen (bymehen) e rrisin vëllimin e vet. Përfundimisht nxënësit duhet të dinë njësitë e madhësive përkatëse.

Literatura: Për arsimtarët, Fizika për kl. e dytë të gjimnazit, drejtimi shkencor.

Fq.1-14 dhe fq.89-94

Për nxënësit, Fizika e kl. 7

Kjo literaturë shërben edhe për detyra.

3. FUSHA ELEKTRIKE STATIKE (3)

3.1 Sasia e elektricitetit. Nga Demokriti deri te Kuloni. Ligji i Kulonit. Fusha elektrike. Puna në fushë elektrike. Potenciali elektrik, tensioni dhe njësitë e tyre. (2)

3.2 Kapaciteti elektrik dhe njësia e tij. Kondenzatori i rrafshët (1)

Udhëzim: Në këtë kapitull në dy orët e para, nxënësit duhet të kuptojnë se në natyrë ekzistojnë vetëm dy lloje elektriciteti dhe se në mes tyre paraqitet tërheqja apo dëbimi në varësi prej ngarkesave që bashkëveprojnë. Të tregohet se në vertetimin e ligjit të bashkëveprimit kanë punuar edhe shumë shkencëtarë duke u nisur nga grekët e vjetër dhe përfunduar me Kulonin.

U tregohet nxënësve se fusha e gravitetit dhe fusha elektrike statike janë fusha forcash konservative prandaj, këto fusha kanë potencial. Te fusha e gravitetit kemi potencialin gravitacional, kurse te fusha elektrike statike kemi potencialin elektrik. Aparati matematik është plotësisht identik për të dy forcat, përkatësisht për të dy fushat e këtyre forcave. Kjo kuptohet më së miri duke bërë krahasimin e shprehjeve përkatëse. Të njehsohet puna në fushën elektrike, ngjashëm si te fusha të gravitetit. Nxënësit duhet të vërejnë dallimin në mes të potencialit dhe tensionit edhe pse këto dy madhësi maten me të njëjtën njësi.

Në orën e tretë nxënësi duhet të kuptojnë çka është kondensatori, për çka shërben dhe çfarë lloje të tyre mund të ndërtohen.

Në këtë kapitull nxënësit duhet të përvetësojnë njësinë e sasisë së elektricitetit (C), njësinë e potencialit, përkatësisht tensionit (V) dhe njësinë e kapacitetit elektrik (F).

Literatura: Fizika për kl. VIII, fq. 3-20 dhe detyrat në fund të librit, fq. 146-150, det. 1-17.

Për arsimtarët preferohet libri Fizika i kl. II të gjimnaz, drejtimi shkencor.

4. RRYMA ELEKTRIKE NJËKAHORE (4)

4.1. Intensiteti dhe densiteti i rrymës elektrike. Veprimet e rrymës elektrike: magnetik, termik, optik dhe kimik. (1)

4.2. Rezistenca elektrike dhe njësia e saj. Ligji i Omit për pjesë të qarkut dhe qark të mbyllur elektrik. Rregullat e Kirhofit dhe zbatimi i tyre. Puna dhe fuqia e rrymës elektrike. (2)

4.3. Shndërrimi i energjisë elektrike në energji të brendshme. Ligji i Xhaulit. (1)

Udhëzim: Në këtë kapitull nxënësit duhet të kuptojnë dy llojet e rrymës elektrike, lëvizjen e ngarkesave, rezistencën elektrike, veprimet e saj, punën dhe fuqinë e rrymës elektrike dhe njësitë e tyre matëse. Të kuptojnë ligjin e Omit për një pjesë të qarkut dhe të njejtin ligj për qark të mbyllur, të kuptojnë se qarku elektrik për rrymë njëkahore gjithmonë duhet të jetë qark i mbyllur.

Të kuptojnë nga detyrat dy mënyrat e lidhjes së rezistorëve. Të arrijnë atë nivel të njohjes sa të mund të zbatojnë dy rregullat e Kirhofit në qark elektrik. Të dinë shndërrimin e energjisë elektrike në energji termike që njihet si ligji i Xhulit.

Nxënësit duhet të mbajnë në mend si përkufizohet në sistemin SI njësia për intensitet të rrymës elektrike (A), si bashkëveprim të rrymave paralele, njësia për densitet të rrymës elektrike A/m^2 , njësia për rezistencë (ohm) dhe të dinë çka është rezistenca specifike dhe përcjellshmëria specifike.

Literatura: Fizika për kl. VIII. Mësimet mund të gjenden në mes të fq. 21 dhe 48. Detyrat po në të njëjtin libër fq. 151-159, det. 18-76.

5. FUSHA MAGNETIKE E RRYMËS ELEKTRIKE (3)

5.1 Fusha magnetike e rrymës elektrike dhe e magnetëve të përhershëm.

Ligji i Amperit për fushën magnetike të rrymës elektrike. (1)

5.2 Përkufizimi i forcës magnetike dhe induksionit magnetik. Fusha magnetike e përcjellësit me rrymë pambarim të gjatë. Bashkëveprimi i dy përcjellësve. Fusha magnetike në mjedise. (2)

Udhëzim: Në këtë kapitull nxënësit duhet të krijojnë përfytyrimin për ekzistimin e dy fushave magnetike. Fusha e parë magnetike është fusha e magnetëve të përhershëm të cilën e kemi mësuar në shkollë filllore duke filluar nga lënda e diturisë së natyrës dhe e kemi ndeshur në disa lëndë të tjera, duke përfshirë edhe lëndën e fizikës në kl. VIII. Për fushë magnetike të magnetëve të përhershëm duhet të cekim edhe Tokën në të cilën ekzistojnë dy pole, poli verior magnetik dhe jugor magnetik. Fusha magnetike e magnetëve të përhershëm ka potencial, pra është fushë e forcës konservative, sikurse që kemi cekur më herët për fushën elektrike statike dhe fushën e gravitetit.

Fushë tjetër magnetike është ajo e rrymës elektrike, fushë kjo e cila gjeti zbatim të rëndësishëm tek instrumenet elektrike dhe elektromotorët. Pra, rryma elektrike është burim i një fushe magnetike. Për përcaktimin e fushës magnetike të rrymës elektrike shërbehemi me një veti të fushës magnetike të formuluar në formë të ligjit të Amperit. Nxënësit duhet të kuptojnë edhe fluksin magnetik, forcën e Amperit, induksionin magnetik. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të dinë të dallojnë fushën magnetike në boshllëk H dhe fushën magnetike në mjedise që njihet si induksion magnetik B. Më në fund, pasi të kuptojnë ligjin e Amperit kenë mundësi të përcaktojnë fushën magnetike të një përcjellësi drejtvizor me rrymë, pambarim të gjatë dhe bashkëveprimin e tyre.

Përfundimisht, nxënësi duhet të kuptojnë ekuivalencën e fushës magnetike të rrymës elektrike me fushën magnetike të magnetëve të përhershëm.

Literatura: Fizika për kl. VIII

Fizika për kl. II gjimnaz, drejtimi shkencor, kap.136-144;

Detyrat të merren nga fizika për kl. II gjimnaz, fq.160-162.

6. INDUKSIONI ELEKTROMAGNETIK (IEM) (2)

6.1 Kuptimi i induksionit elektromagnetik dhe disa mënyra të paraqitjes së tij.

Përfitim i ligjit të Faradeit për induksion elektromagnetik Vetinduksioni. (1).

6.2 Përkufizimet themelore të rrymës alternative. (1)

Udhëzim: Në radhë të parë nxënësi duhet të kuptojnë përgjigjen në pyetjen: Nëse në kapitullin e mëparshëm kuptuam se rreth përcjellësit nëpër të cilin rrjedhë rryma krijohet fusha magnetike, atëherë a ka vend edhe procesi i kundërt? Pra, të krijojmë rrymë nga fusha magnetike. Përgjigjja është pozitive dhe kjo shprehet me ligjin e Faradeit kurse këto rryma i quajmë të induktuara. Kjo rrymë gjen zbatim të madh, sepse në këtë parim punojnë gjeneratorët, transformatorët e rrymës alternative, apo pikërisht gjenerohet vetë rryma alternative. Nëse mbështetemi në parimin: të krijojmë rrymë të induktuar duhet të ndryshojmë në çfarëdo mënyre fushën magnetike, atëherë vetvetiu kuptojmë se për këte duhet të ekszistojnë disa metoda të cilat e krijojnë këtë mundësi.

Ora e dytë e mësimit ka të bëjë me paraqitjen e veçorive themelore të rrymës alternative. Meqenëse nxënësi i klasës së 9-të, ende nuk ka mësuar trigonometri të planit, shpjegimi i rrymës alternative duhet të mbështetet vetëm në interpretimin gjeometrik.

Më në fund nxënësit duhet të mbajnë në mend njësinë për forcë elektrolëvizore të induktuar (V), njësinë për koeficient të vetinduksionit L, (Henri) dhe njësinë për frekuencë të rrymës alternative (Hz).

Literatura: Fizika për kl. VIII, fq. 67-81;

Fizika për kl. III gjimnaz, drejtimi shoqëror- gjuhësor fq. 49-56;

Detyrat në të njëjtin libër, fq. 59-62.

7. OPTIKA (4)

7.1 Drita si fushë elektromagnetike. Mënyrat e përcaktimit të shpejtësisë së dritës (astronomike dhe laboratorike). Ligjet themelore të optikës gjeometrike. (2)

7.2. Pasqyrat e rrafshta dhe sferike. Prizmi optik. Thjerrat. Qelqi zmadhues. Mikroskopi optik. (2)

Udhëzim: Nxënësit duhet të kuptojnë se drita është fushë elektromagnetike (EM), prandaj shpejtësia e dritës dhe veçoritë e tjera të saj janë shpejtësi dhe veçori të kësaj fushe. Duhet të përvetësojnë mënyrat si përcaktohet shpejtësia e dritës, ato astronomike dhe laboratorike, se indeksi i thyerjes përkufizohet si raport i shpejtësisë së dritës në dy mjedise. Duhet të njihen me ligjet themelore të optikës gjeometrike dhe në mbështetje të tyre të konstruktujnë pozitën dhe madhësinë e shembëllimit në vartësi të pozitës së objektit në pasqyra sferike dhe thjerra. Të kuptojnë çka është prizmi optik dhe zbatimi i vetisë së tij në analizë spektrale.

Të aftësohen për njehsimin e zmadhimit linear të thjerrave përmbledhëse dhe fuqinë e tyre optike, por njëkohësisht duke u mbështetur në ligjet e optikës gjeometrike të kuptojnë konstruksionet e shembëllimit të objektit në qelqin zmadhues dhe mikroskop optik.

Literatura: Fizika për kl. VIII

Detyrat në të njëjtin libër, fq. 161-164.

8. STRUKTURA E ATOMIT DHE BËRTHAMA E TIJ (3)

8.1 Modelet e atomit. Hipoteza e Plankut për rrezatim. (1)

8.2 Struktura e bërthamës së atomit. Radioaktiviteti. Veprimi biologjik dhe mbrojtja nga rrezatimi radioaktiv (1)

8.3 Energjia e lidhjes dhe defekti i masës. Fisioni bërthamor. Fuzioni bërthamor. Energjia bërthamore (1).

Udhëzim: Nxënësit duhet të njihen me modelin e J. J. Tomsonit për atom, me modelin planetar të Raterfordit dhe modelin e Borit për atom të hidrogjenit. Që të kuptohet modeli i Borit duhet të paraqitet hipoteza e Plankut për rrezatim. E tërë kjo pa ndonjë ngarkesë matematike.

Për orën e dytë nxënësit duhet të njihen me grimcat përbërëse të bërthamës, masat e tyre, numrin e nukleoneve në bërthamë, izotopet izobaret, izotonet. Ligjin radioaktiv dhe kohën e gjysëmzbërthimit duhet ta njohin edhe nga aspekti i veprimit biologjik si dhe nevojën e mbrojtjes së ambientit nga rrezatimi.

Literatura: Fizika për kl. VIII, fq. 124-136

Detyrat në të njëjtin libër, fq. 164-168

9. FIZIKA E GJENDJES SË NGURTË (1)

9.1. Gjysëmpërçuesit. Përçueshmëria e primesave. Transistorët. Superpërçueshmëria. (1)

Udhëzim: Nxënësit duhet të njihen me arritjen e elektronikës bashkëkohore e cila mbështetet në teknikën e përpunimit të gjysëmpërçuesve. Të tregohet se gjenerata e elektronikës bashkëkohore, gjenerata e tranzistorëve kaheërë e ka zëvendësuar gjeneratën e gypave elektronik të cilët në raport me ta ishin të përmasave shumë të mëdha

Literatura: Fizika e kl. VIII

Fizika e kl. III gjimnaz, drejtimi shoqëror-gjuhësor, fq. 201-224

10. NJERIU DHE GJITHËSIA (1)

10.1. Njohuri themelore për gjithësinë. Yjet planetet dhe trupat e tjerë qiellorë. Pasqyrë e shkurtër e zhvillimit historik të astronomisë. (1)

Udhëzim: Nxënësve duhet t'u ofrohet njohuri për pozitën e tyre në gjithësi. Të tregohet se Toka është planet i tretë në sistemin diellor, se Hëna është satelit natyral i Tokës dhe se Dielli është yll i zakonshëm që quhet xhuxh i verdhë. Në zhvillimin e shkurtër të astronomisë, nxënësit të njihen me faktin se astronomia nuk është vetëm shkencë vrojtuese, por në dekadat e fundit edhe eksperimentuese. Të tregohet se disa fluturake kaherë janë larguar nga sistemi diellor dhe po depërtojnë kah brendia e galaktikës.

Literatura: Astronomia për kl. IV.

Ushtrimet demonstruese dhe eksperimentale

Nëse shkolla ka kabinet të fizikës, atëherë sipas mundësive arsimtari i lëndës, së bashku me nxënës, në kuadër të orës, pas shpjegimit të njësisë mësimore, të ndalet në demonstrimin eksperimental të asaj njësie. Preferohet që gjatë vitit shkollor të realizohen këto ushtrime eksperimentale:

1. Demonstrimi i ndërrimit të vëllimit të trupit me temperaturë. (Depërtimi i sferës metalike nëpër unazë);
2. Vartësia e periodës së lavjerrësit matematik nga gjatësia e perit të tij (teorema e Galileit);
3. Verifikimi eksperimental i ligjit të Omit për qark të mbyllur elektrik;
4. Matja e largësisë fokale të thjerrës konvergjente me ndihmën e bankës optike.

Legjenda: 31 - numri i orëve të leksioneve, 4 orë në dispozicion

Rezultatet e pritura

Në fund të klasës së nëntë, nxënësit duhet të fitojnë aftësi që:

- Të rikujtojnë dhe të riprodhojnë fakte kur ato nevojiten për njohuri të reja, pra, njohja e të dhënave të ndeshura më parë, për t'i kuptuar, përdorur dhe ndryshuar ato, (p.sh. si njehsohet shpejtësia e dritës);
- Të shfrytëzohen idetë dhe rregullat kur ato nevojiten si dhe të përdoren konceptet e përgjithshme për zgjidhje të një problemi të veçantë;
- Të analizojnë njësitë mësimore dhe temat mësimore veç e veç;
- Të krijojnë, të zbulojnë risi në fizikë, duke kombinuar ide të ndryshme, pra të krijojnë një tërësi nga pjesët e saj teorike;
- Të identifikojnë, të dallojnë, të përcaktojnë, të përshkruajnë, të klasifikojnë dukuritë e ndryshme fizike;
- Të përceptojnë, të reagojnë, të vlerësojnë, shfaqjen e dukurive fizike (objektivat emocionale).

4. ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR TË NXËNËSVE

(Udhëzime metodologjike)

Procesi i mësimdhënies realizohet edhe përmes detyrave mësimore, punës së pavarur dhe pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme të nxënësve në

mënyrë individuale, në çifte ose në grupe. Qëllim kryesor i individualizimit në mësim është t'i mësojë nxënësit për të nxënë, të formojë tek ata motivim pozitiv për nxënie dhe të çlirojë aftësitë potenciale te secilit prej tyre.

Zgjedhja e njësive mësimore për nxënie, në të shumten e rasteve, duhet t'u përshtatet nxënësve ose grupeve të nxënësve. Preferohet që arsimtari të përcaktojë mësimet të veçanta që nxënësit më parë t'i përgatitin në shtëpi e mandej një anëtar i grupit të referojë para nxënësve dhe arsimtarit. Zakonisht ndarjen e këtyre njësive mësimore e bën arsimtari në kuadër të orëve mësimore të një muaji.

Nxënësit mund të punojnë në grup një ushtrim eksperimental në laboratorin e shkollës, p.sh. përcaktimi i indeksit të thyerjes së dritës me mikroskop.

Për aftësimin e nxënësve me qëllim pavarësimin të tyre, ata duhet të njohin dukuritë dhe fenomenet e ndryshme në fizikë t'i kuptojnë ato, të aftësohen për zbatimin e tyre në jetën praktike, të bëjnë analizën e dukurisë fizike duke e ndarë atë në pjesë të veçanta etj.

Meqë klasa e nëntë është orientuese dhe përgatitore për vazhdim në shkollë të mesme, të lartë, atëherë arsimtari duhet të provojë të çmojë aftësitë e nxënësve për orientim të mëtejshëm. Në këtë drejtim do të përcaktojë njësi mësimore të veçanta sipas interesimit të nxënësve.

Gjeografi

GJEOGRAFI

1 orë në javë, 35 orë në vit

I. HYRJE

Filozofia e lëndës. Gjeografia si shkencë empirike lëndë studimi ka objektet, dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike dhe shoqërore në hapësirë dhe në kohë. Përmbajtjet gjeografike janë të kombinuara në mes vedi në hapësirë dhe në kohë. Kombinimet e objekteve dhe elementeve natyrore e shoqërore krijojnë dukuri e procese në rrethana të ndryshme, të cilat ndikojnë në jetën e njerëzve, në bimë, kafshë etj.

Gjeografia ka për qëllim njohjen dhe të kuptuarit e rrethanave të ndryshme në hapësirë dhe në kohë në përmasa (shkallë) lokale, rajonale dhe globale. Lënda gjeografisë e forcon përceptimin e nxanësve ndaj hapësirës, duke krijuar njohuri për vendndodhje, treva, rajone e vende të ndryshme.

Këto njohuri kanë për qëllim të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar lidhjen, kontekstin dhe tërësinë integrale në kushtet e ndryshme të mbijetesës, përdorimin e burimeve, ndikimin në hapësirë (mjedis) dhe mundësitë e veprimit të ndryshëm njerëzor.

Lënda e gjeografisë ka për qëllim gjithashtu të ofrojë njohuri mbi kushtet natyrore të trevave, rajoneve, vendeve, veçoritë e tyre sociale e ekonomike, rrethanat e ndryshme të jetës së njerëzve në shkallë treve, vendi, rajoni e globi. Ajo ndihmon të kuptuarit e drejtë të kulturave të ndryshme, vlerave të tyre dhe mënyrës se jetesës.

Lënda e gjeografisë ofron njohuri për ndërveprimin njeri-naturë, i ndihmon krijimit të ndërgjegjes mbi tërësinë e mjedisit, shfrytëzimin e resurseve në përmasa që nuk krijojnë debalansë të mëdha në ambientin jetësor.

Çka gjeografia iu ofron nxënësve?

Lënda e gjeografisë në klasën 9-të do të sigurojë njohuri mbi:

- Hapësirën dhe orientimin dhe në terren me anën e hartave topografike;
- Përbërjen e korës së Tokës, shkëmbinjtë, mineralet, metalet dhe jo-metalet e dobishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror;
- Tërmetet dhe vullkanet si dukuri dhe katastrofa natyrore me pasoja të mëdha për shoqëri;
- Tërësinë e mbështjellësit gjeografik, sferat që e përbëjnë dhe ligjësitë e përgjithshme gjeografike në mënyrë që të kuptohen më mirë dukuritë natyrore dhe efektet e veprimit të njeriut;
- Problemet e ndotjes së mjedisit me veprimet e tepruara të njeriut dhe pasojat e ndotjes;

- Lëvizjen e popullsisë në botë, rritjen e shpejtuar të saj në pjesën më të madhe të njerëzimit, për tranzicionin demografik, për politikën popullore,
- Strukturat e popullsisë, ndryshimet në to dhe rolin e tyre në jetën e njerëzve;
- Procesin e urbanizimit, ndërlidhjet me proceset shoqërore, pasojat nga urbanizimi i shpejtuar, rëndësinë e komunikacionit në botën bashkëkohore;
- Hartën politike të botës sot, për proceset politike bashkëkohore;
- Problemin e ushqimit në botë, urinë dhe ushqimin e pamjaftueshëm në një anë dhe tepricat, në anën tjetër;
- Natyrën, resurset natyrore, banueshmërinë, veçoritë demografike, nivelin e zhvillimit ekonomik, strukturën ekonomike, ndërlidhjet në mes të shteteve dhe kontinenteve të Evropës, Azisë, Afrikës, Amerikës Veriore, Amerikës Jugore, Australisë dhe Oqeanisë;
- Trevat e banuara me shumicë shqiptare, evolucionin e tyre historik, ndërlidhjen e dobët gjeografike, ekonomike e kulturore, pasuritë natyrore e njerëzore të trevave shqiptare, shkallën e shfrytëzimit të tyre dhe rolin e tyre në zhvillimin e ardhshëm;
- Veçoritë popullore në trevat shqiptare, proceset karakteristike demografike, zhvillimin e turizmit dhe të komunikacionit si dy mundësi të mëdha për zhvillimin socio-ekonomik dhe ndërlidhjet intensive të tyre;
- Ndarjen e punës në trevat shqiptare, bashkëpunimin në mes tyre, me shtetet fqinjë dhe vendet e rajonit e më gjerë.

Lidhjet e gjeografisë me lëndët e tjera

Gjeografia, nga përmbajtja, është komplekse. Në përbërjen e saj bëjnë pjesë disa sfera: litosfera, hidrosfera, biosfera, atmosfera, sferat socio, teknosfera, të cilat përbëhen prej objekteve, elementeve, dukurive, proceseve, strukturave në përmasa të vogla, të mesme e të mëdha hapësinore. Pastaj çdo sferë është e përbërë prej shumë elementeve që kanë përbërje të ndryshme dhe qëndrojnë në raporte të ndryshme. Kjo llojllojshmëri e sferave, e elementeve të tyre e objekteve që i krijojnë, ka nevojë për njohuri komplekse dhe lidhje në mes të disiplinave brenda gjeografisë dhe jashtë saj.

Objektet, dukuritë dhe proceset që i studion gjeografia kanë nevojë për ndërlidhje permanente në mes të morfologjisë, përbërjes gjeologjike, llojit të klimës, hidrografisë mbi dhe nëntokësore, llojit të vegjetacionit, mënyrës së shfrytëzimit të objekteve natyrore nga njeriu, vartësisht nga mjetet, mundësitë e diturisë që ka, mënyra dhe niveli i organizimit shoqëror e politik, dendësia e banimit, shkalla e zhvillimit etj.

Kjo ndërlidhje e shumëfishtë brenda dhe jashtë gjeografisë, kërkon ndihmën edhe nga shkencat e tjera: nga fizika, biologjia, kimia, gjeologjia, gjeodezia, matematika, ekonomia, statistika, sociologjia, drejtësia, politika etj.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË NXËNIES

Cilat njohuri dhe shkathtësi duhet të zhvillohen

Përmes mësimit të gjeografisë nxënësit duhet të njohin të vërtetën gjeografike, t'i kuptojnë dukuritë gjeografike, proceset në zhvillim, raportet në hapësirë dhe të përvetësojnë njohuritë praktike.

Nxënësit duhet të përfitojnë njohuri për Tokën, hartën në përgjithësi, të kuptojnë vartësinë reciproke të elementeve natyrore e shoqërore në shkallë të ndryshme, zhvillimin e pabarabartë ekonomik, teknik e kulturor, raportet bashkëkohore ekonomike dhe politike.

Nxënësit duhet të aftësohen për të vërejtur objektet, dukuritë dhe proceset, duhet të aftësohen për të përdorur hartën dhe atlasin. Nxënësit duhet të mësohen t'i njohin faktet, t'i zbulojnë ato dhe t'i komentojnë. Të kuptojnë vartësinë reciproke në mes të elementeve natyrore dhe shoqërore. Nxënësit duhet të përgatiten t'i zbatojnë njohuritë përmes mësimit dhe punës praktike. Te nxënësit duhet të zhvillohet mendimi krijues dhe logjik.

Mësimi bashkëkohor i gjeografisë ka për qëllim të nxitë, udhëzojë në qasje e metoda bashkëkohore për zgjidhjen e problemeve dhe detyrave, shfrytëzimin e burimeve të shkruara dhe nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Rajonet nuk duhet të përpunohen sipas mënyrës së vjetër sistematike, sipas shabllonit të vjetruar, por në bazë të zgjedhjes së problemit, sqarimit të tij, duke shfrytëzuar lidhjen shkak-pasojë.

Objektivat e veçanta

Më mësimin e gjeografisë në klasën 9-të pritet që nxënësit të kuptojnë mirë e drejtë faktet, dukuritë e procesët dhe të dinë t'i përdorin ato njohuri në jetën praktike:

- Nxënësit do të mësojnë përbërjen komplekse të gjeografisë, ndërlidhjet e njohurive gjeografike më të tjera;
- Të kuptojnë hartën topografike, të lexojnë atë dhe ta përdorin për t'u gjetur në hapësirë;
- Të mësojnë për korën e Tokës, llojet e shkëmbinjve, xeheroret e dobishme (metalike e jometalike) dhe përdorimin e tyre për zhvillimin ekonomik;
- Të mësojnë për tërmetet, shkaqet e tyre, mënyrën e paraqitjes, dëmet e shkaktuara, mënyrat e mbrojtjes prej tyre, pastaj për vullkanet, shpërndarjen e tyre, rolin për ekonomi (xehetari, industri, bujqësi, ndërtimtari etj.);
- Për ndotjen, ndotësit kryesor, pasojat e ndotjes për botën e gjallë në nivelin lokal e deri global;
- Për rritjen e diferencuar të popullsisë, për faktorët që e shkaktojnë, për pasojat e rritjes së shpejtuar dhe të ngadalësuar, për planifikimin dhe

mënyrat e planifikimit, për strukturat e popullsisë, ndryshimin e tyre në lidhje me zhvillimin ekonomik-shoqëror etj.;

- Për procesin e urbanizimit, shkaktarët dhe pasojat e urbanizimit të shpejtuar, për zhvillimin e komunikacionit, llojeve të tij në lidhje me shumë faktorë;
- Për veçoritë natyrore, popullore e ekonomike të kontinenteve si tërësi të mëdha gjeografike, nivelin e zhvillimit ekonomik, duke i ndërlidhur faktorët e zhvillimit në hapësirë dhe në kohë;
- Njohja me trevat e banuara me shumicë shqiptare, shtrirjen e tyre gjeografike, evolucionin historik, madhësinë territoriale e popullore, begatitë natyrore, rolin e tyre për zhvillimin ekonomik, numrin e popullsisë së trevave shqiptare, veçoritë demografike, shkallën e zhvillimit ekonomik në ndërlidhje me faktorët e shumtë shoqërorë, kulturorë, politikë e natyrorë, Kosovën në raport me vendet te Evropës dhe ndaj disa vendeve të botës.

III. ASPEKTET NDËRDISIPLINARE

Arsimimi demokratik

Duke i përvetësuar mirë mësimet e gjeografisë, nxënësitë do të përgatiten për arsimimin demokratik, për barazinë mesgjimore, mesmoshore, në mes të popujve, grupeve të ndryshme përkrah përkatësia racore, fetare, kulturore. Nxënësit duhet të edukohen në frymën e tolerancës gjinore, fetare, racore e etnike, në frymën e bashkëpunimit pa marrë parasysh dallimet e përmendura. Gjeografia ka mundësi që përmes shembujve të ndihmojë në mirëkuptimin, në rritjen e bashkëpunimit në mes të vendeve e popujve të ndryshëm pa marrë parasysh përkatësinë e tyre dhe nivelin e zhvillimit.

Shkathtësitë jetësore, objektivat e nxënies

Përmes nxënies teorike dhe punës praktike, nxënësit do të përgatiten për situata të ndryshme, duke ua zhvilluar shkathtësitë e të kuptuarit të fakteve, dukurive e proceseve, ligjeve e ligjshmërive, të raporteve, të nxerrjes së përfundimeve të drejta dhe zbatimin e tyre në jetë.

Mendimi logjik, kritik, metodologjia dhe qasja për mësim të integruar

Materia e zgjedhur për klasën 9-të nga gjeografia është koncipuar në atë mënyrë që të ndihmojë dhe zhvillojë mendimin logjik e kritik, duke theksuar shkaqet e vërteta të zhvillimit të dukurive e proceseve gjeografike. Për shembull, resurset natyrore janë rezultat i dukurive dhe proceseve në korën e Tokës, ndërsa këto ndihmojnë zhvillimin ekonomik nëse shoqëria ka mjete e kuadro. Të kuptuarit e drejtë të fenomeneve natyrore si tërmetet, vërshimet, stuhitë etj., i ndihmojnë njerëzve në kapërcimin më të lehtë të katastrofave natyrore. Rritjen e shpejtuar të popullsisë duhet kuptuar si pasojë e nivelit të ulët të zhvillimit ekonomik, arsimor, organizimit të ulët politik e shën-

detësor, por edhe si shkaktar i ngecjes në zhvillimin ekonomik, i shpenzimeve më të larta në ekonomi, arsim, kulturë, infrastrukturë, i zvogëlimit të buxhetit familjar, komunal, shtetëror.

Metodologjia dhe qasja për mësim të integruar nënkupton mënyrën çfarë rruge duhet zgjedhur për t'i kuptuar gjërat më mirë dhe në kompleksitetin e tyre. Metodologjia e drejtë mund të arrihet nëse çdo objekt ose dukuri merret si një tërësi e përbërë prej elementeve në relacione të ndryshme dhe se gjatë kohës ndryshon si struktura, ashtu edhe relacionet. Metodologjia e suksesshme mundëson kuptimin më të plot të: objekteve, dukurive, proceseve, strukturave etj.

IV. ZOTËSITË DHE SHKATHTËSITË KRYESORE

Promovimi i shkathtësive të përgjithshme dhe të veçanta nga lënda e gjeografisë

Përmes mëimit të gjeografisë të zgjedhur për këtë klasë; promovojmë këto shkathtësi të përgjithshme dhe të veçanta:

- Kuptimin e ndërlidhjeve dhe ndërndikimeve;
- Kuptimin e ligjeve dhe ligjshmërive;
- Kuptimin e dukurive dhe proceseve në natyrë dhe në shoqëri;
- Kuptimin e unitetit, tërësisë, të pjesëve dhe raporteve në mes të pjesëve përbërëse;
- Kuptimin e të përgjithshmes dhe të veçantës;
- Shkathtësinë e orientimit në hapësirë;
- Shkathtësinë e përdorimit të njohurive për të fituar nga fenomenet natyrore ose për t'u ikur dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
- Kuptimin e rritjes së popullsisë nën ndikimin e faktorëve që e shkaktojnë dhe kuptimin e pasojave nga shtimi i lartë ose i ulët;
- Të kuptuarit e ndërlidhjeve në mes të strukturave të popullsisë dhe procesve shoqërore e ekonomike;
- Të kuptuarit e drejtë të raporteve në mes të shkallës së zhvillimit dhe shfrytëzimit të begative natyrore në nivel të rajonit, shtetit, kontinentit;
- Të kuptuarit e drejtë të situatës ekonomike, sociale, kulturore në trevat shqiptare dhe synimet e popullsisë shqiptare për të dalë nga kjo gjendje.

Zgjedhja e temave dhe e njësive mësimore ka rëndësi të madhe për të zhvilluar të nxënësit shkathtësitë, mendimin logjik, kritik, kuptimin integral, raportin e pjesëve, pjesëve me tërësinë etj. Për këtë klasë janë zgjedhur temat nga katër sfera të gjeografisë me qëllim të kuptohen specifikat e objekteve, dukurive e proceseve fiziko-gjeografike, shoqërore-ekonomike në botë si tërësi, në kontinente dhe në trevat shqiptare në veçanti.

V. PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJES–PROGRAMI MËSIMOR

(Fondi orëve: 1 orë në javë, 35 orë në vit)

30 orë zhvillim i njësive mësimore

5 orë në dispozicion të mësimeve të mësimdhënësit

Lënda e Gjeografisë për kl. IX do të përbëhet prej katër pjesëve (temave mësimore):

- I. Gjeografia fizike;
- II. Gjeografia humane (shoqërore);
- III. Gjeografia regjionale e kontinenteve;
- IV. Gjeografia nacionale.

I. Gjeografia fizike: (8 orë)

Temat

1. Lënda, ndarja, detyrat e gjeografisë dhe ndërlidhjet me shkencat e tjera;
2. Orientimi dhe lëvizja në terren me ndihmën e hartave topografike;
3. Shkëmbinjtë në koren e Tokës dhe pasuritë minerale;
4. Tërmetet dhe vullkanet;
5. Mbështjellsit gjeografik dhe ligjësitë e përgjithshme gjeografike;
6. Problemet e sotme në ndotjen e ambientit.

II. Gjeografia humane (shoqërore): (8 orë)

Temat

1. Lëvizja e popullsisë dhe tranzicioni demografik në botë, dallimet regjionale dhe politika popullore;
2. Struktura e popullsisë dhe dinamika e tyre: (biologjike, ekonomiko-sociale, arsimore, etnike, racore, fetare);
3. Urbanizmi si proces botëror dhe implikimet e tij;
4. Komunikacioni bashkëkohor dhe roli i tij;
5. Harta politike e botës bashkëkohore;
6. Problemi i ushqimit në botë.

III. Gjeografia regjionale: (9 orë)

Temat

1. Evropa: Kushtet natyrore dhe popullsia. Veçoritë ekonomike dhe harta politike;
2. Azia: Kushtet natyrore dhe popullsia. Veçoritë ekonomike dhe harta politike;
3. Afrika: Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe popullsia. Veçoritë ekonomike dhe politike;
4. Amerika Veriore dhe Qendrore: Natyra dhe popullsia. Veçoritë ekonomike dhe politike.
5. Amerika Jugore: Natyra dhe popullsia. Ekonomia dhe ndarja politike.
6. Australia dhe Oqeania: Natyra dhe popullsia. Ekonomia dhe veçoritë politike.

IV. Gjeografia nacionale: (10 orë)

Temat

1. Hapësira gjeografike e trevave shqiptare;
2. Resurset natyrore në trevat shqiptare;
3. Dinamika demografike në trevat shqiptare;
4. Turizmi si potencial ekonomik dhe shoqëror;
5. Komunikacioni si mundësi e ndërlidhjes në rajon e më gjerë;
6. Trevat shqiptare dhe ndarja ndërkombëtare e punës;
7. Kosova ndaj Evropës dhe botës.

Orientimet për punë të pavarur të nxënësve

Për të pasur sukses në mësimin e gjeografisë nxënësve u nevojitet një lloj autonomie e punës. Nxënësit do të mund të jenë të pavarur me ndihmën e profesorit, sepse faktor kryesor do të jetë roli i tyre.

Për t'i realizuar me sukses detyrat duhet :

Të jetë koordinator, lehtësues, udhëzues dhe jo udhëheqës në procesin mësimor;

Njohuritë e veta t'i përhapë te nxënësit;

Të krijojë në klasë klimë besimi;

T'i inkurajojë nxënësit në progresin e tyre;

Të nxitë motivimin dhe interesimin e nxënësve;

Të inkurajojë nxënësit për të marrë inisiativa;

Të ndihmojë nxënien, të jep këshilla për të mësuar (të dëgjojë me vëmendje dhe të analizojë me qëllim të ndërmjetësorë në korigjimin e gabimeve);

Të ketë rolin e bashkëbiseduesit në zgjidhjen e detyrave, problemeve;

Të kërkojë, të hulumtojë mënyra të reja të mësimdhënies dhe t'i aktualizojë në klasë;

T'i orientojë nxënësitë më shumë si duhet të mësojnë çfarë duhet të mësojnë;

Duke u pëmbajtur në këto pika, nxënësit kuptojnë të gjitha procedurat e zgjidhjes së problemeve në klasë dhe jashtë klasës,

Marrin inisiativa (nuk presin të nxiten për të marrë fjalën);

Nuk kanë frikë të bëjnë gabime;

U përkushtohen punës së tyre;

Nuk presin informacione të gatshme vetëm nga profesori,

Hulumtonë burime të ndryshme informacioneve si (biblioteka, Interneti, CD, TV, radio, filmi etj),

Përpiqen të vlerësojnë pikat pozitive dhe negative dhe të përmirësohen,

Udhëheqin nxënien e tyre,

Bashkëpunojnë gjatë punës në grupe dhe dëshmojnë frymë bashkëpunimi (nuk përpiqen të hyjnë në rivalitet me të tjerët),

Marrin përgjegjësi në punën kolektive.

Tërësia e parë: gjeografia fizike

Njësia mësimore	Qëllimi dhe objektivat specifike	Përbajtjet	Rezultatet e pritura	Korelacioni me njësitë dhe lëndët e tjera
Lënda, ndarja, detyrat e gjeografisë dhe ndërlidhjet me shkencat e tjera	Të kuptuarit e lëndës së gjeografisë, detyrat dhe ndërlidhjet mes disiplinave.	Përbërësit e gjeografisë, kuptimi i sferave dhe ndërlidhjeve në mes tyre.	Kuptimi i strukturës së gjeografisë, sferave të Tokës dhe ndërlidhjeve në mes tyre.	Kuptimi i ndërlidhjeve në mes të sferave të Tokës.
Orientimi dhe lëvizja në terren me ndihmën e hartave topografike.	Të mësuarit e nxënësve me orientimin në hartë dhe hapësirë, leximin dhe komentimin e har tave.	Kuptimi i hartës, llojet e hartave, harta topografike, leximi i hartës dhe orientimi në hapësirë.	Përdorimi i hartës topografike dhe mjeteve të tjera për orientim në hapësirë.	Ndërlidhja e gjeografisë dhe gjeodezisë.
Shkëmbinjtë në koren e Tokës dhe pasuritë minerale	Të njohurit e nxënësve me koren e Tokës, llojet e shkëmbinjve, dhe llojet e mineraleve	Krijimi i kores së Tokës, llojet e shkëmbinjve, shkëmbinjtë mineralmbajtës.	Të kuptuarit e krijimit të korës, të shkëmbinjve dhe xeherorëve metalikë dhe jometalikë.	Ndërlidhja në mes gjeografisë dhe gjeologjisë.
Tërmetet dhe vullkanet	Të njohurit me dukuritë e tërmeteve dhe vullkaneve, të shkaqeve dhe pasojave. Shtrirja gjeografike e tyre.	Dukuria e tërmetit, elementet e tërmetit, llojet, shkaktarët, pasojat, mundësitë e parashikimit. Vullkanet, elementet, llojet, shkaktarët, pasojat.	Të kuptojnë dukurinë, mënyrat e paraqitjes, matjen e tërmeteve, mënyrat e shpëtimit. Kuptimi i vullkaneve, shkaktarët, pasojat, shtrirja gjeografike.	Ndërlidhja në mes njohurive gjeografike dhe gjeologjike. Ndërlidhja me historinë.
Mbështjellësi gjeografik dhe ligjësitë e përgjithshme gjeografike.	Të kuptuarit e tërësisë së mbështjellësit gjeografik, të ndërvartësisë në mes të sferave dhe ligjësiave gjeografike.	Uniteti i mbështjellësit gjeografik, kauzaliteti, totaliteti, qarkullimi i materies, fenomenet ritmike, (a)zonaliteti.	Kuptimi i unitetit të mbështjellësit gjeografik, i kauzalitetit, i fenomeneve ritmike, i shtrirjes (a)zonale të disa elementeve gjeografike.	Ndërlidhja e dukurive dhe elementeve natyrore dhe shoqërore
Problemet e sotme në ndotjen e ambientit	Të njohurit e nxënësve me dukurinë e ndotjes së mjedisit jetësor, shkaktarët e ndotjes, pasojat nga ndotja dhe masat për zvogëlimin e saj.	Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore, ndotja e ajrit, ujit, tokave, degradimi i tokave, treguesit e ndotjes, masat e mbrojtjes.	Të kuptuarit e përdorimit joracional të begative natyrore, xeheve, ujit, pyjeve, tokave, ajrit.	Korelacioni i njohurive gjeografike, biologjike, tekniko-teknologjike, ekonomike, juridike e politike.

Tërësia e dytë: Gjeografia humane (shoqërore)

Njësitë mësimore	Qëllimi dhe objektivat specifike	Përmbajtjet	Rezultatet e pritura	Korelacioni me njësitë dhe lëndët e tjera
Lëvizja e popullsisë dhe tranzicioni demografik në botë, dallimet regjionale dhe politika populative.	Shpjegimi i rritjes së përsheptuar të popullsisë në botë, shkaqet dhe pasojat. Fazat e tranzicionit demografik në botë dhe te ne. Të kuptuarit e politikës populative.	Shtimi absolut dhe relativ, nataliteti, fertiliteti, fekonditeti, mortaliteti, mortaliteti infantil. Etapat dhe nënetapat e tranzicionit Llojet e politikave populative	Njohja me fazat e përsheptimit dhe stabilizimit. Shkaqet e rritjes së përsheptuar dhe rritjes së ngadalësuar. Kuptimi i 3 etapave dhe nënetapave. Kuptimi i politikës populative.	Ndërlidhja në mes rritjes së popullsisë dhe zhvillimit ekonomik e shoqëror. Matematikën.
Strukturat e popullsisë dhe dinamika e tyre (biologjike, ekonomike-sociale, arsimore, etnike, racore, fetare).	Të kuptuarit e dallimeve në strukturën biologjike, ekonomike-sociale, arsimore etj dhe ndërlidhja me zhvillimin human. Indikatorët e zhvillimit human.	Raporti mesgjnor, koeficienti maskulinitetit, feminitetit, popullsia aktive, të mbajtur, e re, e mesme, e moshuar, nivelet e arsimimit, struktura etnike, gjuhësore, racore, fetare.	Të kuptojë raportin mesgjnor, raportin popullsi aktive/joaktive, arsimuar/paarsimuar, kontigjentet e popullsisë dhe strukturat e tjera.	Korelacioni në mes të strukturave të popullsisë dhe ecurive shoqërore-ekonomike.
Urbanizimi si proces botëror dhe implikimet e tij.	Njohja e procesit të urbanizimit në botë, te ne, niveli i urbanizimit, shkaqet, pasojat, ndërlidhjet me proceset e tjera.	Urbanizimi, zgjerimi hapësinor, arealet metropolitane, faktorët e urbanizimit, pasojat e urbanizimit, ndërlidhjet me proceset e tjera.	Kuptimi i rritjes së qyteteve, raporti me vendbanimet e tjera, aglomerimet e popullsisë.	Ndërlidhja në mes të urbanizimit, industrializimit, deagrarizimit. Ndërlidhja me lëndën e historisë
Komunikacioni bashkëkohor dhe roli i tij	Zhvillimi i komunikacionit në botë, etapat, llojet, rëndësia e tij në botën bashkëkohore.	Komunikacioni si degë e proces, llojet dhe rëndësia.	Kuptimi i bartjes së mallrave, njerëzve, informacioneve. Format bashkëkohore.	Zhvillimi tekniko-teknologjik, ekonomik e social dhe komunikacioni.
Harta politike e botës bashkëkohore.	Harta politike e botës sot, proceset politike gjatë shekullit XX dhe tash. Kuptimi i globalizimit dhe regjionalizimit.	Kolonializmi, dekolonializmi, format bashkëkohore të vartësisë dhe ndërlidhjeve politike. Globalizimi dhe regjionalizimi.	Të kuptojë proceset politike gjatë shekullit XX dhe manifestimet e tij.	Ndërlidhja në mes formave të vartësisë politike dhe ekonomike. Ndërlidhja me lëndën e historisë.

Problemi i ushqimit në botë.	Raportet në mes të prodhimit të ushqimit dhe rritjes së popullsisë. Viset me teprica dhe me mungesa të ushqimit.	Përparimi i bujqësisë, rritja dhe ngecja e prodhimit të ushqimit. Ndhimat në ushqim.	Të dijë të bëjë diferencimin e viseve me teprica dhe mungesa në ushqim. Të njohë shkaqet themelore të kësaj dukurie.	Korelacioni në mes prodhimit të ushqimit, rritjes së popullsisë dhe zhvillimit ekonomik e tekniko-teknologjik. Ndërlidhja me lëndën e kimisë.
-------------------------------------	--	--	--	---

Tërësia e tretë: Gjeografia regjionale e kontinenteve

Njësia mësimore	Qellimi dhe objektivat specifike	Përmbajtjet	Rezultatet e pritshme	Korelacioni me njësitë dhe lëndët e tjera
Evropa, natyra, popullsia, ekonomia dhe harta politike	Evropa. Të njohurit e nxënësve me natyrën, pasuritë natyrore, me pozitën gjeografike, me veçoritë e popullsisë, të zhvillimit ekonomik (revolucionet industriale), të standardit të lartë dhe diferencave rajonale.	Pozita e rëndësishme gjeografike, natyra e llojllojshme, klima dinamike, pasuri ujore të mjaftueshme, toka të mira, pasuri natyrore të ndryshme dhe të shfrytëzuara, dendësi e madhe e popullsisë, rritje e ngadalësuar, shkallë e lartë e zhvillimit, arsimimit etj.	Kuptimi i rrethanave të volitshme natyrore, ndikimi pozitiv i tyre në popullim dhe zhvillimin ekonomik e social të këtij kontinenti.	Ndërlidhja e njohurive fiziko-gjeografike, humano-gjeografike, ekonomike dhe tekniko-teknologjike. Ndërlidhja me lëndët e matematikës, biologjisë
Azia, natyra, popullsia, ekonomia dhe harta politike	Azia. Të njohurit me veçoritë fiziko-gjeografike, populllative, socialo-ekonomike dhe politike të kontinentit më të madh, Azisë, me kontraste të mëdha natyrore, etnike, sociale, fetare dhe ekonomike.	Kontinenti më i madh, Kontrastet më të mëdha relievoe, klimatike, hidrografike, biogjeografike, populllative, etnike, fetare, sociale, ekonomike, politike.	Njohja e veçorive fiziko-gjeografike, populllative, ekonomiko-sociale, etnike, gjuhësore etj.	Korelacionet në mes dukurive natyrore, populllative, ekonomike, sociale, etnike etj. Ndërlidhja me lëndët e biologjisë, edukatës qytetare.
Afrika, natyra, popullsia,	Afrika, kontinent i ngrohtë, i pasur me resurse, i	Njohuritë gjeologjike, morfologjike, klimatike,	Njohja me veçoritë e natyrës, me pasuritë	Njohuritë mbi Afrikën të kërkohen në gërshetimin e

<p>ekonomia dhe harta politike</p>	<p>kontrasteve klimatike e biogeografike, i popullsisë me biodinamikë të lartë, me nivel të ulët zhvillimi ekonomik, arsimor etj.</p>	<p>biogeografike, strukturës fisnore dhe etnike, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, social e kulturor, i krizave politike.</p>	<p>natyrore, me proceset e konsolidimit etnik, me popullsinë e varfër, me rritjen e shpejtuar të popullsisë, me problemet politike.</p>	<p>njohurive fiziko -gjeografike, demogjeografike, kulturore dhe politiko-historike. Ndërlidhja me lëndët e matematikës, biologjisë, edukatës qytetare.</p>
<p>Amerika Jugore, natyra, popullsia, ekonomia dhe harta politike</p>	<p>Amerika Jugore me vargmale të reja e të gjata, me klimë të ngrohtë, me lumin më të madh në botë, me popullim të vjetër e të rinj, me përzierje racore e etnike, me ekonomi dinamike dhe në zhvillim.</p>	<p>Shtirja e vargmaleve të larta në perëndim, e fushave në lindje, e pasurive natyrore, e vegjetacionit tropik, e kulturave tropike, e kulturës së vjetër indiane dhe romane-latine , e shteteve të vogla e të mëdha në zhvillim.</p>	<p>Njohuritë mbi natyrën e veçantë, mbi kulturën e vjetër indiane dhe evropiane latine, popuj dhe raca të përziera, ekonominë në zhvillim, shtetet banane në pjesën qendrore dhe shtetet e mëdha në jug.</p>	<p>Gërshetimi i njohurive gjeografike gjeologjike, biologjike, kulturore, historike e ekonomike.</p>
<p>Australia dhe Oqeania, natyra, popullsia, ekonomia dhe harta politike</p>	<p>Njohuritë mbi Australinë dhe Oqeaninë, të natyrës së veçantë, me shkretëtira, gjysëm shkretëtira e male, me pak lumenj, me shumë kullota, me popuj vendorë dhe të ardhur evropianë, me pasuri të medha dhe ekonomi dinamike.</p>	<p>Natyrë karakteristike, shkretëtira, male të larta, pak lumenj, ishuj të gjelbër, resurse të medha natyrore, kolonizim i ri, ferma të medha bujqësore, popullsi urbane, komunikacion të zhvilluar ajror.</p>	<p>Të njohin: Hapësira të mëdha, tri shkretëtira, varg malet skajore të larta, klimë e veçantë, pak lumenj, shumë kullota, blegtori ekstensive komerciale, ferma të mëdha e të ralla, qytete skajore, pasuri xehese, ekonomi dinamike.</p>	<p>Ndërlidhja në mes njohurive gjeografike, ekonomike, historike, biologjike.</p>

Tërësia e katërt: Gjeografia e trevave shqiptare

Njësia mësimore	Qellimi dhe objektivat specifike	Përmbajtjet	Rezultatet e pritura	Korelacioni me njësitë dhe lëndë e tjera
Hapësira gjeografike e trevave shqiptare	Kuptimi i trevave shqiptare, procesi i tkurrjës, copëtimit dhe ndërlidhjes së dobët.	Trevat në lliri dhe gjatë periudhave të mëvona. Pozita gjeografike e tyre, ndërlidhja në mes trevave.	Të njohet shtrirja gjeografike e trevave shqiptare. Pozita gjeografike, ndërlidhja në mes tyre	Ndërlidhja në mes njohurive gjeografike dhe historike shtrirjes së trevave shqiptare.
Resurset natyrore në trevat shqipta re	Struktura e resurseve natyrore, shpërndarja gjeografike, niveli i shfrytëzimit, potenciali i tyre.	Resurset minerale dhe jominerale, lloji, sasia, shfrytëzimi i deritashëm dhe shfrytëzimi në të ardhmen.	Të dihen resurset metalike, jometalike, organogjene, potenciali i tyre për zhvillimin ekonomik.	Korelacioni në mes njohurive gjeografike, gjeologjike dhe ekonomike.
Dinamika demografike në trevat shqiptare	Dinamika populllative në trevat shqiptare. Dinamika e komponenteve natyrore dhe mekanike. Niveli i përtëritjes, strukturat themelore të popullsisë.	Rritja numerike, rritja relative, ecuria e komponentave natyrore, migrimet, periudhat, drejtimet, shkaqet dhe pasojat. Strukturat e popullsisë, diferencat dhe ngjashmeritë.	Kuptimi i shtimit absolut e relativ, i shkaqeve dhe pasojave, strukturat e popullsisë, migrimet, llojet, drejtimet.	Ndërlidhja në mes komponenteve demografike dhe shkaktarëve të tyre. Ndërlidhja me matematikën, statistikën etj.
Turizmi si potencial ekonomik dhe shoqëror	Turizmi si dukuri në trevat shqiptare. Viset emitive dhe receptive turistike. Kapacitetet turistike. Roli i turizmit në ndërlidhjet shqiptare dhe rajonale.	Fazat në zhvillimin e turizmit, viset turistike. Funkzioni ndërlidhës i turizmit në trevat shqiptare e më gjerë. Motivët natyrore dhe kulturore në funksion të turizmit.	Kuptimi i turizmit si dukuri në trevat shqiptare dhe roli i tij në të ardhmen. Kontributi i turizmit në zhvillimin e bashkëpunimit në mes popujve dhe shteteve.	Korelacioni në mes mundësive dhe interesave ekonomike e shoqërore për zhvillimin e turizmit. Ndërlidhja e njohurive gjeografike, historike-kulturore dhe ekonomike.

<p>Komunikacioni si mundësi e ndër lidhjes në rajon e më gjërë.</p>	<p>Komunikacioni në trevat shqiptare, niveli i arritur. Vijat bazë të komunikimit ndërshqiptar dhe rajonal. Zhvillimi perspektiv i komunikacionit.</p>	<p>Fazat e zhvillimit të komunikacionit në trevat shqiptare. Ngecja në zhvillim, rrjeti rrugor, pasojat e zhvillimit të dobët.</p>	<p>Të njihen funksionimi i komunikacionit në trevat shqiptare në të kaluarën dhe në të ardhmen. Roli i komunikacionit në afrimin në mes popujve të rajonit.</p>	<p>Korelacioni në mes zhvillimit të komunikacionit dhe zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Ndërlidhja me historinë</p>
<p>Trevat shqiptare dhe ndarja ndërkombëtare e punës.</p>	<p>Trevat shqiptare dhe ndarja ndërkombëtare e punës. Roli i pasurive natyrore në ekonomi. Resurset shoqërore dhe roli i tyre në ndërlidhjet rajonale. Struktura e ekonomisë dhe bilanci tregtar.</p>	<p>Pozita e trevave shqiptare në Mesdhe dhe në Evropë. Struktura e resurseve natyrore dhe roli i tyre në ekonominë e rajonit e më gjerë. Fuqia punëtore, veçoritë e saj në ekonominë e vendeve të rajonit.</p>	<p>Struktura e resurseve natyrore dhe integrimi i tyre në ekonominë ndër kombëtare. Emigracioni dhe roli i tij për ekonominë e vendeve fqinje e më larg. Eksporti dhe importi dhe roli i tyre për ekonominë e trevave shqiptare.</p>	<p>Ndërlidhja në mes njohurive gjeografike, gjeologjike, ekonomike, historike e politike.</p>
<p>Kosova ndaj Evropës dhe botës.</p>	<p>Njohja me emigrimin e kosovarëve në Evropë dhe në botë. Koha, shkaqet, vendet, efektet ekonomike, sociale dhe politike. Ardhja e ndërkombëtarëve në Kosovë.</p>	<p>Madhësia territoriale, popullative, niveli i zhvillimit ekonomik, marrëdhëniet ekonomike, emigrimi koso var, efektet ekonomike, sociale, politike. Lufta, protektorati mbi Kosovën, raportet me botën.</p>	<p>Kuptimi i situatës ekonomike, sociale dhe politike në Kosovë. Procesi i emigrimit në Evropë dhe në botë, shkaqet dhe implikimet. Mundësitë e investimeve nga diaspora.</p>	<p>Ndërlidhja e njohurive gjeografike, ekonomike, politike dhe historike.</p>

V. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- 1). *Dr. Ruzhdi Pllana*, **GJEOGRAFIA** për kl. V të shkollës fillore, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 2). *Dr. Asllan Pushka*, **GJEOGRAFIA** për kl. VI të shkollës fillore, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2000;
- 3). *Dr. Rifat Blaku*, **GJEOGRAFIA** për kl. VII të shkollës fillore, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2000;
- 4). *Dr. Riza I. Çavolli*, **GJEOGRAFIA** për kl. VIII të shkollës fillor, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 5). *Dr. Ruzhdi Pllana*, **GJEOGRAFIA FIZIKE** për klasën e parë të gjimnazit, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 6). *Dr. Asllan Pushka*, **GJEOGRAFIA SHOQERORE** për klasën II të shkollës së mesme, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 7). *Dr. Riza I. Çavolli*, **GJEOGRAFIA** për kl. III të shkollave të mesme, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2000.

Histori

HISTORI

2 orë në javë, 70 orë në vit

HYRJE

Filozofia e lëndës

Historia si shkencë shoqërore ka objekt studimi shoqërinë njerëzore nga kohët më të hershme deri në ditët tona, në të gjitha dimensionet e saj: civile, sociale, ekonomike, politike, kulturore, racore dhe fetare.

Çka ofron lënda e historisë për kl. IX?

Lënda e historisë për klasën IX si klasë orientuese ka për qëllim përforcimin e njohurive dhe përmbajtjeve nga vitet e mëparshme.

Programi i lëndës së historisë për klasën IX synon që duke bërë një rumbullakim të njohurive paraprake të thellojë njohuritë e nxënësve dhe të pasqyrojë sa më objektivisht ngjarjet dhe proceset historike.

Përfshirja e historisë së përgjithshme do të mësohet në korelacion me historinë e popullit shqiptar që do të ndikojë në formimin më të plotë qytetëruar, intelektual, shkencor, kulturor e atdhetar të nxënësve.

Programi përcakton një raport të orëve mësimore për të gjitha periudhat kohore dhe është i pajisur me elemente bashkëkohore kurrikulare.

Në program pasqyrohen rezultatet më të reja shkencore të historisë vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

I. QËLLIMET E PËRGJITHSHME

- Zotërimi i njohurive dhe koncepteve për të kaluarën njerëzore
- Njohja e kulturave të ndryshme nëpër periudha të caktuara të së kaluarës së njerëzimit:
 - mënyrat e jetës dhe të të menduarit;
 - personalitetet e njohura;
 - ngjarjet e rëndësishme historike;
 - vendet dhe institucionet;
 - besimet;
- Kuptimin e ndërlidhjeve dhe ndërndikimeve në shoqëri;
- Arsimimi demokratik;
- Zhvillimi i autonomisë të nxënësi;

- Zhvillimi i mendimit kritik;
- Zhvillimi i tolerancës;
- zhvillimi i vetërespektit dhe respektit për të tjerët.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA

Edukimi

- Të afirmohet si individ me personalitet, i vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë që ka si anëtar i një shoqërie demokratike;
- Të karakterizohet me ndjenja të atdhedashurisë dhe të krenarisë Kombëtare;
- Të afirmohen ndjenjat dhe traditat më të mira për popujt e ndryshëm të botës;
- Të nxitet fryma e respektit për të gjithë popujt.

Kronologjia

- Të jetë në gjendje të kuptojë dhe të dallojë kronologjinë e zhvillimit të ngjarjeve në periudhat e ndryshme historike dhe roline e personaliteve si p.sh.: Leka i Madh, Skënderbeu, Napoleon Bonaparta, Nëna Tereze, e të tjerë.
- Të dijë të përdorë me saktësi konceptet historike në kohë dhe në hapësirë, duke i pajisur ato me koncepte të reja të realitetit shoqëror.

Cilësia dhe thellësia e njohurive historike

- Të aftësohet të karakterizojë epokat më të rëndësishme të historisë, në planin ekonomik, social, politik e kulturor;
- Të jetë i aftë të analizojë dhe të gjykojë drejt shkaqet dhe rrjedhat e ngjarjeve, në rrethana të ndryshme në periudha të caktuara historike;
- Të aftësohet që përmes mësimin të historisë të kuptojë rolin e popullit shqiptar në ndërtimin e paqës, tolerancës dhe mirëkuptimit me popujt e tjerë;
- Të jetë në gjendje të kuptojë lidhshmërinë e historisë kombëtare me historinë rajonale dhe botërore, duke vënë në dukje tiparet e përgjithshme dhe specifikat e përbashkëta.

Interpretimi

- Të jetë i aftë të kuptojë se për ngjarje, dukuri, procese, objekte apo figura historike të historisë botërore dhe kombëtare ka interpretime të ndryshme. Për këtë arsye nxënësi dhe mësimdhënësi duhet të kenë të zhvilluar mendimin e tyre kritik për kuptimin sa më të drejtë të këtyre ngjarjeve;

- Të jetë në gjendje të kuptojë dhe të analizojë proceset historike, figurat apo dukuritë në periudhat më të rëndësishme të historisë botërore dhe asaj kombëtare, duke veçuar faktet nga opinionet dhe paragjykimet;
- Të dijë të ballafaqohet në mënyrë kritike me disa nga llojet e burimeve të ndryshme të informacionit të shfrytëzuar për një ngjarje apo periudhë historike.

Kërkimet historike

- Të dijë të grumbullojë dhe të vlerësojë informacionin për një problem të caktuar pa e shpëputur nga konteksti i tij historik, duke arritur të nxjerrë përfundime të vlefshme;
- Në përputhje me moshën të përvetësojë elemente të metodologjisë mësimore-shkencore në mënyrë që nën drejtimin e mësimit të lëndës të mundë të realizojë punime (referate) me karakter shkencor për probleme të ndryshme të historisë.

Organizimi dhe komunikimi

- Të përvetësojë njohuri dhe shkathtësi të përshkruaj dhe të shpjegojë periudhat e ndryshme të historisë;
- Të jetë i aftë të debatojë me argumente për probleme të caktuara historike, qofshin këto edhe të diskutueshme;
- Të krijojë shprehje që përmes diskutimit të synojë në arritjen e kompromiseve, duke respektuar qëndrimet dhe argumentet e kundërta.

III. ZOTËSITË DHE SHKATHTËSITË E SYNUARA

Përmes mësimit të historisë për këtë klasë do të promovohen këto shkathtësi:

- Shkathtësinë e orientimit në kohë dhe në hapësirë që nga mjedisi ku jeton e tutje;
- Aftësitë (shkathtësitë) për zhvillim të personalitetit human;
 - Zhvillimi i shkathtësive për të kuptuar dhe gjykuar në mënyrë të pavarur dhe kritike për ngjarjet dhe proceset;
 - Zhvillimi i shkathtësive për të komunikuar me të tjerët;
 - Zhvillimi i shkathtësive për të nxënë gjatë gjithë jetës;
 - Zhvillimi i shkathtësive të përdorimit të njohurive të fituara mbi ngjarjet shoqërore për zgjidhjen e konflikteve në situata të ndryshme jetësore;
 - Zhvillimi i shkathtësive për të kuptuar drejt situatat politike, ekonomike, sociale, kulturore në shoqëri;
- Aftësitë kulturore:
 - Të analizojë elemente të ndryshme sociale-kulturore lokale, rajonale dhe më gjerë;
 - Të krahasojë kulturat e të tjerëve me kulturën e vet;

- Sjelljet e veta t'ua përshtatë zakoneve të një shoqërie demokratike dhe të civilizuar.

IV. ASPEKTET NDËRLËNDORE DHE NDËRDISIPLINARE

Lidhja e historisë me lëndët e tjera

Historia si shkencë nga përmbajtja është komplekse. Në përbërjen e saj bëjnë pjesë disa lëmenj dhe disiplina si: arkeologjia, heraldika, etnografia, toponimia, numizmatika, arkivistika, muzeologjia etj. të cilat në vete përbëhen nga shumë elemente që kanë pika studimi të ndryshme dhe qëndrojnë në raporte të ndryshme. Kjo llojshmëri e lëmenjve dhe e objekteve të studimit ka nevojë për njohuri komplekse lidhje ndërdisiplinare brenda historisë, por edhe me shkencat e tjera. Periudhat, fenomenet, dukuritë dhe proceset shoqërore që i studion historia janë ngushtë të ndërlidhura përherë me shkencat e tjera si: gjuha dhe letërsia, gjeografia, sociologjia, filozofia, ekonomia, teknologjia, arti, muzika, matematika dhe shkencat, tjera ekzakte etj.

V. PËRMBAJTJA PROGRAMORE

(Fondi i orëve: 2 orë në javë, 70 orë në vit)

59 orë zhvillim i njësisë mësimore

11 orë në dispozicion të mësimeve të mësimdhënësit

Programi i lëndës së historisë për kl. IX do të përbëhet prej katër pjesëve që do të përbëjnë një tërësi. Pasi që përmbajtja e programit parasheh përfundim të tërë asaj që është mësuar në vitet paraprake është bërë një ndarje e tillë, duke u mbështetur në periudhat historike nga parahistoria deri në ditët e sotme.

- I. Parahistoria me historinë e kohës së vjetër;**
- II. Historia e mesjetës;**
- III. Historia e kohës së re;**
- IV. Historia bashkëkohore**

I. Parahistoria me historinë e kohës së vjetër (12 orë)

Temat:

- 1). Fillet e organizimit të shoqërisë njerëzore;
- 2). Lindja e lashtë;
- 3). Antikiteti grek;
- 4). Maqedonia e lashtë;
- 5). Ilirët, tradita dhe kultura;
- 6). Tradita hebraiko-krishtere;
- 7). Roma dhe Perandoria Romake

II. Historia e mesjetës (16 orë)

Temat:

- 1). Bizanti;
- 2). Arabët – lindja e islamizmit;
- 3). Evropa Karoline;
- 4). Kryqëzatat
- 5). Arbëria në shek.XI-XV;
- 6). Perandoria Osmane;
- 7). Epoka e Skënderbeut;
- 8). Humanizmi dhe renesansa

III. Historia e kohës së re (15 orë)

Temat:

- 1). Reformacioni dhe kundërreformacioni;
- 2). Zbulimet e mëdha gjeografike;
- 3). Lindja e shteteve nacionale;
- 4). Lufta për koloni dhe formimi i SHBA-ve;
- 5). Iluminizmi;
- 6). Perandoria e Napoleonit;
- 7). Kongresi i Vjenës;
- 8). Lëvizjet nacionale në Evropë dhe në Ballkan në shek. XIX;
- 9). Rilindja Kombëtare Shqiptare;
- 10). Marrëdhëniet ndërkombëtare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

IV. Historia bashkëkohore (16 orë)

Temat:

- 1). Lufta e Parë Botërore;
- 2). Shqiptarët prej Shpalljes së Pavarësisë deri në LDB;
- 3). Komunizmi, Fashizmi, Nationalsocializmi;
- 4). Lufta e Dytë Botërore;
- 5). Marrëdhëniet politike dhe ekonomike pas vitit 1945;
- 6). Shqiptarët pas vitit 1945.

Parahistoria me Histori të Kohës së Vjetër

Temat	Qëllimet dhe objektivat specifike	Përmbajtjet dhe njësit mësimore	Rezultatet e pritshme	Korelacion me disiplinat dhe lëndët tjera
I Fillet e organizimit të shoqërisë njerëzore	Njohja me fazat e para të zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe karakteristikat e tyre	Procesi i zhvillimit të shoqërisë njerëzore; Koha e gurit. <i>Koha e metaleve; veglat e punës, mënyra e jetesës dhe besimet.</i>	Të dijë të dalloj specifikat kryesore të secilës fazë Të dijë të numëroj disa nga mjetet e punës	Ndërlidhja me Artin, Arkeologjinë, Gjeografinë, Biologjinë
II Lindja e Lashtë	Njohja me konceptin e shteteve të para. Organizimin e tyre hierarkik, jetën e sundimtarve dhe jetën shoqërore Njohja me besimin e tyre	Fillet e shteteve të para: Egjipti, Mesopotamia, Kina, India. Arti dhe arkitektura, Sundimtarët, tempujt dhe varret (piramidat), ekonomia, transporti <i>Përëndit, legjendat dhe zakonet</i>	Të dijë të dalloj karakteristikat kryesore të shteteve të para, të dijë të përshkruaj jetën shoqërore të asaj kohe. T'i njoh përëndit kryesore	Ndërlidhja me: Arkeologjinë, Etnografinë, Mitologjinë, Gjeografinë, Matematikën, Artin, Letërsinë
III Antikiteti Grek	Njohja me kulturat e hershme të rajonit të Mesdheut. Lëvizjet e hershme të popullsisë. Njohja me organizimin shtetëror në Athinë dhe Spartë. Luftërat e asaj kohe. Jetën shoqërore, kulturore dhe besimet	Kultura e Kretës dhe e Mikenës Athina dhe Sparta. Luftërat greko – persiane dhe Luftërat e Peleponezit. Aspekte të mënyrës së jetës: arti dhe arkitektura, qytetet dhe godinat publike, ujësjellësi, qytetarët dhe skilleverit, arsimimi për vajza dhe djemë, lojrat olimpike dhe teatri, anijet dhe tregëti, ushtarët dhe gjendja e luftës Përëndit, mitet, legjendat dhe zakonet, filozofia	Të dijë të dalloj specifikat kryesore të kulturës së Kretës dhe Mikenës. Të njoh dhe të dijë të bëjë dallimin mes rregullimit shtetëror demokratik sklla vopronar Në Athinë dhe rregullimit oligarkik në Spartë. Të dijë shkaqet dhe betejat kryesore të luftërave të asaj kohe. Të dijë specifikat kryesore të jetës së përditshme të shoqërisë greke të asaj kohe. Të dijë për Lojrat Olimpike. Të njohë dhe të dalloj përënditë kryesore	Ndërlidhja me: Arkeologjinë Artin, Edukatën Fizike, Matematikën, Gjeografinë, Letërsinë, Filozofinë, Ekonominë, Arkitekturën

<p>IV Maqedonia e lashtë</p>	<p>Njohja me mendimet për prejardhjen e maqedonëve të lashtë Njohja me shtetin maqedonas të asaj kohe, Lekën e Madh Kulturën Helene</p>	<p>Maqedonia e lashtë dhe helenizmi <i>Zgjerimi i shtetit Maqedon në kohën e Filipit II Leka i Madh dhe pushtimet e tij,</i> Kultura Helene</p>	<p>Të dijë pikpamjet e ndryshme për prejardhjen e maqedonve të lashtë. Të njoh specifikat kryesore të shtetit të Maqedonisë së Lashtë. Të dijë për jetën dhe pushtimet e Lekës së Madh Të dijë karakteristikat themelore të Kulturës Helene</p>	<p>Ndërlidhja me Arkeologjinë, Artin, Gjeografinë, Filozofinë</p>
<p>V Ilirët, tradita dhe kultura</p>	<p>Njohja me origjinën e Ilirëve, një ndër popujt më të vjetër të Ballkanit. Fiset ilire, shtetet ilire, jetën e përditshme, luftërat. Besimi dhe kultura ilire</p>	<p>Ilirët Aspekte të mënyrës së jetesës: <i>organizimi shoqëror, arti, arkitektura, qytetet, anijendërtimtaria dhe tregtia, ushtarët dhe luftrat.</i> Besimi dhe kultura ilire: <i>hyjnitë, varret (tumat), veshjet (tunika, dalmatika, fibulat), Muzika (Niketë Dardani), Ushqimet dhe pijet, mjekësia dhe shëndeti.</i></p>	<p>Të dijë për teoritë mbi prejardhjen e ilirëve. Të njoh fiset kryesore ilire dhe vendshtrirjen e tyre. Të njoh shtetet ilire dhe të di të dalloj mbretërit ilire. Betejat kryesore, qytetet kryesore. Të dijë për anijendërtimtarinë. Të njoh dhe të di të dalloj veshjet kryesore, ushqimet tipike, veglat muzikore ilire, veglat e punës armët, mjeksinë. Të njoh perënditë kryesore ilire</p>	<p>Ndërlidhja me: Arkeologjinë, Etnografinë, Numizmatikën, Artin, Muzikën, Gjeografinë</p>
<p>VI Tradita Hebraiko – Krishtere</p>	<p>Njohja me filltet e besimit monoteist, librat e para të shenjëta. Njohja me filltet e krishterizmit. Librat e shenjëta (Bibla) Krishterizmi të ilirët</p>	<p>Fillet e monoteizmit <i>Librat e shenjëta hebreje, Lindja dhe përhapja e krishterizmit, Jeta e Jezu Krishtit, librat e shenjëta-Bibla,</i> Krishterizmi të ilirët: <i>Flori dhe Lauri, Shën Jeronimi, Dak Dardani, Ndikimi i ilirëve në përhapjen krishterizmit</i></p>	<p>Të dijë të dalloj besimin politeist me atë monoteist, të njoh librat e parë të shenjëta. Të dijë të përshkruaj jetën dhe veprimtarinë e Jezu Krishtit, të</p>	<p>Ndërlidhja me Artin, Gjeografinë, Filozofinë, Letërsinë</p>

			njohë librin e shenjtë Biblën. Të dijë për krishterizmin tek ilirët dhe t'i njoh martirët dhe të shenjtit e parë ilir.	
VII Roma dhe Perandoria Romake	Njohja me fillet e Romës së Lashtë dhe forcimin e zgjerimin e saj. Njohja me Perandorinë Romake. Luftërat kryesore. Njohja me organizimin shtetëror e shoqëror, jeta e përditshme. Njohja me kulturën, artin dhe besimin romak	Themelimi i Romës Shoqëria e hershme romake, Zgjerimi i shtetit romak. Perandoria Romake <i>Pushtimet, organizimi ushtarak, qytetarët dhe sklevërit –gladiatorët.</i> Arti, Kultura dhe Besimi Arkitektura, godinat publike, rrugët, viaduktet, Hyjnitë, letërsia, filozofia, e drejta Romake.	Të dijë për themelimin e Romës dhe për shoqërinë e hershme romake. Të dallojë ndryshimet dhe avancimet nga republika, mbretëria në perandori. Të dijë betejat kryesore, të njoh karakteristikat e organizimit shtetëror dhe ushtarak dhe të drejtën romake. Të dijë karakteristikat themelore të artit arkitekturës, të njoh poetët, shkrimtarët, oratorët dhe filozofët më të njohur romak. Të njoh dhe të dijë të dallojë perënditë kryesore romake nga ato greke.	Ndërlidhja me: Artin, Gjeografinë, Letërsinë, Drejtesinë

Histori e Mesjetës

Temat	Qëllimet dhe objektivat specifike	Përmbajtjet dhe njësit mësimore	Rezultatet e pritshme	Korelacion me disiplinat dhe lëndët tjera
VIII Bizanti	Njohja me ndarjen e Perandorisë Romake. Depërtimet e fiseve barbare. Njohja me filltet e shtetit të Bizantit, organizimi administrativ. Kultura, Arti. Ndarja e kishës	Ndarja e përandorisë Romake Invazionet dhe migrimet e hershme: Gotët, Hunët, Vandalët, Sllavët, Avarët . Shoqëria bizantine në kohën e Justinianit <i>Organizimi administrative-shtetëror i Përandorisë Bizantine</i> <i>Thema e Durrësit, Nikopojës.</i> Sllavët e jugut dhe shteti i Rashkës Kultura Bizantine <i>Arti, arkitektura, jeta qytetare.</i> Krishterizmi Lindor dhe Përendimor	Të dijë arsyet e ndarjes së Perandorisë Romake. Të dijë kohën e depërtimeve të fiseve barbare dhe të dalloj depërtimet dhe vendosjet e tyre. Të dijë organizimin administrativ-shtetëror të Bizantit. Të dijë karakteristikat themelore të Themës së Durrësit dhe Nikopojës. Të dijë vendosjen e Sllavëve të Jugut dhe organizimin dhe shtrirjen e Shtetit të Rashkës. Të dijë karakteristikat themelore të kulturës dhe artit bizantin. Të dijë arsyet e ndarjes së kishës në lindore dhe perendimore dhe të bëjë dallimet elementare mes tyre.	Ndërlidhja me Gjeografinë, Letërsinë, Demografinë
IX Arabët-Lindja e	Njohja me shoqërinë arabe në mesjetë.	Organizimi i shoqërisë arabe - Lindja dhe përhapja e Islamizmit,	Depërtimi arab në Evropë	Ndërlidhja me: Gjeografinë,

Islamizmit	Lindja dhe përhapja e Islamizmit.Njohja me organizimin shtetror arab.Njohja me pushtimet dhe kulturën arabe	Jeta e Muhametit,Libri i shenjtë- Kur`ani. Kalifatet Arabe	Kultura arabe Të dijë të përshkruaj gjendjen dhe tiparet karakteristike të shoqërisë arabe në mesjetë.Të dijë arsyet dhe rrethanat e lindjes së Islamizmit. Të dijë të përshkruani jetën dhe veprimtarinë e Muhametit. Të njoh librin e shenjtë Kuranin	Letërsinë, Filozofinë
X Evropa Karoline	Njohja me veqoritë themelore të Feudalizmit. Ngjajshmërit dhe tiparet dalluese nga shoqëria e Bizantit dhe ajo Arabe.Njohja me fillet e Shtetit Frang.Jeta dhe veprimtaria e Karlit të Madh. Pasojat e vdekjes së Karlit Madh.	Feudalizmi-karakteristikat e përgjithshme Frankët-organizimi shtetëror, jeta kulturore dhe tradita Karli i Madh – organizimi ushtarak <i>Formimi i Francës,Gjermanisë dhe Italisë</i>	Të kuptoj karakteristikat themelore të feudalizmit të hershëm.Të kuptoj shkaqet e formimit të shtetit Frank dhe specifikat e zhvillimit dhe zgjerimit të tij.Të dijë të për rolin e Karlit të Madh.Të dijë për krijimin e shteteve të reja pas rënies së shtetit Frank	Ndërlidhja me: Gjeografinë, Artin, Letërsinë, Gjuhën frënge
XI Kryqëzatat	Njohja me zhvillimin e tregtisë dhe qyteteve mesjetare.Njohja me aspektet esenciale të organizimit të kryqëzatave. Ekspeditat dhe tipa- ret dalluese të tyre. Pasojat dhe rezultatet e tyre.	Qytetërimi Evropian në shek.XI-XIII Zhvillimi tregëtisë dhe qyteteve mesjetare Kryqëzatat – Motivet për organizimin e tyre; <i>Kalimi i kryqëtarëve nëpër trevat .Arbërore; Rezultatet dhe pasojat e luftërave kryqëtare</i>	Të kuptoj ndryshimet shoqërore të kohës,të di specifikat kryesore të zhvillimit të tregtisë dhe qyteteve.Të kuptoi qëllimin e organizimit të kryqëzatave dhe pasojat e tyre.	Ndërlidhja me: Gjeografinë, Letërsinë, Ekonominë, Filozofinë

<p>XII Arbëria në shek.XI-XV</p>	<p>Njohja me rrethanat dhe me fazat e zhvillimit të shtetit të Arbërit, njohja me principatat shqiptare të shek.XIV-XV. Njohja me tiparet dalluese të zhvillimit të marrëdhënieve feudale të principatave shqiptare</p>	<p>Arbërit-pasardhësit e Ilirëve Shteti i Arbërit dhe Despotati i Artës Principatat shqiptare gjatë shek.XIV-XV <i>Topiajt, Balshajt, Zenebishtët, Shpatajt.</i></p>	<p>Të njoh fazat e zhvillimit të shteti të Arbërit.Të njoh sunduesit e shtetit të Arbërit.Të dijë principatat shqiptare të shek.XIV-XV.Të dijë karakteristikat themelore të shoqërisë shqiptare të kohës</p>	<p>Ndërlidhja me: Arkeologjinë, Heraldikën, Gjuhën e Letërsinë, Gjeografinë, Artin.</p>
<p>XIII Perandoria Osmane</p>	<p>Njohja me tiparet dalluese të të Shtetit Osman. Forcimi i shtetit Osman, pushtimet Osmane. Depërtimet osmane në Ballkan</p>	<p>Ballkani në prag të depërtimit Osman Pushtimet Osmane në Ballkan. <i>Beteja e Kosovës-luftë e koalicionit ballkanik kundër Osmanëve.</i></p>	<p>T ë dijë tiparet dalluese të shtetit osman, pushtimet osmane. Rezistencën e popujve të Ballkanit</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë, Letërsinë, Artin</p>
<p>XIV Epoka e Skënderbeut</p>	<p>Njohja me pushtimet osmane të tokave shqiptare. Qëndresa shqiptare,krijimi i beslidhjes shqiptare në udhëheqjen e Skënder beut.Fitoret e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut.Raportet e skënderbeut me Evropën</p>	<p>Pushtimet e tokave shqiptare nga Osmanët <i>Qëndresa shqiptare.</i> Kuvendi i Lezhës <i>Besëlidhja shqiptare-Shteti i Skënderbeut.</i> Fitoret e medha shqiptarëve nën udhëheqjen Gjergj Kastriotit Skenderbeut (1443-1468) <i>Marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet Evropiane</i></p>	<p>Të dijë për depërtimet dhe pushtimet osmane në tokat shqiptare. Rezistencën e shqiptarëve. Krijimin e besëlidhjes shqiptare-Lidhja e Lezhës. Vendimet e Lidhjes. Betejat dhe fitoret e kryesore të shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut. Karakteristikat themelore të shoqërisë shqiptare të kohës. Mardhënjet e shtetit të Skënderbeut me vendet e Evropës.</p>	<p>Ndërlidhja me: Etnografinë, Heraldikën, Gjeografinë, Gjuhën, Letërsinë, Diplomacinë, Artin,Muzikën</p>

<p>XV Humanizmi dhe Renesansa (shek. 14-15)</p>	<p>Njohja me rrethanat e shfaqjes së ideve humaniste. Përfaqësuesit kryesor të Humanizmit dhe Renesancës. Përhapja e këtyre ideve te shqiptarët</p>	<p>Humanizmi dhe Renesansa <i>Rrethanat në të cilat u shfaq Humanizmi dhe Renesanca.</i> <i>Italia-Djep i Humanizmit dhe Renesancës.</i> <i>Përhapja dhe konfrontimi i ideve humanis te me kishën.</i> <i>Reflektimi i ideve humaniste tek shqiptarët.</i></p>	<p>Të dijë rrethanat specifike në të cilat u shfaqen idetë humaniste. Të dijë humanistët e parë. Të kuptojë shkaqet e lindjes së humanizmit në Itali dhe ndikimin e saj në Evropë dhe te shqiptarët</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografin, Artin, Muzikën, Letërsinë, Filozofinë, Arkitekturën, Sociologjinë</p>
--	---	---	---	---

Histori e Kohës së Re

Temat	Qëllimet dhe objektivat specifike	Përmbajtjet dhe njësit mësimore	Rezultatet e pritshme	Korelacion me disiplinat dhe lëndët tjera
<p>XVI Reformacioni dhe kundër-Reformacioni</p>	<p>Njohja me arsyet e lindjes së protestantizmit, specifikat dalluese nga pikëpamjet kishtarë të deriatëhershme dhe përpjekjet e kishes që t'i kundërvihet</p>	<p>Lindja e Protestantizmit <i>Martin Luteri dhe idetë e tij.</i> <i>Përhapja e Protestantizmit.</i> Kundërreformacioni Katolik</p>	<p>Të kuptojë tiparet dalluese të krishterizmit dhe protestantizmit dhe shkaqet e kundërveprimit të kishës ndaj lëvizjes reformiste protestante</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë, Filozofinë, Sociologjinë, Letërsinë, Artin</p>
<p>XVII Zbulimet e Mëdha Gjeografike</p>	<p>Njohja me arsyet ekonomike të zbulimeve gjeografike. Udhëtimet dhe zbulimet dhe rëndësia e këtyre zbulimeve për progresin njerëzor</p>	<p>Udhëtimet dhe Zbulimet Gjeografike <i>Shkaqet e zbulimeve gjeografike.</i> <i>Zbulimi i Amerikës.</i> <i>Zbulimet e tjera gjatë shek. XV-XVI.</i> <i>Rrjedhojat e zbulimeve gjeografike.</i></p>	<p>Të shpjegojë arsyen dhe qëllimet e zbulimeve gjeografike. Të shpjegojë rëndësinë dhe pasojat e zbulimeve.</p>	<p>Ndërlidhja me: Etnografinë, Gjeografinë, Ekonominë, Tregëtinë, Matematikën, Navigacionin, Biologjinë</p>

<p>XVIII Lindja e shteteve nacionale</p>	<p>Njohja me shkaqet e krijimit të shteteve nacionale. Tiparet dalluese të shoqërisë mesjetare dhe shoqërisë së re borgjeze dhe rëndësia e përgjithshme shoqërore e krijimit të shteteve nacionale</p>	<p>Revolucionet borgjeze në Evropë në shek.XVI-XVIII <i>Revolucioni në Vendet e Ulëta.</i> <i>Revolucioni në Angli.</i> <i>Revolucioni në Francë.</i></p>	<p>Kuptimi i tipareve dalluese të mesjetës dhe kapitalizmit dhe specifikat e lindjes së marrëdhënieve mënieve më të reja që ndikuan në krijimin e shteteve nacionale</p>	<p>Ndërlidhja me: Sociologjinë, Gjeografinë, Teknikën, Fizikën, Teknologjinë</p>
<p>XIX Lufta për koloni dhe formimi i SHBA-ve</p>	<p>Njohja me arsyet esenciale të luftërave për koloni dhe rëndësia ekonomike e këtyre luftërave. Roli i madh që pati zbulimi dhe formimi i SHBA-ve për zhvillimin e përgjithshëm njerëzor</p>	<p>Pushteti kolonial anglez në Amerikë-lufta për pavarësi <i>Shpallja e pavarësisë së SHBA-ve.</i> <i>Kushtetuta e vitit 1887.</i></p>	<p>Kuptimi i shkaqeve të luftërave koloniale dhe ndryshimi i raporteve politike në Evropë dhe botë pas formimit të SHBA-ve Të dijë për parimet bazë të kushtetutës së vitit 1887</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë, Artin, Edukatën Qytetare, Letërsinë</p>
<p>XX Iluminizmi</p>	<p>Njohja me idetë iluministe, arsyet pse lindën këto ide, rëndësia e tyre për zhvillimin e shoqërisë, ndikimi dhe përhapja e tyre</p>	<p>Shfaqja e iluminizmit <i>Iluministët më të shquar dhe idetë e tyre.</i> <i>Përhapja e ideve iluministe.</i></p>	<p>Të kuptojë tiparet dalluese të ideve iluministe dhe shkaqet e përvetësimit të këtyre ideve. Të njoh iluministët më të shquar.</p>	<p>Ndërlidhja me: Letërsinë, Gjeografinë, Filozofinë</p>
<p>XXI Perandoria e Napoleonit</p>	<p>Njohja me gjendjen në Francë dhe arsyet e ardhjes në pushtet të Napoleonit. Shkaqet e pushtimeve të Napoleonit. Roli i tij si</p>	<p>Kriza në Francë dhe ardhja e Napoleonit në pushtet <i>Shpallja e Francës përandori</i> <i>Pushtimet e Napoleonit</i></p>	<p>Marrëdhëniet e Napoleonit me Ali Pashë Tepelenën <i>Beteja e Vaterlosë-internimi i Napoleonit</i> Të kuptojë gjendjen në</p>	<p>Ndërlidhja me: Sociologjinë Gjeografinë, Letërsinë, Gjuhën frënge, Diplomacinë</p>

	strateg e politikan. Shkaqet e disfatës së tij		Francë dhe rrethanat e ardhjes së Napoleonit në pushtet. Tiparet dalluese të luftërave të Napoleonit. Raportet e tij me Ali Pashë Tepelenën dhe të njohë shkaqet e disfatës së Napoleonit dhe pasojat e saj	
XXII Kongresi i Vjenës	Njohja me ndryshimet në Evropë pas luftërave të Napoleonit dhe shkaqet e atyre ndryshimeve dhe pasojat e tyre.	Kongresi i Vjenës <i>Rrethanat e organizimit të Kongresit të Vjenës.</i> <i>Vendimet e Kongresit të Vjenës.</i> <i>Dhe reflektimi i tyre në Evropë.</i>	Të kuptoj vendimet e Kongresit të Vjenës dhe ndikimet e këtyre vendimeve në ndryshimet e mëtejme në Evropë	Ndërlidhja me: Gjeografinë, Diplomacinë
XXIII Lëvizjet Nacionale në Evropë dhe Ballkan në shek.XIX	Njohja me shkaqet dhe arsyet e bashkimit të Gjermanisë, Italisë. Rëndësinë ekonomike-politike të të këtij bashkimi. Njohja me gjendjen në Ballkan dhe aspiratat e shteteve ballkanike për pavarësi dhe zgjerim territorial në dëm të fqinjëve	Bashkimi i Gjermanisë dhe Bashkimi i Italisë. Krijimi i shteteve të pavarura në Ballkan <i>Greqia, Rumania, Serbia dhe Mali Zi.</i>	Të kuptoi specifikat dalluese të zhvillimit në Gjermani dhe Itali dhe rrjedhat e bashkimit. Të kuptoj procesin e pavarësimit të disa shteteve të Ballkanit dhe aspiratat pushtuese të këtyre shteteve ndaj fqinjëve	Ndërlidhja me: Gjeografinë, Letërsinë, Diplomacinë

<p>XXIV</p> <p>Rilindja Kombëtare Shqiptare</p>	<p>Njohja me aspiratat çlirimtare të popullit shqiptar, karakteristikat dalluese të fazave të Rilindjes Kombëtare dhe shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.</p>	<p>Fillet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare <i>Lidhja Shqiptare e Prizrenit.</i> <i>Lidhja Shqiptare e Pejës.</i> <i>Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës shqiptare në fund të shek XIX.</i> Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908 – 1912 <i>Revolucioni Xhonturk dhe shqiptarët.</i> <i>Kryengritjet antiosmane 1909 – 1912.</i> Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë Qeveria e përkohshme-Ismael Qemali</p>	<p>Të kuptoi esencën e synimeve të luftës çlirimtare dhe tiparet dalluese të çdo faze çlirimtare të luftës së popullit tonë. Të kuptoi dhe vlerësoi rëndësin e shpalljes së pavarësisë.</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, Diplomacinë, Gjeografinë, Artin, Muzikën</p>
---	--	--	---	---

Histori Bashkëkohore

Temat	Qëllimet dhe objektivat specifike	Përmbajtjet dhe njësit mësimore	Rezultatet e pritshme	Korelacion me disiplinat dhe lëndët tjera
<p>XXV</p> <p>Mardhëniet ndërkombëtare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX</p>	<p>Njohja me diplomacinë e shteteve të atëher shme Evropiane dhe arsytet e formimit të aleancave ushtarake. Të njihet me të mbërrimet shkencoroteknike dhe rolin që patën këto zbulime në progresin njerëzor</p>	<p>Evropa në fund të shek. XIX dhe fillim shek. XX <i>Formimi i aleancës tripalëshe.</i> <i>Formimi i bllokut të Antantës.</i> <i>Krizat ndërkombëtare.</i> Zhvillimi shkencës dhe i teknikës në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Ekonomia, Shkenca dhe Teknika.</p>	<p>Të kuptoi në esencë shkaqet e acarimit të marrëdhënjeve ndërkombëtare (raportet mes shteteve të mëdha) dhe pretendimet ekspansioniste të tyre. Të kuptoi arsytet e nxitjes së zbulimeve shkencoroteknike dhe rëndësin e tyre</p>	<p>Ndërlidhja me Gjeografinë, Teknologjinë, Biologjinë, Ekonominë, Diplomacinë</p>
<p>XXVI</p> <p>Lufta e Parë Botërore</p>	<p>Njohja me përpyekjet e popullit shqiptar për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe konsolidimin e shtetit shqiptarë. Të dijë për qëndresën dhe gjendjen që kishin</p>	<p>Shkaqet e fillimit të Luftës së Parë Botërore-Fillimi i luftës <i>Frontet kryesore të luftës</i> Hyrja e Italisë në luftë, Fronti ballkanik Hyrja e SHBA –ve në luftë <i>Roli SHBA-ve në ngadhënjimin e Antantës.</i> <i>Rrjedhojat dhe karakteri i Luftës së Parë Botërore.</i></p>	<p>Të kuptoi esencën e kësaj lufte dhe tiparet dalluese të palëve ndërluftuese shkaqet që SHBA hynë në luftë dhe pasojat për zhvillimin e më tej</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë, Teknologjinë, Mediat (Propagandën), Kimin, Matematikën</p>

	shqiptarët gjatë luftës.Njohja me gjendjen e shqiptarve pas luftës.Njohja me gjendjen e shqiptarve jasht kufijve shtetëror.	Paqa e Versajës Vendimet e Paqës së Vërsajës	të luftës.Përfundimi i luftës dhe vendimet e Paqes së Versajit.Të dijë për raportet e reja që u krijuan në Evropë.	
XXVII Shqiptarët prej Shpalljes së Pavarësisë deri në L.D.B.	Njohja me përpjekjet e popullit shqiptar për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe konsolidimin e shtetit shqiptarë.Të dijë për qëndresën dhe gjendjen që kishin shqiptarët gjatë luftës.Njohja me gjendjen e shqiptarve pas luftës.Njohja me gjendjen e shqiptarve jasht kufijve shtetëror	Përpjekjet e shtetit Shqiptarë për konsolidim <i>Vendosja e Princ Vidit në Shqipëri.</i> Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore. Shqipëria gjatë viteve 1920-1939 Kosova dhe viset tjera shqiptare 1913-1941 <i>Lufta e shqiptarëve për çlirim dhe bashkim kombëtarë.</i> <i>Përpjekjet e Mbretërisë jugosllave për asimilim, çkombëtarizim dhe shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e veta.</i>	Të kuptoi specifikat dalluese të zhvillimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptarë.T'i kuptoi karakteristikat kryesore të kohës së mbretërisë dhe politikën e jashtme që ndoqi shteti shqiptarë. Të kuptoi gjendjen e shqiptarve në ish Mbretërin Jugosllave.	Ndërlidhja me: Gjeografinë,Letërsinë,Artin,Sociologjinë, Diplomacinë,Etnologjinë, Sociologjinë, Diplomacinë, Etnologjinë,Muzikën
XXVIII Komunizmi, Fashizmi dhe NacionalSocializmi	Njohja me shkaqet e ngadhnjimit të komunizmit në B.S.Shkaqet e shfaqjes dhe përhapjes së fashizmit dhe nacizmit si forma më të ashpra të diktaturës.Të njoh specifikat e komunizmit,fashizmit dhe naci zmit dhe pasojat për njerzimin nga këto regjime	Revolucioni i Tetorit dhe pasojat Përmbysja e carizmit,lufta civile dhe vendosja e regjimit komunist në Rusi. Italia dhe Gjermania 1918-1939 <i>Rrethanat politike ekonomike dhe sociale në Itali pas Luftës së Parë Botërore.</i> <i>Vendosja e Diktaturës fashiste në Itali.</i> Rrethanat politike ekonomike dhe sociale në Gjermani pas Luftës së Parë Botërore. <i>Ardhja në pushtet e Nacistëve në Gjermani.</i> <i>Pasojat e ideologjive ekstreme për njerëzimin (Komunizmi, Fashizmi, Nacizmi).</i>	Të kuptoi dallimin dhe specifikat e demokracive perendimore nga diktatura komuniste,fashiste dhe nacistë,të dijë të bëjë dallimin e specifikave të këtyre tri diktaturave dhe roli negativ që patën për njerëzimin.	Ndërlidhja me: Gjeografinë, Letërsinë

<p>XXIX Lufta e Dytë Botërore</p>	<p>Njohja me rrethanat që quan në L.D.B.Fillimi i luftës dhe rrjedhojat e saj.Frontet kryesore. Hyrja e SHBA-ve në luftë dhe roli i saj vendimtarë. Përfundimi i luftës dhe pasojat e saj për njerzimin.</p>	<p>Krijimi aleancave politiko ushtarake dhe fillimi i LDB <i>Sulmi i Gjermanisë kundër Polonisë 1939.</i> <i>Sulmi i Gjermanisë kundër BS-Hyrja e SHBA në luftë dhe forcimi i qëndresës së popujve të robëruar.</i> Zhvillimi i luftës gjatë viteve 1943-45 Kriza e Blokut fashist dhe fundi i LDB. Kapitullimi i Italisë . <i>Veprimet kryesore ushtarake gjatë 1944.</i> <i>Kapitullimi i Gjermanisë.</i> Pasojat e LDB</p>	<p>Të kuptoi arsytet dhe shkaqet që quan në shpërthimin e luftës.Të kuptoi qëndrimet dhe angazhimet e Fuqive kryesore gjatë luftës.Rolin e aleatve dhe bashkëpunëtorve të tyre për shkatërrimin e fashizmit dhe nazizmit. Frontet kryesore dhe betejat kryesore.Përfundimin e luftës dhe pasojat e saj për njerzimin.</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë,Letërsinë ,Kimin,Matematikën ,Biologjinë,Filozofinë, Teknologjinë</p>
<p>XXX Marrëdhëniet politike dhe ekonomike pas vitit 1945</p>	<p>Njohja me rrethanat e krijuara pas L.D.B. Krijimi i OKB-së.Lufta e Ftoht në mes dy blloqeve.Konfliktet loka le si pasoj e kësaj ndarje.Rritja e kërkesave për paqe dhe mirkuptim. Konferencat ndërkombëtare me qëllim mirëbesimi dhe mirkuptimi.</p>	<p>Gjendja ndërkombëtare pas mbarimit të LDB Konferenca e paqës dhe ndryshimet në hartën politike të Evropës. <i>OKB dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtarë.</i> <i>Lufta e ftohtë dhe ballafaqimi Lindje – Përqëndim.</i> <i>Konfliktet lokale dhe marrëdhëniet veri –jug.</i> Forcimi i paqës dhe sigurisë në Evropë <i>Rritja e kërkesave për paqe dhe mirëkuptim.</i> <i>Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian.</i> Fuqizimi i rolit të Këshillit të Evropës</p>	<p>Të kuptoi shkaqet e ndarje ve të shteteve në dy blloqe. Të njoh dhe të dij të dalloj tiparet dhe pikpamjet kryesore të këtyre blloqeve. Të dijë për funksionimin organizimin,rolin dhe rëndësin e OKB-së. Të dijë të bëjë krahasimin në mes të konflikteve lokale kryesore dhe reflektimet e këtyre konflikteve për rritjen e kërkesave për paqe dhe mirkuptim. Të dijë par vendimet e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian si dhe per rolin e Këshillit të Evropës</p>	<p>Ndërlidhja me:Gjeografinë, Edukatën qytetare, Teknologjinë, Sociologjinë, Diplomacinë, Filozofinë,</p>

<p>XXXI Shqiptarët pas vitit 1945</p>	<p>Njohja me gjendjen e shtetit shqiptarë pas L.D.B.Vendosa e komunizmit në Shqipëri. Pozita ndërkombëtare e shtetit shqiptar. Njohja me reflektimet e lëvizjeve demokratike në Shqipëri. Përmbysja e sistemit monist. Ngadhënjimi i pluralizmit Njohja me gjendjen e shqiptarëve në territorin e Kosovës, viseve tjera në ish-Jugosllavi dhe Çamëri pas L.D.B.</p> <p>Dhuna dhe represioni ndaj tyre,qëndresa e tyre dhe mbijetesa. Njohja me situatën ekonomike, politike e shoqërore në Kosovë gjatë viteve `90 .Vetorganizimi i shqiptarve ndaj regjimit serb.Vendimet e shqiptarve për liri e pavarësi. Dalja në skenë e UÇK-së. Çlirimi i Kosovës.</p>	<p>Shqipëria në sistemin socialist totalitarë 1944-1990.</p> <p>Vendosja e regjimit komunist <i>Qëndresa e forcave antikomuniste. Pozita e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare Kolektivizimi dhe shpronësimi i fshatarësisë Arsimit, Shkenca dhe Kultura.</i> Shëmbja e komunizmit dhe pluralizmi politik <i>Kriza politike dhe rritja e lëvizjes antikomuniste. Formimi i PD dhe partive tjera politike. Gjendja ekonomike,sociale dhe kriza e vitit 1997.</i></p> <p>Kosova,viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi dhe Çamëria 1945-1989 <i>Copëtimi i viseve shqiptare në ish-Jugosllavi. Dhuna dhe terrori shtetëror mbi shqiptarët. Demonstratat e viteve 1968 dhe 1981. Likuidimi i Autonomisë së Kosovës 1989. Gjenocidi dhe shpërngulja me dhunë e çamëve nga trojet e veta.</i> Kosova gjatë viteve 1990-1999 <i>Vetorganizimi i shqiptarëve dhe pluralizmi politik. Deklarata Kushtetuese dhe Kushtetuta e Kaçanikut. Referendumi dhe zgjedhjet e lira. Eskalimi i dhunës dhe dalja në skenë e UÇK . Çlirimi i Kosovës.</i></p>	<p>Të dihet të dallohet qëndrimin dhe pikpamjetë forcave kryesore politike në Shqipëri pas L.D.B.Arsyet e vendosjes së komunizmit në pushtet.Organizimin dhe funksionimin e pushtetit komunist.Masat ekonomike, politike,kulturore e arsimore që ndërmerri regjimi.Të dihet për pozitën e shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare. Të dihet të përshkruajë arsyetë e përmbysjes së komunizmit dhe ngadhënjimin e pluralizmit në Shqipëri.</p> <p>Të dihet arsyet e copimit të tokave shqiptare.Të kuptoi politikën e</p>	<p>Ndërlidhja me: Gjeografinë,Letërsinë,Artin,Teknologjinë,Ekonominë,Filozofinë, Sociologjinë, Drejtësinë,</p>
--	--	---	---	--

			<p>shtetit jugosllav ndaj shqiptarëve. Të kuptoi politikën e shtetit grek ndaj Çamërisë. Të kuptoi dhe të dijë të përshkruaj gjendjen e shqiptarve në këto shtete dhe masat e shqiptarve për mbijetesë.</p> <p>Të dijë të përshkruaj amplitudën e rënje- ngri- tjeve të pozitës së shqiptarve në Kosovë gjatë viteve `90. Vetorganizimin dhe vend imet e tyre për liri e pavarësi. Shkaqet e daljes së UÇK-së në skenë. Intervenimin ndërkombëtar dhe çlirimin e Kosovës.</p>	
--	--	--	---	--

VIII. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- 1). *Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Isa Bicaaj, HISTORIA* për klasën e parë të shkollave të mesme profesionale, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 2). *Dr. Bep Jubani, Mr. Isa Bicaaj, Dr. Vilson Kuri, HISTORIA* për klasën e parë të shkollave të mesme, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 3). *Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Hysni Myzyri, HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR* për klasën e dytë të shkollave të mesme profesionale, botoi shtëpia botuese Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë, 2001;
- 4). **Historia e Popullit Shqiptarë** për shkolla të mesme, Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 5). **Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve**, botoi Siprinti, Prizren 2000;
- 6). *Dr. Agron Gani, Dr. Hysni Myzyri, Dr. Jusuf Bajraktari, HISTORIA* për klasën e dytë të shkollave të mesme, botoi Shtëpia Botuese **Libri Shkollor**, Prishtinë, 2001;
- 7). Aspekte të mësimdhënjes së historisë, Prishtinë 1997;
- 8). Aspekte të mësimdhënjes së historisë, Tiranë 1997;
- 9). *Bardhyl Musai, Psikologji edukimi*, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 1999;
- 10). **Atlas historik**, La Storia Del Mondo, Grup autorësh, Milano, 2000;
- 11). **Atlas Of World History**, London, New York, Sydney, 1999;
- 12). **Datum iz Svjetske Historie**, Grup autorësh, Svjetlost, Sarajevo 1999;
- 13). Programet e shkollës së mesme të përgjithshme (lëndët shoqërore), Tiranë 2000;
- 14). **Kurrikuli shkollor**, Grup autorësh, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë;
- 15). *Robert Stradling, Teaching 20 th – century, European history, Council of Europe*, Publishing/Editions du Conseil de l'Europe, Germany, 2001;
- 16). *Falk Pingel, The European home: representations of 20 th century Europe in history textbooks*, Council of Europe Publishing/Conseil de l'Europe, Germany, 2000.

*Edukatë
qytetare*

EDUKATË QYTETARE

1 orë në javë, 35 orë në vit

HYRJE

Lënda mësimore **Edukatë Qytetare** në shkollën tetëvjeçare është mësuar si lëndë mësimore nga viti shkollor 1996/97 në klasën e parë dhe të pestë dhe përfundimisht në vitin shkollor 1999/2000 në klasën katërt dhe tetë. Në ciklin e klasave të ulëta është mësuar si EDUKATË SHOQËRORE, kurse në mësimin lëndor (klasa V-VIII) EDUKATË QYTETARE.

Në ciklin e klasave të ulëta temë qendrore është nxënësi në raport me familjen, shkollën, komunitetin.

Në mësimin lëndor (V-VIII) dominon raporti i fëmijës me njohjen e organizimit të shoqërisë njerëzore dhe përgatitja e tij për integrim në shoqëri.

Në klasën nëntë prioriteti kalon në trajtimin e dukurive sociale, si qytetaria, organizimi shoqëror e politik i shoqërisë, organizimi i brendshëm i shoqërisë si dhe liritë dhe të drejtat e njeriut.

Për zhvillimin dhe realizimin me sukses të përmbajtjeve programore të kësaj lënde mësimore në klasën IX do të bëjmë përpjekje të përcaktojmë çka duhet të mësojë nxënësi dhe sa mund të aftësohet për zbatim praktik të asaj që ka mësuar, ndërsa për arsimtarin do të përcaktojmë çka duhet të dijë ai dhe ti përcaktojmë standardet adekuate.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË EDUKATËS QYTETARE

Koncepti bashkëkohor i **Edukatës qytetare** përfshin në vete integrimin e sistemeve: shoqëror-politik, social, juridik, ekonomik dhe atë të vlerave.

Në strukturën programore të Edukatës qytetare për klasën IX (viti orientues) janë të gërshetuara përmbajtjet nga sistemi shoqëror – politik, social, juridik dhe ai i vlerave. Më pak ka përmbajtje nga sistemi ekonomik. Kjo është bërë me qëllim të mos ketë dyfishime të përmbajtjeve nga fusha e ekonomisë, sepse në këtë vit shkollor si lëndë e veçantë (profesionale – orientuese) mësohet EKONOMIA.

Ndër objektivat e përgjithshme për formimin qytetar të nxënësit është se ata duhet të dinë së idetë dhe parimet demokratike të organizimit të shoqërisë realizohen vetëm në institucione. Përmes edukatës qytetare nxënësit duhet të zhvillojnë kompetencat dhe përgjegjësitë qytetare. Në këtë kontekst, në klasën IX rriten në mënyrë të ndjeshme njohuritë që i kanë përfutur në jetë

si dhe në shkollimin paraprak për vlerat, parimet dhe kriteret demokratike si pikë referimi e institucioneve publike.

Për të kuptuar ndikimin e qeverisjes në jetën e përditshme, në komunitet dhe në shoqëri në tërësi, nxënësit duhet të dinë si është e organizuar qeverisja lokale dhe qendrore, cili është raporti dhe cilat janë kompetencat e tyre.

Edukimi për shoqëri civile është gjithashtu ndër objektivat shumë të rëndësishme të mësimi të edukatës qytetare. Nxënësit duhet të kuptojnë përfundimisht se shoqëria civile mund të organizohet dhe të funksionojë vetëm nëse rregullohet me ligj.

Edukimi qytetar i ndihmon nxënësit të kuptojë marrëdhëniet ndërkombëtare (në një botë gjithnjë më të ndërvarur) si ndikojnë këto marrëdhënie në secilin shtet.

Edukimi qytetar duhet të aftësojë nxënësit për pjesëmarrje publike, ti kuptojnë vlerat qytetare e njerëzore, si patriotizmi, sovraniteti kombëtar, globalizimi, drejtësia, barazia, kompromisi, toleranca etj.

Në aspektin shoqëror orientim parësor i edukatës qytetare është të përgatitë nxënësit për jetë, duke filluar nga jeta në familje, në shkollë, në komunitet dhe në shoqëri në tërësi. Pastaj t'i aftësojë nxënësit për të ngritur probleme shoqërore, duke i njohur me ecurinë (procedurën) e ngritjes së këtyre problemeve dhe adresimin e tyre adekuat.

Nxënësit duhet të aftësohen për të:

- Evidencuar problemin;
- Bërë publike;
- Adresuar ku dhe si duhet;
- Zgjedhur atë;
- Gjetur alternativa të zgjedhjes;
- Deleguar të tjerët në zgjedhjen e çështjeve të vështira si dhe për të formuar qëndrime të caktuara për problemet shoqërore.

Cilat janë objektivat që një kapitull i tërë i kushtohet studimit të ligjit si pjesë e edukatës qytetare?

Të kuptuarit e drejtë të ligjit, të karakterit të tij si rregullues i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve.

Njohja, vendosja dhe zbatimi i ligjit nga qytetarët.

Sundimi i ligjit ndihmon në njohjen e vlerave të vërteta të tij, si drejtësia, liria dhe barazia.

Njohja e ligjit rrit efikasitetin e edukimit qytetar, ndihmon në formimin e ndërjegjes, kulturës qytetare si dhe të qëndrimeve dhe të sjelljeve qytetare.

Vetëdijësimi i nxënësve për rëndësinë shoqërore të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm të vlerave shoqërore, veçmas vlerave morale, karakteri human i të cilave kushtëzon edhe zhvillimin e plotë të personalitetit.

Ndër vlerat më të larta të shoqërisë demokratike është njohja dhe respektimi i lirive dhe i të drejtave të njeriut. Për këtë arsye një kapitull i veçantë i kushtohet pikërisht kësaj tematike.

Synimet e përgjithshme të Edukatës qytetare janë:

- Arsimi demokratik;
- Kuptimi i ndërlidhjeve dhe ndikimeve të ndërsjella në shoqëri;
- Zhvillimi i mendimit kritik;
- Aftësia për bisedime;
- Zhvillimi i qëndrimeve dhe vlerave;
- Zhvillimi i tolerancës;
- Zhvillimi i respektit dhe i vetërespektit, dhe
- Zhvillimi i nisëativës dhe i vetënisiativës që vetë të krijojë dhe të zbulojë situata të reja.

ASPEKTE LËNDORE DHE NDËRLËNDORE

Përmbajtja e Edukatës qytetare është gërshetim përmbajtjesh mësimore nga shumë disiplina shoqërore, humane, të artit dhe shkencore.

Struktura e programit të Edukatës qytetare për klasën IX – viti orientues përkon me përmbajtjet programore të lëndëve mësimore si E drejta civile – qytetare, E drejta ndërkombëtare, filozofi, sociologji, histori, gjeografi dhe shkencat politike.

Arsimtarët gjatë realizimit të njësive mësimore do të hasin në përmbajtje programore me marrëdhënie korelative shumë të afërta me lëndët e tjera mësimore, si p.sh.

- *Gjuhë amtare*, në rastin kur shkruhet ndonjë ese p.sh. për të drejtat qytetare; përdorë dramën, lojen e roleve, veçmas me rastin e zbulimit të të drejtave në konflikt,
- *Matematikën* (p.sh. numërimi dhe llogaritja e votave në sistemet e ndryshme zgjedhore),
- *Histori* trajtimi i të drejtave të fëmijëve pas luftërave
- *Gjeografi*, temë e lirë, njerëzit në lëvizje, migrimet, refugjatët, nomadët,
- *Artet*, bërja e posteve me mesazhe për të drejtat e fëmijëve. Bërja e pikturave dhe skulpturave të cilat prekin çështje të tilla si liria, varfëria, njerëzit pa strehë etj.

Struktura e programit

Njohuri të reja 31 orë
Në dispozicion 4 orë
35 javë me nga 1 orë në javë

Tërësitë mësimore dhe fondi i orëve:

- I. QYTETARIA (6)
- II. LIGJSHMËRIA (8)
- III. QEVERISJA DEMOKRATIKE (11)
- IV. LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT (10)

Kapitulli I

I. QYTETARIA (detyrimet dhe aftësitë qytetare) 6 orë

Qytetari-pikënisës dhe bartës i demokracisë së drejtpërdrejtë

Historiat i shkurtër i zhvillimit të demokracisë (nga Greqia deri me sot). Demokracia e drejtpërdrejtë dhe me përfaqësim. Pushteti në demokraci u shërben të gjithëve.

Shkolla dhe komuniteti

Sprovimi i demokracisë së drejtpërdrejtë, detyrave dhe përgjegjësi të pjesëmarrësve në procesin edukativ në shkollë. Nxënësi në rolin ndërlidhes të familjes, shkollës dhe komunitetit.

Informimi dhe pjesëmarrja qytetare

Roli i informimit për qytetarin. Funkcionet e informimit (i saktë, i vërtetë, i pawnshtëm, i plotë, pluralist). Qëndrimi i qytetarit ndaj mjeteve të informacionit.

Konfliktet dhe zgjidhja e konflikteve

Llojet e konflikteve dhe dukuritë që i shoqërojnë ato (konflikte për burime; konflikte për synime e qëllime; konflikte për vlera). Palët në konflikt, sjelljet konfliktuese dhe interesat që shkaktuan konflikte. Konfliktet për mosmarrveshjet pronësore, konfliktet në marrëdhëniet familjare dhe dukuritë që shoqërojnë konfliktin.

REZULTATET E PRITURA

- Të kuptojnë konceptin bashkëkohor të QYTETARISË, përkatësisht EDUKATËS QYTETARE;
- Të njihen me detyrimet e tyre qytetare;
- Të mbajnë qëndrim të qartë ndaj aftësive, qendrimeve dhe sjelljeve qytetare;
- Të identifikojnë mënyrat bashkëkohore të komunikimit dhe të zhvillojnë shkathhtësitë e komunikimit;
- Të njohin dhe të jenë të aftë të përdorin teknologjitë bashkëkohore të mësimin;
- Të përshkruajnë sistemin tonë arsimor (në të gjitha nivelet), funksionimin e shkollës, njohjen e rregullave shkollore dhe atë nëpër situata konkrete;
- Të debatojnë për rregullore të caktuara të arsimit, për shembull të arsimit fillor;
- Të identifikojnë të drejtat dhe detyrat e shkollës, përkatësisht komunitetit;
- Të mbajnë qëndrim të qartë për marrëdhëniet shkollë-komunitet;

- Të diskutojnë në grup dhe të marrin pjesë në mënyra aktive në zgjidhjen e problemeve reale që paraqiten në jetën shkollore, apo shembujve konkretë të dhënë nga arsimtari;
- Të komentojnë qëndrimin e mjeteve të informacioneve ndaj qytetarëve dhe qytetarëve ndaj mjeteve të informacionit;
- Të mbajnë qëndrim kritik ndaj fjalës publike;
- Të demonstrojnë aftësi të komunikimit masiv, përmes shkrimit në gazetë apo ndonjë emisioni të thjeshtë në radio apo televizion;
- Të demonstrojnë aftësi komunikimi edhe me mjete të tjera komunikimi, siç është Interneti etj.
- Të identifikojnë llojet e konflikteve siç janë konflikti për burime, synime dhe vlera dhe të ofrojnë zgjidhje përkatëse.

Kapitulli II

I. LIGJSHMËRIA (roli i faktorit ligjor në drejtimin e shoqërisë), 8 orë

Ligji dhe funksionet e ligjit

Ç'është ligji? Ç'është zakoni? Dallimi në mes ligjit dhe zakonit. Pse duhen ligjet. Cilat janë funksionet e ligjeve.

Llojet dhe përgatitja e ligjeve

Dallimi në mes të ligjit dhe kushtetutës. Ligji civil. Ligji penal dhe Ligji ndër-kombëtar. Cilat janë procedurat e miratimit të ligjit nga organi ligjvënës.

Sistemi ligjor dhe llojet e tij

Sistemi ligjor përbëhet nga këto lloje rregullash: Rregullat që drejtojnë sjelljen. Rregullat për të caktuar rregulla të vlefshme. Rregullat për ndryshimin e rregullave. Rregullat për interpretimin e rregullave dhe Sistemi ligjor është një tërësi rregullash sjelljeje, të përcaktuara me ligj. Rregullat për ndëshkimin e shkeljeve.

Llojet e simeveve ligjore: Sistemi ligjor tradicional (kanunet), Sistemi ligjor fetar dhe Sistemi ligjor civil.

Drejtësia dhe organet e saj

Ç'është drejtësia? Ekzistojnë tri lloj procesesh: penale, civile dhe administrative. Këto procese zgjidhen në gjykatat përkatëse: Gjykata komunale dhe ajo e qarkut, pastaj gjykatat e specializuara (ekonomike dhe ushtarake). Të drejtat kryesore të qytetarit (Liria e fjalës, E drejta e pronës private, Liria e shtypit, Liria e petitionit etj).

Minoritetet dhe grupet tjera shoqërore

Ç'kuptohet me nocionin minoritete? Dallimi në mes minoritetit dhe grupeve shoqërore. Minoritetet që jetojnë në Kosovë.

Mbrojtja shëndetësore e qytetarëve

Mbrojtja institucionale dhe individuale. Rregullat higjienike dhe sanitare. Kërcënimet serioze për shëndetin: droga, alkooli, duhani etj.

REZULTATET E PRITURA

- Të vetëdijësohen për rolin e ligjit në drejtimin e shoqërisë demokratike;
- Të njohin ligjin themelor të një shteti-**Kushtetutën**;
- Të kuptojnë ç'është ligji, dhe cilat janë llojet e ligjeve;
- Të përshkruajnë funksionet e ligjit dhe të bëjnë dallimin ligj-rregull-zakon;
- Të diskutojnë për lloje të ndryshme të ligjeve civile, penale etj. dhe reflektimin e tyre në jetën e përditshme;
- Të shpjegojnë procedurën e përgatitjes së ligjeve si dhe të identifikojnë akterët që marrin pjesë në hartimin dhe në miratimin e ligjeve;
- Të mbajnë qëndrim kritik ndaj ligjeve;
- Të dëshmojnë praktikisht se njohin sistemin ligjor të vendit;
- Të vihen në situatë të bëjnë dallimin e sistemeve të ndryshme ligjore;
- Të prezantojnë disa lloje gjykimesh si civile, penale dhe administrative;
- Të formojnë konceptin e qartë se ç'është drejtësia dhe cilat janë organet e saj;
- Të përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e qytetarit si individ dhe si anëtarë i shoqërisë;
- Të shpjegojnë se mbrojtja shëndetësore e qytetarit është ndër të drejtat themelore të njeriut;
- Të diskutojnë rreth nocioneve kushtetutë, ligj, rregull, zakon, procedurë sistem ligjor drejtësi, përgjegjësi, mbrojtje shëndetësore, e të tjera.

Kapitulli III

I. QEVERISJA DEMOKRATIKE (Forma, funksioni dhe kompetencat) 11 orë

Sistemet politike dhe format e realizimit të demokracisë

Demokracia si formë qeverisjeje. Ç'është demokracia? Parimet e qeverisjes demokratike. Vlerat demokratike (të drejtat njerëzore; drejtësia, barazia, liria, e vërteta, patriotizmi).

Tipat e demokracisë dhe format e qeverisjes

Sistemet politike në shoqëri. Format e realizimit të demokracisë. Format e qeverisjes: unitare, federatë, konfederatë.

Kuvendi i Kosovës

Historiati i shkurtër i Kuvendit të Kosovës. Zgjedhja e anëtarëve të Kuvendit. Struktura organizative. Kryesia e Kuvendit të Kosovës. Grupet parlamentare. Komisionet parlamentare.

Qeveria e Kosovës

Si formohet Qeveria e Kosovës? Kush e bën emërimin e Kryeministrit? Sa ministri ka Kosova? Cilat janë detyrat dhe kompetencat e ministrive?

Presidenti

Procedura e zgjedhjes së kryetarëve të shteteve në disa vende evropiane. Zgjedhja e Presidentit të Kosovës. Cilat janë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij. Mandati i Presidentit.

Organet komunale në Kosovë

Kuvendi komunal, ekzekutivi, bashkësitë lokale, kompetencat e tyre. Funksionimi i pushtetit vertikal në Kosovë.

Partitë politike

Përkufizimi i partive politike. Funksionet e partive politike. Partitë politike dhe pushteti lokal dhe qendror.

Zgjidhjet e konflikteve

Gjyqi, arbitrimi, ndrëmjetësimi

Roli i OJQ-ve dhe i sindikatave në shoqëri

Ç'janë OJQ dhe sindikatat? Format e veprimit të tyre. Format e aktivitetit sindikalist. Organizatat joqeveritare dhe sindikatat në Kosovë.

REZULTATET E PRITURA

- Të përshkruajnë (prezantojnë) sistemet e ndryshme politike, unitare, demokratike etj.
- Përmes lojës së roleve në klasë të demonstrojnë tipat e ndryshëm të demokracisë, përkatësisht të dramatizojnë forma të ndryshme të qeverisjes;
- Të përshkruajnë organizimin e KUVENDIT TË KOSOVËS dhe organeve të tij.
- Të paraqesin skematikisht strukturën organizative të Kuvendit të Kosovës dhe të organizojnë diskutim për të.

- Të debatojnë për funksionet dhe kompetencat e Parlamentit të Kosovës si organ ligjvënës;
- Të shpjegojnë organizimin e Qeverisë së Kosovës, strukturën organizative të ministrive të saj dhe funksionet e tyre si pushtet ekzekutiv (kompetencat dhe mangësitë);
- Të përshkruajnë institucionin e Presidentit si institucion i veçantë që ngrihet mbi interesat partiake dhe përfaqëson unitetin e popullit;
- Të shpjegojnë se ç'është pushteti lokal;
- Të identifikojnë strukturën vertikale të funksionimit të pushtetit në Kosovë;
- Të debatojnë për kompetencat e pushtetit lokal, si ndikon ky pushtet në jetën e njerzëve dhe të komunitetit;
- Të prezantojnë organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Kosovë;
- Të përshkruajnë mënyrën e formimit të partive politike, rolin dhe rëndësinë që kanë ato për organizimin e jetës politike dhe institucionale në Kosovë;
- Të shpjegojnë llojet e ndryshme të zgjedhjeve dhe sistemeve zgjedhore;
- Me shembuj konkretë të demonstrojnë forma të ndryshme të zgjedhjes së konflikteve;
- Të debatojnë për rolin dhe rëndësinë e OJQ-ve në organizimin e jetës civile;
- Të organizojnë vizita organeve përkatëse në mënyrë që të njihen konkretisht me funksionimin e tyre.

Kapitulli IV

I. LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT (Vlera universale e lirive dhe të drejtave njerzore) 10 orë

Ç' janë të drejtat e njeriut?

Të drejtat e njeriut janë: universale, konkrete, të pandashme, plotësojnë njëra – tjetrën dhe janë të patjetërsueshme.

Klasifikimi i të drejtave

Të drejtat ligjore; të drejtat morale; të drejtat e njeriut; kategoritë e të drejtave; të drejtat e fëmijëve dhe vetëdijësimi për gjininë.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e njeriut, vlerat morale dhe filozofike

Liria, barazia, drejtësia

Të drejtat e njeriut

Dokumentet e para të të drejtave të njeriut; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut

Cilat janë të drejtat që shpall Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut? Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Të drejtat që mbrohen nga Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore).

Kufizimi i të drejtave

Kur shteti mund t'i kufizojë të drejtat e njeriut? Roli i avokatit. Ç'është Referendumi, peticioni? Dallimi ndërmjet kufizimit ligjor dhe shkeljes së lirisve dhe të drejtave të njeriut.

Lidhja e të drejtave

Të gjitha të drejtat janë të rëndësishme dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Lidhja e të drejtave në nivel ndërkombëtar. Të drejtat në konflikt.

Të drejtat e njeriut në Kosovë

Korniza kushtetuese. Marrëveshjet ndërkombëtare. Ligjet. Rregulloret.

REZULTATET E PRITURA

- Të shpjegojnë (prezantojë) kuptimet e ndryshme të konceptit Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe burimet e tyre;
- Të identifikojë vlerat që qëndrojnë në themel të të drejtave të njeriut
- Të bëjnë krahasime të interpretimeve bashkëkohore si dhe trajtimin e të drejtave të njeriut në vende të ndryshme evropiane dhe botërore;
- Të jenë në gjendje të bëjë klasifikomin e të drejtave:
 1. Të drejtat politike dhe civile;
 2. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
- Të mbajnë qëndrim të qartë ndaj caktimit të kritereve për grupimet e ndryshme të lirisve dhe të drejtave të njeriut;
- Me shembuj konkretë nga jeta e përditshme të identifikojnë situata dhe zhvillime që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të njeriut;
- Të identifikojnë institucionet vendore dhe ndërkombëtare që merren me përcaktimin dhe mbrojtjen e lirisve dhe të drejtave të njeriut;
- Të japin pasqyrën kronologjike - (historike) të dokumenteve themelore të të drejtave dhe lirisve të njeriut;
- Të krahasojnë përmbajtje të dokumenteve themelore të drejtave dhe lirisve të njeriut dhe t'i interpretojë ato në kontekstin historik;
- Të përshkruajnë funksionet, procedurat dhe mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë të mbrojtjes së drejtave dhe lirisve të njeriut;
- Të shpjegojnë nene nga Kushtetuta e Kosovës që merren me përcaktimin e lirisve dhe të drejtave të njeriut;
- Të analizojnë dhe të vlerësojnë mbrojtjen e lirisve dhe të të drejtave qytetare;

- Të jenë në gjendje të bëjnë dallimin e kufizimit ligjor të të drejtave nga shkelja e të drejtave dhe lirive të qytetarit;
- Të identifikojnë dhe përshkruajnë raste të shkeljes së të drejtave të njeriut nga jeta e përditshme dhe pasojat që lënë ato në jetën e individit si dhe komunitetit;
- Të përshkruajnë raste të kundërshtimit të të drejtave (p.sh. e drejta e shprehjes së lirë kundruall të drejtës për jetë private të pacenuar).
- Të arrijnë të dallojnë të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor ndaj të drejtës për një shtyp të lirë;
- E drejta për t'u shprehur lirisht ndaj të drejtës së tjetrit për t'u dëgjuar;
- Të kuptojnë se kërkesa për të drejta dhe liri maksimale për vete, implicite do të thotë kufizim i të drejtave të të tjerëve;
- Të identifikojnë lidhjet kauzale midis të drejtave personale, ekonomike dhe politike.

Orientimi për punë të pavarur

Orientimi për punë të pavarur sendërtohet përmes ndërtimit metodik të çdo njësie mësimore veç e veç, karshi kërkesave specifike përmbajtësore të çdo mësimi.

Për çdo njësi mësimore do të përgatitetë aparaturë e posaçme didaktike, që përpos përmbajtjes konsiston edhe në këto tri pika:

- Të zbulojnë idetë kryesore të mësimit;
- Të mendojnë në mënyrë kritike;
- Detyrat konkrete për punë praktike.

Duke respektuar autonominë e arsimit për organizimin e procesit mësimor dhe orët që i ka në dispozicion inkurajohet ai të zhvillojë më shumë veprimtari praktike dhe vizita me karakter edukativ e mësimor intitucioneve të ndryshme si p.sh. gjykatat, kuvendet, shoqatat joqeveritare, KMDLNJ etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. *Grup autorësh, Edukatë qytetare 5*, Prishtinë, 1999;
2. *Grup autorësh, Edukatë qytetare 6*, Prishtinë, 1999;
3. *Grup autorësh, Edukatë qytetare 7*, Prishtinë, 1999;
4. *Dr. Fatmira Myteberi & Astrit Dauta j& Majlinda Keta, Qytetaria 1*, Tiranë, 2000;
5. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Standardet për nxënësit dhe mesuesit në lëndën e Edukimit Qytetar**, (DRAFT), Tiranë, 1997;
6. Instituti i Studimeve Pedagogjike, **Kurrikula dhe shkolla** (Lëndët shoqëror 2), Tiranë, 2002;
7. *Grup autorësh, Të gjitha qeniet njerëzore...*, Doracak për mësimin e të drejtave të njeriut, UNESCO, Belgjikë, 1998;
8. *David Keri*, Fondacioni Kombëtar për Kërkime Arsimore NEER, **Edukimi i të Drejtës për QYTETARI në Kurrikul: Vështrim** Ndërkombëtar, Londër 1999;
9. *Prof. Francois Andiger*, **Edukimi për të Drejtën Demokratike të Qytetarisë**, Strastburg, 2000;
10. *Graham Haydon*, Instituti i Arsimit, *Agjenda e Edukimit Moral*, Londër 2001;
11. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë.

Artet

EDUKATA MUZIKORE DHE EDUKATA FIGURATIVE

HYRJE

Lëmi kurrikular—Artet përfshin muzikën dhe artet vizuale, të cilat në përgjithësi kontribuojnë në formimin e gjithanshëm të personalitetit të nxënësve nga aspekti estetik, moral, social, fizik etj.

Artet- zhvillojnë kreativitetin dhe shkathtësitë intelektuale (aftësia për analizë, sintezë dhe aftësia për vlerësim) si dhe stimulojnë motvimin pozitiv, bashkëpunimin, vetëdisiplinën dhe entuziazmin që t'u qasen përvojave dhe mënyrave të reja të shprehjes artistike (personale dhe kolektive).

Artet u ofrojnë nxënësve mundësi për të kuptuar dimensionet e ndryshme të jetës shpirtërore dhe të veprimtarisë njerëzore (shkenca, teknologjia, artet dhe religjioni).

I. Objektivat e përgjithshme të Arteve

- Ndërgjegjësimi mbi vlerat estetike;
- Njohja dhe zotërimi i mënyrave të ndryshme të shprehjes artistike;
- Nohja me artet në kultura të ndryshme dhe në periudha të ndryshme historike përmes të vërejturit, analizës dhe të shprehurit;
- Zhvillimi i aftësive krijuese;
- Zhvillimi i atësisë për të lidhur dimensionet shpirtërore, shkencore dhe artistike në qasjet për kulturën dhe artin në përgjithësi.

II. Aspektet ndërdisiplinare

- Edukimi artistik (muzikor dhe figurativ) mund të ndërlihet me të gjithë lëmenjtë e kurrikulit bërthamë, posaçërisht me lëvizjen, (gjuhën amtare dhe të huaj) dhe lëndët e tjera me dimension artistik;
- Muzika ndikon pozitivisht në kulturën e të folurit, e me këtë në kulturën e përgjithshme të komunikimit dhe të shprehjes;
- Lëvizja në ndikimin e muzikës fiton plasticitet, koordinim dhe arrihet euritmia (lëvizja e bukur);
- Muzika ndihmon nxënësit të përvetësojnë gjuhën e huaj në mënyrë tingullore, më lehtë e më shpejt;
- Nxënësit përmes lëndës së artit figurativ do të ndërlihen me temat nga lëndët e tjera si: muzikë, gjuhë, histori etj.

EDUKATË MUZIKORE

1 orë në javë, 35 orë në vit

QËLLIMI/SYNIMI

Edukimi dhe arsimimi muzikor merr pjesë në formimin e personalitetit të nxënësve në aspektin estetik, në aktivizimin e proceseve psikike e para së gjithash të sferës emocionale, në formimin moral-social, fizik etj.

Synimi kryesor i edukimit dhe arsimimit muzikor është që nxënësit të bëhen muzikëdashës dhe njohës të artit muzikor. Në këtë mënyrë ata bëhen pjesëmarrës në jetën muzikore të mjedisit të tyre social dhe bartës të amatorizmit muzikor. Kjo do të thotë: nxënësit aftësohen për ta përjetuar artin muzikor dhe për t'u shprehur me mjetet shprehëse të tij.

Objektivat e Edukimit muzikor

Kompleksiteti i qëllimit /synimit të edukimit muzikor determinon një spektër objektivash konkrete:

- Edukimi muzikor **zhvillon dashurinë** e nxënësve ndaj muzikës, sidomos përmes përjetimit dhe shprehjes muzikore ndikon në formimin e ndjenjës estetike, patriotike, sociale etj;
- **Zhvillimi i veshit muzikor dhe zërit** të nxënësve është komponente nismëtare e edukimit muzikor, së pari duke e zhvilluar ndjenjën ritmike dhe melodike. Këndimi i drejtë dhe i bukur, pra zhvillimi i zërit të nxënësve është objekt i vazhdueshëm i procesit edukativ-arsimor;
- Përmes formave të ndryshme të punës edukative muzikore realizohet edhe **arsimimi teorik**. Përgjithësimet teorike të dukurive të ndryshme muzikore bëhen rrjedhore përjetimi paraprak i tyre.
- **Dëgjimi i muzikës** i sjell nxënësit në lidhje të drejtpërdrejtë me **krijimtarinë muzikore, vlerat estetike muzikore dhe me shumë informacione mbi dukuritë muzikore**;
- **Aktiviteti kreativ** i nxënësve ka vend të posaçëm në edukimin muzikor. Nuk mjafton t'i aftësojmë nxënësit vetëm për përjetim dhe riprodhim muzikor, njëkohësisht duhet t'i nxisim që aktiviteti i gjithmbarshëm mësimor muzikor të përshkohet me veprime kreative;
- **Kultivimi i shijes muzikore** arrihet në unitet dhe gërshetim me të gjitha objektivat e tjera. Meqenëse përvoja muzikore e nxënësve është e vogël duhet kujdesur t'i diferencojnë vlerat muzikore përmes dëgjimit të këngëve dhe veprave me cilësi të lartë muzikore;
- **Kori, formacionet e ndryshme instrumentale dhe ansamblet** e tjera janë forma masive muzikimi. Kur organizohen dhe funksionojnë nën udhëheqje pedagogjike - artistike të mësimdhënësit, paraqesin formë të punës edukative, ku interpretimi muzikor mund të arrijë nivel të lartë. Puna me këto ansamble është formë e rëndësishme e mësimin të

zgjedhur në kuadër të edukimit muzikor; me fond të posaçëm katër(4) orësh.

- **Aftësimi i nxënësve për përdorimin e kompjuterit**, mjeteve dhe aparateve teknike muzikore për dëgjim dhe incizim të muzikës;
- **Objektiv specifik** i edukimit muzikor (në të gjitha klasat) është të vërehen nxënësit që dallohen me muzikalitet të shprehur dhe disponim pozitiv ndaj artit muzikor. Këta duhet të nxiten e të mbështeten për t'u orientuar në shkollimin special muzikor;
- **Orientimi** i nxënësve për profesionet muzikore mund të ndihmohet duke i njoftuar me përbërjen dhe mundësitë e institucioneve muzikore si dhe institucionet e profesionet e tjera ku njohuritë muzikore janë të nevojshme.

<p>PËRMBAJTJA PROGRAMORE</p> <p>Edukimi muzikor në arsimimin e përgjithshëm, konkretisht në arsimin fillor (1-5) dhe të mesëm të ulët (VI-IX) ka strukturë përmbajtësore specifike. Ai nuk paraqet disiplinë të veçantë muzikore, por gërshetim elementesh nga disiplina të caktuara muzikore në një strukturës realitvisht të mvetësishme. Komponentet kryesore të kësaj strukture janë: dëgjimi i muzikës, këndimi, luajtja në instrumente, arsimimi teorik (përmes përjetimit dhe njohjes praktike-dëgjimore të fenomeneve dhe të dukurive muzikore), puna krijuese si komponente më vete dhe gërshetimi i saj në format e tjera të punës edukative –muzikore.</p>	<p>Trajtimi didaktik-metodik i përmbajtjes mësimore të klasës IX</p> <p>Baza e konceptimit didaktik-metodik të mësimdhënies ndërvepruese të edukimit muzikor pushon në muzikimin e nxënësve dhe të mësimdhënësit. Kjo do të thotë se të gjitha çështjet, dukuritë, fenomenet muzikore do të konceptohen, prezantohen dhe përvetësohen përmes dëgjimit, këndimit, luajtjes në instrument dhe mundësive të tjera praktike të mësimdhënies muzikore.</p> <p>Koncepti i mësimdhënies ndërvepruese nënkupton muzikim dhe veprime të tjera reciproke përcjellëse të mësimdhënësit dhe nxënësit. Për të arritur përfundime njohëse parapakisht duhet të prijë përjetimi i tyre emocional. Pra, dukuritë muzikore së pari do të përjetohen e pastaj do të ngriten në njohuri të vetëdijshme për t'u rizbatuar, por tash në mënyrë të vetëdijshme.</p>	<p>Aftësitë dhe shkathtësitë</p> <p>Shkathtësitë dhe aftësitë muzikore i referohen gradualitetit dhe sistemit të theksuar, prandaj procedurat metodike duhet të mbështeten në këto parime. Përmes ushtrimeve, në mënyrë gradual dhe sistematike, shkathtësitë dhe aftësitë muzikore zhvillohen dhe përsosen. Në mësimdhënien muzikore duhet të arrihet shkathtësia e këndimit (melodike dhe ritmike), e luajtjes në instrument, përqendrimi i vëmendjes muzikore, shkathtësia e leximit dhe shkrimit muzikor, aftësia për përjetim (qëndrim, perceptim muzikor etj).</p>
<p>1. Dëgjimi i muzikës -bazat e kulturës muzikore</p> <p>Dëgjohen dhe komentohen kompozime vokale, vokalo-instrumentale dhe instrumentale nga aspekte të ndryshme (vepra, autori, interpreti, forma, stili, zhanri).</p>	<p>Kriteret më të rëndësishme të zgjedhjes së veprave për dëgjim janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Veprat duhet të kenë vlerë artistike muzikore; Veprat duhet t'u përgjigjen aftësive përjetuese dhe perceptive të nxënësve të kësaj moshe. <p>Nga aspekti metodik duhet të plotësohen këto kërkesa kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Dëgjime të përsëritura të një vepre (insert i veprës), pra pasurimi i përjetimit (formimi i qëndrimit); Dëgjime me kohëzgjatje të shkurtër dhe në intervale të vogla kohore (përqendrimi i vëmendjes dhe sigurimi i mbamendjes më të madhe). 	<p>Standardet për çmuarje</p> <p>Në përfundim të klasës së IX nxënësit do të duhet të kenë zotëruar shkathtësi dhe njohuri të caktuara nga kompetentet e edukimit muzikor. Këto të arritura të nxënësve do të çmohen në vazhdimësi nga ana e mësimdhënësit të lëndës duke përfshirë edhe vetëçmuarjen nga ana e nxënësve mbi përparimin e tyre në</p>

<p>2. Këndimi Këndohen këngë, tema ose fragmente nga veprat e dëgjuaara, arie ose korale nga operat e dëgjuaara, kanone etj. Përmes tyre përpunohet dukuria e caktuar teorike (shkalla, ritmi, dhe elementet e tjera).</p> <p>3. Luajtja në instrumente Shoqërohen këngët, temat e melodive</p>	<p>1.1 Përbërja, interpretimi: solistik, kamertal, formacionet e mëdha (kori, orkestra etj)</p> <p>1.2. Autorët: Kompozitorë botërorë dhe shqiptarë, të traditës dhe bashkëkohorë. Në klasën IX nxënësit njohin autorët në bazë të veprave të dëgjuaara ose të interpretuara. Nuk njihen me autorë sipas kontinuitetit historik, por në vartësi nga veprat e përzgjedhura. Nxënësit nuk duhet të ngarkohen me të dhëna biografike-historike, por me informacione thelbësore dhe atraktive për rolin e kompozitorit në zhvillimin e artit muzikor në kuptimin e relacioneve kohore –stilistike. Këto informacione thelbësore mund të merren gjithashtu me programe speciale (lojëra) kompjuterike për fëmijë në formë testi shumë atraktiv.</p> <p>1.3. Njohuritë mbi format muzikore: Sikurse në klasat e mëparshme do të ndiqet parimi: njohuritë fitohen në mënyrë praktike përmes dëgjimit dhe interpretimit;</p> <p>1.3.1. gjatë shtjellimit metodik duhet mbështetur në parimin e sistematizimit metodik, pra duhet nisur nga tërësi të rumbullakësuaara formale kah të vërejturit e pjesëve përbërëse të tyre. Në këtë kontekst nxënësit do të aftësohen të gjenden edhe në dallimin e stilit homofonik dhe polifonik. Meqenëse në klasat e mëparshme janë punuar çështje më themelore mbi format muzikore, në këtë klasë do të bëhet thellimi i mëtejme i tyre përmes shembujve përkatës të rinj.</p> <p>1.4. Njohja e instrumenteve do të bëhet si në klasat e mëparshme, duke u njohur me tingëllimën e tyre dhe pamjen, gjithnjë përmes dëgjimit të tingullit dhe të vërejturit e pamjes dhe ndërtimit të tyre. Kjo mund të realizohet edhe me inkorporimin dhe përvetësimin e përdorimit të CD-Rom-it.</p> <p>1.5. Temë më vete do të jenë zhanret muzikore: artistike, popullore dhe e lehtë. Përmes shembujve do të vërehen cilësitë</p>	<p>bazë të një pasqyre të plotë të gjithë punës së nxënësve ne vitin shkollor.</p> <p>Çmuarja e përparimit të nxënësve, përveç formës standarde mund te bëhet edhe përmes testeve (anketave) muzikore të herë pas hershme.</p> <p>Rezultatet e pritshme (parametrat e çmuarjes)</p>
--	---	---

<p>dhe interpretohen melodi me instrumente ritmike e melodike gjithnjë brenda mundësive të nxënësve.</p> <p>4. Të shprehurit dhe krijimi muzikor Zgjedhje e mënyrës së interpretimit, të shprehurit përmes mjeteve shprehëse muzikore (improvizimi, krijimi i melodisë së re, etj) dhe të shprehurit përmes mjeteve shprehëse të arteve të tjera nën ndikimin e muzikës së dëgjuar, shprehje kreative përmes programeve të thjeshta në kompjuter etj.</p> <p>5. Njohja e institucioneve dhe profesioneve muzikore</p>	<p>kryesore të këtyre zhanreve</p> <p>2.1. Këngët, të kënduara sipas veshit ose tekstit notal, pasurojnë prerjetimet artistike vokale të nxënësve. Në vartësi nga përmbajtja e tyre melodiko-poetike nxisin ndjenja estetike-muzikore, patriotike, sociale etj. Këndimi i këngëve në mënyrë të drejtë dhe të bukur zhvillon zërin e nxënësve; Këndimi i temave të veprave që dëgjohen mundëson gjeturi dhe lidhmëri më të madhe gjatë dëgjimit; Përmes këngëve përforcohen tonalitetet, pra shkallët e mësuara, por mund të mësohet edhe ndonjë e re. Dukuritë e ndryshme melodike, ritmike, formale, stilistike etj. Po ashtu mund të përjetohen dhe përvetësohen përmes këndimit. Këngët këndohen sipas veshit dhe sipas tekstit notal ose me kombinim të të dy mënyrave (pjesët që i tejkalojnë aftësitë e nxënësve për këndim notal i këndojnë me ndihmën e mësimdhënësit sipas veshit). Këndimi koral është formë e posaçme e punës edukative-muzikore; Në këtë formacion marrin pjesë nxënësit e zgjedhur me muzikalitet dhe aftësi vokale, pra është mësimdhënie e zgjedhur për nxënës të dalluar. Përmes këndimit koral të nxënësve zhvillojmë aftësi interpretuese dhe ndjenjë harmonike, njohin literaturë korale si dhe shumë komponente të muzikimit cilësor. Nga aspekti më i gjerë edukativ këndimi koral zhvillon ndjenjën për arritjen e qëllimit të përbashkët dhe të përgjegjësive, disiplinën e vetëdijshme dhe entuziazmin krijues. Kordinimi koral ka fond të posaçëm katër (4) orësh në javë.</p> <p>Përdorimi i instrumenteve sjell gjallëri në procesin ed. Muzikor,</p>	<p>Nxënësit do të jenë aftësuar për të dëgjuar, vërejtur dhe mbajtur mend elemente të caktuara muzikore (kontrastin dhe unitetin) ndërtimin ritmik, melodik, formal, tempin, ngjyrën dinamikën, etj.)</p> <p>Nxënësit do të jenë aftësuar për këndim të drejtë dhe të bukur sipas veshit dhe sipas tekstit notal deri në një nivel të caktuar</p>
---	---	---

duke e bërë muzikimin më të pasur dhe më atraktiv. Shoqërimi ritmik, melodik dhe harmonik (kryesisht nga ana e mësimdhënësit) është mundësi e shkëlqyeshme për gërshetimin e aktivitetit kreativ, ndjenjës harmonike etj. Në këtë kuadër roli i ndonjë nxënësi që frekuenton shkollën e muzikës për instrument të caktuar është shumë i mirëseardhur, jo vetëm që ngrit muzikimin e klasës në nivel më të lartë, por ndikon pozitivisht te nxënësit e tjerë lidhur me rëndësinë që ka muzika në jetën e tyre. Zgjedhja e instrumenteve që përdoren në klasë varet nga përcaktimi i mëparshëm i nxënësve. Meqenëse të arriturat teknologjike (kompjuterike) vetvetiu e mundësojnë përdorimin e thjeshtë të këtyre mjeteve mësimore (kompjuterit) dhe përdorimin e tyre me një njohje minimale të funksionimit të tyre, në klasën IX nxënësit mund të përvetësojnë edhe programet (e thjeshta) muzikore që shërbejnë për sajimin e përcjelljes së thjeshtë instrumentale të këngëve që ata i punojnë në klasë.

Puna krijuese zhvillon vetëdijen lidhur me vlerën e personalitetit të nxënësit, kurse mësimdhënia bëhet më përmbajtësore, më tërheqëse, më atraktive. Liria e plotë e të shprehurit të nxënësve është parakusht i suksesit; duhet inkurajuar individualiteti i nxënësve kurse mësimdhënësi duhet të veprojë si psikolog i stërholluar që nxit dhe mbështet shprehjen e nxënësit. Moto në këtë punë duhet të jetë: **guxo, provo, krij!** Format konkrete të zbatuara në klasat e mëprashme si: plotësimet meloritmike, ndryshimet meloritmike, krijimi i melodisë së re sipas vargjeve poetike, krijimi i melodisë pa tekst, interpretimi i ndryshëm i këngës, të shprehurit e ndryshëm artistik përmes lëvizjes, shprehjes letrare, figurative e të tjera, në këtë klasë fitojnë

Nxënësit do të jenë aftësuar për të përvetësuar disa nocione themelore nga arsimimi teorik.

Nxënësit do të jenë aftësuar për luajtje në instrumente fëmijërore dhe tjera sipas zgjedhjes dhe mundësisë së tyre.

	<p>dimensione të reja dhe më të gjera emocionale, intelektuale karakteristike për moshën adoleshente. Përvec kësaj me programe të thjeshta kompjuterike (MIDI-AUDIO-VIDEO) mund të realizohet punë kreative, kombinim i animacioneve dhe fotografive (që fëmijët i sajojnë vetë në kompjuter) dhe kombinimi i tyre me përcjellje muzikore.</p> <p>Që mundësitë e veprimit ndërsocial të rriten dhe që kompjuteri mos të largojë ata nga komunikimi i ndërsjellë dhe bashkëpunimi gjatë nxënies, kjo punë mund të bëhet në mënyrë grupore (kolektive). Njëri bën animacionet, tjetri bën përcjelljen muzikore, kurse i treti bën kombinimin e tyre në programin kryesor.</p> <p><u>Njohja e institucioneve muzikore</u> në vend përmes vizitave, demonstrimit të përbërjes dhe veprimtarisë së tyre (shkolla e muzikës, orkestri, RT, redaksia muzikore, studiot muzikore etj.) Përmes programeve të radios e televizionit, por dhe Internetit e - mediave të ndryshme të njihen institucionet adekuate në botë.</p> <p>5.1. Njohja e profesioneve muzikore në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes pjesëmarrjes në koncerte e shfaqje muzikore. Nxënësit që krahas shkollës fillore dhe të mesme të ulët vijojnë edhe shkollën fillore të muzikës duhet të animohen të vazhdojnë shkollimin e mesëm muzikor, d.m.th të orientohen në profesione muzikore.</p> <p>5.2. Njohja e profesioneve të tjera ku formimi muzikor është i nevojshëm: mësuesia, bibliotekaria, gazetaria e specializuar etj.</p>	<p>Nxënësit do të jenë aftësuar për tu shprehur lirshëm mbi muzikën e degjuar.</p>
--	--	--

UDHËZIME PËRDORIMI TË LITERATURËS DHE TË BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Përveç përmbajtjeve mësimore që gjenden në tekstet aktuale prej klasës V-VIII dhe librit të klasës së parë të shkollës së mesme e që janë në numër mjaft të madh, shtojmë edhe disa të tjerë.\

1. *Wolfgang Amadeus Mozart*, Rekuem d-mol Kv 626;
 2. *Frederik Shopen*, Vals nr. 6-8 op. 64;
 3. *Sergej Prokofjev*, **Simfonia klasike**, koha I;
 4. *Carl Orf*, Carmina Burana (pjesë);
 5. *Philip Glass*; **Koncert per violinë e orkestër**;
 6. *Penderecki*, **Simfonieta për harkor**;
 7. *Arvo Pert*, **Cantus in memoriam B.Britten**, STRINGS and BELL;
 8. *Lorenc Antoni*, **Suitë korale**;
 9. *Rexho Mulliqi*, "Akuarelet e Prizrenit";
 10. *Esat Rizvanolli*, Musica Simfonica;
 11. *Feim Ibrahim*, **Toccata C-dur**;
 12. *Valton Beqiri*, Kuartet harkor;
 13. *Mendi Menxhiqi*, Oratorium-fragment;
 14. *Vinçenc Gjini*, Letrat, solo këngë;
- VII. Orientimet për punë të pavarur të nxënësve

Përmbajtja mësimore e edukimit muzikor u ndihmon nxënësve që në çdo komponentë të punojë në mënyrë të pavarur përmes formave të ndryshme të punës dhe aktiviteteve muzikore si:

- Krijimi i melodive të reja;
- Përshtypjet nga muzika e dëgjuar;
- Përpilimi i kasetave dhe CD me shembuj muzikorë (nga të gjitha zhanret dhe stilet);
- Përdorimi i programeve aplikative kompjuterike për shprehje;
- Nxitja e nxënësve për dëgjim të muzikës (në mënyrë individuale) në kohën e lirë
- Përpilimi i albumeve muzikore mbi kompozitorët, instrumentet etj.;
- Nxitja e nxënësve për vizita koncerteve (në grupe ose në mënyrë individuale) dhe vështrime kritike mbi shfaqjet e ndryshme muzikore në shkollë (formë e punës gazetareske) etj.

EDUKATË FIGURATIVE

1 orë në javë, 35 orë në vit

Qëllimi

Qëllimi e arteve të bukura është që nxënësit ta ndjejnë veten pjesëmarrës në një vepër arti;

Zhvillimi i krijimtarisë së nxënësit dhe aftësimi i komunikimit me njerëz përmes imazheve vizuale;

Përmes artit figurativ nxënësit mësojnë të shprehin idetë dhe aftësitë e vëzhgimit;

Të zhvillojnë aftësitë e analizës dhe të përshkrimit të veprave të artit në periudha të ndryshme historike;

Krijimi i të bukurës dhe të jetuarit me të.

Objektivat e Edukimit figurativ

Kompleksiteti i qëllimit / synimit të edukimit figurativ përcakton një spektër objektivash konkrete:

- Vrojtimi dhe mbajtja në mend e formave, ngjyrave dhe e raporteve hapësinore;
- Shfrytëzimi i materialeve të ndryshme për punë;
- Vrojtimi analitik dhe paraqitja figurative;
- Formimi i kriterëve estetikë;
- Kuptimi i veprave artistike;
- Imagjinimi dhe kultivimi i interesimeve për thesarin kulturor, lëvizjet bashkëkohore në art të kombit të tij dhe të kombeve të tjera.

Udhëzime metodologjike

Metodologjia e kësaj lënde është veprimtari bashkëpunuese mes arsimtarit që drejton dhe nxënësit që merr në shfrytëzim njohuritë dhe aftësitë e tij. Në këtë orë mësimore punojnë të gjithë nxënësit, pavarësisht nga talenti i tyre.

Nxënësve u jepen njohuri të pasurojnë ndjenjat e të zhvillojnë imagjinatën, kujtesën, të krijojnë shprehje për të dhënë idetë e tyre në një formë tjetër përmes figurës. Nxënësi gjithmonë ndjen kënaqësinë e suksesit.

Ai krijon atë që dëshiron, duke u mbështetur në informacionin e paraqitur. Ai përdor teknikë, ku ndjehet më i sigurt.

Nxënësi të lirohet nga stresi i pamundësisë për të riprodhuar modelin e paraqitur.

Nxënësi merr pjesë në shpjegimin e mendimit të shprehur nga piktorët e afirmuar, nga më të rriturit dhe krahason mendimet e tij me të shokëve dhe shkëmbejnë përvojën me njëri-tjetrin.

Metodologjia e punës në këtë lëndë plotëson më së miri qëllimin kryesor të lëndës: krijimin e të bukurës dhe të jetuarit me të. Ky përfundim mbështetet në këto etapa të orës së mësimi:

1. Te tërheqja e nxënësit për të vëzhguar të bukurën në natyrë.
 - E bukura ndodhet në natyrë, në mjedisin ku jetojmë, në ndërtesat ku banojmë, në lidhjet tona shoqërore, në lidhjet familjare etj. Pra, kudo ka diçka të bukur, por nxënësi duhet të orientohet për ta vëzhguar atë.
2. Nxënësit i jepet mundësia të krijojnë të bukurën sipas mendimit dhe mundësive të tij.
 - Nxënësi krijon i thelluar në imagjinatën e tij duke iu afruar ralitetit, por duke dhënë edhe interpretimin e tij.
3. Nxënësve u krijohet hapësirë të jetojnë me të bukurën, duke rregulluar me krijimet e tyre mjedisin përmes përdorimit të formave gjeometrike të ndryshme në mobilimin e dhomës, kombinimin e nuancave të ngjyrave sipas gamës, kombinimin në veshje etj.

Nxënësit mësojnë për rolin e artit në shtëpi, në shkollë, në sheshet ku luajnë, në fshat dhe në qytetin ku jetojnë.

Orientimet e nxënësve për punë të pavarur

Orientimet e nxënësve për punë të pavarur duhet trajtuar problem në nivelin e përgjithshëm, punë me masën e nxënësve pa përfshirë këtu punën e diferencuar me talentët e veçantë.

Për të punuar nxënësit më të pavarur duhet liruar dhe udhëzuar më shumë në punën praktike se teorizimeve të lodhshme.

Në orientimin fillestar të punës, ndër të tjera, mund të veçojmë:

- Nxënësi mësohet si ta mbajë lapsin në dorë, jo si penën, po me të gjitha gishtat. Të vizatojë, jo vetëm me dorë, (se bëhet i ngathët) por me të gjithë krahun, lirshëm.
- Të mos konsiderojmë të panevojshme stërvitjen e nxënësve për të hequr vija të lirshme paralele, të drejta të lakura, rrethore etj.

Përpara detyrës nxënësi zbaton dy procedura: Në fillim vëren gjatë dhe me vëmendje objektin që do të vizatojë, jo vetëm nga një pozicion. Pastaj bëhen disa skica paraprake konstruktive me vija ndihmëse.

Qëllimet e veçanta të nxënies	Përmbajtja programore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
Tema: Teknika e vizatimit (7 orë)			
Nxënësit duhet të njihen me të shprehurit figurativ. Duhet të përvetësojnë shkathtësitë e shprehjes së vijave dhe të formave.	<ul style="list-style-type: none"> • Ç'është arti; • Vija-elemente i shprehjes artistike; • Vizatim sipas modelit; • Ritmi i vijave; • Drejtpeshimi i formave; 	Përmbajtja arsimore duhet të trajtohet në frymën e artit. Nuk duhet të nënçmohet shprehja figurative e nxënësit. Duhet bërë përpjekje që nxënësi të realizojë temën e dhënë, pavarësisht nga aftësitë e tij të shprehjes figurative.	Nxënësi merr pjesë në të gjitha aktivitetet e edukatës figurative. Nxënësi tregon shkathtësi të shprehjes së vijave.
Tema: Teknikat e pikturimit (8 orë)			
Nxënësi duhet të përvetësojë kombinimet e ngjyrave dhe përdorimin e teknikave të pikturimit.	<ul style="list-style-type: none"> • Spektri i ngjyrave; • Ngjyrat themelore dhe kombinimi i tyre; • Teknika e pikurimit; • Shprehja tridimensionale (me anë të ngjyrës në natyrë); • Natyra dhe format e saj; • Forma reale dhe joreale; 	Duhet të sigurohen materiale të llojllojshme didaktike të cilat lehtësojnë metodologjinë e mësimdhënies dhe kështu sigurojnë mësim në nxënie të suksesshme. Vizitat e ekspozitave të pikturës dhe diskutimet janë të preferueshme.	Nxënësi përvetëson teknikat e pikturimit dhe kombinimet e ngjyrave.
Tema: Dizajni grafik (3 orë)			
Zhvillimi i krijimtarisë së nxënësve dhe aftësimi i komunikimit me njerëzit përmes imazheve vizuale. Familjarizimi me teknikat e grafikës dhe të shtypit. Ata mund të inkurajohen - këshillohen për këtë drejtim si profesion të tyre të ardhshëm nëse kanë prirje.	<ul style="list-style-type: none"> • Teknika e grafikës; • Grafika njëngjyrëshe; • Grafika dy, tringjyrëshe; • Shtypi i lartë ; • Ornamenti (shprehje simetrike); • Qeramika; • Kolazhi (temë në grupe 4 – 5 nxënës.) 	Nxënësit duhet të vizitojnë studio të disenjit grafik dhe të shtypit.	Nxënësit janë të informuar me teknikat e disenjit grafik dhe shtypit. Ata mund të shprehin preferimet e tyre për këtë drejtim si profesion i tyre i ardhshëm.
Tema: Arti aplikativ (7 orë)			
Nxënësit duhet të aftësohen të	<ul style="list-style-type: none"> • Tekstura (ballina e librit); 	Ushtrohen praktikisht aktivitete të	Nxënësit janë kreativ

<p>komunikojnë me njerëzit përmes imazheve vizuale. Ata orientohen drejt kërkimeve të fakteve kulturore artistike si fenomen kompleks. Zbulohet shpirti krijues dhe prirjet artistike të nxënësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Menytë; • Ilustrimi i një libri të lexuar; • Simbolet (komunikim vizuel); • Disejnit grafik; • Skenografia; • Vizitë ekspozitës; • Kostumografia; • Arkitektura (entrieri dhe eksterieri); • Mozaiku (punë në grupe 4 – 5 nx.); • Vitrazh (punë në grupe 4 – 5 nx.); • Natyrë e qetë (pikturë); • Portreti; • Karikatura; • Vizitë monumenteve kulturore; • Personifikimi dhe alegoria; 	<p>ndryshme të prezantuara. Nxënësit mund të zgjedhin vetë cilën njësi të kësaj teme ta zhvillojnë. Ata mund të inkurajohen të punojnë në grupe apo individualisht. Në fund mund të ekspozojnë punimet e larmishme të grupeve dhe individëve në klasë dhe të bëjnë analizën e tyre. Ata me këtë rast duhet të inkurajohen të jenë kritikë në punën e të tjerëve por edhe në atë personale.</p>	<p>dhe të aftë të bëjnë imazhe vizuale. Nxënësit kërkojnë format figurative, vlerësojnë punimet, kombinojnë ngjyrat dhe teknikat. Ata po ashtu shprehin interesimin për këto drejtime si profesionistë të ardhshëm.</p>
<p>Tema: Skulptura (5 orë)</p>			
<p>Mësimdhënësi kujdeset që nxënësit të kuptojnë drejtëpeshimin dhe shprehjen tridimensionale.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Skalitja dhe skeleti i saj struktural; 	<p>Nxënësit mund të vizitojnë atelie të skulptorëve dhe të provojnë veten në skulpturim duke luajtur me materialet dhe mjetet e skulpturimit.</p>	<p>Nxënësi informohet për mundësit e materialeve për krijimin e skulptures. Ata poashtu kuptojnë shprehjen tridimensionale.</p>
<p>Tema: Arkitektura (3 orë)</p>			
<p>Duhet të krijohen koncepte të reja artistike për arkitekturën.</p>	<p>Njësia mund të zgjedhet nga mësimdhënësi (lloji i objekteve që do të merren në shënjestër të analizës).</p>	<p>Mund të prezantohen objekte të ndryshme arkitektonike me slajda, foto ose me shëtitje në rrethinën e shkollës në aspektin artistik.</p>	<p>Nxënësit krijojnë koncepte artistike për arkitekturën dhe marrin pjesë lirshëm në shprehjen e mendimeve</p>

			gjatë analizës së objekteve.
Tema: Histori e artit (3 orë)			
Marrja e njohurive të përgjithshme mbi vlerat e qytetëruara të të menduarit dhe të vepruarit.	<ul style="list-style-type: none"> • Arti ilir; • Arti shqiptar (shekulli XIX, XX); • Punim sipas imagjinatës; • Vlerësimi estetik i punimeve. 	Analizohen periudha të ndryshme kohore dhe diskutohet përmes prezantimit me slajde, foto, vizatime, piktura, ekspozita.	Nxënësi diskuton mendimin e shprehur nga piktorët e afirmuar, nga më të rriturit dhe krahason mendimin e vet me të shokëve në klasë. Ata shkëmbejnë përvojat e njëri-tjetrit të marra gjatë vitit ose edhe në vitet e mëparshme për të vlerësuar krijimtarinë, për të vlerësuar atë që atij i duket e bukur.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Xhonson, **Historia e artit;**

Harvarda Arnasona H., **Historia e artit modern;**

Arti bashkëkohor i Kosovës;

Muharremi H., **Kultura figurative** - kl . II;

Goçi R., **Kultura figurative** – kl . VII, VIII;

Goçi R., **Edukatë estetike** – kl . I për shkollat e mesme;

Nimani Sh., **Shqyrtime artistike;**

Muriqi N., **Baraspesha estetike;**

Muriqi N., **Kultura figurative** kl . V –VI;

Emërllahu D., **Edukata estetike;**

Gaxholli E., **Mjeshtrit e pikturës;**

Mësimdhënësit dhe nxënësit inkurajohen të shfrytëzojnë edhe burime të tjera mësimore siç janë revistat profesionale, katalogët e posaçërisht Internetin, etj.

*Edukatë fizike
dhe sportet*

EDUKATË FIZIKE DHE SPORTI

2 orë në javë, 70 orë në vit

HYRJE

Në kuadër të rritjes, zhvillimit biologjik dhe shoqëror të nxënësve të kësaj moshe e në vartësi të kushteve punuese, problemet vepruese programore të edukimit dhe arsimit të mirëfilltë sportiv ndërlidhen kryesisht me:

1. Aktivitete lëvizore themelore dhe ato specifike përkatëse për formimin e shpërhive mjeshtërore në sportet e zgjedhura nga nxënësit;
2. Kuptimet parimore që duhet forcuar dhe vënë në funksion e njëherësh që shprehen me vazhdimësi sistematike lëvizore, -tjetërsim në rritje të aftësive motorike si dhe sigurimin optimal të përzgjedhjes së nxënësve të kësaj moshe:
 - 2.1. Aftësi të kufizuara psikosomatike (- 3 sigma), mesatare dhe të përpunuar (+ 3 sigma). Për dy grupet e skajshme (\pm 3 sigma) të nxënësve duhet siguruar trajtim të posaçëm aktivitetesh lëvizore në shumë prej së paku 5 orë në javë. Grupi i majtë i shpërndarjes, mbulohet me lëvizje korrigjuese aftësuese përkatëse, ndërsa nxënësit e përparuar duhet grupizuar në paralele sportive, së paku nga një në çdo qendër komunale,
3. Rritjen e përgjegjësisë së mësuesit të edukimit fizik e sportiv, aktivitetet e tij dhe drejtorit të shkollës për aktivitetet lëvizore të nxënësit;
 - 3.1. Rritjen e bashkëpunimit efikas me prindërit, psikologun dhe mjekun-specialist të shkollës me organet e tjera qeveritare dhe joqeveritare në mënyrë të evitohen gabimet e të rritet ndikimi pozitiv lëvizor te fëmijët tanë.

Përmbajtja:

Teori e edukimit fiziko sportiv – 3 orë;

Vlerësim i aftësive motorike – 4 orë;

Atletikë - 14 orë;

Lojëra sportive – mësimi zgjedhor 23 orë;

Gjymnastikë sportive – ritmike -14 orë;

Valle popullore - 4 orë.

Në dispozicion 8 orë

Noti - 10 deri 15 ditë;

Ski 7-10 ditë.

Shëtitje dhe fushim 3 orë gjatë vitit.

Gara sportive (sipas kushteve).

Treguesit sasiorë e njëherësh cilësorë të rritjes dhe zhvillimit biologjik, të formimit të shprehive, kontrollit të shkallës së përparimit, etj., mund të sigurohen e të shprehen përmes këtyre veprimeve matëse, të ndryshoreve si:

A. Bazike (antropometrike): gjatësia trupore, pesha trupore, perimetrat truporë (2-3), forca eksplozive e këmbëve—kërcim nga vendi, forca eksplozive e duarve—hudhja e medicinballit, vrapim në 60 metra si dhe qëndrueshmëria—vrapim në 400 metra (nxënëset) dhe 800 (nxënësit).

B. Mjeshtërore: Dy ndryshore nga atletika, dy ndryshore nga lojërat sportive (udhëheqja, gjuajtja—goditja etj.), dy ndryshore nga gjimnastika sportive dhe një ndryshore nga noti.

Matjet duhen bërë tri herë në vit, posaçërisht ndryshoret e informatave motorike, duhen bërë në fillim të vitit në fund të gjysëmvetorit të parë dhe në fund të vitit shkollor.

Qëllimet e veçanta	Përmbatja programore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet që duhet arritur
Temat			
1. Teori e edukimit fiziko-sportiv (1 orë)	1. Aktivitetet që i presin nxënësit gjatë mësimin të edukatës fizike dhe sportive.	Forma e punës frontale. Metoda e punës verbale.	Krijimi i vetëdijës më të lartë të nxënësve për aktivitete trupore.
2. Vlerësim i aftësive motorike (4 orë).	Matja e aftësive fizike dhe zhvillimi trupor.	Forma e punës në grup. Metoda verbale dhe e demonstrimit.	Shkalla e përparimit si dhe rezultatet e garave në mjeshtërinë sportive (vlerësimi përfundimtar i nxënësve).
3. Atletikë (14 orë).	<p>Ecjet dhe vrapimet:</p> <p>1.Ecja sportive; 2.Ushtrime për reagim të shpejtë; 3.Nisja dhe përshpejtimi; 4.Vrapim në 60m, 400m,-F dhe 800m-M.</p> <p>Kërcimet:</p> <p>1.Kërcim së zgjati-këmbë mbledhur; 2.Kërcim së zgjati trupin hark; 3.Kërcim së larti "Fosberi".</p> <p>Hudhjet:</p> <p>1.Shtytja e gjyles 4 kg; 2.Hudhja e topave 250gr;</p>	<p>Forma frontale, në grup. Metoda verbale, demonstrimi sintetik.</p> <p>Forma frontale dhe në grup. Metoda verbale e demonstrimit dhe e kombinuar.</p> <p>Forma frontale dhe në grup.</p>	<p>Përsosja e strukturës lëvizore mbi 60%,</p> <p>-//- mbi 70%</p> <p>-//- mbi 80%</p>

<p>4. Lojëra sportive-mësimi zgjedhor-(23 orë).</p>	<p>a)Elementet teknike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Pasimet dhe pranimet; 2.Driblimi-udhëheqja; 3.Mashtrimet; 4.Goditjet- gjuatjet. <p>b)Elementet taktike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Mbrotje – individuale dhe në grup. 2.Sulm individual dhe në grup. 	<p>Metoda verbale e demonstrimit dhe e kombinuar.</p> <p>Forma në çifte, frontale, individuale dhe në grup. Metoda verbale, e demonstrimit, sintetike dhe e kombinuar.</p>	<p>Përsosja e teknikës së elementeve teknike mbi 80% si dhe përsosja taktike 60%-70%;</p>
<p>5.Gjymnastikë sportive-(14 orë)</p>	<p>Hekuri:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Nga varja e përzier rrotullim me forcë prapa, në mbështetje para. 2.Rrotullim prapa nga mbështetja para. 3.Dalje në hark. <p>Paralelja(M):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Lëkundje në mbështetje mbi krah. 2.Lëkundje në mbështetje mbi duar. 3.Ngritja në lëkundje para deri në ndenje me këmbëhapur. 4.Ngritje me shpalosje deri në ndenje me këmbëhapur. 5.Dalje me lëkundje prapa nga 	<p>Forma e punës në grupe-puna me ushtrim plotësues.</p> <p>Metodat verbale, të demostrimit, sintetike, analitike dhe e kombinuar.</p>	<p>Përsëritja dhe përsosja e elementeve të theksuara nëpër vegla mbi 60%.</p>

	<p>mbështetja mbi duar.</p> <p>Unazat:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Lëkundje në varje në unaza. 2.Nga lëkundja para në varje të palosur. 3.Dalje në lëkundje para dhe prapa. 4.Nga varja e palosur dalje me rotullimin e shpatullave prapa. <p>Kërcimet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Kërcim kaluqi në gjerësi, këmbët anash. 2.Kërcimi me këmbë të hapura anash. 3.Kërcim kaluqi me këmbë të mbledhura. <p>Ushtrime në dysheme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Vertikalja mbi shpatulla. 2.Nga mbështetja shtrirë para, kalim në mbështetje shtrirë prapa. 3.Ekuilibri ballor. 4.Ekuilibri anësor 5.Kapërdim fluturimthi. 6.Vertikalja në mbështetje në duar. 7.Rrotullimi anësor. <p>Paralelet e shkallëzuara:</p>	<p>-//-</p> <p>-//-</p> <p>-//-</p> <p>-//-</p>	<p>-//-</p> <p>-//-</p> <p>-//-</p>
--	--	---	-------------------------------------

<p>5b)Gjymnastikë sportive-femrat (14 orë).</p>	<p>1.Varje në drushtën e sipërme. 2.Nga lëkundja me kapje nga sipër mbështetje e këmbëve në drushtën e ulët,kthim për 180 shkallë. 3.Varje në drushtin e lartë, kalim me këmbë anash, (majtas-djathtas). 4.Lëkundja ballore. 5.Rrotullim prapa në drushtën e ulët. 6.Rrotullim prapa nga mbështetja e shaluar. 7.Dalje me trup të shtrirë prapa përtej drushtës së ulët.</p> <p>Trari gjymnastikor:</p> <p>1.Hipjet në shalëpërkulje me mbështetje. 2.Ecje mbi tra në majë të gishtave-para-prapa. 3.Kërcim me të dy këmbët nga vendi. 4.Kthim për 180-360shkallë. 5.Qëndrimi në ekuilibër krahët anash-poshtë. 6.Dalje me trup të lakuar-hark. 7.Kombinime me elemente të mësuara.</p> <p>Përsëritje e elementeve të përvetësuara në klasën V, VI, VII,</p>	<p>-//-</p> <p>edhe puna në rresht, stacione, ushtrim plotësues</p> <p>-//-</p> <p>edhe puna në rresht, stacione, ushtrim plotësues.</p> <p>-//-</p>	<p>Përsëritja dhe përsosja e elementeve të ushtrimeve në vegla gjymnastikore për femra, të mësuara më parë në shkallë mbi 60%.</p> <p>-//-</p> <p>-//-</p> <p>Perfeksionimi dhe përsosja e lëvizjeve sa më të bukura-estetike dhe natyrore mbi 80%.</p>
---	--	--	---

5c) Gjimnastika ritmike	VIII nga ecjet, vrapimet, kërcimet, kthimet, ushtrimet me rekuizita (topa, rrathë, litar të shkurtër, shishe druri, etj.)	Forma frontale, në grup, në çifte. Metodat e punës verbale, e demonstrimit, sintetike, e kombinuar.	Perfeksionimi dhe përsosja e lëvizjeve sa më të bukura-estetike dhe natyrore mbi 80%.
6. Vallet popullore	Përsëritja e valleve popullore të përvetësuara në klasët V,VI,VII,VIII (kombëtare dhe ndërkombëtare)	Forma e punës frontale, në grup, individuale. Metodat verbale, demonstrimit, sintetike dhe kombinuara.	Përsosja e lëvizjeve specifike të stileve të notit dhe të kërcimit mbi 80%
7. Noti – 10 deri 15 ditë.	Përsëritja dhe përvetësimi i stileve të notit (kroli, kroli në shpinë, bretkocë, delfin) dhe kërcime të lira.	Forma frontale, grupore, individuale. Metodat – verbale, demonstrimit, sintetike, kombinuar dhe e garave.	Përsosja e lëvizjeve specifike të stileve të skijimit mbi 80%
8. Ski – 7 deri 10 ditë.	Përvetësimi i elementeve të teknikës së lëvizjeve në ski, të mësuara më parë (ecjet, kthimet, ngjitjet, zbritjet, kalimet, vrapimet, lëshimet, sllallom dhe sllallom i madh.	Forma frontale, grupore, individuale. Metodat – verbale, demonstrimit, sintetike, kombinuar dhe e garave.	Realizimi i programit të planifikuar për shëtitje 80% - 100%.
9. Shëtitjet	Sipas programit të përbashkët të lëndëve tjera, dy herë në vit me program të posaçëm nga edukimi fizik dhe sportiv.	Organizimi sipas kërkesave didaktiko metodike për shetitje dhe fushim.	Realizimi i planit për organizimin e garave 100%
10. Garat (8 orë)	Organizimi i garave – së paku nga dy lojra sportive	Sipas rregullave të lojrave	

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbetjeve programore në mënyrë profesionale dhe shkencore mësimmëdhënësit mund të shërbejnë me këtë literaturë:

1. **Edukata fizike** për nxënësit e klasës V, VI – të (*B. Hasangjekaj – J. Puka*);
2. **Edukata fizike** për nxënësit e klasës VII, VIII– të (*B. Hasangjekaj – J. Puka –M. Nixha*);
3. **Edukata fizike** për klasën e I-rë dhe II-të, të AMO (Grup autorësh);
4. **Edukata fizike** (përkthim) – klasa I-rë, II-të së mesme (*A.Fehmiu-N.Koshi*);
5. **Hendboll**, *Prof.dr.Faik Çitaku*;
6. **Basketboll**, *Prof.dr. Masar Nixha*;
7. **Volejbol**, *Prof.dr. Enver Gjinolli*;
8. **Atletikë**, *Prof.dr. Hysen Rakovica*;
9. **Futboll**, *Prof.dr. Enver Gjinolli*;
10. **Ski**, *Prof.dr. Masar Nixha – Mr.Aziz Dujaka*;
11. **Metodika e Edukatës fizike**, *Beqir Hasangjekaj-ligjërues*;
12. **Edukimi fizik** në shkollë - grup autorësh nga Tirana
13. **Teoria e trajningut sportiv**, *Prof.dr. Faik Çitaku*;
14. **Sate Practice – in Physical Education - Baalpe**

Fillet
e ekonomisë
dhe të drejtësisë

FILLET E EKONOMISË DHE TË DREJTËSISË

(3 orë në javë, 105 orë në vit)

HYRJE

Në suaza të këtij lëmi jepen informacionet e duhura për orientimin profesional për tri degë (fusha) të ekonomisë, të drejtësisë dhe të bujqësisë (secila me 35 orë në vit).

Është e nevojshme që këto fusha të shtjellohen në formë cikli në paralelet e klasës së nëntë në kuadër të një shkolle ku do të fillohej me mësimin e fazave ekonomike, juridike dhe atyre të bujqësisë. Mësimdhënësit do të ishte mirë të jenë persona të diplomuar të lëmenjve përkatës dhe të cilët do të ishin të angazhuar gjatë tërë vitit në procesin mësimor.

Qëllimi

Të mësuarit e lëmenjve shoqërorë dhe bujqësorë ka për qëllim përmes sqarimit dhe zhvillimit të njësive përkatëse mësimore nxënësit të njohohen me konceptet themelore të lëmenjve të shkencave shoqërore si dhe me ndikimin që kanë këto fusha në rregullimin e jetës shoqërore, ekonomike dhe në prodhimtarinë bujqësore, ruajtjen e mjedisit dhe prodhimin e ushqimit të shëndoshë për popullatën tonë dhe për eksport.

Synimet: Mësimdhënësit duhet të angazhohen që secili nxënës:

- Të nxitet drejt pavarësisë dhe ngritjes së ndërgjegjes së tij të jetë sa më i pavarur;
- Të bëhet i vetëdijshëm për prirjet, interesimet, aftësitë dhe njohuritë e tij personale;
- Të mësohet t'i përvetësojë qëndrimet pozitive të vlerave, aftësitë kreative vepruese dhe kompetencat shoqërore dhe të jetë në gjendje t'i fusë këto në veprim;
- T'i zhvillojë aftësitë e punës së pavarur por edhe së bashku me të tjerët si dhe ta kuptojë faktorin shoqëror në profesion dhe në punë;
- Të marrë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme të jetë në gjendje të bëjë përzgjedhje të menduara mirë gjatë arsimit të mëtutjeshëm dhe gjatë orientimit profesional;

Ky lëmë është paraparë t'u pasqyrojë dhe ofrojë nxënësve njohuritë dhe shkathtësitë që nevojiten për njohjen e të drejtave të tyre, ato qytetare, ekonomike e të tregut dhe bazat e një bujqësie moderne e të përparuar dhe mundësitë për orientim dhe përzgjedhje të një profesioni të ardhshëm, në bashkëpunim me arsimtarin dhe me prindërit.

Objektivat e përgjithshme

Nga kjo lëndë nxënësi duhet të përfitojë një pasqyrë reale për drejtimit e çaktuara shoqërore dhe në këtë aspekt lënda duhet të tentojë që të nxënësi të kultivojë dhe të zhvillojë shkathtësitë e caktuara, duke filluar nga niveli i përgjithshëm e duke përfunduar me një nivel operacional.

EKONOMIA

(Gjithsej 35 orë në vit)120

OBJEKTIVAT E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET QË DUHET ARRITUR
Tema 1: Ç'është ekonomia (3 orë)			
Njohja me kuptimin e ekonomisë dhe elementet e saj.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkufizimi i ekonomisë; ▪ Elementet e ekonomisë; ▪ Gërshtetimi i ekonomisë me fushat e tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantimi i aktivitetit ekonomik të njeriut në epoka të ndryshme të zhvillimit të tij (nga epoka e gurit, mesjeta deri tek industrializimi); plotësimi i nevojave njerëzore; ekonomia shtëpiake, ekonomia e një lokaliteti; ekonomia e një vendi. ▪ Të theksohet roli dhe rëndësia e zhvillimit ekonomik në zhvillimin e arsimit, kulturës, shëndetësisë, shkencës. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit të fitojnë njohuri mbi ekonominë; të japin mendimet e tyre lidhur me rolin e zhvillimit ekonomik.
Tema 2: Degët e rëndësishme të ekonomisë së Kosovës (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nxënësve me degët më të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bujqësia; ▪ Industria; ▪ Tregtia; ▪ Ndërtimtaria; ▪ Komunikacioni; ▪ Shërbimet. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Paraqiten veçoritë e degëve ekonomike; ▪ Ilustrohet pjesëmarrja e këtyre degëve në ekonominë e Kosovës në faza të ndryshme; ▪ Përdoren ilustrime tabelare dhe grafike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi arrijnë t'i dallojë degët ekonomike dhe veçoritë e tyre.
Tema 3: Zhvillimi ekonomik i Kosovës (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja me rrethinën ekonomike dhe burimet natyrore dhe materiale të zhvillimit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Pozita gjeostrategjike e Kosovës; ▪ Resurset njerëzore; ▪ Resurset natyrore; ▪ Burimet financiare; ▪ Kuptimi i investimeve dhe rëndësia e tyre. 	<p>Rikujtimi i materies të mësuar nga lëndët e mëpërshe nga njohuria e natyrës dhe gjeografia;</p> <p>Një shembull i investimeve.</p>	<p>Nxënësi duhet të fitojë dituritë themelore mbi pasuritë natyrore dhe njerëzore të vendit tone dhe si këto pasuri aktivizohen në shërbim të zhvillimit.</p>

Tema 4: Tranzicioni dhe rindërtimi i vendit (3 orë)			
Të njohetohet nxënësit me kuptimin dhe përmbajtjen e tranzicionit ekonomik në të cilin po kalon Kosova.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rindërtimi i vendit; ▪ Privatizimi i pronave shoqërore; ▪ Nisiativa private; ▪ Sektori publik; ▪ Punësimi dhe papunësia. 	Të shpjegohen hapat e ndërmarrë në vendet e tjera në kalimin nga ekonomia shtetërore në atë të tregut; Të prezantohen veçoritë e Kosovës në ecje kah ekonomia e tregut; Të bëhen vizita në ndërmarrjet të cilat privatizohen apo të privatizuara.	Të nxitet të menduarit mbi nisiativat individuale dhe grupe të biznesit dhe mbi pronën.
Tema 5: Ekonomia e tregut (3 orë):			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të fitohen njohuritë themelore mbi ekonominë e tregut. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Historiku i shkurtër i ekonomisë së tregut ▪ Veçoritë kryesore të ekonomisë së tregut; ▪ Roli i shtetit në ekonominë e tregu 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prezantohen përvojat nga vendet e zhvilluara. ▪ T'u sigurohet nxënësve kontakti me tregun (të lagjes, të qytetit, tregun e fuqisë punëtore etj.) ▪ Të diskutohen përshtypjet e nxënësve lidhur me tregun. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit të kuptojnë rolin e tregut në gjenerimin e prodhimit dhe të shërbimeve.
Tema 6: Paraja dhe bankat (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nxënësve me paranë, emetimin e parasë, bankat dhe kreditë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zanafilla e parasë; ▪ Format dhe funksioni i parasë; ▪ Bankat; ▪ Kreditë dhe kamatat; ▪ Inflacioni dhe pasojat e tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përmes vizitave të nxënësve në banka dhe njoftimit të tyre me punët e bankave, të sqarohet: ▪ ç'është paraja dhe si bëhet emisioni i parasë (euros); ▪ veprimtaria e bankave; ▪ si bëhet tërheqja dhe depozitimi i parave në bankë; ▪ si paguhen shërbimet bankare; ▪ se si shkaktohet inflacioni dhe cilët janë dëmet e tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi të identifikojë veçoritë e përgjithshme të parasë dhe të njohë veprimtaritë themelore të bankave.
Tema 7: Buxheti (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nxënësve me formimin e buxhetit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Formimi dhe shpërndarja e buxhetit; ▪ Burimet e tjera të buxhetit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Me shembuj konkretë paraqiten të hyrat dhe të dalat në një familje. ▪ Të demonstronhet si duhet të manaxhohet buxheti personal i një nxënësi apo i një individi. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit të arrijnë njohuri themelore si sigurohen mjetet për nevojat familjare dhe si duhet të manaxhohet buxheti personal.

Tema 8: Ndërmarrjet ekonomike (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja e nxënësve me kuptimin, llojet dhe veçoritë e ndërmarrjeve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptimi i ndërmarrjeve dhe llojet; ▪ Ndërmarrjet individuale; ▪ Ortakitë; ▪ Shoqëritë aksionere. ▪ Kërkesa dhe oferta në treg. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nga vizitat e ndërmarrjeve të diskutohet: kuptimi i ndërmarrjeve dhe i ndërmarrësisë; veçoritë e tyre, perspektiva e zhvillimit. ▪ Të diskutohet çka blejnë dhe çka shesin ndërmarrjet në treg. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të fitohen njohuritë si formohet dhe si funksionon një ndërmarrje.
Tema 9: Prodhimi dhe produktiviteti (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të diskutohet roli i prodhimit dhe faktorët e prodhimit në ekonomi 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prodhimi dhe faktorët e tij; ▪ Puna; ▪ Toka; ▪ Kapitali; ▪ Produktiviteti. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të vizitohet një punëtori apo ofiqinë prodhuese nga e cila nxënësit do të kuptojnë: ▪ si organizohet dhe si realizohet prodhimi; cilët janë faktorët e prodhimit; sa njësi mund të prodhojë një punëtor; ▪ çka duhet ndërmarrë për të prodhuar më shumë njësi brenda një ore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësit të njohin mënyrën e organizimit të prodhimit dhe rolin e produktivitetit.
Tema 10: Rezultati afarist dhe evidenca financiare (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohja me rezultimin e fitimit apo të humbjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të hyrat ; ▪ Të dalat (shpenzimet materiale, pagat, amortizimi, kamatat, tatimet etj.); ▪ Shpërndarja e fitimit; ▪ Evidenca financiare. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të sqarohet kujt i takon fitimi dhe kujt i takojnë pagat në një ndërmarrje; ▪ Çka ndodh me ndërmarrjet që punojnë me humbje. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të fitohen njohuritë si përllogaritet fitimi apo humbja nga një aktivitet ekonomik..

Tema 11: Manaxhmenti dhe kuptimi i tij (5 orë)

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptimi i manaxhimit dhe diskutimi i rolit të manaxherit dhe pronarit (apo pronarëve) të ndërmarrjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptimi i manaxhmentit dhe funksionet e manaxhmentit; ▪ Manaxhmenti dhe manaxherët; ▪ Puna e manaxherit; ▪ Burimet informative; ▪ Sistemi informativ i ndërmarrjes. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizohen vizita të nxënësve në ndërmarrje ekonomike, banka dhe organizata të tjera. Diskutohen çështjet e pronësisë, manaxhimit duke përfshirë organizimin, udhëheqjen, ekzekutimin e detyrave, sistemin informativ dhe kontrollin. ▪ Këto probleme diskutohen në klasë, ku kërkohet mendimi i nxënësve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi të kuptojë si dhe kush manaxhon me ndërmarrjen.
---	---	--	---

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Literatura e gjerë për arsimtarët:

1. *Ahmet Mançellari, Sulo Hadri, Dhori Kule, Stefan Qirici: Hyrje në ekonomi*, Tiranë, 2000;
2. *Nexhmi Rexha, Nail Reshiti: Bazat e marketingut*, Riinvest, Prishtinë 1998;
3. *Shyqri Llac: Produktiviteti dhe manaxhimi*, Tiranë, Panteon, 2000.;
4. Instituti Riinvest: Riinvest: Aktiviteti ekonomik dhe zhvillimi demokratik i Kosovës, Projekt studimor, Prishtinë, korrik 1999;
Interneti
5. Edukata qytetare kl. VIII, *Libri shkollor*, Prishtinë 2001.

BUJQËSI

(Gjithsej 35 orë në vit)

OBJEKTIVAT E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET QË PRITEN
Tema 1. Hyrje në bujqësi (3 orë)			
Njohja me temat mësimore të degës së bujqësisë që parashihen të zhvillohen në kuadër të lëndës “Lëmenj shoqërorë“	Përkufizimi i shkurtër i bujqësisë si degë ekonomike, lidhmëria e saj me shkencat e natyrës (kimi, biologji, fizikë, matematikë etj.) dhe me degët e tjera të ekonomisë.	Rikujtimi dhe lidhmëria e njohurive të cilat nxënësit i kanë marrë gjatë mësimave paraprake me theks në aspektin praktik prodhues.	Nxënësve duhet t’u bëhet e njohur rëndësia e bujqësisë për ekonominë dhe shoqërinë.
Tema 2. Kushtet agro ekologjike (3 orë)			
Meteorologjia, elementet e saj dhe klima	<ul style="list-style-type: none"> - Temperatura; - Shtypja atmosferike; - Lëvizja e ajrit; - Klasifikimi i klimës; - Ndryshimet klimatike; - Klima e Kosovës; - Kushtet meteorologjike, klimatike në relacion me prodhimtarin bujqësorë. 	<ul style="list-style-type: none"> -Me fotografi dhe pano të shpjegohet ndërtimi dhe parimi i punës së aparateve meteorologjike, -Mundësisht, të demonstronhet në praktikë (vizitë stacionit meteorologjik) funksionimi i aparateve. 	Nxënësit duhet të fitojnë njohuri themelore për fenomenet kryesore meteorologjike dhe klimatike.
Tokat dhe klasifikimi	<ul style="list-style-type: none"> - Toka si sistem shumëfazor; - Pedogjeneza dhe evolucioni; - Vetitë fizike, kimike dhe biologjike të tokës; - Format e dëmtimit dhe masat mbrojtëse; - Klasifikimi dhe tipat më të rëndësishëm të tokave në Kosovë. 	Përdorimi i hartës, atlaseve pedologjike, vizita në terren dhe hapja e profilit pedologjik, përmes të cilit do të shpjegohen proceset e formimit dhe evolucionit të tokës.	Nxënësit duhet të fitojnë njohuritë themelore për tipat kryesorë pedologjikë të tokave në Kosovë dhe aftësitë prodhuese të tyre.

Tema 3. Mekanizimi në bujqësi (3 orë)			
Makinat bujqësore për punimin e tokës dhe operacionet e tjera në prodhimtarinë bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> - Njoftim me makinat bujqësore për punim bazë të tokës, dhe operacionet e tjera gjatë prodhimtarisë bujqësore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të vizitohen fermat bujqësore me mekanizim përkatës për të parë praktikisht funksionimin e tyre. - Në raste të tjera duhet që përmes fotografive, vizatimeve dhe formave të tjera të prezantimit të bëhet sa më konkret funksionimi i makinave bujqësore për punimin e tokës dhe proceset e tjera në prodhimtarinë bujqësore. 	Njohja e nxënësve me makinat bujqësore dhe funksionimin e tyre gjatë procesit të punës.
Tema 4. Kulturat lavërtare, foragjere dhe perimet (3 orë)			
Njohja e nxënësve me veçoritëe prodhimtarisë së kulturave më të rëndësishme lavërtare, foragjere dhe perimore.	<ul style="list-style-type: none"> -Kulturat më të rëndësishme që kultivohen në Kosovë dhe masat agroteknike për kultivimin e tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes vizitës së fermave bujqësore nxënësit duhet të njihen me proceset agroteknike të kultivimit të kulturave lavërtare;foragjere dhe perimore. - Diskutim i lirë me nxënës për kulturat bujqësore që kultivohen në mjedisin e tyre jetësor; - Përmes formave të tjera të prezantimit (fotografi, video, CD, etj), nxënësve u bëhet më konkrete prodhimtaria e këtyre kulturave bujqësore. 	Nxënësit njoftohen me kulturat më të rëndësishme të këtij grupi që kultivohen në Kosovë, si dhe me disa operacione agroteknike të prodhimtarisë së tyre.

Tema 5. Kulturat pemëtare e vreshtare (3 orë)			
<p>Njohja e nxënësve me veçoritë e prodhimtarisë së kulturave më të rëndësishme pemëtare dhe vreshtare.</p>	<p>-Kulturat më të rëndësishme pemëtare dhe kultivarët e hardhisë që kultivohen në Kosovë dhe masat agroteknike për kultivimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes vizitës së fermave bujqësore nxënësit duhet të njihen me proceset agroteknike dhe pomoteknike të kultivimit të kulturave pemëtare dhe të hardhisë; - Diskutim i lirë me nxënës për kulturat që kultivohen në mjedisin e tyre jetësor; - Përmes formave të tjera të prezantimit (fotografi, video, CD, etj), nxënësve u bëhet më konkrete prodhimtaria e këtyre kulturave bujqësore. 	<p>Nxënësit njoftohen me kulturat më të rëndësishme të këtij grupi kulturash bujqësore që kultivohen në Kosovë, si dhe me disa operacione agroteknike dhe pomoteknike të prodhimtarisë së tyre.</p>
Tema 6. Blegtoria dhe shëndeti i kafshëve (6 orë)			
<p>Njohja e nxënësve me k veçoritë e prodhimtarisë blegtorale dhe masat e përkujdesit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Njohja me llojet e kafshëve shtëpiake që mbarështohen më së shpeshti në fermat tona. - Masat më të rëndësishme të teknologjisë së mbarështimit, higjienës dhe gjendjes shëndetësore të tyre. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes vizitës në ferma blegtorale nxënësit duhet të njihen me llojet e kafshëve, teknologjinë e mbarështimit dhe masat e përkujdesit për kafshët, me theks për sëmundjet më të shpeshta të kafshëve dhe masat për parandalimin dhe luftimin e tyre. - Diskutim i lirë me nxënës për kategoritë e kafshëve që mbarështohen në mjedisin e tyre. 	<p>Nxënësit do të njoftohen me llojet e kafshëve shtëpiake që më së shpeshti kultivohen në fermat tona si dhe me masat e përkujdesit për gjendjen shëndetësore të tyre.</p>

		- Përmes formave tjera të prezantimit (fotografi, video, atlase, CD, etj), nxënësve u bëhet më konkrete teknologjia e mbarshimit dhe përkujdesjes higjienike e shëndetësore të llojeve të kafshëve shtëpiake.	
Tema 7. Teknologjia ushqimore (5 orë)			
Njohja e nxënësve me format e përpunimit të prodhimeve të kulturave bujqësore dhe atyre blegtorale.	-Njohja me proceset teknologjike të përpunimit dhe kapacitetet përpunuese në Kosovë të prodhimeve lavërtare, perimore, pemëtare, blegtorale, pijeve joalkoolike dhe alkoolike.	-Përmes vizitës në njësi apo industri të përpunimit të prodhimeve bujqësore, nxënësit të njihen me proceset dhe kushtet e përpunimit dhe ruajtjes së prodhimeve të gatshme; - Diskutim i lirë me nxënës për llojet e përpunimit të prodhimeve në amvisëritë ku jetojnë; -Përmes formave të tjera të prezantimit (fotografi, video, CD, etj), nxënësve u bëhet më konkret procesi teknologjik i përpunimit të prodhimeve bujqësore si dhe kushteve të ruajtjes së prodhimeve të gatshme.	Nxënësit të njohohen me llojet dhe mënyrat e përpunimit të prodhimeve bujqësore (lëndëve të para dhe produktet e tyre) si dhe me kushtet higjieniko-sanitare të prodhimitarisë dhe të ruajtjes së prodhimeve.

Tema 8. Mbrojtja e bimëve (3 orë)

<p>Njohja e nxënësve me sëmundjet, dëmtuesit si dhe masat për mbrojtjen e kulturave bujqësore.</p>	<ul style="list-style-type: none">- Njohja e nxënësve me shkaktarët e sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore;- Masat për parandalimin dhe luftimin e tyre.	<ul style="list-style-type: none">- Përmes vizitës së fermave bujqësore nxënësit të njihen me sëmundjet dhe dëmtuesit me të cilët ballafaqohet prodhimtaria, si dhe me masat që zbatohen në terren për parandalimin dhe luftimin e tyre;- Diskutim i lirë me nxënës për simptomat që ata i kanë vërejtur më së shpeshti te bimët;- Përmes formave të tjera të prezantimit (fotografi, video, atlase, CD, etj), nxënësve u konkretizohen shenjat e sëmundjeve dhe dëmtuesve si dhe masat për parandalimin dhe luftimin e tyre te kulturat bujqësore.	<p>Nxënësit njoftohen me shkaktarët kryesorë të paraqitjes së sëmundjeve dhe dëmtuesit, si dhe masat për parandalimin dhe luftimin e tyre.</p>
---	--	---	--

Tema 9. Përdorimi i lëndëve kimike dhe mbrojtja e mjedisit (3 orë)

<p>Njohja e nxënësve me lëndët kimike që përdoren në bujqësi (plehrat dhe pesticidet) si dhe me përdorimin e drejtë të tyre në mbrojtjen e mjedisit, por edhe të shëndetit të njerzve.</p>	<ul style="list-style-type: none">- Njohja e llojeve më të shpeshta të plehrave dhe pesticideve që përdoren në bujqësi;- Veprimin e tyre në kultura bujqësore,- Rreziqet për mjedisin, dhe mundësitë e helmimit me to, si dhe masat për zvogëlimin e këtij rreziku.	<ul style="list-style-type: none">- Gjatë vizitës në ndonjë fermë, apo barnatore bujqësore nxënësit njihen me llojet e lëndëve kimike, format e formulimit të tyre, përdorimin e drejtë të tyre për arritje të rendimenteve, por edhe me mundësitë e përdorimit jo të drejtë të tyre dhe pasojat që shkaktohen qoftë te bimët, por edhe te kafshët dhe te njerëzit;- Diskutim i lirë me nxënës për ndonjë rast helmimi me lëndë	<p>Njohja e nxënësve me llojet kryesore të plehrave dhe pesticideve, veprimin e tyre pozitiv në rendiment të kulturave bujqësore, por edhe me veprimin ndotës të tyre në rast të përdorimit joprofesional.</p>
---	---	--	--

		kimike bujqësore; - Përmes formave të tjera të prezantimit (fotografi, video, atlase, CD, etj), nxënësve u bëhet më i qartë përdorimi i lëndëve kimike, në veçanti mundësitë e helmimit me këto lëndë.	
Tema 10. Njohuri nga biznesi në bujqësi (3 orë)			
Njohja e nxënësve me drejtimin e fermes bujqësore dhe me marketingun.	Njohja e nxënësve me organizimin e fermes bujqësore, lidhshmërinë e agrobiznesit me marketingun e prodhimeve bujqësore.	Përmes vizitave që organizohen në ferma private ose shoqërore, nxënësit duhet të njihen me veçoritë themelore të drejtimit të fermës bujqësore, prodhimit të suksesshme, hulumtimit të tregut dhe parametrave të tjerë që përcaktojnë ekonomizimin e ndërmarrjes.	Njohja e nxënësve me funksionimin sa më ekonomik të fermës bujqësore.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. *Banjska, G. Lavërtaria e përgjithshme*, për shkollat e mesme bujqësore. Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës (ETMMK) – Prishtinë;
2. *Derkaçev, E. Balog, N. Pedologjia*, për shkollat e mesme bujqësore. ETMMK-Prishtinë, 1989;
3. *Efendiu, T. Zajmi, A. Pemëtarja e përgjithshme*, për shkollat e mesme bujqësore. ETMMK-Prishtinë, 1997;
4. *Susuri, L. Pireva, I. Mbrojtja e bimëve*, për shkollat e mesme bujqësore. *Libri Shkollor*-Prishtinë, 1998;
5. *Meçe, M. Drejtimi i fermave*. Botim i AFADA-s, Tiranë 1997
6. **Blegtorja** (pjesa e veçantë), për kl. IV dega e bujqësisë, ETMMK, Prishtinë;
7. *Kloppnann, Ch. Mekanika bujqësore*, Tiranë, 1998;
8. Kovaçi, E. etj. **Plehrat, pesticidet dhe mjedisi**, Tiranë, 1999.

BAZAT JURIDIKE-ADMINISTRATIVE

(Gjithsej 35 orë në vit)

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Nga kjo lëndë nxënësit duhet të përfitojnë pasqyrën reale për drejtimit (degët) e caktuara shoqërore dhe bujqësore dhe në këtë aspekt lënda duhet të tentojë që të nxënësi të kultivojë dhe të zhvillojë shkathtësitë e caktura, duke filluar nga një nivel i përgjithshëm e duke përfunduar me një nivel operacionesh.

Objektivat e veçanta të nxënësit	Përmbajtja programore	Udhëzimet metodologjike	Rezultatet e pritura
TEMA 1: Hyrje në bazat juridike 3 orë			
- Njohja me lëmin juridik në kuadër të lëmenjve shoqëror.	- Përkufizimi i lëndës; - Marrëdhëniet e saj me degët dhe disiplinat tjera; - Ndikimi i informatikës dhe i statistikës etj.	Sqarimi praktik dhe të theksohet roli i sajë në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në shoqëri	Nxënësit duhet të kenë të qartë që në fillim se me çka merret kjo degë e së drejtës dhe çfarë rëndësie ka në zhvillimin, rregullimin dhe krijimin e sigurisë juridike.
TEMA 2: E drejta kushtetuese 6 orë			
- Njohja e nxënësve me kushtetutën si bazë e sistemit juridik, identifikimi i të drejtave dhe lirive qytetare ndaj shtetit, kushtetushmëria dhe ligjshmëria etj.	- Parimet e së drejtës kushtetuese; - Parimi i barazisë qytetare; - Parimi i kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë; - Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të shtetasve; - Të drejtat politike dhe sociale; - Liritë ekonomike dhe të drejtat; - Përmbajtja e kornizës kushtetuese; - rëndësia e së drejtës kushtetuese.	Sqarimi sa më praktik me shembuj konkret edhe rolin e kushtetutës në rregullimin shoqëror si akti më i lartë juridik.	Nxënësit duhet të kuptojnë të drejtat dhe liritë si të vetat edhe të të gjithë qytetarëve që të drejtat e veta të dinë t'i mbrojnë, por të respektojnë edhe të drejtat e të tjerëve, në veçanti të minoriteteve.

TEMA 3: E drejta administrative 3 orë			
Njohja me të drejtën administrative (kuptimi, objekti dhe përmbajtja).	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i administratës; - Akti administrativ; - Marrëveshja juridiko-administrative; - Rëndësia e së drejtës administrative (procedura dhe kontesti administrativ); - Organet administrative në Kosovë; - Obligimet dhe përgjegjësia. 	<ul style="list-style-type: none"> -Të demonstrohen disa shembuj të vendimeve administrative dhe të sqarohen me komentim të lehtë (p.sh. mospaguarja e tatimit të obliguar nga qytetari dhe vendimi i organit administrativ të formës së prerë; -Mundesisht të vizitohen institucionet dhe te konkretizohen veprimet administrative. 	Nxënësit duhet të dinë se cilat janë të drejtat dhe detyrimet e tyre si qytetarë dhe të cilat duhet t'i dallojnë dhe respektojnë p.sh. nxjerrja e lejes së njohtimit, pasaportës, paraqitje e vendbanimit etj.
TEMA 4: E drejta civile 6 orë			
Njohja me kuptimin (nacionin) e së drejtës civile (pronësore)	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i pronës dhe i pasurisë; - E drejta objektive dhe subjektive; - Të drejtat absolute dhe relative; - Servitudi – pengu; - Regjistrimi publik dhe mbrotja; - Të drejtat personale; - Të drejtat detyrimore; - Qarkullimi juridik i këtyre të drejtave etj. 	Të demonstrohen disa shembuj të kontratës së shitblerjes, dhe të shoqërohen me komentim të qartë relacionet.	Nxënësit duhet të jetë i familjarizuar me mënyrën e fitimit të pronës. Si duhet atë ta mbrojmë. Ta dallojë pronën nga pasuria, hipotekën nga servitudi etj.
TEMA 5: E drejta familjare 3 orë			
Kuptimi dhe përmbajtja e së drejtës familjare	<ul style="list-style-type: none"> - E drejta martesore; - Pronësia e bashkëshortëve; - E drejta prindore; - Fëmijët martesor dhe jomartesorë; - Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve; - Adoptimi; - Kujdestaria, ushqimi. 	Të vizitohet ofiçaria civile.	Nxënësit duhet t'i kuptojnë këto relacione të jetës reale – prej atyre martesore, prindore, barazisë së fëmijëve, adoptimit, kujdestarisë si dhe dhënies së ushqimit.

TEMA 6: E drejta penale 3 orë			
Kuptimi, objekti dhe ndarja e së drejtës penale.	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi, thelbi i veprës penale; - Rrezikshmëria e veprës penale; - Mbrojtja ekstreme; - Vetëdijësia, faji; - Dënimi, masat e sigurisë; - Sanksionet penale për të miturit; - shuarja e dënimit – rehabilitimi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të vizitohet ndonjë ent për riedukimin e të rinjve; - Të vizitohet gjykata penale, ku shihet haptas bërësi i veprës penale. -Të shikohet ndonjë film dokumentar ose artistik me këtë tematikë dhe të diskutohet pastaj me nxënësit për ngjarjen . 	Nxënësit duhet të vetëdijësohen dhe të kuptojnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe peshën e izolimit të bërësve të veprave penale që të kenë kujdes që të mos ndeshin në kundërshtim me ligjin.
TEMA 7: E drejta ndërkombëtare publike, afariste, private 6 orë			
<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i së drejtës ndërkombëtare publike ; - Kuptimi dhe përmbajtja e së drejtës ndërkombëtare afariste; - Kuptimi dhe rregullat mbi kompetencat ndërkombëtare. 	<ul style="list-style-type: none"> - Subjektet e së drejtës ndërkombëtare publike; - Sanksionet në të drejtën ndërkombëtare publike; - E drejta ndërkombëtare e luftës. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrohen disa shembuj sanksionesh të së drejtës ndërkombëtare publike; - Të sqarohet e drejta ndërkombëtare e luftës ; -Të mundësohet që nxënësit të kuptojnë parimet jo vetëm të së drejtës nacionale, por edhe të asaj ndërkombëtare publike në këtë periudhë të politikës së globalizimit dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar. E tërë kjo të jetë vetëm në mënyrë informative. 	Nxënësi duhet të tregojë kureshtje për lëmin në fjalë dhe të merr pjesë në diskutime të lira për temat që shtjellohen.
Tema 8: Vizitë institucioneve 5 orë			
Nxënësit duhet të informohen praktikisht me temat e shtjelluara	- Vizitë institucioneve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të vizitojnë institucione të ndryshme, të shoqëruar nga mësime të nxënësit; - Gjatë këtyre vizitave ata duhet të jenë të lire të bëjnë pyetje dhe diskutime rreth çështjeve që shtjellohen. 	Nxënësit duhet të jenë të informuar për mundësitë që i ofron drejtimi juridik, nëse ata përcaktohen që këte ta kenë profesion të tyre të ardhshëm. Ata po ashtu duhet të dinë se cilat shkolla të mesme janë të orientuara në këtë drejtim.

*Bazat
e tehnikcēs*

BAZAT E TEKNIKËS

(3 orë në javë, 105 orë në vit)

HYRJE

Në kuadër të kësaj lëmie jepen informacionet e nevojshme për orientim profesional për katër fusha (degë) të lëmit të teknikës (secili me nga 26 orë në vit): elektroteknikë, ndërtimtari, makineri dhe industri.

Është mirë që këto fusha të mësohen në formë cikli: në disa paralele të klasës së nëntë të një shkolle do të fillohej me mësimin e elektroteknikës, ndërsa në disa të tjera me mësimin e ndërtimtarisë, dhe kështu me radhë, kështu që mësimdhënësit (do të ishte mirë të jenë inxhinierë të fushës përkatëse) do të ishin të angazhuar gjatë tërë vitit, e edhe mësimi do të ishte më i efektshëm.

Qëllimi i të mësuarit të lëndëve teknike është që, përmes zhvillimit të njëjësive mësimore përkatëse, nxënësit të njohohen me konceptet themelore të fushave kryesore të lëmit të teknikës, si dhe me ndikimin që kanë këto fusha në: prodhimtari, shoqëri, mjedisin që na rrethon dhe në kushtet tona jetësore.

Lëmi teknik është paraparë t'u mësojë nxënësve njohuritë dhe shkathtësitë që nevojiten në ekonominë bashkëkohore dhe t'i udhëzojë lidhur me përzgjedhjen e profesionit të tyre të ardhshëm.

Kjo lëndë nxënësve do t'u mundësonte, që së bashku me prindërit, e nën udhëzimin e mësimdhënësit, të zgjedhin profesionin e tyre të ardhshëm. Nuk duhet harruar se imazhi i mirë për një profesion përftohet përmes programeve të mira që i knaqin kërkesat e nxënësve, punëdhënësve dhe të komunitetit, e me to, do të duhej sa më saktë dhe sa më gjerësisht të njihen nxënësit.

Udhëzime metodologjike

Mësimdhënësit duhet t'i qasen mësimdhënies nga aspekti pedagogjik i shtruarjes së problemeve teknike, me qëllim që njohuritë e fituara nxënësit të mund t'i përdorin në rrafshin praktik. Këto njohuri nuk duhet të jenë të ndërlikuara, por të jenë sa më të kuptueshme dhe të lidhura me praktikën: "Nuk ka asgjë më praktike se një teori e mirë dhe nuk ka asgjë më teorike se një praktikë e mirë" (Kurt Lewin).

Kompjuterët janë vegla me rëndësi në procesin e mësimin. Ata mund të përdoren për rritjen e cilësisë së nxënies: përmes leksioneve të veçanta

kompjuterike, duke përdorur lloj-lloj paketash softuerike dhe CD-ROM-a interaktive, e veçanërisht duke shfrytëzuar mundësitë e Internet-it.

CD-ROM-i rëndom është një burim i dobishëm i informacioneve, meqenëse ka kapacitet të madh të bartjes së teksteve dhe të imazheve (fotografive) të printuara (shtypura) e po ashtu edhe të zërit dhe të videoprogrameve.

Me anë të kompjuterëve mund të përdoret metoda e mësimit që ka për qendër jo lëndën, por nxënësin. Për shembull, nxënësit mund të punojnë në grupe, pavarësisht, në projekte të caktuara; në këtë rast roli i mësimit është t'u ndihmojë dhe t'i udhëzojë nxënësit.

Është mirë që numri i kompjuterëve në klasë të jetë i barabartë me numrin e nxënësve, por nëse është vështirë të sigurohet kjo, atëherë një kompjuter mund ta përdorin edhe dy nxënës.

Për nxënësit e talentuar duhet të organizohen orë mësimi shtesë dhe aktivitete të lira, që të stimulohen dhe maksimalisht të zhvillohen aftësitë e tyre në pajtim me interesimet e tyre.

Aspektet ndërdisiplinare

Mësimdhënësit duhet të kenë për objektiv dhënien e diturive nga lëmi i teknikës, pa përsëritje të njohurive që jepen në lëmenj të tjerë, si bie fjala në TIK, fizikë, kimi etj., e nga ana tjetër, të theksojnë lidhshmërinë e lëmit (degës) përkatës me lëmin (degën) e caktuar. Kështu, bie fjala, kur flitet për prodhimin e energjisë elektrike, duhen shfrytëzuar njohuritë edhe nga degët e ndryshme të lëmit teknik që kanë të bëjnë me këtë materie (xehetaria, makineria, elektroteknika, mbrojtja e mjedisit etj.), që nxënësi të mund të ketë një pasqyrë të plotë lidhur me prodhimtarinë e energjisë elektrike. Globalizimi që ka përfshirë tërë shoqëritë e botës, kërkon qytetarë që mund të punojnë në kushtet e shumëllojshmërisë, si në vend, ashtu dhe jashtë vendit, andaj edhe ky aspekt duhet pasur parasysh gjatë zhvillimit të mësimit nga kjo lëndë.

Objektivat e përgjithshme dhe të veçanta të nxënies

Nga kjo lëndë nxënësi duhet të përfitojë një parafytyrim real për drejtimet (degët) e caktuara teknike dhe, në këtë aspekt, lënda duhet të tentojë që të nxënësi të kultivojë dhe zhvillojë shkathtësitë e caktuara teknike, duke filluar nga një nivel i përgjithshëm e duke përfunduar me një nivel operacional.

Mësimdhënësi duhet të përpiqet që të secili nxënës:

- Të zhvillojë ndjenjën (sënsin) e kureshtjes dhe të dëshirës për nxënie;
- Të zhvillojë mënyrën vetjake të të nxënës;
- Të përforcojë shprehinë e formulimit në mënyrë të pavarur të pikë-pamjeve, mbështetur jo vetëm në dituri, por edhe në arsyen e shëndoshë dhe në sënsin teknik.

Nxënësi duhet:

- Të marrë njohuri dhe përvojë të mjaftueshme të jetë në gjendje të bëjë përzgjedhje të menduara mirë gjatë arsimimit të mëtejshëm dhe gjatë orientimit profesional, dhe
- Të mësojë ta përdorë diturinë si mjet, me qëllim;
- Të formulojë dhe provojë supozimet, si dhe të zgjidhë problemet;
- Në mënyrë kritike të shqyrtojë dhe të vlerësojë konstatimet dhe raportet.

Objektivat e veçantë të nxënies jepen në fund, pas paragrafit IX, si **Shtojcë** në formë tabelare, për secilën fushë të kësaj lënde.

Zotësitë dhe shkathtësitë kryesore

Përmes kësaj lënde mësimdhënësi të synojë që të nxënësi të kultivojë dhe të zhvillojë shkathtësitë e veçanta e të rëndësishme për profesionin e tyre, siç janë, p.sh., aftësia e ballafaqimit me probleme të thjeshta të natyrës teknike, zhvillimi i sensit për të përdorur pajisjet dhe veglat e ndryshme teknike, zhvillimi i shkathtësisë për të paraqitur në mënyrë grafike proceset (e thjeshta) e ndryshme teknologjike etj.

Planifikimi i përmbajtjes (programi mësimor)

Përzgjedhja e përmbajtjes së kësaj lënde mbështetet në filozofinë e përfitimeve themelore teknike për degë të caktuara të kësaj lënde.

Përmbajtja e lëndës, sipas fushave të caktuara, jepet në fund, si **Shtojcë**, pas paragrafit IX.

Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies së kësaj lënde mbështetet në shtjellimin sa më konkret, nga aspekti pedagogjik, të problematikës së caktuar, duke i mbajtur të gjithë nxënësit në aktivitetet të përhershëm, përmes temave interesante dhe aktuale për lëmin përkatës dhe përmes paraqitjes sa më ilustrative dhe interaktive.

Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë metodën demonstrative, në mënyrë që nxënësi të ketë një parafytyrim sa më të qartë të elementeve, pajisjeve dhe sistemeve për të cilat bëhet fjalë.

Puna praktike, aq sa lejojnë kushtet e shkollës, të jetë e pranishme në masë të caktuar në procesin e mësimin. Përmes saj, nxënësi duhet të përftojë shkathtësitë e nevojshme themelore për ushtrimin e një profesioni.

Duhet paraparë vizita profesionale në ndërmarrje, uzina dhe fabrika të ndryshme, në mënyrë që nxënësit të shohin për së afërmi organizimin e punës në to dhe të njihen konkretisht me pajisjet dhe stabilimentet, parimin e

punës të së cilave e kanë mësuar në klasë, si dhe me proceset e ndryshme teknologjike që zhvillohen aty.

Varet nga kushtet konkrete si do t'i organizojë shkolla këto vizita, por preferohet që në një ditë të caktuar të vizitohen disa ndërmarrje, për shkak të shfrytëzimi më racional të kohës.

– Udhëzimet metodologjike konkrete për njësitë mësimore të caktuara, për secilën fushë të kësaj lënde, jepen në fund, si **Shtojcë**, pas paragrafit IX.

Standardet për çmuarje dhe për vlerësim

Për këtë lëndë, çmuarja dhe vlerësimi i nxënësit duhet të jetë me notë dhe në formë përshkruese. Ky është element i rëndësishëm për nxënësit dhe për prindërit, që së bashku të mund ta përzgjedhin profesionin e ardhshëm të nxënësit. Po ashtu edhe për mësimdhënësit në shkollët më të larta të shkollimit (në formë rekomandimi), në mënyrë që ata më lehtë të mund të çmojnë dhe të vlerësojnë afinitetet e nxënësëve të tyre të ardhshëm.

Shembull: Nxënësi tregon interesim të posaçëm dhe ka shkathtësi për t'u marrë me mirëmbajtjen e pajisjeve të videoteknikës.

Orientimet për punë të pavarur të nxënësve

Njohuritë e marra nga lëndët përkatëse dhe puna praktike do të jenë bazë për orientimin e nxënësve për punë të pavarur, me qëllim të pavarësimin të tyre. Për shembull, pas vizitës profesionale në një objekt të caktuar industrial, nxënësi duhet të japë një përshkrim të funksionimit të pajisjeve të caktuara, ose të zhvillimit të një procesi të caktuar teknologjik.

ELEKTROTEKNIKË

(Gjithsej 26 orë në vit)

OBJEKTIVAT E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET E PRITSHME
Tema 1: Hyrje në elektroteknikë (1 orë)			
– Njohja me fushën e elektroteknikës në kuadër të lëndës “Lëmi teknik”.	– Përkufizimi i elektroteknikës dhe i degëve të saj. – Lidhjet e kësaj fushe të dijes me zhvillimin e shkencës në fusha të tilla, si: fizika, matematika, kimia, informatika etj.	– Përmes rikujtimit të materies të mësuar në klasët e mëparshme të përkufizohet lënda e elektroteknikës dhe të theksohet roli i saj në ekonomi dhe në jetën e përditshme.	– Nxënësi duhet ta ketë të qartë që në fillim se me çka merret kjo degë e teknikës dhe cili është roli i saj në zhvillimin e teknikës në përgjithësi.
Tema 2: Elementet e qarqeve elektrike dhe elektronike (2 orë)			
– Njohja e nxënësve me elementet e qarqeve elektrike dhe elektronike, në mënyrë që të mund t'i identifikojnë ato në pajisjet e ndryshme elektrike dhe elektronike dhe në skemat e tyre elektrike.	– Rezistorët, kondensatorët, induktorët (bobinat); – Diodat, transistorët, tiristorët; – Pilat (bateritë).	– Paraqitja e veçorive kryesore të elementeve të qarqeve elektrike dhe elektronike përmes ilustrimit me elemente dhe shembuj konkretë; – Demonstrimi i rezistorëve dhe kondensatorëve dhe shpjegimi i kodit të ngjyrave që përcakton vlerat e tyre; – Përcaktimi i anodës dhe i katodës të diodës, dhe i emiterit, kolektorit dhe bazës të transistorit; dallimi ndërmjet transistorit dhe tiristorit.	– Nxënësi duhet të dijë t'i identifikojë, në skema dhe në pajisje të ndryshme elektrike dhe elektronike, elementet kryesore të qarqeve elektrike dhe elektronike, dhe t'i dijë veçoritë e tyre kryesore.
Tema 3: Sistemet e prodhimit të energjisë elektrike (2 orë)			
– Njohja me parimin e punës së termocentraleve dhe hidrocentraleve;	– Centralet elektrike; – Gjeneratorët e rrymës elektrike: të vazhduar dhe alternativë	– Me fotografi, transparenca apo videoprogrami të paraqitet puna e një centrali elektrik;	– Nxënësi duhet të dijë si prodhohet energjia elektrike nga

<p>– Njohja me parimin e punës së gjeneratorëve të rrymës elektrike.</p>	<p>(njëfazorë dhe trefazorë).</p>	<p>– Të tregohet ndërtimi i një gjeneratori të rrymës elektrike.</p>	<p>termocentralet dhe hidrocentralet. – Nxënësi duhet të dijë parimin e punës së gjeneratorëve elektrikë.</p>
<p>Tema 4: Sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike (2 orë)</p>			
<p>– Njohja e nxënësve me parimin e ndryshimit të tensionit ose të rrymës alternative në qarqet dhe sistemet elektrike. Sqarimi përse transmetimi i energjisë elektrike në largësi bëhet me tension të rritur.</p>	<p>– Transformatorët; – Nënstationet, kabinat elektrike; – Sistemet ajrore dhe kablllore të transmetimit të energjisë elektrike; – Rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike.</p>	<p>– Përmes skemave dhe relacioneve themelore të shpjegohet parimi i punës së transformatorit; – Të vizitohet ndonjë nënstation elektrik që nxënësit të shohin për së afërmi si duket ai.</p>	<p>– Nxënësi duhet të dijë parimin e punës së transformatorit; – Nxënësi duhet të dijë si është i organizuar rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë.</p>
<p>Tema 5: Përdorimi i energjisë elektrike (2 orë):</p>			
<p>– Njohja e nxënësve me shndërrimin e energjisë elektrike në lloje të tjera të energjisë: mekanike, termike, optike etj.</p>	<p>– Fushat e përdorimit të energjisë elektrike dhe llojet e përdoruesve; – Përfitim i energjisë mekanike nga makinat elektrike: motorët elektrikë; – Shfrytëzimi i energjisë elektrike në industri: furrat elektrike dhe furrat mikrovalore.</p>	<p>– Me fotografi dhe pano të shpjegohet ndërtimi dhe parimi i punës së motorëve elektrikë: të rrymës alternative dhe të rrymës së vazhduar. – T'u demonstron nxënësve edhe në praktikë puna e një motori elektrik.</p>	<p>– Nxënësi duhet të dijë të bëjë klasifikimin e përdoruesve elektrikë dhe të instalimeve elektrike; – Nxënësi duhet të dijë parimin e punës së motorëve elektrikë.</p>
<p>Tema 6: Pajisjet elektroshtëpiake (2 orë)</p>			
<p>– Njohja e nxënësve me pajisjet elektrike që përdoren në shtëpi dhe me parimin e punës së tyre.</p>	<p>– Hekuri – ujtia, furnela elektrike, boileri, kaloriferi; – Frigoriferi dhe kondicioneri; – Pajisjet larëse, pastruese dhe të gatimit: rrobalarësja, enëlarësja, fshesa elektrike, makina grirëse etj.</p>	<p>– Me fotografi dhe pano të shpjegohet ndërtimi dhe parimi i punës së pajisjeve elektroshtëpiake; – Mundësisht t'u demonstron nxënësve edhe në praktikë puna e ndonjë pajisjeje elektroshtëpiake.</p>	<p>– Nxënësit duhet të dinë parimin e punës së pajisjeve elektroshtëpiake.</p>

Tema 7: Instalimet elektrike në banesa dhe mbrojtja nga rryma elektrike (3 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> - Njohja e nxënësve me materialet dhe elementet (pajisjet) kryesore që përdoren për instalimet elektrike në banesa dhe me rreziqet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtja nga rryma elektrike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Materialet dhe elementet elektro-instaluese: përcjellësit, prizat, spinat, çelësat, siguresat, reletë mbrojtëse, matësit e energjisë elektrike etj.; - Ndrichiimi i banesës dhe normat e ndrichiimit; llambat; - Skema e instalimeve elektrike të një banese dhe rregullat për instalime - Mbrojtja nga rryma elektrike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Me skema elektrike të shpjegohet realizimi i instalimit elektrik në një banesë dhe të jepen rregullat kryesore për instalime të thjeshta në banesa. - Të përshkruhen veçoritë kryesore të materialeve dhe të pajisjeve elektro-instaluese dhe të shpjegohet mënyra e mbrojtjes nga rryma elektrike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet t'i dijë rregullat e përgjithshme për instalimet në banesa dhe t'i njohë elementet kryesore elektroinstaluese; - Ai duhet të vetëdijësohet për rreziqet nga rryma elektrike dhe të jetë në gjendje të japë ndihmën e parë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.
Tema 8: Mjetet e punës të elektricistit dhe të elektronistit (2 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> - Njohja me veglat e punës së elektricistit dhe të elektronistit dhe me avometrin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Veglat e punës së elektricistit dhe të elektronistit; avometri; Puna praktike: - Instalimi i një llambe ndrichiimi që komandohet nga një çelës dhe i një llambe ndrichiimi që komandohet nga dy pozicione.; - Realizmi i një qarku të thjeshtë elektronik; - Përdorimi i avometrit si: ampermetër, voltmetër dhe ommetër. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmes realizimit praktik të një skeme të thjeshtë elektrike ose elektronike të njihen nxënësit me veglat kryesore të punës dhe me punën e elektricistit dhe të elektronistit dhe me instrumentin universal për matjen e madhësive elektrike – avometrin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi të jetë në gjendje të realizojë praktikisht një instalim të thjeshtë: një llambë ndrichiimi që komandohet nga një çelës; - Nxënësi të jetë në gjendje të realizojë praktikisht një qark të thjeshtë elektronik me transistor. - Nxënësi të dijë të përdorë avometrin për matjen e tensionit, rrymës dhe rezistencës.
Tema 9: Sistemet elektronike të komunikimit (2 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> - Njohja me parimet e punës të sistemeve elektronike të 	<ul style="list-style-type: none"> - Sinjalet analoge dhe digjitale; - Sistemeve të komunikimit: 	<ul style="list-style-type: none"> - Me anë të skemave-blok të shpjegohen parimet e punës të 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të dijë parimet e punës së

komunikimit.	dhënësi, kanali i transmetimit, marrësi; – Modulimi/demodulimi, kodimi, multipleksimi/demultipleksimi.	sistemeve elektronike të komunikimit dhe të procesit të modulimit/demodulimit dhe multipleksimit/demultipleksimit.	sistemeve elektronike të komunikimit dhe parimet themelore të procesit të modulimit/demodulimit dhe multipleksimit/demultipleksim.
Tema 10: Sistemet e telekomunikacionit (3 orë)			
– Njohja me parimet e punës së sistemeve të telefonisë fikse, celulare dhe satelitore.	– Sistemet e telefonisë fikse: hyrje; parimi i punës së telefonit; faksi; – Centralët telefonike: centrali automatik, centrali digjital komutues elektronik; – Rrjetet e telekomunikacionit me fije optike; – Sistemet e telefonisë së lëvizshme: telefonia celulare dhe satelitore;	– Përmes skemave-blok të thjeshta të shpjegohet parimi i punës së centraleve telefonike; – Të demonstrohet puna e telefonit fiks dhe celular; – Të organizohet një vizitë profesionale në një qendër telekomunikimi.	– Nxënësi t'i dijë parimet e punës së sistemeve të telefonisë fikse, celulare dhe satelitore; – Nxënësi të dijë si punon telefoni dhe faksi.
Tema 11: Sistemet e komunikimit radiofonik dhe televiziv (2 orë)			
– Njohja me sistemet e komunikimit radiofonik dhe televiziv.	– Sistemet e marrjes së zërit: mikrofoni, altoparlanti; radiomarrësi; – Sistemet e transmetimit dhe marrjes së figurës: kamera, televizori; – Televizioni satelitor.	– Përmes skemave-blok të thjeshta dhe figurave ilustrative të shpjegohen parimet e punës së sistemeve të komunikimit radiofonik dhe televiziv.	– Nxënësi të dijë parimet e punës së sistemeve të komunikimit radiofonik dhe televiziv; – Nxënksi të dijë parimin e punës së mikrofonit dhe të altoparantit.
Tema 12: Sistemet e regjistrimit dhe riprodhimit të zërit dhe të figurës (2 orë)			
– Njohja me parimet e punës së sistemeve të regjistrimit dhe riprodhimit të zërit dhe të figurës.	– Sistemet e regjistrimit dhe riprodhimit të zërit: gramafoni, magnetofoni, stereofonia, kompaktdisku; – Sistemet e regjistrimit dhe riprodhimit të figurës: magnetoskopi; <i>Puna praktike:</i> – Prodhiimi i ndonjë programi që mund të emetohet në radion apo televizionin e shkollës.	– Përmes skemave-blok të thjeshta dhe figurave ilustrative të shpjegohen parimet e punës së sistemeve të regjistrimit të zërit dhe të figurës. – Të organizohet një vizitë profesionale në një qendër radiodifuzive.	– Nxënësi të dijë parimet e punës së sistemeve të regjistrimit dhe riprodhimit të zërit dhe të figurës.

Tëma 13: Sistemet e kontrollit automatik (2 orë)			
Njohja me parimet themelore dhe me elementet kryesore të sistemeve të rregullimit automatik.	<ul style="list-style-type: none"> – Parimet themelore të rregullimit automatik; – Sensorët e zhvendosjes: sensorët e forcës, të temperaturës, të nivelit, të shtypjes dhe rrjedhës së fluideve; – Sensorët optoelektronikë. 	<ul style="list-style-type: none"> – Me anë të skemës-blok të paraqitet parimi i punës i një sistemi të kontrollit automatik; – Të shpjgohet parimi i punës i sensorëve kryesorë (të forcës, të temperaturës, të nivelit etj.). 	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi të dijë parimin e punës së një sistemi të kontrollit automatik; – Nxënësi të dijë parimin e punës së sensorëve kryesorë: të forcës, të temperaturës, të nivelit etj.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

P. Cippo, J. Agalliu, F. Basha, I. Xhamaj, Teknologjia 4, ShBLSH, Tiranë, 2001;

Literatura plotësuese (për mësimdhënësin):

H. Huebscher, J. Klane, E. Pflueger, S. Appelt, Osnovi elektrotehnike (përkth. nga gjermanishtja), T.K., Zagreb, 1981;

Për ilustrimin e elementeve dhe dukurive elektrike dhe për shembuj të ndryshëm të llogaritjeve të thjeshta.

D. Nuehrman, Kucni magnetoskopi na lak nacin, (përkth. nga gjermanishtja), T.K., Zagreb, 1983;

Për shpjgime shtesë lidhur me: magnetofonët, altoparantët dhe magnetoskopët.

N. Caka, Optoelektronika, UP, Prishtinë, 1996;

Për shpjgime shtesë lidhur me: kompakt-disqet, diodat laser, LED-at, fijet optike; sensorët optoelektronikë; modulimin, demodulimin.

A. Shehu, Telekomunikacionet, Tiranë, 1995;

Për shpjgime shtesë lidhur me bazat dhe sistemet e telekomunikacionit.

I. Limani, Elementet e automatikës, (dispensë), FET, Prishtinë, 1997;

Për shpjgimin e parimeve themelore të sistemeve të kontrollit automatik dhe për shpjgimin e sensorëve kryesorë.

– **Vërejtje:** Inkurajohet përdorimi i literaturës në gjuhë të huaja dhe i materialeve nga Interneti, si dhe i programeve edukative në formë elektronike.

MAKINERI

(Gjithsej 26 orë në vit)

OBJEKTIVAT E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET E PRITURA
Tema 1: Materialet inxhinierike (4 orë)			
– Njohja e nxënësve me materialet inxhinierike që përdoren në makineri.	– Materialet inxhinierike (çeliku, polimerët etj.): rëndësia, ndarja themelore dhe përdorimi i tyre.	– Mësimdhënia duhet mbështetur në të dhënat e mjaftueshme për llojet e materialit dhe të bëhet konkretizimi me materiale ilustruese.	– Nxënësi duhet të dijë cilat janë materialet kryesore inxhinierike që përdoren në makineri.
Tema 2: Përpunimi me prerje (4 orë)			
– Njohja e nxënësve me bazat e përgjithshme të përpunimit me prerje; – Njohja e nxënësve me disa lloje makinash dhe instrumenteve metalprerëse.	– Bazat e përgjithshme të përpunimit me prerje; – Llojet e makinave dhe të instrumenteve metalprerëse: tornoja, makina për retifikim, makina për shpim, makina për frezim etj.	– Me slajde, fotografi, skica dhe videoprograme t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të proceseve të përpunimit me prerje; – Vizitë një punëtorie të përpunimit me prerje.	– Nxënësi të dijë parimin e punës të makinave metalprerëse dhe të instrumenteve prerëse.
Tema 3: Përpunimi termik (4 orë)			
– Njohja e nxënësve me llojet e përpunimit termik të materialeve makinerike.	– Llojet e përpunimit termik: kalitja, pjekja, riardhja.	– Me slajde, fotografi, skica dhe videoprograme t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të proceseve të përpunimit termik; – Vizitë një punëtorie të përpunimit termik. –	– Nxënësi të dijë parimin e punës së pajisjeve për përpunim termik.

Tema 4: Makinat hidraulike (4 orë):			
– Njohja e nxënësve me parimet themelore dhe përdorimin e makinave hidraulike.	– Makinat hidraulike: pompat, turbinat me ujë etj.	– Me ilustrime t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të makinave hidraulike; – Vizitë një reparti me makina hidraulike.	– Nxënësi të dijë parimin e punës të makinave hidraulike.
Tema 5: Saldimi (3 orë)			
– Njohja e nxënësve me proceset e saldimit të metaleve dhe të masave plastike	– Parimet e procesit të saldimit: saldimi me hark elektrik; saldimi me elektrorezistencë.	– Me slajde, fotografi, skica dhe videoprograme t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të proceseve të saldimit; – Vizitë një punëtorie të saldimit.	– Nxënësi të dijë parimet e proceseve të saldimit dhe rëndësinë e tij në industri.
Tema 6: Makinat termike (3 orë)			
– Njohja e nxënësve me parimet themelore dhe përdorimin e makinave termike.	– Parimi i punës dhe përdorimi i makinave termike: kaldajat, turbinat; – Skemat themelore të termoelektrocentraleve.	– Me ilustrime t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të makinave termike; – Vizitë një reparti me makina termike.	– Nxënësi të dijë parimin e punës të makinave termike.
Tema 7: Ngrohja, ventilimi dhe klimatizimi (4 orë)			
– Njohja e nxënësve me parimet themelore të punës së pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim.	– Pajisjet për ngrohje; – Pajisjet për ventilim; – Pajisjet për klimatizim.	– Me ilustrime t'u shpjegohen nxënësve parimet themelore të pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim; – Vizitë një reparti me pajisje të ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit.	– Nxënësi të dijë parimin e punës të pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- F. Krasniqi, Xh. Fejzullahu, Hidraulika dhe termodinamika*, tekst për shkolla të mesme, ETMM, Prishtinë, 1989;
- Për shpjegimin e makinave hidraulike dhe të makinave termike.
- F. Krasniqi, Ngrohja dhe klimatizimi I*, UP, Prishtinë, 2000;
- Për shpjegimin e pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim.
- F. Krasniqi, Ngrohja dhe klimatizimi II*, UP, Prishtinë, 2001;
- Për shpjegimin e pajisjeve për ngrohje, ventilim dhe klimatizim.
- B. Bytyçi, H. Osmani, N. Qehaja, Materialet e makinerisë, Libri shkollor*, Prishtinë, 1999;
- Për shpjegimin e materialeve inxhinierike dhe përpunimin termik.
- Z. Krasniqi, Përpunimi me prerje I*, UP, Prishtinë, 1987. – Për shpjegimin e përpunimit me prerje.
- B. Bytyçi, Rr. Maksuti, H. Osmani, Doracak për mësim praktik me teknologji për saldatorë*, Prishtinë, 1990. – Për shpjegimin e saldimit.

INDUSTRI

(Gjithsej 26 orë në vit)

OBJEKTIVAT E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET E PRITURA
Tema 1: Njohuri të përgjithshme mbi artin minerar (1 orë)			
– Njohja e nxënësit me rezervat e mineraleve të dobishme dhe shtrirjen e tyre.	– Ndarja dhe klasifikimi i vendburimeve (VB) sipas: numrit të mineraleve, substancës minerare, paraqitjes së mineraleve dhe formës së VB.	– Mësimdhënia duhet mbështetur në paraqitjen konkrete të vendburimeve të mineraleve.	– Nxënësi të këtë parafytyrim për vendburimet dhe artin minerar.
Tema 2: Hapja dhe përgatitja e vendburimeve të mineraleve të dobishme (2 orë)			
– Njohja e nxënësit me mënyrat kryesore për përgatitjen e vendburimeve për fazën e shfrytëzimit.	– Fushat minerare, ndarja e tyre, dhe mënyrat e hapjes dhe përgatitjes së objekteve minerare: horizontale, të pjerrëta dhe vertikale.	– Konkretizimi i materies përmes skicave, fotografive dhe skemave; – Vizitë vendburimeve më karakteristike të mineraleve.	– Nxënësi të njihet më përgatitjet e nevojshme për fillimin e shfrytëzimit të vendburimit.
Tema 3: Ndërtimi i punimeve minerare (2 orë)			
– Njohja e nxënësit me mënyrat e ndërtimit të punimeve minerare dhe mbrojtjen e tyre.	– Ndërtimi i punimeve minerare, operacionet që zhvillohen duke filluar nga rrëzimi i shkëmbit, ngarkimi, transporti dhe mënyrat e mbrojtjes nga shembjet eventuale.	– Nxënësit duhet dhënë një pasqyrë të plotë të këtyre operacioneve në një mënyrë sa më të thjeshtë.	– Marrja e njohurive të bollshme rreth ndërtimit të punimeve minerare.

Tema 4: Shfrytëzimi nëntokësor i mineraleve të dobishme (2 orë)			
– Njohja e nxënësve me shfrytëzimin nëntokësor të mineraleve të dobishme.	– Shfrytëzimi nëntokësor; – Llojet e sistemeve dhe proceseve që zbatohen në minierat tona; – Mbrojtja e hapësirës punuese nga shembjet e mundshme.	– Mësimëdhenësi duhet që këto parime t'i konkretizojë me fotoqrafi, skica etj; – Vizitë vendburimeve nëntokësore të mineraleve të dobishme.	– Nxënësi të ketë një pasqyrë të plotë për vendburimet nëntokësore.
Tema 5: Shfrytëzimi sipërfaqësor i mineraleve të dobishme (3 orë)			
– Njohja e nxënësve me shfrytëzimin sipërfaqësor të mineraleve të dobishme.	– Elementet e punimeve minerare në kushtet e përdorimit për shfrytëzim në sipërfaqe; – Proceset kryesore të punës për zbulimin dhe nxjerrjen e mineralit të dobishëm.	– Mësimëdhenësi këto parime t'i konkretizojë me fotoqrafi, skica etj.; – Vizitë vendburimeve sipërfaqësore të mineraleve të dobishme.	– Nxënësi të ketë një pasqyrë të plotë për vendburimet sipërfaqësore.
Tema 6: Metalurgjia si degë industriale (1 orë)			
– Njohja e nxënësve me bazat e metalurgjisë.	– Ndarja e metalurgjisë: metalurgjia procesore, metalurgjia përpunuese dhe materialet; – Kapacitetet ekzistuese në Kosovë.	– Në mënyrë sa më konkrete të shpjegohet ndarja e metalurgjisë në degë përkatëse dhe të jepen të dhëna për kapacitetet ekzistuese përkatëse në vendin tonë.	– Nxënësi të ketë njohuri të mjaftueshme për rëndësinë e metalurgjisë si degë industriale dhe perspektivën e saj në vendin tonë.
Tema 7: Metodat kryesore të përtimit të metaleve (2 orë)			
– Njohja e nxënësve me metodat kryesore të përtimit të metaleve nga xehet dhe koncentratet e tyre.	– Metoda pirometalurgjike; – Metoda hidrometalurgjike për përtitimin e metaleve.	– Në mënyrë sa më konkrete dhe të thjeshtuar nga aspekti metodologjik të përshkruhen metodat pirometalurgjike dhe hidrometalurgjike për përtitimin e metaleve.	– Nxënësi të ketë njohuri të mjaftueshme për metodat kryesore metalurgjike për përtitimin e metaleve.

Tema 8: Hekuri dhe çeliku (2 orë)

<p>– Njohja e nxënësve me procesin e përfimit të hekurit dhe çelikut në industri.</p>	<p>– Procesi i përfimit të hekurit nga xehet e hekurit dhe pajisjet përkatëse: furrëlarata, furrat elektrike;</p> <p>– Proceset e përfimit të çelikut nga hekuri i papërpunuar: konvertorët.</p>	<p>– Me figura përkatëse të shpjegohet procesi teknologjik i përfimit të hekurit nga xehet e tij dhe i çelikut nga hekuri.</p>	<p>Nxënësi t'i dijë veçoritë kryesore të hekurit dhe të çelikut dhe të bëjë dallimin ndërmjet tyre.</p>
---	--	--	---

Tema 9: Metalet me ngjyrë (3 orë)

<p>– Njohja e nxënësve me procesin e përfimit të metaleve me ngjyrë.</p>	<p>– Përfimi i plumbit;</p> <p>– Përfimi i zinkut;</p> <p>– Përfimi i ferro-nikelit.</p>	<p>– Me figura dhe skema-blok përkatëse të shpjegohet procesi teknologjik i përfimit të metaleve me ngjyrë (Pb, Zn, FeNi) nga xehet e tyre;</p> <p>– Vizitë objekteve metalurgjike në vend.</p>	<p>– Nxënësi të dijë rëndësinë dhe rolin e metaleve me ngjyrë në ekonominë e vendit;</p> <p>– Nxënësi të dijë proceset e përfimit të metaleve me ngjyrë nga xehet e tyre.</p>
--	--	---	---

Tema 10: Përpunimi i metaleve (2 orë)

<p>– Njohja e nxënësve me proceset dhe pajisjet për përpunimin e metaleve.</p>	<p>– Finalizimi i produkteve nga metali me anë të deformimit plastik (në të ftohtë dhe të nxehtë);</p> <p>– Teknologjitë e procesit të derdhjes në bazë të hekurit dhe të metaleve me ngjyrë.</p>	<p>– Metodologjia e mësimdhënies duhet mbështetur në shtjellimin e përpunimit të metaleve me shembuj konkretë nga programet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;</p> <p>– Vizitë punëtorive metalpërpunuese.</p>	<p>– Nxënësi të njohë metodat për përpunimin e metaleve.</p>
--	---	---	--

Tema 11: Industria kimike (2 orë)			
Njohja e nxënësve me industrinë kimike.	<ul style="list-style-type: none"> – Proceset kimike: veprimet e shndërrimit kimik; – Reaktorët; – Operacionet kimike: veprimet fizike apo fiziko-kimike (klasifikimi, filtrimi, sedimentimi, kristalizimi etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> – Këto njësi mësimore është e domosdoshme të punohen në laboratorë, ku do të demonstroheshin proceset dhe operacionet kimike. 	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi të dijë proceset dhe operacionet kimike kryesore (bazë).
Tema 12: Industria e gomës dhe e plastikës (2 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> – Njohja e nxënësve me industrinë e gomës dhe të plastikës. 	<ul style="list-style-type: none"> – Prodhimet e gomës (për makina luksoze, kamionë, damperë, shirita): – Proceset e përpunimit të gomës; – Operacionet e përpunimit të plastikës: presimi, injektimi, nxehja dhe ftohja. 	<ul style="list-style-type: none"> – Me shembuj konkretë dhe ilustrime përkatëse të shpjegohen proceset e përfutimit të gomës dhe të plastikës; – Vizitë objekteve që merren me prodhimin e gomës dhe plastikës. 	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi të njohë proceset themelote për prodhimin e gomës dhe të plastikës.
Tema 13: Industria e tekstilit dhe e lëkurës (2 orë)			
<ul style="list-style-type: none"> – Njohja e nxënësve me industrinë e tekstilit dhe të lëkurës. 	<ul style="list-style-type: none"> – Lëndët e para dhe proceset për përfutimin e tekstilit (mëndafshi, pambuku, celuloza); Lëndët sintetike në industrinë e tekstilit: polimeret, poliamidi, poliesteri; – Industria e lëkurës 	<ul style="list-style-type: none"> – Me ilustrime përkatëse të njihen nxënësit me prodhimet kryesore të industrisë së tekstilit dhe të lëkurës dhe me proceset e përfutimit të tyre; – Vizitë në ndërmarrjet industriale të industrisë së tekstilit dhe të lëkurës. 	<ul style="list-style-type: none"> – Nxënësi të njohë produktet kryesore të industrisë së tekstilit dhe të lëkurës dhe proceset e prodhimit të tyre.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- H. Sauku, I. Nako*, **Ndërtimi i punimeve minerare**, I, II, III, Tiranë, 1986;
– Për shpjegimin e artit mineralar, hapjet dhe përgatitjen e vendburimeve.
- S. Guxha*, **Shfrytëzimi nëntokësor i burimeve të mineraleve të dobishme**, I, II, III, Tiranë, 1984;
– Për shpjegimin e shfrytëzimit nëntokësor të mineraleve të dobishme.
- S. Lita, R. Koçibelli, N. Seteri*, **Shfrytëzimi në sipërfaqe i vendburimeve të mineraleve të dobishme**, UT, Tiranë, 1985;
– Për shpjegimin e shfrytëzimit sipërfaqësor të mineraleve të dobishme.
- B. Bozic*, **Metalurgjia gvozdja**, Beograd, 1973;
– Për shpjegimin e proceseve të përtimit të hekurit dhe të çelikut.
- F. Agolli*, **Metalet me ngjyrë**, Prishtinë, 1985;
– Për shpjegimin e proceseve të përtimit të metaleve me ngjyrë.
- E. Beqiri*, **Operacionet mekanike**, UP, Prishtinë, 1995;
– Për shpjegimin e proceseve dhe operacioneve kimike.
- E. Beqiri*, **Operacionet difuzive**, UP, Prishtinë, 1988;
– Për shpjegimin e proceseve dhe operacioneve kimike.
- A. Dushi, M. Filipovic*, **Teknologjia e gomës dhe përpunimi**, Prishtinë, 1981;
– Për shpjegimin e industrisë së gomës.
- C. William, W. Ake*, **Tekstile reinforcement**, London, 1983.
– Për shpjegimin e industrisë së tekstilit.

NDËRTIMTARI

(Gjithsej 27 orë në vit)

QËLLIMET E VEÇANTA TË NXËNIES	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	UDHËZIME METODOLOGJIKE	REZULTATET E PRITSHME
<p>Kaptina 1:</p> <p>Njohja dhe informimi i nxënësve me konceptet, kërkesat dhe përparësitë themelore të këtij lëmi me qëllim krijimi të parafytyrimit të qartë dhe nxitjes së interesimit dhe kureshtjes te nxënësit për këtë drejtim.</p> <p>Njohja me hapësirën, terrenin dhe prerjet e formave të ndryshme me qëllim informimi të nxënësve, pa pretenduar arritjen e nivelit shkencor të gjeometrisë deskriptive.</p> <p>Nxënësit njihen me përpjesa të ndryshme dhe me rëndësinë e zbatimit të tyre.</p>	<p>PERGATITJA</p> <p>Trupat themelore gjeometrikë (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prizmi; - Cilindri; - Koni; -Sfera; - Ndonjë formë jo e rregullt 	<p>Nxënësit punojnë në grupe (4-6 nxënës) dhe përgatisin format themelore nga materiali i butë (argjila apo plastelina) duke i realizuar prerjet e tyre me rrafshe (folie e fortë PVC ose ndonjë material tjetër i fortë). Prerjet e fituara nxënësit duhet t'i vizatojnë suksesivisht, secili për vete, në fletore A4, pa vija, me vegla vizatimi ose me dorë të lirë, duke tentuar në pedantëri, por pa pasur nevojë të zbatojnë precizitet të tepruar.</p> <p>Nuk duhet tentuar në rezultate-produkte uniforme prandaj duhet lejuar nxënësve lirinë në të shprehur si në dimensione, ashtu edhe në prezantim.</p> <p>Veçanërisht duhet kushtuar kujdes që nxënësit të kuptojnë përpjesën e prezantimit (1:1, 1:2, 1:5).</p> <p>Pas përfundimit të detyrës, punimet ekspozohen në klasë dhe diskutohet për to (për format e tyre, madhësitë në të cilat janë punuar dhe krahasimi i tyre me ndonjë objekt të ndërtuar në qytetin tuaj, materiali me të cilin janë punuar dhe materialet e tjera me të cilat do të mund të punoheshin në ndërtimtari). Mësimdhënësi duhet të nxitë nxënësit të marrin pjesë aktive në punë dhe në diskutime, duke përdorur në diskutime terminologjinë e lëmitë në fjalë me qëllim që ata të njihen me terminologji të këtij lëmi.</p>	<p>Nxënësi tregon interesim dhe merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara. Nxënësi kupton dhe di të zbatojë përpjesën e prezantimit 1:1, 1:2, 1:5.</p> <p>Nxënësi po ashtu merr pjesë pa ngurrim në diskutime të lira gjatë analizës së punimeve të kryera, duke pasuruar kështu fjalorin me fjalë dhe terminologji profesionale të lëmit në fjalë.</p>
<p>Njohja dhe informimi i nxënësve me lëmin e gjeodezisë, konceptet</p>	<p>Gjeodezi (3)</p> <p>Tereni</p>	<p>Fillimisht nxënësit informohet qartë çka paraqesin izoipset, duke rikujtuar njohuritë nga</p>	<p>Nxënësi tregon interesim dhe me</p>

<p>kryesore dhe terminologjinë themelore të këtij lëmi.</p> <p>Njohja me instrumentet për matje gjeodezike dhe rendësia e zbatimit të tyre në ndërtimtari.</p> <p>Zgjuarja e kureshtjes dhe interesimi i nxënësit për këtë lëmi duke i informuar ata për perspektivën që mund ta kenë pasi të kryhet ky drejtim në shkollat e mesme (ku do të bëhet <i>teknik i gjeodezisë</i>) apo më tutje në fakultete (<i>inxhinier i gjeodezisë</i>).</p>	<p>Izoipset Profili</p>	<p>gjeografia e klasëve të mëparshme. Sqarime konkrete me vizatime, fotografi, harta. Pastaj, nxënësit të organizuar në grupe (4-6 nxënës) përgatisin maketa të terrenit, sipas detyrave të përgatitura më parë nga mësimdhënësi, duke përdorur kartuçin me trashësi adekuate të dhënë në përpjesën e terrenit në detyrën e dhënë. Për shkak të njohjes me forma të ndryshme të relieveve, është e preferueshme që mësimdhënësi të përgatitë detyra ku kërkohen forma të rrafshëta dhe të pjerrëta të terrenit.</p> <p>Veçanërisht duhet kushtuar kujdes që nxënësit të kuptojnë përpjesën e prezantimit 1:200, 1:250, 1:500 dhe rëndësinë e zbatimit të saj. Gjatë punës me grupe nxënësit stimulohen të diskutojnë lidhur me mundësitë e tjera të punimit të formave të terrenit (me materiale të tjera p.sh. plastelinë, mellë, allçi etj.) duke futur gjatë diskutimeve në përdorim terminologjinë e këtij lëmi dhe duke sqaruar kuptimin e tyre. Mësimdhënësi duhet të bëjë krahasime të vazhdueshme me format e ndryshme në natyrë. Sipas mundësive të shkollës, nxënësve duhet tu tregohen instrumentet për matje gjeodezike, zbatimin e tyre me shembuj konkret në obor të shkollës, me ndonjë fotografi apo skicim të thjeshtë të tyre.</p>	<p>kënaqësi merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara. Nxënësi kupton dhe di të zbatojë përpjesën e prezantimit 1:200, 1:250, 1:500. Nxënësi po ashtu merr pjesë pa ngurrim në diskutime të lira gjatë analizës së punimeve të kryera, duke pasuruar kështu fjalorin me fjalë dhe terminologji profesionale të lëmit në fjalë. Në fund të kursit ai e ka të qartë se çfarë mundësisish ofron drejtimi në fjalë.</p>
<p>Kapitla 2:</p> <p>Njohja e nxënësve me lëmin e arkitekturës, konceptet themelore dhe rëndësinë e zhvillimit të saj për të gjitha veprimtaritë në jetën e</p>	<p>Arkitekturë</p> <p>Shtëpi e banimit individual (3)</p> <p>- Projekti;</p>	<p>- Nxënësve duhet t'u prezantohen grafiki shpesh disa projekte ekzistuese (me ndihmën e projektorit, grafoskopit, letrës së ngjitur në mur apo nëse ka mundësi, kompjuterit) nga</p>	<p>- Nxënësi është i informuar për përmbajtjen e lëmit të arkitekturës;</p>

<p>gjitha veprimtaritë në jetën e njeriut. Nxitja e interesimit dhe kureshtjes për këtë drejtim dhe informimi i saktë për mundësitë e profesioneve të ndryshme në kuadër të këtij lëmi. Veçanërisht është e rëndësishme që nxënësit të kenë të qartë mundësitë që ofron ky drejtim si <i>teknik arkitekture</i>, titull ky që mund të merret pas kryerjes së shkollës së mesme. Po ashtu ata duhet të informohen për mundësitë e studimit të këtij lëmi më tutje, në fakultete.</p> <p>Njohja e nxënësve me terminologjinë e këtij lëmi me qëllim pasurimi të fjalorit të nxënësve në biseda të përditshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Muret; - Shtyllat; - Trarët; - Unazat (Serklazhet); - Themelet; - Pullazi; - OXHaku; - Shkallët; Teraca, Logja - Ancaku (Konzola); - Dyert, dritaret; - Elementet e kuzhinës; - Elementet sanitare; - Elementet e enterierit; - Situacioni dhe hortikultura; - Trashëgimia kulturore 	<p>mësimdhënësi duke biseduar për elementet dhe prezantimin grafik të tyre. Nxënësve duhet preferuar konsultimin e revistave të ndryshme që trajtojnë çështje arkitektonike, duke ua nxitur kështu kureshtjen dhe dëshirën të futen në botën e arkitekturës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse tregojnë interesim, nxënësit mund të riprodhohen një projekt të thjeshtë, me vegla vizatimi (p.sh. objekt banimi individual me dimensione 10m x 10m), nga ato që u janë prezantuar nga mësimdhënësi. Është e dëshirueshme që ndonjëri prej grupeve të zgjedhë projekt nga trashëgimia kulturore (ndonjë objekt i cili është si monument i mbrojtur nga shteti). - Në fund, grupet prezantojnë para klasës punën e tyre dhe diskutojnë për to. - Në disa raste (ndonjëri prej grupeve në klasë) me pëlqimin e mësimdhënësit, mund ta zëvendësojnë punën vizatimore me punim të maketit. Në këtë rast mësimdhënësi duhet të përcjellë dinamikën e këtij grupi më me kujdes. <p>Vërejtje: mësimdhënësi nuk do të shpjegojë vetëm teoretikisht asnjë nga këto elemente, por duhet ti konkretizojë ato në çdo rast;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Preferohen bisedat e lira me nxënësit, duke t'i dëshirat dhe prirjet e tyre për profesion. 	<p>arkitekturës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Di të lexojë dhe të prezantoj thjeshtë elementet e një projekti (muret, dyert, dritaret, shkallët, elementet e kuzhinës, sanitaret dhe mobiet); - Nxënësi tregon kureshtje dhe dëshirë të merr pjesë në të gjitha veprimtaritë e punës në grupe. - Është i informuar qartë për mundësitë që i sjell ky drejtim si profesion i tyre i ardhshëm.
<p>Njohja e nxënësve me punën konkrete në zyre projektuese me qëllim informimi më afër me profesionin në fjalë.</p>	<p>Vizitë në byro projektuese (3)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Projektimi; - Përpunimi; - Fazat (statika, elektrika, hidro, ngrohja); - Maketet; 	<p>Nxënësit të shoqëruar me mësimdhënësin, shkojnë në zyre të ndryshme projektuese. Vështrojnë, zhvillojnë biseda me të punësuarit lidhur me problemet e profesionit të tyre. Nëse shprehet interesim nga nxënësit dhe nëse ka mundësi nga ana e zyreve projektuese, nxënësit mund të asistojnë në secilën punë</p>	<p>Nxënësit kanë pasqyrë të qartë lidhur me punën që zhvillohet në byro projektuese dhe këtë e dëshmojnë gjatë diskutimeve të ndryshme.</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Fotokopjimi; - Palosja i projekteve. 	me orar të caktuar pas orëve mësimore. Në fund duhet të kërkohet nga ata që të shkruajnë ditarin e punës gjatë ditës/ditëve në zyret projektuese ku ata nxiten të shprehin prirjet e tyre për lëmin në fjalë.	
Kaptina 3: NDËRTIMTARI E LARTË DHE E ULTË			
Në këtë bllok nxënësi duhet të informohet për veprimtarinë e këtij drejtimi, përmbajtjen dhe rendësinë e tij në jetën e njeriut. Po ashtu nxënësi duhet të ketë të qartë mundësitë e profesioneve që ofron ky drejtim, veçanërisht pas kryerjes së shkollës së mesme ku do të merret titulli: <i>teknik i ndërtimtarisë</i> , por po ashtu ai duhet ta ketë të qartë edhe perspektivën pas studimeve universitare.	Konstruksionet në ndërt. (3) <ul style="list-style-type: none"> - Konstr. prej drurit; - Konstr. prej betonarmesë; -Konstr. prej çelikut; -Konstr. Alternative; - Pneumatike, plastikës; - Rrugët; - Hekurudha; - Urat; - Tunelet; Pendat. 	Mësimdhënësi zgjedh objekte me konstruksione të ndryshme ndërtimore të cilat ua prezanton nxënësve përmes fotografive, slajdeve apo vizatimeve. Aty ku ka mundësi, mund të vizitohen objektet që janë në afërsi të shkollës. Nxënësit inkurajohen në biseda të lira duke qartësuar lidhshmërinë dhe dallimin në mes të drejtimin të ndërtimtarisë dhe arkitekturës.	Nxënësi ka të qartë se me çfarë ka të bëjë drejtimi i ndërtimtarisë dhe perspektivën që i ofron. Ai po ashtu tregon kureshtje dhe interesim për çështjet e këtij drejtimi.
Nxënësit duhet të informohen më konkretisht për punën që zhvillohet në punishte.	Vizitë në punishte (3) <ul style="list-style-type: none"> - Zyra për udhëheqjen e realizimit të projektit - Interpretimi i projektit - Plani i veprimit për ndërtimin e objektit - Mbikëqyrja 	Mësimdhënësi organizon vizitën në punishte me nxënësit. Duhet pasur shumë kujdes që t'u shpjegohet nxënësve që në fillim rrezikun nga lëndimet e ndryshme në punishte. Nxënësit do të vëzhgojnë punën e realizimit, do të bisedojnë me punëtorët duke i pyetur për hollësi të punës së tyre. Nëse tregohet interesim, nxënësit mund të asistojnë në punishte edhe pas orëve të mësimin. Në fund nxënësit duhet të shkruajnë raport të ditës/ditëve në punishte, sipas udhëzimeve konkrete të mësimdhënësit.	Nxënësi merr pjesë aktive në të gjitha veprimtaritë e organizuara në klasë apo në punishte. Ai është i njoftuar me perspektivën që ofron drejtimi i ndërtimtarisë.

Kaptina: 4	ZANATET		
<p>Nxënësit duhet të informohen për shumëllojshmërinë e zanateve në lëmin e ndërtimtarisë, rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik dhe nevojën për ato zanate në tregun kosovar dhe më gjerë. Ata duhet të inkurajohen për orientimin profesional në këto zanate, duke u shpjeguar se në atë mënyrë mund të gjejnë shumë më shpejt punë dhe mund të fitojnë mjaft mirë për një jetesë cilësore. Nxënësi duhet të ketë një pasqyrë të qartë për zanatet e ndryshme dhe jo paragjykime.</p>	<p>Llojet e zanateve (3) Latues; Armues; Murator Mjeshtër i llamarinës Mjeshtër i fasadës Mjeshtër i ngjyrosjes Mjeshtër i allçisë Mjeshtër i axhustratorisë Zdrukthëtar; Mjeshtër çeramike Mjeshtër i mermerit Mjeshtër i parketit Mjeshtër i ujësjellësit dhe i kanalizimit; Hidroizolues Xhamprerës</p>	<p>Preferohet i tërë kapitulli të zhvillohet në lidhshmëri me objektin e përpunuar në kaptinën: Arkitekturë, duke përmendur dhe theksuar rëndësinë e secilit zanat në suksesshmërinë e tërësishtme të objektit arkitektonik. Po ashtu duhet dhënë rëndësi lidhjes së zanateve me të lexuarit e projekteve të prezantuara grafikisht. Preferohet të ndiqen udhëzimet e prodhuesve të specializuar dhe broshurat e tyre, duke mos u thelluar në hollësitat e ekzekutimit të punimeve.</p>	<p>Nxënësi tregon interesim dhe kureshtje për zanatet e ndryshme. Merr pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që organizohen në klasë apo në punishte.</p>
<p>Nxënësi duhet të njoftohet me profesionet e përmendura dhe specifikat e tyre duke vizituar punëtoritë e ndryshme, apo vendpunishtet ku zhvillohen punët e zanateve. Nxënësit duhet të afrohen me terminologjinë e zanateve të ndryshme.</p>	<p>Vizitë punëtorive të zanateve apo punishtes ku zhvillohen ato (3)</p>	<p>Nxënësit të shoqëruar nga mësimezhënësi, vizitojnë punëtoritë e zanateve të ndryshme. Ata zhvillojnë biseda dhe diskutime me mjeshtër të ndryshëm lidhur me zanatin e caktuar, problemet dhe përparësitë e secilit prej tyre. Nëse tregohet interesim, nxënësit mund të asistojnë në punën e zanateve, pas orarit mësimor dhe në fund të shkruajnë raport lidhur me ditën/ ditët e kaluara në punëtori.</p>	<p>Nxënësit kanë pasqyrë të qartë për zanatet, nuk kanë paragjykime dhe dijnë se cila është rëndësia e tyre në ndërtimtari dhe çka mund të ofrojnë ato nëse zgjidhen si profesion në të ardhmen. Nxënësit poashtu dëshmojnë se e kanë pasuruar fjalorin terminologjik lidhur me zanatet gjatë bisedave, diskutimeve dhe shkrimeve (raporteve).</p>

REKAPITULIM

<p>Më në fund mësimdhënësi duhet t'u ndihmojë nxënësve të rumbullakësojnë njohuritë dhe informatat e fituara në këtë periudhë.</p> <p>Atyre duhet t'u ndihmohet në organizimin e informatave në kokën e tyre me qëllim që ata të jenë në gjendje të shprehin përcaktimin e tyre profesional për të ardhmen. Por, mësimdhënësi, duhet po ashtu, në bashkëpunim me prindin, të këshillojë nxënësin lidhur me përcaktimin profesional në bazë të prirjeve dhe interesimit që ka treguar gjatë zhvillimit të këtij lëmi.</p>	<p><i>Përmbledhje e njohurive (3)</i></p>	<p>Mësimdhënësi mund të jetë i lirë në organizimin e përmbledhjes së këtij lëmi. Mund të organizojë prezantimin e punimeve që janë punuar nga nxënësit dhe të diskutohet për to; prezantimin e slajdeve apo fotove të ndryshme ku vërehen objekte që janë duke u ndërtuar dhe të diskutohet për to; vizitë shkollës së mesme profesionale për drejtimin e ndërtimtarisë.</p>	<p>Nxënësi ka pasqyrë të qartë për drejtimin: <i>Ndërtimtari</i>. Ai mund të zhvillojë diskutime konstruktive me mësimdhënësin, prindin dhe me të tjerët lidhur me përzgjedhjen e profesionit të tij si karrierë e tij e ardhme duke i ditur përparësitë, por edhe përgjegjësitë që ka ky profil.</p>
--	---	--	---

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

- E. Neufert, Projektovanje*, (përkthim nga gjermanishtja), emri në origjinal *Bauentu urfschlehe*, 1978;
Grup autorësh, Bazat e ndërtimtarisë, tekst për shkollat e mesme teknike (përkthim nga gjuha serbokroate)
K. Nela, Gjeodezia, Prishtinë;
F. Drançolli, Kulla shqiptare, Prishtinë, 2001;
G. Knezevic, Visestambene zgrade, Zagreb, 2001;
F. Doli, Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar, Prishtinë, 1993;
F. Doli, Të krijuarit dhe arkitektura, Prishtinë, 1997;
J. Antal, L.Kusnir, I. Slamen, Arhitektonska grafika, Zagreb;

Mësimdhënësit inkurajohen që po ashtu të shfrytëzojnë literaturë të lirë edhe në gjuhët e huaja, posaçërisht revista profesionale. Po ashtu është i dëshirueshëm hulumtimi i burimeve më të reja nga Interneti.

Pajisjet dhe parakushtet e preferuara për mbarëvajtjen e këtij lëmi.

Kabineti për projektion me projektor/grafoskop/ videobim. Mjete që shkolla duhet t'i sigurojë në kabinetin e punës: slajde, revista profesionale, letër, flomasterë me ngjyrë, skalperë, gërshërë, kartuç për punimin e maketeve, mellë për ushtrim, plastelinë, mjete vizatimi (tavolinat e pajisura me trekëndësha, shinë, lapsa teknike etj.).

IX. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE PROGRAMIT

IX.1

Udhëzime të përgjithshme

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, me Udhëzimin administrativ nr. 09 / 2002 rregullon zbatimin e Planit dhe të programit mësimor për klasën e nëntë (9).

Të gjithë nxënësit të cilët e përfundojnë klasën e tetë (8) kanë të drejtë ta vazhdojnë klasën e nëntë në lokalet e shkollës që e cakton Drejtoria Komunale e Arsimit, me aprovimin e MASHT.

Me kryerjen e klasës së nëntë, për nxënësit, mbaron shkollimi i obligueshëm.

Të gjithë nxënësit të cilët e përfundojnë klasën e nëntë kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e dhjetë (10) apo në klasën e parë të arsimit të mesëm të lartë, i cili nuk është i obligueshëm.

IX.2

Organizimi i procesit mësimor

Mësimi i rregullt

Plani dhe programi mësimor i klasës së nëntë duhet të realizohet për jo më pak se 35 javë prej 37 javëve të obliguara me ligj ose për 175 ditë të përcaktuara me vitin kalendarik shkollor 2002 / 03.

Në strukturën e Planit dhe të programit mësimor të klasës së nëntë (9) janë përfshirë 8 fusha mësimore, dy prej të cilave janë fusha të reja profesionale. Kjo bëhet me qëllim që nxënësve t'u mundësohet orientimi në arsimin e mesëm profesional:

1. Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë

2. Bazat e teknikës

1. *Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë*, ka lëndën mësimore me të njëjtin emër. Plani dhe programi mësimor është i organizuar në tre module apo kapituj:

- 1.1. Ekonomi

- 1.2. Bujqësi

- 1.3. Drejtësi dhe administratë

2. *Bazat e teknikës* ka lëndën me të njëjtin emër.

Plani dhe programi mësimor është i organizuar në katër module apo kapituj:

- 2.1. Elektroteknikë

- 2.2. Makineri

- 2.3. Ndërtimtari

- 2.4. Industri

Secili modul (kapitull) i lëndës **Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë** realizohet për jo më pak se 35 orë brenda vitit mësimor, kurse modulet i lëndës **Bazat e teknikës** realizohet për jo më pak se 26 orë brenda vitit mësimor.

Mësimdhënia

Procesi i mësimdhënies, për të gjitha lëndët e klasës së nëntë (9), realizohet nga mësimdhënës të kualifikuar të lëndëve përkatëse.

Nr.	Lënda	Kualifikimi i kërkuar i mësimdhënësit
1.	Gjuhë shqipe e letërsi	Profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe Profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe
2.	Gjuhë angleze	Profesor i gjuhës dhe letërsisë angleze
3.	Matematikë	Profesor i matematikës
4.	Informatikë	Profesor i matematikës – informatikës Inxhinier i informatikës
5.	Biologji	Profesor i biologjisë
6.	Fizikë	Profesor i fizikës
7.	Kimi	Profesor i kimit
8.	Gjeografi	Profesor i gjeografisë
9.	Histori	Profesor i historisë
10.	Edukatë qytetare	Profesor i sociologjisë, profesor i pedagogjisë, profesor i historisë, jurist i diplomuar
11.	Edukatë arti figurativ	Profesor i kulturës figurative
12.	Edukatë muzikore	Profesor i kulturës muzikore
13.	Edukatë fizike dhe sportet	Profesor i edukatës fizike
14.	Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë 1. Ekonomi 2. Bujqësi 3. Drejtësi	1. Ekonomist i diplomuar 2. Inxhinier i diplomuar i bujqësisë 3. Jurist i diplomuar
15.	Bazat e teknikës 1. Elektroteknikë 2. Makineri 3. Ndërtimtari 4. Industri	1. Inxh. i elektroteknikës 2. Inxh. i makinerisë 3. Inxh. i ndërtimtarisë; inxh. i arkitekturës 4. Inxh. i diplomuar i teknologjisë

Variantet e realizimit praktik të këtyre dy lëndëve të fundit (14,15) mësimore duhet të organizohen nga shkolla varësisht nga kushtet në të cilat ajo e zhvillon procesin mësimor.

Këto dy lëndë mësimore kanë nga 3 orë mësimi në javë, përkatësisht 105 orë mësimi në vit.

Vlerësimi i nxënësve për të gjitha lëndët bëhet ashtu siç është paraparë në pjesën e përgjithshme të këtij plani dhe programi, ndërsa për lëndët **Fillet e ekonomisë dhe të drejtësisë** si dhe **Bazat e teknikës**, bëhet sipas të njëjtave parime, por notimi bëhet sipas moduleve apo kapitujve nga mësimdhënësi përkatës. *Nota përfundimtare e lëndës është mesatarja e notave të moduleve përkatëse.*

Mësimi praktik

Mësimi praktik realizohet për të gjitha lëndët, të cilat në planin dhe programin e tyre mësimor e kanë të paraparë mësimin (punën) praktik. Mësimi praktik realizohet për jo më pak se 2 javë brenda vitit mësimor kalendarik.

Mësimi praktik realizohet sipas planit të përbashkët të shkollës dhe të Drejtoratit për Arsim të Komunës. Në këtë ndërmarrje përfshihen vizitat informative mësimore në institucione, në kompani, në kombinatë, në fabrika, në ndërmarrje, në punëtori etj.

Orët e mësimi praktik udhëheqen nga mësimdhënësi i lëndës përkatëse.

Përgatiti për shtyp:
SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR Prishtinë
Shtypi: *TIMEGATE* Prishtinë

Katalogimi në publikim (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi

Plani dhe programi mësimor : Për klasën IX orientuese / [Redaktorë : Isuf Zeneli...et al].- Prishtinë : Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2002 (Prishtinë : Timegate).- 224 fq.; 24 cm.

ISBN 9951-07-075-2

ISBN 9951-07-075-2